



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
NJËSIA E INSPEKTORËVE

Nr. 56/29 Prot.

Tiranë, më 29.12.2023

**Raporti i Inspektimit**

**MBI KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK TË GJYKATAVE DHE ZYRAVE TË  
PROKURORIVE PRANË TYRE MBI TRAJTIMIN E KËRKESAVE ME OBJEKT  
“LIRIM ME KUSHT”**

në zbatim të

Vendimit nr. 1, datë 11.02.2020 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë, më 29.12.2023

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

### Titulli:

Raporti i inspektimit “Mbi kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”, në zbatim të vendimit nr. 1, datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

### Data e përgatitjes:

28/12/2023

### Përgatitur:

Znj. Elena Pelushi, znj. Joana Asimi, znj. Alma Tafani, znj. Lindita Male,  
z. Julian Zonja

### Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

z. Artur Metani

Miratoi  Ndryshoi  Ktheu

Dt. 29/12/2023



## I. Pjesa hyrëse

Me vendimin nr. 1, datë 11.02.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht””, i ndryshuar dhe shtuar me vendimet nr. 1/1, datë 20.02.2020, nr. 43, datë 03.10.2022 dhe nr. 58, datë 25.10.2023, është vendosur zhvillimi i inspektimit tematik pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor<sup>1</sup>: Shkodër, Lezhë, Tropojë, Kukës, Durrës, Elbasan, Kavajë, Tiranë, Krujë, Mat, Fier, Berat, Vlorë, Korçë; Gjirokastër, dhe Gjykatave të apelit: Durrës; Tiranë; Korçë; Vlorë; Shkodër dhe Gjirokastër, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht” për periudhën 01.01.2017 – 31.01.2020.

Vendimi për kryerjen e inspektimit është nxjerrë në mbështetje të nenit 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat “ë” dhe “k” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe bazuar në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektimi tematik është vendosur të zhvillohet në gjykatat dhe zyrat e prokurorive të sipërpërmendura, nisur nga tematika e inspektimit e lidhur me territorin brenda të cilave janë ngritur dhe funksionojnë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku vuajnë dënimin persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Inspektimi tematik është vlerësuar të ketë karakter njohës dhe konstatues lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht” nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit si dhe zyrat e prokurorive pranë tyre në raport me respektimin e legjislacionit material dhe procedural në fuqi. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i këtij inspektimi tematik është vlerësuar edhe si një mjet për identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjellje të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm do të justifikonin fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Inspektimi përfshiu një numër të madh vendimesh të trajtuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat e apelit, subjekte të këtij inspektimi dhe Gjykata e Lartë, si dhe praktikat e ekzekutimit të prokurorisë lidhur me këto vendime.

Vendimet gjyqësore të trajtuara u fokusuan brenda një periudhe 3 vjeçare, duke u evidentuar zbatimi i legjislacionit procedural dhe material lidhur me kërkesat me objekt “Lirimi me kusht” dhe është shtrirë edhe tej këtij afati kryesisht për vendimet e Gjykatës së Lartë.

Për kryerjen e inspektimit, në mbështetje të pikës 4, të vendimit nr. 1, datë 11.02.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ngarkuar fillimisht, e vetmja inspektore znj. Marsela Pepi. Në vazhdim duke qenë se organika e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është

---

<sup>1</sup> Ky emërtim nuk përdoret më, për shkak të riorganizimit të gjykatave dhe prokurorive, por për efekt të këtij inspektimi do të përdoret terminologjia e periudhës së inspektimit.

plotësuar me burime njerëzore shtesë, si dhe duke patur në konsideratë kompleksitetin dhe volumin e dokumentacionit shkresor të administruar, faktin e lejes së lindjes së inspektore përgjegjëse znj. Marsela Pepi, është vlerësuar e nevojshme që në vendimin nr. 1, datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të bëhen disa shtesa dhe ndryshime, me anë të vendimit nr. 43, datë 03.10.2022. Sipas këtij vendimi në pikën 4.1 të tij është parashikuar se për kryerjen e inspektimit ngarkohen inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtëme:

- a) Inspektore znj. Lindita Ziguri për çështjet, të cilat i përkasin Gjykatës së Apelit Durrës, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Kavajë; Durrës; Elbasan, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Inspektorja është ndihmuar nga ndihmësinpektorët znj. Loreta Jashari, z. Nertil Kanina dhe znj. Elisa Mezini.
- b) Inspektore znj. Alma Tafani për çështjet, të cilat i përkasin Gjykatës së Apelit Korçë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Inspektorja është ndihmuar nga ndihmësinpektorët znj. Aulona Levani dhe z. Renato Tushaj.
- c) Inspektore znj. Elena Pelushi dhe inspektore znj. Joana Asimi për çështjet, të cilat i përkasin Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Inspektorët janë ndihmuar nga ndihmësinpektorët z. Julis Zebi, z. Andi Gumaj dhe z. Vildan Kaloshi.
- d) Inspektori z. Julian Zonja për çështjet, të cilat i përkasin Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë; Krujë; Gjirokastrë dhe Mat, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Inspektori është ndihmuar nga ndihmësinpektorët znj. Migena Bako, znj. Alma Troshani.
- e) Inspektori z. Besnik Maho për çështjet, të cilat i përkasin Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Kukës; Tropojë; Lezhë, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Inspektori për shkak të largimit të tij nga funksioni, është zëvendësuar me inspektorët znj. Alma Tafani dhe z. Julian Zonja për çështjet që i përkasin rretheve gjyqësore Tropojë dhe Lezhë si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, dhe me inspektorët znj. Lindita Ziguri dhe znj. Joana Asimi për çështjet që i përkasin rretheve gjyqësore Shkodër dhe Kukës, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre. Të dy grupet e inspektorëve për rrethet gjyqësore përkatëse kanë shqyrtuar edhe çështjet që i përkasin Gjykatës së Apelit Shkodër dhe zyrës së prokurorisë pranë saj. Inspektori është ndihmuar nga ndihmësinpektorët z. Armand Dumani, znj. Ornela Shurdhaj.

Gjithashtu, me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektore znj. Elena Pelushi.

Kryerja e inspektimit është bazuar në vendimin e inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: "Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë gjykatave apo prokurorive subjekt inspektimi me qëllim administrimin e dokumentacionit, objekt inspektimi". Kjo fazë

ka përfshirë hapat si më poshtë:

- a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga të gjithë inspektorët;
  - b) Janë hartuar shkresat drejtuar gjykatave dhe zyrave të prokurorisë objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga të gjithë inspektorët;
  - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas gjykatave dhe zyrave të prokurorisë përkatëse dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
- a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
  - b) Vlerësuar se duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar sipas grupeve të inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:
- a) Hartimi i raporteve të veçanta nga secili prej grupeve të inspektimit për prokuroritë që janë përfshirë në inspektim, sipas një model/strukture të njëjtë;
  - b) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

- 4) Faza e katërt: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit”.

Referuar fazave të përcaktuara në vendimin për kryerjen e inspektimit, në fazën e parë të inspektimit mbi bazën e kërkesave për informacion, nga ana e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë janë administruar të dhënat përkatëse. Më konkretisht janë administruar të dhënat nga:

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 2354 prot., datë 28.10.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/29 prot., datë 31.10.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. shkresa me nr. 2464 prot., datë 07.11.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/66 prot., datë 09.11.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
3. shkresa me nr. 418 prot., datë 06.03.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 68/17 prot., datë 11.03.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 824 prot., datë 28.02.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. shkresa me nr. 4771/1 prot., datë 31.10.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/42 prot., datë 02.11.2022;
3. shkresa me nr. 2464 prot., datë 07.11.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/66 prot., datë 09.11.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
4. shkresa me nr. 418 prot., datë 06.03.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 68/17 prot., datë 11.03.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 149/1 prot., datë 27.02.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 68/10 prot., datë 02.03.2020;
2. shkresa me nr. 1632/1 prot., datë 27.10.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/41 prot., datë 01.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 2476 prot., datë 28.02.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 69/9 prot., datë 02.03.2020;
2. shkresa me nr. 12349 prot., datë 03.11.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/52 prot., datë 03.11.2022.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 933 prot., datë 06.03.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 219/2, datë 09.03.2020;
2. shkresa me nr. 3553 prot., datë 02.11.2021, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/60, datë 07.11.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 236/1 prot., datë 22.03.2020, regjistruar pranë ILD-së me nr. 220/3 prot., datë 24.04.2020;
2. shkresa me nr. 4188/1 prot., datë 31.10.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1820/45 prot., datë 02.11.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**



1. shkresa me nr. 354/1 prot., datë 04.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 219/3 prot., datë 09.03.2020;
2. shkresa me nr. 1561/1 prot., datë 07.11.2020, e protokolluar në ILD me nr. 2820/68 prot., datë 09.11.2022;
3. shkresa me nr. 3645/2 prot., datë 31.01.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/5 prot., datë 02.02.2023;
4. shkresa me nr. 264/1 prot., datë 17.03.2023, e protokolluar në ILD më 27.03.2023.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 716/1 prot., datë 06.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 220/1 prot., datë 09.03.2020;
2. shkresa me nr. 2974/1 prot., datë 10.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 220/2 prot., datë 11.03.2020;
3. shkresa me nr. 3645/1 prot., datë 16.11.2022, e protokolluar në ILD me nr. 1820/78 prot., datë 21.11.2022;
4. shkresa me nr. 3645/3 prot., datë 24.03.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/19 prot., datë 30.03.2023.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 363 prot., datë 03.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 219/1 prot., datë 06.03.2020;
2. shkresa me nr. 11314/1 prot., datë 12.22.2022, e protokolluar në ILD me nr. 2820/82 prot., datë 27.12.2022;
3. shkresa me nr. 273/1 prot., datë 23.01.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/6 prot., datë 23.01.2023.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. Shkresa me nr. 2474/1 prot., datë 10.03.2020, e protokolluar me nr. 220/2 prot., datë 11.03.2020;
2. shkresa me nr. 9622/1 prot., datë 04.11.2022, e protokolluar në ILD me nr. 2820/61 prot., datë 07.11.2022;
4. shkresa me nr. 879/1 prot., datë 26.01.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/4 prot., datë 31.01.2023;
5. shkresa me nr. 2017/1 prot., datë 23.02.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/10 prort., datë 27.02.2023.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**



1. shkresa me nr. 897/1 prot., datë 06.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 68/15 prot., datë 06.03.2020;
2. shkresa me nr. 5958/1 prot., datë 27.10.2022, e protokolluar në ILD me nr. 2820/38 prot., datë 31.10.2022;
3. shkresa me nr. 7637/1 prot., datë 05.01.2023, e protokolluar në ILD me nr. 2820/91 prot., datë 09.01.2023;
4. shkresa me nr. 2005/1 prot., datë 03.04.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/21 prot., datë 05.04.2023.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 1307/1 prot., e protokolluar në ILD me nr. 69/14 prot., datë 06.03.2020;
2. shkresa me nr. 8208/1 prot., datë 25.11.2022, e protokolluar në ILD me nr. 2820/82 prot., datë 01.12.2022;
3. shkresa me nr. 2418/1 prot., datë 05.04.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/22 prot., datë 07.04.2023.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 59 prot., datë 26.02.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. 68/9 prot., datë 28.02.2020;
2. shkresa me nr. 237 prot., datë 26.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. 2820/9 prot., datë 28.10.2022;
3. shkresa me nr. 237/1 prot., datë 04.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. 2820/69 prot., datë 09.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 1255 prot., datë 28.02.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. 69/7 prot., datë 02.03.2020;
2. shkresa me nr. 4821 prot., datë 08.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar në ILD me nr. 2820/72 prot., datë 10.11.2022:

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. Shkresa me nr. 108 prot., datë 17.02.2020, regjistruar në ILD me nr. 68/1 prot., datë 19.02.2020;
2. Shkresa me nr. 731/1 prot., datë 27.10.2022, regjistruar në ILD me nr. 2820/27 prot., datë 28.10.2022;



**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. Shkresa me nr. 180 prot., datë 14.02.2020, regjistruar në ILD me nr. 69/1 prot., datë 18.02.2020;
2. Shkresa me nr. 731/1 prot., datë 27.10.2022, regjistruar në ILD me nr. 2820/27 prot., datë 28.10.2022;

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 273 prot., datë 04.03.2020, regjistruar në ILD me nr. 68/16 prot., datë 10.03.2020;
2. shkresa me nr. 1356/1 prot., datë 11.11.2022, regjistruar në ILD me nr. 2820/77 prot., datë 16.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 1446/1 prot., datë 26.02.2020, e protokolluar në ILD me nr. 69/13 prot., datë 09.03.2020;
2. shkresë me nr. 3986/2 prot., A. B, datë 06.07.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/25 prot., datë 07.07.2023;
3. shkresa me nr. 3986/1 prot., datë 29.05.2023, e protokolluar në ILD me nr. 56/24 prot., datë 31.05.2023.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 235 prot., datë 29.03.2020, regjistruar në ILD me nr. 68/18 prot., datë 04.05.2020;
2. shkresa me nr. 733/1 prot., datë 04.11.2022, regjistruar në ILD me nr. 2820/71 prot., datë 10.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa nr. 2578/1 prot., datë 27.09.2023 e protokolluar në ILD me nr. 56/20 prot., datë 03.04.2020.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 267/1 prot., datë 03.11.2022, regjistruar në ILD me nr. 2820/64 prot., datë

07.11.2022;

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 454/1 prot., datë 03.03.2020, e protokolluar në ILD me nr. 69/12 prot., datë 09.03.2020;
2. shkresa me nr. 3014/1 prot., datë 17.11.2022 e protokolluar me nr. 2820/79 prot., datë 21.11.2022.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 204 prot., datë 28.02.2020, protokolluar në ILD me nr. 68/12 prot., datë 03.03.2020;
2. shkresa me nr. 1022 prot., datë 03.11.2022, protokolluar në ILD me nr. 2820/62 prot., datë 07.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 2521/1 prot., datë 31.10.2022, protokolluar në ILD me nr. 2820/49 prot., datë 03.11.2022;
2. shkresa me nr. 340 prot., datë 20.2.2020, protokolluar në ILD me nr. 69/2 prot., datë 24.2.2020.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 169 prot., datë 04.09.2020, protokolluar në ILD nr. 68/21 prot., datë 25.09.2020;
2. shkresa me nr. 437 prot., datë 02.11.2022, protokolluar në ILD me nr. 2820/63 prot., datë 07.11.2022.

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 34 prot., datë 17.02.2020, protokolluar në ILD me nr. 68/2 prot., datë 19.2.2020;
2. shkresa me nr. 35 prot., datë 26.02.2020, protokolluar në ILD me nr. 68/14 prot., datë 04.03.2020;
3. shkresa me nr. 231 prot., datë 01.11.2022, protokolluar në ILD me nr. 2820/54 prot., datë 04.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 108/1 prot., datë 27.2.2020, protokolluar në ILD me nr. 69/3 prot., datë 28.02.2020;
2. shkresa me nr. 568/1 prot., datë 31.10.2022 protokolluar në ILD në datën 31.10.2022;

**Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 423/1 prot., datë 20.08.2020, protokolluar në ILD me nr. 68/20 prot., datë 20.08.2020;
2. shkresa me nr. 2591/1 prot., datë 09.11.2022, protokolluar në ILD me nr. 2820/73 prot., datë 10.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**


1. shkresa me nr. 4406 prot., datë 16.04.2020, protokolluar në ILD me nr. 69/15 prot., datë 21.05.2020;
2. shkresa me nr. 14508 prot., datë 02.11.2022/1, protokolluar në ILD me nr. 2820/44 prot., datë 02.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 1062/1 prot., datë 26.02.2020, e Gjykatës së Apelit Tiranë, protokolluar në ILD me nr. 68/7 prot., datë 27.02.2020;
2. shkresa me nr. 6615/4 prot., datë 09.11.2022, e Gjykatës së Apelit Tiranë, protokolluar në ILD me nr. 2820/70 prot., datë 09.11.2022;
3. shkresa me nr. 6615/6 prot., datë 10.11.2022, e Gjykatës së Apelit Tiranë, protokolluar në ILD me nr. 2820/75 prot., datë 11.11.2022;
4. shkresa me nr. 6615/4 prot., datë 31.10.2022, e Gjykatës së Apelit, protokolluar në ILD me nr. 2820/40 prot., datë 31.10.2022;
5. shkresa me nr. 169/1 prot., datë 28.02.2020, e Prokurorisë së Apelit, protokolluar në ILD me nr. 69/8 prot., datë 02.03.2020.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 166/1 prot., datë 19.02.2020, e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, protokolluar në ILD me nr. 68/3 prot., datë 21.02.2020.



**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 171 prot., datë 28.02.2020 e Gjykatës së Apelit Durrës, regjistruar pranë ILD-së me nr. 68/13 prot., datë 04.03.2020;
2. shkresa me nr. 1011/1 prot., datë 24.10.2022 e Gjykatës së Apelit Durrës, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/35 prot., datë 26.10.2022;
3. shkresa me nr. 262 prot., datë 02.03.2020 e Prokurorisë së Apelit Durrës, regjistruar pranë ILD-së me nr. 69/10 prot., datë 03.03.2020;
4. shkresa me nr. 1065/1 prot, datë 10.11.2022 e Gjykatës së Apelit Durrës, regjistruar pranë ILD-së me nr. 2820/76 prot., datë 14.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 199 prot., datë 27.04.2020, e Gjykatës së Apelit Vlorë, protokolluar në ILD me nr. 68/19 prot., datë 04.05.2020;
2. shkresa me nr. 1010/1 prot., datë 01.11.2022, e Prokurorisë së Apelit Vlorë, protokolluar në ILD me nr. 2820/47 prot., datë 03.11.2022;
4. shkresa me nr. 880/1 prot., datë 01.03.2023 e Gjykatës së Apelit Vlorë, protokolluar në ILD me nr. 56/11 prot., datë 02.03.2023.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 305 prot., datë 26.02.2020, e Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në ILD me nr. 68/8 prot., datë 18.02.2020;
2. shkresa me nr. 1012 prot., datë 01.11.2022, e Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në ILD me nr. 2820/53 prot., datë 04.11.2022;
3. shkresa me nr. 137 prot., datë 05.03.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në ILD me nr. 69/11 prot., datë 06.03.2020;
4. shkresa me nr. 700 prot., datë 04.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në ILD me nr. 2820/67 prot., datë 09.11.2022.

**Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër/Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

1. shkresa me nr. 310/2 prot., datë 27.02.2020 e Gjykatës së Apelit Shkodër, regjistruar në ILD me nr. 68/11 prot., datë 02.03.2020;
2. shkresa me nr. 129/1 prot., datë 26.02.2020 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, protokolluar në ILD me nr. 69/4 prot., datë 28.02.2020;
3. shkresa me nr. 1376/1 prot., datë 09.11.2022 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, protokolluar në ILD me nr. 2820/74 prot., datë 11.11.2022;

4. shkresë me nr. 310/1 prot., datë 20.02.2020 e Gjykatës së Apelit Shkodër, regjistruar në ILD me nr. 68/5 prot., datë 24.02.2020.

**Nga Gjykata e Lartë, janë marrë informacionet/dokumentacioni si më poshtë:**

- 1.shkresa me nr. 16 prot., datë 06.01.2023, protokolluar në ILD me nr. 56 prot., datë 10.01.2023;
- 2.Shkresa me nr. 6977/1 prot., datë 05.01.2023, protokolluar në ILD me nr. 2820/90 prot., datë 09.01.2023;
3. Shkresa me nr. 6977/1 prot., datë 22.02.2023, protokolluar në ILD me nr. 5619 prot., datë 24.02.2023;
4. shkresa me nr. 65/1 prot., datë 12.01.2023, protokolluar në ILD me nr. 56/2 prot., datë 13.01.2023;
5. shkresa me nr. 6977/1, datë 22.02.2023, protokolluar në ILD me nr. 56/9 prot., datë 24.2.2023.

Dokumentacioni si më sipër, ku edhe është mbështetur kryerja e inspektimit, përfshin në pjesën më të madhe vendimet gjyqësore, shoqëruar me kapakun e dosjes dhe RIV (regjistri i veprimeve) të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore subjekte të këtij inspektimi, kopje e ankimit/eve, kopjet e vendimeve të gjykatave më të larta, vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, tabelat standarte të kërkesave me objekt “Lirim me kusht” që i përket viteve 207, 2018, 2019 dhe janar 2020, praktika të urdhërave për ekzekutimin e vendimit penal, si dhe për disa çështje është vlerësuar edhe marrja e fashikujve gjyqësorë përkatës.

Të dhënat e administruara janë përqëndruar në dokumentacionin që përfshin RIV (Regjistrimi i veprimeve) për dokumentimin e shortit; kapakun e dosjes e cila pasqyron të dhëna të përgjithshme lidhur me nr. e çështjes, datën e regjistrimit, gjyqtarin, seancat, datën dhe numrin e vendimit, si dhe mbi ankim në Apel; vendimin gjyqësor që përfshin edhe të dhënat mbi palët pjesëmarrëse në gjykim dhe pretendimet e tyre, arsyetimin e gjykatës dhe konkludimin përkatës, disponimin e gjykatës si dhe të dhëna nëse ndaj vendimit është ushtruar ankim; dokumentimin e ankimit si dhe vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit ku përfshihen të dhëna mbi pretendimet e ankuesit, si dhe arsyetimin/konkludimin e Gjykatës së Apelit së bashku me disponimin; dokumentimin e faktit nëse ka patur rekurs dhe vendimin përkatës të Gjykatës së Lartë; praktikën e ekzekutimit të prokurorit lidhur me vendimet për pranimin e kërkesës me objekt “Lirim me kusht”.

Gjatë kësaj faze të administrimit të dokumentacionit të duhur, nga ana e inspektorëve është proceduar edhe me përsëritje kërkesash për të bërë të mundur marrjen e informacionit të plotë në funksion të realizimit të inspektimit. Dhe në funksion të kësaj, krahas kërkesave të përsëritura, nga ana e inspektorëve është proceduar edhe me vizita në zyrat përkatëse të prokurorisë dhe gjykatës, dhe më konkretisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatën e Apelit dhe Prokurorinë e Apelit Korçë, ku janë mbajtur edhe procesverbalet përkatëse për marrjen e dokumentacionit.



Pas administrimit të të dhënave, në vijim të fazave të përcaktuara të inspektimit është kaluar në përpunimin e tyre dhe studimin e tyre, me qëllim mundësimin e hartimit të raporteve individuale të inspektimit. Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit dhe informacionit të grumbulluar, këto faza kanë marrë më shumë kohë sesa ajo e parashikuar.

Fokusi i inspektimit lidhur me trajtimin e kërkesave “lirim me kusht”, u përqëndrua kryesisht në pesë drejtime kryesore: i) respektimi i legjislacionit material dhe procedural; ii) ecuria e gjykimit të kësaj kërkesë në një gjykatë më të lartë; iii) qëndrimi i organit të akuzës në seancë gjyqësore dhe ankimet apo rekursat ndaj vendimeve për të cilat gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë disponuar; iv) procedurat për caktimin e gjyqtarit apo prokurorit për trajtimin e kërkesave me objekt: “Lirim me kusht”; v) analizimit të procedurave të ekzekutimit të vendimit penal me objekt “Lirim me kusht” në funksion të evidentimit të fakteve nëse ka patur vonesa apo zbatim të gabuar të legjislacionit procedural në fuqi në drejtim të cënimit të lirisë individuale të individit.

Analiza e këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale me nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar, në fuqi për periudhën e inspektimit; Rekomandimit R (2003) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me lirin me kusht; si dhe në Praktikën e Gjykatës së Lartë, Praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe në doktrinën.

Në funksion të qëllimit të inspektimit, analiza e të dhënave të administruara është bërë duke u proceduar me secilën prej gjykatave të rretheve gjyqësore/zyrave të prokurorisë në veçanti, për të kaluar në analizimin e tyre në kuadër të Gjykatës së Apelit në juridiksionin e të cilit përfshihej secila prej gjykatave të rretheve gjyqësore, në vazhdim në analizimin në nivel të Gjykatave të Apeleve dhe për të përfunduar në Gjykatën e Lartë.

Nga inspektimi i kryer, u konstatuan praktika të ndryshme të zbatuara lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirimi me kusht”, në drejtim të zbatimit të neneve 471, 477 të K. Pr. Penale dhe 64 të K. Penal, si dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015. Këto praktika evidentuan qëndrime të ndryshme, jo vetëm të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apeleve midis tyre, por edhe midis gjyqtarëve të të njëjtës gjykatë, si edhe qëndrime të ndryshme edhe nga Gjykata e Lartë referuar vendimmarrjeve të saj të viteve 2021-2023 të lidhur me vendimmarrjet e subjekteve të inspektimit, brenda periudhës së inspektimit. Gjithashtu qëndrime të ndryshme u konstatuan edhe midis zyrave të prokurorisë në drejtim të qëndrimit të tyre në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, dhe në drejtim të ekzekutimit të këtyre vendimeve.

Referuar këtyre konstatimeve nga ana e grupit të inspektimit, është konkluduar si e nevojshme nxjerrja e rekomandimeve në funksion të unifikimit të praktikave të ndjekura nga gjykatat dhe prokuroritë, si në drejtim të evidentimit të praktikave në përputhje me jurisprudencën lidhur me zbatimin e dispozitave mbi bazën e të cilave trajtohen kërkesat me objekt “lirim me kusht”, ashtu edhe në drejtim të propozimeve në fushën legjislative për të mundësuar qartësimin e



dispozitive procedurale dhe materiale, për magjistratët të cilët merren me interpretimin dhe zbatimin e tyre.


## II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Referuar periudhës së inspektimit 01.01.2017 deri në 31.01.2020, inspektimi përfshiu trajtimin me vendim të 2514 kërkesave me objekt "Lirim me kusht", me shpërndarje si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor /viti	2017	2018	2019	2020	Në total
Berat	11	33	34	0	78
Durrës	44	45	34	1	124
Elbasan	149	147	130	3	429
Fier	249	252	225	10	736
Gjirokastrë	17	18	24	0	59
Kavajë	56	91	82	1	230
Korçë	64	76	63	4	207
Krujë	18	22	27	2	69
Kukës	0	0	0	0	0
Lezhë	99	92	51	1	243
Mat	20	25	14	2	61
Tiranë	17	29	25	1	72
Tropojë	2	8	4	0	14
Shkodër	0	6	142	10	158
Vlorë	7	3	24	0	34
Në total	755	846	854	41	2514

Mbi bazën e këtyre kërkesave, janë iniciuar gjykimet në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe më pas në gjykatat më të larta në rast ankimi apo rekursi, për t'u proceduar më tej nga prokurori me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit.

Ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Berat, Fier dhe Vlorë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Durrës, Elbasan dhe Kavajë, janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Durrës, ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Tropojë, Shkodër dhe Lezhë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Krujë, Mat, Tiranë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe ndaj vendimeve të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Korçë. Më konkretisht të dhënat si më poshtë:



Gjykata e Apelit /viti	2017	2018	2019	2020	Në total
Durrës	27	29	31	6	92
Gjirokastrë	2	3	2	0	7
Korçë	17	17	20	0	54
Tiranë	17	18	15	2	52
Shkodër	21	36	31	2	90
Vlorë	38	87	131	0	256
Total					

Nga të dhënat e administruara lidhur me rekursat e shqyrtuara<sup>2</sup> nga Gjykata e Lartë, referuar vendimeve të dhëna sipas viteve nga Gjykatat e Apeleve, rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Gjykata e Apelit/viti	2017	2018	2019	2020	Në total
Durrës	2	0	0	0	0
Gjirokastrë	0	0	0	0	0
Korçë	2	0	1	0	3
Tiranë	1	0	0	0	1
Shkodër	0	0	0	0	0
Vlorë	0	2 <sup>3</sup>	0	0	0

Vendimet e Gjykatës së Lartë janë përkatësisht të vitit 2017 në 2 raste dhe të tjerat janë të viteve 2022, 2023.

➤ **Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht”, nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër, Tropojë, Kukës, Lezhë, që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, ka rezultuar se:**

#### **1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit.**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkuar në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundërvajtje penale. Gjithashtu asnjë prej kërkuarve në fjalë, të dënuar me burgim për krime nuk kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim të përjetshëm.

<sup>2</sup> Duhet theksuar se këto të dhëna janë referuar periudhës në të cilat ka përfunduar shqyrtimi i vendimeve gjyqësore, nga inspektorët.

<sup>3</sup> Çështjet në fjalë rezultojnë të jenë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, por nuk janë zbardhur vendimet deri në datën e përpilimit të këtij raporti.



Të dënuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-së që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt "lirim me kusht" për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Shënkoll-Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt "lirim me kusht" për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Reç-Shkodër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt "lirim me kusht" për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Tropojë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës për periudhën e inspektimit nuk rezulton të jetë trajtuar asnjë kërkesë me objekt "lirim me kusht".

Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre dhe më pas si rregull me hedhjen short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjykuese e përbërë nga një gjyqtar.


Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë evidentuar 5 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt "lirim me kusht". Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë evidentuar 3 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt "lirim me kusht". Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë evidentuar 4 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt "lirim me kusht".

Shortimi elektronik është përdorur si procedurë caktimi gjyqtari edhe në rastet e ndryshimit të gjyqtarit, për shkak të miratimit të heqjes dorë të gjyqtarit të caktuar me shortin fillestar, si edhe në rastet e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.

#### **1.1. Në rastin e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë/tretë, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Në këtë gjykatë rezultojnë 44 të dënuar që kanë përsëritur kërkesën "lirim me kusht", pas një vendimmarrje të mëparshme për të njëjtën kërkesë. Nga këto raste evidentohet se për 33 prej tyre shqyrtimi i kërkesës së dytë dhe të tretë i të njëjtit kërkues, i ka shkuar pa procedurë shorti, të njëjtit gjyqtar që kishte shqyrtuar kërkesën e parë dhe nuk kishte dhënë vendim përfundimtar (pranim/rrëzim). Ky rregull është respektuar edhe atëherë kur kërkesa e dytë/tretë i është caktuar një gjyqtari tjetër me short elektronik dhe me urdhër të Kryetarit të Gjykatës është bërë ndryshimi. Në dy nga këto raste, është evidentuar sipas RIV tek arsyeja e ndryshimit me



gjqqtarin e përcaktuar pa short duke i kaluar çështjen automatikisht gjyqtarit që ka disponuar me pushim, bazohet në vendim të KLD-së për procedurat e ndarjes së çështjeve me short<sup>4</sup>.

Në 5 raste të tjera, rezulton se kërkesa e dytë/tretë, përmes shortit elektronik i është kaluar një gjyqtari të ndryshëm nga gjyqtari që kishte përfunduar me vendim pushim/deklarim i papranueshëm kërkesën e parë dhe për to është vendosur sërish me të njëjtin lloj disponimi.

Dhe në 5 rastet e tjera, kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim mbi themelin e kërkesës/rrëzim kërkesë nga gjykata e rrethit gjyqësor. Në këto raste, për shqyrtimin e kërkesës së përsëritur konstatohet se gjyqtari rezulton të jetë i ndryshëm. Gjyqtari për këto raste rezulton të jetë caktuar me short elektronik dhe në ato raste kur ka qenë i njëjtë me gjyqtarin që ka vendosur mbi themelin e kërkesës, nga ana e gjyqtarit është proceduar me heqje dorë duke u vazhduar me short elektronik dhe caktuar gjyqtari tjetër. Nga këto raste, evidentohet se në 2 prej tyre gjyqtarët kanë vendosur për kërkesën e dytë deklarim i papranueshëm dhe për 3 të tjerat gjyqtarët kanë vendosur për kërkesën e dytë 2 rrëzim dhe 1 pranim.

Në rastet<sup>5</sup> në të cilat gjyqtarët kanë vendosur deklarim i papranueshëm, rezulton se shkak i këtij disponimi është konstatimi prej tyre i mosrespektimit të kërkesave të nenit 477/2 të K. Pr. Penal, referuar afatit 6 mujor nga dita që vendimi i rrëzimit ka marrë formë të prerë. Për këto raste rezulton se gjyqtarët pas arsytimit të kërkesave të nenit 477/2 të K. Pr. Penale, kanë arsyetuar për mënyrën e disponimit referuar nenit 471 të K. Pr. Penale, ndërsa tek një vendim gjyqtari ka argumentuar disponueshmërinë në referencë të paragrafit 2 të dispozitës në fjalë<sup>6</sup>.

Në rastet në të cilat gjyqtarët kanë vendosur rrëzim, rezulton se shkak i këtij disponimi në 1 rast ka qenë për shkak të mosplotësimit të kriterëve të veçanta dhe në rastin tjetër<sup>7</sup> për shkak të konstatimit të mosplotësimit të afatit të përsëritjes së kërkesës referuar parashikimeve të nenit 477/2 të K. Pr. Penale. Parashikimi në fjalë, është bërë objekt analize edhe nga gjyqtari që ka vendosur rrëzim për shkak të kriterëve të veçanta, por duke e arsyetuar se është në përputhje me këtë afat<sup>8</sup>. Referuar të dhënave të këtij rasti të fundit, konstatohet se kërkesa e përsëritur nuk ka respektuar afatin 6 mujor nga dita që vendimi i rrëzimit ka marrë formë të prerë. Kështu vendimi i parë i rrëzimit me nr. 159, datë 11.12.2017 ka marrë formë të prerë më datë 26.12.2017 dhe kërkesa e dytë për të cilën është marrë vendimi i dytë i rrëzimit me nr. 113, datë 19.09.2018, është regjistruar më datë 08.06.2018.

Në rastin e pranimit<sup>9</sup>, në vendim nuk rezulton të jetë analizuar kushti i parashikuar në nenin 477/2 të K. Pr. Penale për afatin e kërkuar lidhur me kërkesën e përsëritur. Kjo e fundit rezulton të jetë paraqitur në mosprespektim të afatit 6 mujor të parashikuar sipas dispozitës në fjalë. Kështu vendimi i parë i rrëzimit nr. 05, datë 26.02.2018, ka marrë formë të prerë më datë

<sup>4</sup> Shiko RIV me numër akti 49, datë 20.02.2017, nr. 176, datë 27.09.2017.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 93, datë 11.05.2018, nr. 41, datë 02.05.2019.

<sup>6</sup> vendimi nr. 41, datë 02.05.2019.

<sup>7</sup> vendimi nr. 175, datë 24.12.2018.

<sup>8</sup> Vendimi nr. 113, datë 19.09.2018.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 165, datë 01.10.2018.

13.03.2018 dhe kërkesa e përsëritur që është shqyrtuar në themel dhe vendosur pranimi më datë 01.10.2018, është regjistruar më datë 27.08.2018. Për këtë rast do të vlerësohet verifikimi i mëtejshëm në kuadër të ligjit nr. 96/2016 duke patur në konsideratë periudhën kohore dhe konstatimin e rasteve të tjera të së njëjtës natyrë sipas parashikimeve të nenit 117 të të njëjtit ligj.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Në këtë gjykatë nuk ka rezultuar në asnjë rast që ndonjëri prej të dënuarve të ketë paraqitur një kërkesë më shumë se një herë.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër rezultojnë 12 të dënuar të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”, pas një vendimmarrje të mëparshme për të njëjtën kërkesë.

Nga këto raste, evidentohet se vetëm në 2 raste<sup>10</sup>, kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim mbi themelin e kërkesës/rrëzimit kërkesë nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe gjyqtarët për shqyrtimin e kërkesës së dytë janë caktuar me short elektronik, të cilët kanë vijuar dhe përfunduar gjykimin me vendim jopërfundimtar. Gjithashtu për një nga këto raste rezulton se, kërkuesi ka paraqitur edhe një kërkesë të tretë, ku sërish gjyqtari është caktuar nëpërmjet shortit elektronik dhe ka vijuar me dhënien e një vendimi jo përfundimtar. Për këto raste, nga shorti për caktimin e gjyqtarit, është konstatuar se për rastin e kërkuetit që ka paraqitur dy kërkesa, gjyqtari që ka gjykuar të dy kërkesat ka qenë i njëjti dhe në rastin e kërkuetit që ka paraqitur tre kërkesa, gjyqtari ka qenë i njëjtë në shqyrtimin e kërkesës së parë ku është disponuar me vendim themeli/përfundimtar dhe të tretë ku është disponuar me vendim jopërfundimtar, ndërsa kërkesa e dytë është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër.

Në rastin e kërkuetit që ka paraqitur tre kërkesa është konstatuar, se kërkesa e dytë dhe e tretë rezulton të jetë paraqitur pa kaluar 6 muaj nga dita që vendimi i rrëzimit për kërkesën e parë kishte marrë formë të prerë. Kështu vendimi nr. 32 (406), datë 29.01.2019 që ka vendosur rrëzimin ka marrë formë të prerë më datë 14.10.2019 kur është vendosur mospranim ankimi nga Gjykata e Apelit dhe kërkesa e dytë është paraqitur më datë 08.02.2019 e përfunduar më datë 04.03.2019 nga gjykata e rrethit gjyqësor, duke vazhduar me kërkesën e tretë të paraqitur më datë 15.09.2019 dhe për të cilën është përfunduar më datë 02.10.2019 nga i njëjti gjyqtar i gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte gjykuar kërkesën e parë. Në vendimmarrjet lidhur me kërkesën e dytë dhe të tretë gjyqtarët kanë proceduar me deklaram të papranueshëm për shkak të heqjes dorë, sipas nenit 471/5 të K. Pr. Penale pa trajtuar kërkesën e përsëritur.

---

<sup>10</sup> Rasti i parë vendimi nr. 304 (2091), datë 23.04.2019, marrë formë të prerë më datë 08.05.2019 dhe vendimin nr. 69 (452), datë 28.01.2020 për të cilën paraqitja e kërkesës mban datën 24.12.2019.

Rasti i dytë vendimin nr. 32 (406), datë 29.01.2019, me formë të prerë datë 14.10.2019, vendimi nr. 204 (1105), datë 04.03.2019, për të cilën paraqitja e kërkesës mban datën 08.02.2019 dhe vendimi nr. 806 (4866), datë 02.10.2019, për të cilën paraqitja e kërkesës mban datën 15.09.2019.



Për 10 raste, evidentohet se shqyrtimi i kërkesës së dytë është bërë pas vendosjes me vendim jo përfundimtar/deklarim i papranueshëm i kërkesës dhe gjyqtarët për shqyrtimin e kërkesës së dytë janë caktuar me short elektronik të cilët kanë vijuar dhe përfunduar gjykimin. Për 6 nga këto raste, me anë të shortit elektronik është caktuar i njëjti gjyqtar dhe për të tjerët me anë të shortit elektronik është caktuar gjyqtar tjetër, i cili ka vijuar me gjykimin.

## **2. Palët pjesëmarrëse në gjykim**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Referuar vendimeve gjyqësore, konstatohet se në gjykimet me objekt “lirim me kusht” si palë pjesëmarrëse thirren kërkuesi, prokurori, dhe Institucioni i Vuajtjes së Ekzekutimeve Penale (IEVP). Gjatë gjykimit, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Referuar vendimeve gjyqësore, konstatohet se në gjykimet me objekt “lirim me kusht” si palë pjesëmarrëse janë thirrur në përgjithësi kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Vuajtjes së Ekzekutimeve Penale (IEVP). Por ka patur edhe gjyqtarë të cilët në vendimmarrjet e tyre kanë thirrur edhe Shërbimin e Provës, i cili është paraqitur. Gjatë gjykimit, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konstatohet se në gjykimet me objekt “lirim me kusht” si palë pjesëmarrëse thirren kërkuesi dhe prokuroria. Nuk rezulton që të jenë thirrur palë të tjera në gjykim. Gjatë gjykimit, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

#### **2.1. Kërkuesi si palë pjesëmarrëse:**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë, kërkuesi është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në të gjitha llojet e mënyrës së disponimit të gjykatës.

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, kërkuesi është i asistuar nga mbrojtës. Nga të dhënat e kësaj gjykate në të gjitha vendime gjyqësore që është vendosur pranimi i kërkesës, si i vetmi lloj disponimi në gjykatën në fjalë, konstatohet që avokati është caktuar kryesisht nga gjykata.

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë, kërkuesi është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në të gjitha llojet e mënyrës së disponimit të gjykatës. Në rastet e vendimeve ku është vendosur pranimi/rrëzimi i kërkesës për lirim me kusht rezulton se në shumicën e rasteve kur kërkuesi ka qenë i asistuar nga mbrojtësi, rezulton se avokati ka qenë i zgjedhur nga vetë kërkuesi dhe në raste të tjera i

caktuar nga gjykata. Në rastet e vendimeve ku është disponuar me deklaram i papranueshëm, në shumicën e rasteve kërkuesi është pa praninë e një mbrojtësi.

## **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Lidhur me prokurorin si palë pjesëmarrëse, nga vendimet gjyqësore është konstatuar se në të gjitha rastet, nga gjykata është proceduar me pjesëmarrjen e prokurorit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Lidhur me prokurorin si palë pjesëmarrëse, nga vendimet gjyqësore është konstatuar se në të gjitha rastet, nga gjykata është proceduar me pjesëmarrjen e prokurorit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është konstatuar se në 33 raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto raste kanë qenë kur nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për heqje dorë dhe nga gjykata është disponuar me deklaram i papranueshëm të kërkesës.

## **2.3. Gjykata e Apelit Shkodër**

Referuar gjykimeve në Gjykatën e Apelit Shkodër, konstatohet se janë thirrur për të marrë pjesë kërkuesi dhe prokurori. Kërkuesi në të gjitha vendimmarrjet konstatohet se ka qenë i asistuar nga një mbrojtës. Nuk evidentohen të dhëna për thirrjen e IEVP-së apo të Shërbimit të Provës.

## **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, konstatohet se për periudhën 01.01.2017 – 02.07.2018 në këtë zyrë prokurorie procedohej me caktimin e prokurorit, i cili ishte ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë. Për këtë periudhë kohe prokuror i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, ka qenë vetëm 1. Nga data 02.07.2018 deri më datë 31.01.2020, për caktimin e prokurorit është proceduar me caktim nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë duke marrë në konsideratë ngarkesën e secilit prokuror, ku nga vendimet rezulton se kanë qenë 4 prokurorë, si përfaqësues të prokurorisë të përditësuar në katër vite. Kjo ndarje bëhej në momentin e paraqitjes së njoftimit nga Gjykata, duke sigluar emrin e prokurorit përkatës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, konstatohet se për periudhën objekt inspektimi në këtë zyrë prokurorie procedohej me caktimin e një prokurori, i cili bënte pjesë në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale. Për këtë

periudhë kohe seksioni i ekzekutimeve të vendimeve penale është përbërë nga dy prokurorë, dhe caktimi i prokurorit përfaqësues bëhej me anë të ndarjes së çështjeve në gjykim kërkesë “lirim me kusht”, në mënyrë të barabartë.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, konstatohet se për periudhën objekt inspektimi në këtë zyrë prokurorie procedohej me caktimin e një prokurori, i cili bënte pjesën në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale. Për këtë periudhë kohe përbërja e prokurorëve të seksionit të ekzekutimeve të vendimeve ka qenë i ndryshëm. Kështu për periudhën 02.02.2017 – 26.10.2018 në përbërje të këtij seksioni ka qenë 1 prokuror, dhe në vazhdim deri në datë 26.07.2019 ka qenë i përbërë nga 3 prokurorë. Pas kësaj date dhe deri në përfundim të periudhës objekt i këtij inspektimi përbërja ka ndryshuar sërish në 1 prokuror. Për periudhën kur seksioni i ekzekutimeve të vendimeve penale përbëhej nga 3 prokurorë, caktimi i tyre për përfaqësimin e prokurorisë në gjykimet e kërkesave me objekt “lirim me kusht”, bëhej duke u proceduar me ndarjen me short manual.

### **Prokuroria e Apelit Shkodër**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Apelit, është proceduar me anë të shortit manual ndërmjet prokurorëve që konstatohen se kanë marrë pjesë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, në periudhën e inspektimit. Kjo procedurë shorti zhvillohej mbi bazën e listave të shpallura për muajin përkatës nga Gjykata e Apelit Shkodër lidhur me proceset gjyqësore ku përfshiheshin edhe kërkesat e të dënuarve me objekt “Lirim me kusht”. Mbi bazën e këtyre listave Prokuroria e Apelit Shkodër me short manual ose sipas shortit të Gjykatës së Apelit sipas trupave gjyqësore (për shkak të kombinimit të orareve të seancave gjyqësore) ka ndarë çështjet e themelit dhe çështje administrative penale (përfshirë edhe gjykimin e kërkesave për lirim me kusht) sipas prokurorëve.

### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë:**

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve 243, për 36 prej tyre është disponuar me pushim kërkesë, për 94 prej tyre deklarim i papranueshëm, për 10 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 90 pranim kërkesë.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Nga vendimet gjyqësore të administruara, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë regjistruar 14 kërkesa me objekt “lirim me kusht” dhe për të gjitha këto nga ana e gjykatës është vendosur pranim.



## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve 158, në 1 vendim është disponuar me pushim kërkesë, në 62 prej tyre me deklaram i papranueshëm, për 41 me rrëzim kërkesë dhe për 54 me pranim kërkesë.

### **4.1. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkesë, konstatohet se:**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë/tërhiqet nga gjykimi i çështjes penale me objekt; *"Lirim me kusht"* i dënuari nuk është paraqitur/është liruar.

Vendimet e pushimit në fjalë rezultojnë se i përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019. Në vitin 2017 janë 35 vendime, nga të cilat 5 i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Këto 5 vendime rezultojnë të jenë marrë për shkak se kërkuari ka hequr dorë/tërhequr nga kërkesa për lirim me kusht.

Për rastet e disponimit me pushim, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj nenet 387/2, 470-480 të K. Pr. Penale, që evidentohen kryesisht para ndryshimit të ligjit me nr. 35/2017 dhe më pas evidentohet vendosja e bazës ligjore referuar nenit 471 të K. Pr. Penale.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër konstatohet 1 rast për të cilën është proceduar me vendim pushimi dhe arsyeja e këtij disponimi është për shkak se i dënuari nuk është paraqitur se është liruar. Vendimi i përket vitit 2019. Bazë ligjore e përdorur janë nenet 378- 390 të K. Pr. Penale.

### **4.2. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me "deklarimin e papranueshëm të kërkesës", konstatohet se:**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë:**

Në këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është në pjesën më të madhe për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt; *"Lirim me kusht"*, dhe veçanarisht për shkak se i dënuari nuk është paraqitur pa arsye në 1 rast, për shkak se kërkesa është paraqitur brenda afatit 6 mujor nga marrja e vendimit për rrëzimin e kërkesës me vendim gjyqësor të formës së prerë në 1 rast



dhe se nuk ka kryer periudhën minimum të vuajtjes së dënimit në 3 raste. Vendimet në fjalë i përkasin viteve 2018 dhe 2019, dhe nga ana e gjykatës është vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet 64, 387, 471, dhe 417, të Kodit të Procedurës Penale.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Në këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt; “Lirim me kusht” në 47 raste, si dhe për faktin se i dënuari nuk është paraqitur pa një shkak të justifikuar në gjykim në 15 raste. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet në fjalë i përkasin viteve 2018, 2019 dhe 2020. Në vitin 2017 është vetëm një vendim i tillë dhe i përket periudhës pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale sipas ligjit nr. 35/2017.

Konstatohet në këtë gjykatë se një gjyqtar në 10 vendimet që ka dhënë, ku në pikën e parë të dispozitivit ka vendosur deklarinimin e papranueshëm të kërkesës, në pikën e dytë ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj kërkesë penale (bazë ligjore është vendosur neni 471 i K. Pr. Penale). Vendimet janë të viteve 2019 dhe 2020.

#### **4.3. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/ “pranim i kërkesës për lirim me kusht”, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, gjykatat kanë disponuar pas analizimit si të kriterëve objektive, ashtu edhe të kriterëve subjektive në raport me rrethanat e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përmbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për përfitimin e lirit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimit të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përmbushja e këtyre kriterëve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun. Referuar këtij shkakui, konstatohet se:

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Evidentohen edhe vendime rrëzimi për shkak të mosplotësimit të kohës së vuajtur të dënimit që kërkohet në nenin 64 të K. Penal për të përfituar lirim me kusht.





Nga vendimet e rrëzimit të gjykatës së rrethit gjyqësor që janë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, konstatohet se në asnjë rast nuk ka ndryshim vendimi.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Veçanarisht në 8 prej vendimeve të rrëzimit të kërkesës, konstatohet se gjykata ka argumentuar faktin e të qenit përsëritës për një krim të kryer me dashje, nga të cilët në dy raste krahas argumentit të mosplotësimit të arsyeve të veçanta.

Nga vendimet e rrëzimit të gjykatës së rrethit gjyqësor që janë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, konstatohet se vetëm në 2 raste është ndryshuar vendimi duke pranuar kërkesën e kërkuarit për lirim me kusht. Lidhur me këto raste ku shkak i rrëzimit ka qenë për shkak të mospërmbushjes së arsyeve të veçanta, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe, është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruara në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm.

#### **4.3.1. Kriteri subjektiv**

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Lezhë, Tropojë dhe Shkodër, është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se të gjitha vendimet kanë një standard arsyetimi duke iu referuar qëndrimin të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehur me vendimin nr. 2/2015, në lidhje me shprehjen “arsye të veçanta”, duke bërë interpretimin në pika: i) qëllimin e institutit të limit me kusht; ii) interpretimit tekstual të dispozitës, si dhe iii) hapat e nevojshme që gjykatat duhet të mbajnë në konsideratë në gjykimet me objekt: “Lirim me kusht”, administrimi i raporteve të IEVP dhe të shërbimit të provës, natyra e veprës penale, qëndrimi i personit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, kushtet familjare, si dhe në përfundimin e planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e tij në shoqëri dhe qëndrimi që ka mbajtur i dënuari në raport me veprën penale të kryer.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin dhe konkludimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkuar, konstatohet se në rast mosdakortësie nga ana e prokurorit apo kërkuarit është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur

kryesisht në të njëjtat prova të administruara gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

#### **4.3.2. Kriteret objektive**

##### **4.3.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit**

Llogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, referuar interpretimit lidhur me parashikimin e nenit 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit sipas parashikimeve të nenit 64/1 të K. Penal për të përfituar lirimim me kusht, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit sipas parashikimeve të nenit 64/1 të K. Penal për të përfituar lirimim me kusht, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**


Nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit sipas parashikimeve të nenit 64/1 të K. Penal për të përfituar lirimim me kusht, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

Referuar vendimmarrjeve të kësaj gjykate, është evidentuar në një rast<sup>11</sup> mosplotësimi i kohës së vuajtjes së dënimit për përfitimin e lirimimit me kusht, sipas të dhënave të rezultuara nga vendimi gjyqësor dhe për të cilën është vlerësuar kryerja e verifikimit përkatës për të konkluduar për ecurinë e mëtejshme në kuadër të shkeljes disiplinore.

##### **Gjykata e Apelit Shkodër**

---

<sup>11</sup> Vendimi nr. 434 (3790), datë 17.07.2019 ka marrë formë të prerë më datën 01.08.2019



Lidhur me qëndrimet sa më sipër në drejtim të interpretimit të dispozitës për përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të lirimit me kusht, në Gjykatën e Apelit Shkodër është konstatuar ndjekja e të dy praktikave sa më sipër nga trupa gjyqësore të njëjta. Kështu nga pesë trupa gjyqësore, dy trupa i referohen për përlllogaritjen e periudhës në fjalë, masës së dënimit të dhënë nga gjykata dhe tre të tjerët i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita në Kodin Penal.

Konstatimet sa më sipër janë hasur në rastin e arsytetimeve që Gjykata e Apelit ka bërë gjatë shqyrtimit të vendimmarrjeve të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe për të cilat ka vendosur lënie në fuqi, apo rrëzim/pranim, ndërsa nuk evidentohet të ketë patur ankim lidhur me këtë interpretim.

#### **4.3.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal bëhet deri datën e vendimit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës “lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, bëhet deri në datën e vendimit.

##### **Gjykata e Apelit Shkodër**

Konstatimet sa më sipër janë hasur në rastin e arsytetimeve që Gjykata e Apelit ka bërë gjatë shqyrtimit të vendimmarrjeve të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe për të cilat ka vendosur lënie në fuqi, apo rrëzim/pranim, ndërsa nuk evidentohet të ketë patur ankim lidhur me këtë interpretim.

##### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Lezhë, Tropojë, Shkodër, dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, nuk ka patur ankimime

lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatave të rretheve gjyqësore përsa i përket kufijve të përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

#### **4.3.2.2. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tropojë dhe Shkodër, nga gjyqtarët është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP në të gjitha ato raste kur ka pasur kohë pune. Dhe nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton se nuk ka patur raste të përfshirjes në dinamikë kohë pune të kryer nga kërkuesi/i dënuari dhe për këtë arsye nuk ka patur një vlerësim në drejtim të përfshirjes së kësaj periudhe në masën e dënimit të përlllogaritur për efekt të nenit 64/1 të K. Penal, për t'i mundësuar kërkuesit përfitimin nga ky institut.

Lidhur me përlllogaritjen e kohës së punës, nuk ka patur ankimime në Gjykatën e Apelit. Të gjitha vendimet në fjalë të evidentuara për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kanë marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore, pa u ushtruar ankim.

Dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë nga 3 vendime ku është evidentuar përfshirja e kohës së punës në dinamikën e kërkuesit, konstatohet se 2 prej tyre kanë marrë formë të prerë për shkak mosankimimi dhe në 1 rast që është ankimuar konstatohet se shkak i ankimit ka qenë lidhur me përlllogaritjen e uljes së dënimit me vendim gjyqësor. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit<sup>12</sup> kur ka trajtuar shkakun e ankimit, duke përlllogaritur edhe kohën e vuajtjes së dënimit për efekt të nenit 64 të K. Penal, konstatohet se e ka konsideruar se koha e punës përfshihet si përfitim në kohën e vuajtjes së dënimit që do të duhet të përfshihet në përlllogaritjen e vuajtjes së dënimit për përfitimin e lirimit me kusht. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit ka shqyrtuar diskutimin e ngritur në shkaqet e ankimit të prokurorit ndër të tjera edhe lidhur me kohën e vuajtjes së dënimit  $\frac{3}{4}$  referuar parashikimeve të nenit 64/1 të K. Penal, me argumentin se: “Sa i përket pjesës së vuajtur të dënimit rezulton se me vendimin nr. 63, datë 01.11.2017, Gjykata e Shkallës së Parë Tropojë ka vendosur uljen e dënimit në masën 9 (nëntë) muaj, vendim që është konsideruar i pabazuar nga IEVP Tropojë dhe për këtë arsye ata kanë kërkuar në gjykatë rivendosjen në afat të të drejtës së apelitit të vendimit të mësipërm, çështje akoma e pashqyrtuar nga gjykata. Prandaj kërkesa nuk duhet të pranohet pasi kërkuesi i bie të ketë vuajtur më pak se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të dhënë”. Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e saj, lidhur me këtë shkak ka arsyetuar se: “Në fashikullin gjyqësor ka të dhëna kontradiktore në lidhje me kohën e vuajtur në burgim nga kërkuesi. Kështu sipas shkresës së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë, me nr. 2014 prot., datë 12.12.2017, rezulton ky i dënuar duhet të vuajë edhe 3 (tre) vite e (pesë) muaj burgim. Koha e dënimit që i është ulur me vendim

<sup>12</sup> vendimin nr. 74, datë 26.03.2018 të Gjykatës së Apelit që ka vendosur ndryshimin e vendimit me nr. 112, datë 21.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe rrëzimin e kërkesës.

gjykate është 1 (një) vit burgim, ulje këto që mund të realizohen vetëm një herë në vit me maksimumi 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ky shtetas ka përfituar ulje dënimi: - më datë 12.12.2013 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, - më datë 05.02.2015, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, - më datë 02.03.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, - më datë 20.04.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, nuk është dokumentuar se si në intervalin kohor 22.09.2017 deri më 21.12.2017 (për tre muaj), në dy data të ndryshme, dinamika e vuajtjes së dënimit nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë, nga ky i dënuar ka një diferencë të dënimit të vuajtur me afro një vit burgim. Për rrjedhojë arrihet në përfundimin se nuk provohet që ky shtetas të ketë vuajtur 3/4 e dënimit me burgim që i janë dhënë për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/2 dhe 278/2 të Kodit Penal”.

#### 4.3.2.4. Kushtet ndaluese

Nga vendimet e administruara të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Lezhë, Shkodër dhe Tropojë është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me **kushtet ndaluese “përsëritës” dhe për shkak të veprës penale të parashikuar** në nenit 64 të K. Penal. Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuarit të administruara nga *vërtetimi i gjendjes gjyqësore*, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimit.

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Shkodër, Lezhë nga inspektimi i vendimeve ku është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nuk konstatohen raste të lirimit në shkelje të kushteve ndaluese.

Ndërsa nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është evidentuar një rast ku nga Gjykata e Apelit Shkodër<sup>13</sup> është konstatuar zbatim i gabuar i nenit 64 të K. Penal nga gjykata e rrethit gjyqësor, pasi kërkuar rezultonte të ishte i dënuar edhe për një vepër tjetër penale pas dënimit për të cilin kishte përfituar lirim me kusht. Në vendimin gjyqësor të gjykatës së rrethit<sup>14</sup> evidentohet një vendim gjyqësor që pasqyronte dënimin e kërkuarit dhe mbi këtë vendim janë dhënë edhe konkluzionet e prokurorit, si dhe disponuar nga gjykata me vendim. Vendimi i dytë rezulton i evidentuar në ankimin e drejtuesit të prokurorisë dhe mandej edhe në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit. Lidhur me këtë rast, do të vlerësohet verifikimi i mëtejshëm në kuadër të ligjit nr. 96/2016 duke patur në konsideratë statusin e magjistratit, periudhën kohore dhe konstatimin e rasteve të tjera të të njëjtës natyrë sipas parashikimeve të nenit 117 të të njëjtit ligj.

Do të bëhen verifikimet përkatëse pasi të disponohet edhe dosja e plotë e dinamikës së vuajtjes së dënimit të administruar gjatë gjykimit të shkallës së parë.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 33, datë 13.2.2019, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 237, datë 03.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Për kriterin në fjalë, nga vendimet gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Lezhë, Shkodër dhe Tropojë, janë evidentuar në 1 rast pranimit dhe 2 raste rrëzimi që të jenë bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit Shkodër.

**Rasti i pranimit**<sup>15</sup> bën fjalë për kërkuesin i cili përveç dënimit për të cilin kishte paraqitur kërkesë për “lirim me kusht”, rezultonte i dënuar edhe për një krim tjetër të parashikuar nga neni 137/1 i K. Penal. Prokurori ka mbajtur qëndrimin për rrëzimin e kërkesës, ndërsa gjykata e ka pranuar kërkesën ndër të tjera, duke e konsideruar se kërkuesi nuk është në kushtet e ndalimit, të të qënit përsëritës, me arsyetimin se: *“Gjykata konstaton se në rastin konkret vepra penale për të cilën është dënuar i pandehuri është kryer në të njëjtën periudhë kohore kur i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën ka kërkuar lirimin para kohe me kusht por nga ana e Prokurorisë nuk është vendosur bashkimi i të dy procedimeve në një të vetëm. Rezulton se në kohën kur është dënuar për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike” parashikuar nga neni 137/1 i K. Penal i pandehuri ka qenë i paraburgosur për procedimin penal të nisur në lidhje me dënimin objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor. Nga ana tjetër me termin “përsëritës” duhet kuptuar jo kryerja nga ana e të pandehurit e më shumë se një veprë penale por kryerja e një veprë pas dënimit për një veprë tjetër të kryer më parë. Kjo pasi nëse në të njëjtën kohë i pandehuri kryen dy vepra penale të pavarura nga njëra tjetra ai nuk mund të mund të konsiderohet përsëritës apo i dënuar më parë. Sa më sipër Gjykata vlerëson se logjika e ligjvënësit në përcaktimin e ndalimit për një të dënuar përsëritës nga përfitimi i lirit para kohe me kusht ka qenë ndalimi i përfitimit të atyre personave të cilët pavarësisht se kanë marrë një dënim më parë, pas marrjes së këtij dënimi kanë kryer përsëri vepra penale duke treguar kështu se as dënimi i parë nuk ka patur efekt riedukues ndaj tyre. Ndërkohë në rastin në shqyrtim nuk jemi para kësaj situate, i dënuari ka kryer të dy veprat penale në të njëjtën periudhë kohore pavarësisht se të dy procedimet nuk janë bashkuar në një të vetëm kërkuesi është dënuar gjatë kohës kur ka qenë në masë sigurimi për procedimin e dytë. Në këto kushte gjykata çmon se i dënuari nuk mund të konsiderohet si përsëritës në kuptim të nenit 64 të K. Penal. Interpretimi i kundërt do të përjashtonte nga përfitimi i këtij instituti ata të pandehur që në një vendim penal dënohen për dy vepra penale”*. Ndaj vendimit prokurori ka ushtruar ankim për shkaqe të mosplotësimit të kriterëve subjektive, ndërsa nuk referohet tek kushti i ndalimit “përsëritës”. Gjykata e Apelit<sup>16</sup> ka trajtuar këtë pjesë arsyetimi të kushtit përsëritës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe ka konkluduar se vendimi i dënimit të mëparshëm për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i K. Penal, *“shërben për të përcaktuar faktin se i dënuari nuk krijon besimin tek gjykata se ai mund të integrohet në shoqëri dhe të mos kryejë vepra të tjera penale”* dhe në vazhdim pasi ka argumentuar mosprovueshmërinë e rrethanave të veçanta, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit.

#### **Lidhur me rastet e rrëzimit:**

<sup>15</sup> Vendimi nr. 37 (209), datë 21.01.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>16</sup> Vendimi nr. 155, datë 19.06.2019, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Rasti i parë bën fjalë për kërkuesin i cili përveç dënimit në vitin 2018 për të cilin kishte paraqitur kërkesë për “lirim me kusht”, rezultonte nga çertifikata e gjendjes gjyqësore, i dënuar edhe për katër vepra penale të parashikuara nga nenet 242 i K. Penal (në vitin 2009 me gjobë), 290/1 i K. Penal (2011 me gjobë) dhe 297 i K. Penal (2011, me 4 muaj e 10 ditë burgim), të identifikuar sipas vendimit, si kundravajtje dy dhe krim vepra tjetër penale. Prokurori ka mbajtur qëndrimin për rrëzimin e kërkesës, dhe gjykata<sup>17</sup> ka pranuar qëndrimin e prokurorit për rrëzimin e kërkesës duke arsyetuar mbi mospërmbushjen e kriterit përsëritës dhe të arsyeve të veçanta. Lidhur me kriterin përsëritës gjykata arsyeton se: “Në lidhje me plotësimin e **kushtit të tretë**, Gjykata vlerëson kërkuesi, rezulton të jetë dënuar për krime të tjera të kryera me dashje, e cila rezulton të jetë kriter ndalues sipas nenit 64 të K. Penal, fakt i provuar në gjykim nëpërmjet vërtetimit të gjëndjes gjyqësore nr. 7 prot., datë 25.02.2019, ku janë të pasqyruara katër dënime, midis tyre edhe për vepra penale të parashikuara si krime. (neni 290/1). Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se jo të gjitha veprat penale, për të cilat është dënuar kërkuesi parashikohen si krime, por janë kundravajtje penale, fakti që ai është dënuar disa herë tregon për një rrezikshmëri shoqërore të tij, e cila përbën një tregues se ky shtetas mund të kryejë vepra të tjera penale në të ardhmen. Gjykata vlerëson se i dënuari nuk i plotëson kushtet që parashikohen nga neni 64 i K. Penal, të analizuar sa më sipër. Nga ana tjetër, përveç ekzistencës së kriterit ndalues, qënia i dënuar më parë, duke vlerësuar rrethanat e kryerjes së veprës penale, për të cilat është dënuar kërkuesi, marzhet e larta të dënimit veprës penale për të cilën është dënuar, si dhe në mungesë të rrethanave të veçanta familjare, apo shëndetësore, të tij apo familjes, gjykata çmon se duhet rrëzuar kërkesa e tij me objekt “lirim para kohe me kusht”. Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Shkodër<sup>18</sup> që pas shqyrtimit, e ka lënë në fuqi vendimin duke u mbështetur në argumentin e mosplotësimin të arsyeve të veçanta. Në drejtim të kriterit “përsëritës”, Gjykata e Apelit arsyeton se: “Në rastin konkret, Gjykata e Apelit duke e gjetur të drejtë konkluzionin dhe argumentet e gjykatës së shkallës së parë, konstaton se kërkuesi nuk paraqet arsye të veçanta për lirimin e tij me kusht si dhe nuk ka provuar se me dënimin përkatës është rehabilituar dhe i është arritur qëllimi i dënimit penal. ... Referuar dosjes së të dënuarit nga verifikimi në lidhje me kriteret e nenit 64 të K. Penal rezultoi se: ... Së dyti në lidhje me paragrafin e fundit të këtij neni, pra me kushtin përjashtues që kërkuesi s’duhet të jetë përsëritës për krime të kryera me dashje sipas vërtetimit të gjëndjes gjyqësore nr. 7, prot., datë 25.02.2019 si dhe akteve të përfshira në dosjen e tij personale të dërguar nga IEVP rezulton se kërkuesi është dënuar gjithsej katër herë nga gjykatat shqiptare, ku konkretisht tre dënime penale para dënimit përkatës me 4 vjet e 8 muaj burgim, të cilin ai është duke vuajtur dhe për të cilin kërkon lirim para kohe me kusht. Nga analiza e këtyre veprave rezulton se ai është dënuar për veprat penale të “Mosbindje ndaj urdhërit të policisë së rendit publik, parashikuar nga neni 242 i K. Penal, për veprën “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 190/1 i K. Penal, dhe për veprën penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit” neni 297 i K. Penal. Gjykata e Apelit konstaton se pavarësisht se ky i dënuar nuk është përsëritës për krime të kryera me dashje (pasi është dënuar për dy kundravajtje penale të kryera me dashje dhe për një krim të kryer nga

<sup>17</sup> vendimi nr. 108 (2120), datë 24.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>18</sup> vendimin nr. 191 (50-2019-1415), datë 17.07.2019

pakujdesia), pra nuk ka ndalim formal, këto dënime tregojnë që pavarësisht dënimeve të gjykatave dhe qëllimit të tyre jo vetëm ndëshkues por edhe edukues dhe rehabilitues, ky shtetas nuk ka arritur të riintegrohet në shoqëri, por ka përsëritur veprimet e kundraligjshme, duke u dënuar sërish tashmë për një veprë penale më të rëndë si ajo e “Trafikimit të lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283/a/1-22 i K. Penal. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se kryerja e këtyre veprave penale në mënyrë të përsëritur brenda një periudhe të shkurtër, jo vetëm që tregon se ai nuk ka mundur dot të edukohet nga dënimet e mëparshme, por ngre dyshime për arritjen e qëllimit të dënimit aktual që po vuhet si dhe tregon për një rrezik apo mundësi të kryerjes së veprave të tjera penale. Për këto arsye, Gjykata e Apelit konkludon se shtetasi duhet të vuajë plotësisht dënimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”.

Rasti i dytë bën fjalë për një kërkues i cili ishte dënuar me disa vendime penale për të cilat ishte proceduar me bashkim dënimesh dhe ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht nga vuajtja e dënimit të bashkuar. Prokurori ka mbajtur qëndrimin për rrëzimin e kërkesës për shkak të të qenit përsëritës dhe kjo është pranuar edhe nga gjykata<sup>19</sup>, e cila ka arsyetuar se: “... Nga shqyrtimi i materialit të mësipërm provues, Gjykata vlerëson se prej tij provohet se kërkuesi është përsëritës në kryerjen me dashje 3 herë të veprës penale të parashikuar në nenin 140 të Kodit Penal dhe një herë për krimin e parashikuar me nenin 323/1 të Kodit Penal. Pavarësisht se është bërë bashkimi i dënimeve të dhëna ndaj kërkuesit në lidhje me veprat e mësipërme penale të kryera prej tij, Gjykata vlerëson se kërkuesi vërtetohet se është përsëritës 4 herë për krime të kryera me dashje prej tij. Për rrjedhojë, për shkak se kërkuesi vërtetohet se është përsëritës për krime të kryera me dashje, për Gjykatën lirimi me kusht i tij nuk lejohet, por ndalohet nga paragrafi i 3 i nenit 64 të Kodit Penal, në të cilin parashikohet: “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100”. Më tej, Gjykata vlerëson se është e panevojshme të analizohen elementet e tjerë të kërkuara nga neni 64 i Kodit Penal, që kanë të bëjnë me vuajtjen e masës së dënimit të kërkuar nga kjo dispozitë prej kërkuesit, sjelljen e tij, edukimin e tij, etj., por duhet mjaftuar me konstatimin e faktit që kërkuesi është përsëritës për krime të kryera me dashje e për shkak të këtij kriteri ndalues kërkesa e tij për lirim me kusht nuk duhet pranuar”. Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Shkodër<sup>20</sup> që pas shqyrtimit, e ka lënë në fuqi vendimin duke u mbështetur në të njëjtin argument si edhe gjykata e rrethit gjyqësor duke e konsideruar kërkuesin në kushtet ndaluese “përsëritës”, me arsyetimin: “Duke trajtuar kërkesën e paraqitur nga i dënuari, në lidhje me sa është provuar gjatë gjykimit dhe me sa parashikohet nga dispozita e lartpërmendur, në nenin 64 të K. Penal, arrihet në përfundimin se ajo është e pabazuar në ligj dhe në prova, prandaj çmohet se nuk ka vend për ndryshimin e këtij vendimi. Konkretisht, pa trajtuar fare elementët subjektivë siç janë pjesa e vuajtur deri tani e dënimit me burgim, arrihet në përfundimin se kërkuesi nuk plotëson kushtet ligjore për përfitim, nuk plotëson kriteret e

<sup>19</sup> vendimi nr. 62, datë 09.06.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

<sup>20</sup> Vendimi nr. 142, datë 17.05.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër.



*përcaktuara në nenin 64 të K. Penal, pasi rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, i dënuar disa herë sipas vendimeve penale të administruara në gjykim. Kështu, Gjykata e Apelit e gjen të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë se nga shqyrtimi i materialit të mësipërm provues, Gjykata vlerëson se prej tij provohet se kërkuesi është përsëritës në kryerjen me dashje 3 herë të veprës penale të parashikuar në nenin 140 të Kodit Penal dhe një herë për krimin e parashikuar me nenin 323/1 të Kodit Penal. Pavarësisht se është bërë bashkimi i dënimeve të dhëna ndaj kërkuesit në lidhje me veprat e mësipërme penale të kryera prej tij, Gjykata vlerëson se kërkuesi vërtetohet se është përsëritës 4 herë për krime të kryera me dashje prej tij. Për rrjedhojë, për shkak se kërkuesi vërtetohet se është përsëritës për krime të kryera me dashje, për Gjykatën lirimi me kusht i tij nuk lejohet, por ndalohet nga paragrafi i 3 i nenit 64 të Kodit Penal. Po kështu, Gjykata e Apelit e gjen të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë se Gjykata vlerëson se është e panevojshme të analizohen elementët e tjerë të kërkuesit nga neni 64 i Kodit Penal, që kanë të bëjnë me vuajtjen e masës së dënimit të kërkuesit nga kjo dispozitë prej kërkuesit, sjelljen e tij, edukimin e tij, etj., por duhet mjaftuar me konstatimin e faktit që kërkuesi është përsëritës për krime të kryera me dashje e për shkak të këtij kriteri ndalues kërkesa e tij për lirim me kusht nuk duhet pranuar”.*

#### **4.3.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”**

##### **Koha e kushtit/provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**


Në vendimet e pranimit të lirimimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se vetëm në 3<sup>21</sup> vendime nga 85 vendime pranimi, të jetë proceduar me përcaktimin e kohës së provës më të madhe se koha e mbetur e pavuajtur e dënimit me burgim, ndërsa në vendimet e tjera është proceduar me përcaktimin e kohës së provës të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim.

Të 3 vendimet rezultojnë të jenë dhënë nga 1 gjyqtar, dhe i përkasin tre viteve përgjatë periudhës së inspektimit. Përsa i përket arsyetimit për përcaktimin e kësaj kohe e cila rezulton të jetë e njëjtë 2 vjet ndërkohë që kërkuesve u kishin mbetur rreth 7 muaj në maksimum, konstatohet se nga ana e gjyqtarit argumentohet lidhur me kohën e pavuajtur të dënimit, llojin e veprës penale dhe kërkesat e neneve 60, pikat 9 e 10 dhe 61 të K. Penal.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Në vendimet e pranimit të lirimimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se vetëm në 1 vendim nga 14 vendime është proceduar me përcaktimin e kohës së provës të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim, ndërsa në vendimet e tjera është proceduar me përcaktimin e kohës së provës më të madhe ku në 3 prej tyre koha e provës është përcaktuar sa dyfishi i kohës së dënimit të mbetur pa vuajtur.

<sup>21</sup> Vendimi nr. 156, datë 13.10.2017; vendimi nr. 157, datë 16.10.2017; vendimi nr. 104, datë 05.10.2017



Të 14 vendimet rezultojnë të dhëna nga 3 gjyqtarë, njëri prej të cilëve krahas të proceduarit me caktim kohe prove më të madhe, ka proceduar në 1 vendim me kohë të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim. Vendimi në fjalë i këtij gjyqtari, referuar datës së vendimmarrjes në raport me vendimmarrjet e tjera të të njëjtit gjyqtar, rezulton të jetë në datë të mëparshme se të tjerat. Kështu vendimi në fjalë është i vitit 2017 dhe të tjerat rezultojnë të jenë të viteve 2018, 2019.

Në vendimmarrjet e gjyqtarëve për përcaktimin e kohës më të madhe, nuk konstatohet të ketë arsytim mbi mbështetjen ligjore përkatëse, ndërsa në vendimmarrjen për përcaktimin e kohës së barabartë konstatohet se gjyqtari mbështetet në vendimin unifikues.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Në vendimet e pranimit të lirimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se nga 4 gjyqtarë që kanë disponuar në këtë mënyrë, 3 gjyqtarë në të gjitha vendimet e tyre kanë proceduar me përcaktimin e kohës së provës të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim, ndërsa 1 gjyqtar ka proceduar si me përcaktimin e kohës të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim edhe me përcaktimin e një periudhe më të madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Ky gjyqtar ka ndjekur një praktikë të njëjtë në të njëjtën periudhë kohe, duke ndjekur fillimisht praktikën e dytë në 2 vendime<sup>22</sup> dhe më pas në vazhdimësi, në 15 vendime ka proceduar me përcaktimin e kohës së barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim.

Në vendimmarrjet e gjyqtarëve për përcaktimin e kohës si më të madhe apo të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, nuk konstatohet të ketë arsytim mbi mbështetjen ligjore përkatëse.

### **Gjykata e Apelit Shkodër**

Në këtë gjykatë, lidhur me kohën e kushtit, konstatohet se referuar 1 vendimmarrjeje të ndryshimit dhe pranimit të kërkesës për lirim me kusht<sup>23</sup>, është proceduar me disponimin për caktimin e një kohe prove të njëjtë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Lidhur me praktikën sa më sipër, përsa i përket përcaktimit të kohës së provës, nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit nga leximi i vendimeve gjyqësore. Edhe referuar qëndrimit pas dhënies së vendimit, konstatohet se nuk ka patur asnjë ankim nga prokurori lidhur me këtë kriter dhe si i tillë të ishte bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit.

**Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë me pranim kërkesë lirim me kusht, konstatohet se:**

---

<sup>22</sup> nr. 72, datë 19.02.2019 dhe nr. 81, datë 31.01.2019.

<sup>23</sup> Kjo është evidentuar në 1 rast të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit nr. 256 (2207), datë 02.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstatohet se në përgjithësi gjyqtarët shprehen në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Kështu nga totali prej 85 vendime të pranimit konstatohet se në 78 prej tyre gjyqtarët janë shprehur në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, duke e përcaktuar saktësisht me vit, muaj dhe ditë. Në këtë grup prej 78 vendimesh përfshihen të gjithë gjyqtarët që kanë disponuar me pranimin e kërkesës “lirim me kusht”, ndërsa në pjesën e mbetur të vendimeve konstatohet se i përkasin dy gjyqtarëve ku njëri prej tyre nga 35 vendime, vetëm në 1 nuk është shprehur lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit dhe gjyqtari tjetër nga 9 në 6 prej tyre, nuk është shprehur lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë konstatohet se nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit duke e përcaktuar saktësisht me vit, muaj dhe ditë.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër konstatohet se të gjithë gjyqtarët shprehen në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, por duke mos përcaktuar saktësisht me vit, muaj dhe ditë.

Gjithashtu edhe në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet se nuk përcaktohet saktësisht me vit, muaj dhe ditë, pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

### **4.3.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës**

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, gjyqtarët kanë përcaktuar urdhërimin që i dënuari gjatë kohës së provës të mbajë kontakte të rregullta dhe t'i raportojë rregullisht Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku ai banon, por nuk kanë pasqyruar në të gjitha rastet urdhërimet sipas nenit 60 të Kodit Penal.

Kështu nga 5 gjyqtarë, 4 prej tyre në të gjitha vendimmarrjet e tyre të pranimit të kërkesës lirim me kusht kanë disponuar me detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, ndërsa 1 gjyqtar rezulton se nga 17 vendime vetëm në 4<sup>24</sup> prej tyre nuk ka parashikuar detyrime të tilla. Këto vendimmarrje të këtij gjyqtari të fundit rezultojnë të jenë të tilla përgjatë gjithë periudhës së inspektimit.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

---

<sup>24</sup> nr. 68, datë 28.10.2019; nr. 153, datë 25.10.2027; nr. 11, datë 23.02.2017; nr. 169, datë 14.12.2018.

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi janë shprehur lidhur me detyrimet sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, gjyqtarët kanë përcaktuar urdhërimin që i dënuari gjatë kohës së provës të mbajë kontakte të rregullta dhe t'i raportojë rregullisht Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku ai banon, por nuk kanë pasqyruar në të gjitha rastet urdhërimet sipas nenit 60 të Kodit Penal.

Kështu nga 4 gjyqtarë që kanë disponuar me pranim kërkesë lirim me kusht, nga ana e vetëm 1 gjyqtari nuk është disponuar në të gjitha vendimmarrjet e tij, 5 të tilla, me urdhërimin për përcaktimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

#### **Gjykata e Apelit Shkodër**

Në vendimet e saj, në të cilat ka ndryshuar vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht, nuk është proceduar në dispozitiv me parashikimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

#### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

#### **4.3.2.5.2. Fillimi i afatit të provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për periudhën objekt inspektimi është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi nuk janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për periudhën objekt inspektimi është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi nuk janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi nuk janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit.

##### **Gjykata e Apelit Shkodër**



Në vendimet e saj, në të cilat ka ndryshuar vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht, konstatohet se nuk kanë parashikuar fillimin e afatit të provës.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

### **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimit të kërkesës “Lirim me kusht”**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës në tërësi jo të plotë<sup>25</sup> të administruar, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimi kërkuar.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirim me kusht rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë. Konstatohet gjithashtu se prokurori i apelit këtë urdhër ia ka dërguar përveç IEVP-së, për dijeni edhe Shërbimit të Provës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lëniën në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë**

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin

---

<sup>25</sup> Dokumentacioni i sjellë nuk është i shoqëruar me inventarizim të akteve që pasqyrojnë të gjithë të dhënat për ekzekutimin për çdo rast. Dokumentacioni në fjalë nuk është shoqëruar me inventarizimin përkatës.

gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale të rretheve gjyqësore ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirimin me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **✚ Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirimi me kusht”, nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat, Krujë, që përfshihen në Juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, ka rezultuar se:**

#### **1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale, dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundërvajtje penale.

Gjithashtu nga kërkuesit, konstatohet se 3<sup>26</sup> prej tyre kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm.

Të dënuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-së që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP “Ali Demi” dhe IEVP “Vaqar”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Burrel.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP “Fushë-Krujë”.

Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjykuese e përbërë nga një gjyqtar.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë evidentuar 15 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë janë evidentuar 7 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat janë evidentuar 4 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”.

Shortimi elektronik është përdorur si procedurës caktimi gjyqtari edhe në rastet e përjashtimit, heqjes dorë të gjyqtarit të shortuar, apo edhe në rastet e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues.

#### **1.1. Në rastin e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultojnë 5 kërkues, të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”, pas një vendimmarrjeje të mëparshme për të njëjtën kërkesë. Kërkesat e

---

<sup>26</sup> dy çështje që janë rrëzuar kërkesat e të dënuarve me burgim të përjetshëm, vendimi nr. 55 akti, datë 04.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me kërkues I. A., dhe vendimi nr. 61 akti, datë 09.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me kërkues S. B., dhe një çështje që është pranuar kërkesa e të dënuarit me burgim të përjetshëm, vendimi nr. 6/123, datë 14.1.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkues E. D.

përsëritura janë regjistruar në të gjitha rastet pas vendosjes me vendim jopërfundimtar, pushim gjykimi/moskompetencë.

Nga këto raste, evidentohet se në 2 raste gjyqtari ka qenë i njëjti me gjyqtarin që kishte vendosur pushim dhe në të tjerat gjyqtarët kanë qenë të ndryshëm. Për 1 nga këto raste, është vendosur me vendim përfundimtar. Gjyqtarët që kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat e çdo kërkuesi, rezultojnë të jenë caktuar me anë të shortit elektronik.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë rezulton 1 kërkues, i cili ka përsëritur kërkesën “lirim me kusht” pas një vendimmarrjeje të mëparshme për të njëjtën kërkesë, për të cilën ishte vendosur rrëzim i kërkesës dhe pasi kishin kaluar 6 muaj nga dita që vendimi në fjalë kishte marrë formë të prerë. Për kërkesën e dytë është vendosur pranimi. Gjyqtarët në rastin konkret kanë qenë të ndryshëm, duke u caktuar me short elektronik.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat rezultojnë 10 kërkues, të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht” pas një vendimmarrjeje të mëparshme për të njëjtën kërkesë. Kërkesat e përsëritura rezultojnë të jenë regjistruar pasi më parë ishte disponuar me vendim jopërfundimtar, pushimi. Për 7 nga 10 kërkuesit të cilët rezultojnë me dy kërkesa, konstatohet se gjyqtari që ka shqyrtuar secilën prej kërkesave të kërkuesit ka qenë i njëjtë dhe i caktuar në të gjitha këto raste me anë të shortit elektronik. Për 2 kërkues të tjerë të cilët rezultojnë me 2 kërkesa, konstatohet se gjyqtarët kanë qenë të ndryshëm dhe të caktuar edhe këta me anë të shortit elektronik.

Dhe për 1 kërkues, i cili rezulton të ketë paraqitur 3 kërkesa konstatohen dy gjyqtarë të cilët kanë shqyrtuar kërkesat në fjalë, i njëjti ka gjykuar kërkesën e dytë dhe të tretë dhe tjetri kërkesën e parë. Gjyqtarët në fjalë janë caktuar me anë të shortit elektronik pas regjistrimit të secilës kërkesë.

## **2. Palët pjesëmarrëse në gjykim**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat dhe Krujë, konstatohet se në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, si palë pjesëmarrëse thirren kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Vuajtjes së Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Gjatë gjyimit, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **2.1. Kërkuesi si palë pjesëmarrëse**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**



Kërkuesi si palë pjesëmarrëse, rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë në rrethin gjyqësor, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në 8 raste të gjykimeve të kërkesave për të cilat është disponuar me pushim/moskompetencë dhe deklarim të papranueshëm është i asistuar nga një mbrojtës, ndërsa në rastet për të cilat është disponuar me pranim dhe rrëzim të kërkesave për lirim me kusht, gjykimi është zhvilluar me praninë e mbrojtësit të kërkuesit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Kërkuesi si palë pjesëmarrëse, rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë në rrethin gjyqësor, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në 18 raste të gjykimeve të kërkesave për të cilat është disponuar me pushim, ndërsa në rastet për të cilat është disponuar me pranim dhe rrëzim të kërkesave për lirim me kusht, gjykimi është zhvilluar me praninë e mbrojtësit të kërkuesit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Kërkuesi si palë pjesëmarrëse, rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë në rrethin gjyqësor, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në 1 rast të gjykimeve të kërkesave për të cilat është disponuar me pushim, ndërsa në rastet për të cilat është disponuar me pranim dhe rrëzim të kërkesave për lirim me kusht, gjykimi është zhvilluar me praninë e mbrojtësit të kërkuesit.

## **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është konstatuar se vetëm në 1 rast, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Ky rast ka qenë kur nga ana e gjykatës është proceduar me vendim për shpalljen e moskompetencës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është konstatuar se vetëm në dy raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto dy raste kanë qenë kur nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për heqje dorë dhe nga gjykata është disponuar me pushim gjykimi.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është konstatuar se nuk ka asnjë rast që gjykimi i kërkesave për lirim me kusht të jetë zhvilluar pa pjesëmarrjen e prokurorit.

## **2.3. Gjykata e Apelit Tiranë**



Referuar gjykimeve në Gjykatën e Apelit Tiranë, konstatohet se janë thirrur për të marrë pjesë kërkuesi dhe prokurori. Nuk evidentohen të dhëna për thirrjen e IEVP-së apo të Shërbimit të Provës. Në këto gjykime prokurori ka qenë i pranishëm, sikurse edhe kërkuesi është mbrojtur nga një avokat.

### **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”**

#### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Prokuroria pranë kësaj gjykate për periudhën e viteve 2017 dhe 2018 është proceduar me caktim nga shefi i seksionit të ekzekutimeve penale ndër prokurorët pjesë e këtij seksioni. Kjo mënyrë e të proceduarit është argumentuar se nuk ka funksionuar shorti elektronik. Dhe në vazhdim për periudhën e viteve 2019 dhe 2020 është proceduar me caktim nëpërmjet shortit manual nga shefi i seksionit, që dokumentohej me anë të procesverbaleve përkatëse.

#### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, nga Prokuroria pranë kësaj gjykate për të gjithë periudhën e inspektimit është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit që ka përfaqësuar çështjen në procesin e gjykimin, kur kërkuesi ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Në ndryshim nga rregulli në fjalë, nëse prokurori i zyrës së prokurorisë Mat i cili kishte qenë përfaqësues i prokurorisë në gjykimin e themelit, nuk ushtronte më detyrën në këtë zyrë prokurorie apo nëse kërkuesi ishte dënuar nga një gjykatë tjetër ku si përfaqësues prokurorie ka qenë një prokuror i një zyre tjetër prokurorie (jo i zyrës Mat), caktimi i prokurorit në gjykimin me objekt “lirim me kusht” bëhej nga drejtuesi i prokurorisë.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, duke filluar nga data 01.02.2017 është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit nëpërmjet shortit manual ndër të gjithë prokurorët e zyrës. Kjo mënyrë e shortimit, sipas informacionit të sjellë nga ana e kësaj zyre prokurorie, është përdorur pasi në sistemin e shortimit të çështjeve penale që funksionon për prokuroritë nuk ka një rubrikë për shortimin elektronik të këtyre kërkesave.

Nga mënyra e përcaktimit të prokurorit në kërkesat “lirim me kusht”, sipas rregullit të përgjithshëm, është bërë përgjasim në disa raste për shkak të ngarkesës së madhe në punë dhe numrit të vogël të prokurorëve, për shkak të mangësive në organikë. Në këto raste, kërkesat në fjalë i janë ngarkuar prokurorit që mbulon sektorin e ekzekutimeve të vendimeve penale.

#### **Prokuroria e Apelit Tiranë**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht" në Gjykatën e Apelit, konstatohet se është proceduar me anë të shortit manual ndërmjet prokurorëve që konstatohen se kanë marrë pjesë në gjykimet me objekt "lirim me kusht", në periudhën e inspektimit.

#### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm gjithsej 72, për 12 prej tyre është disponuar me shpallje moskompetencë, për 14 me pushim kërkesë, për 13 prej tyre është vendosur deklarimi i papranueshëm i kërkesës, për 13 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 20 çështje është vendosur pranimi i kërkesës.

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 61, për 26 prej tyre është disponuar me pushim kërkesë, për 24 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 11 çështje është vendosur pranimi i kërkesës, ndërsa nuk ka patur vendime për moskompetencë dhe mosshqyrtim të kërkesës.

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 69, për 1 prej tyre është vendosur deklarim i papranueshëm i kërkesës, për 30 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 38 kërkesa është vendosur pranimi.

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat dhe Krujë nuk konstatohet të ketë patur rast që të jetë disponuar lidhur me kërkesën e një të dënuari, për të cilin në vendimin e deklarimit fajtor dhe dënimin me burgim, të ishte disponuar edhe caktimi i një periudhe sigurie gjatë të cilës nuk lejohej zbatimi i nenit 64 të Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 65/a të K. Penal.

#### **4.1. Lidhur me arsyet, për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me shpallje moskompetencë, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës është transferimi i kërkuarit/të dënuarit nga IEVP Vaqarr në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kërkuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Vaqarr dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhrin përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimin.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, arsyeja për të cilën është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës është transferimi i kërkuarit/të dënuarit nga IEVP



Fushë Krujë në një IEVP tjetër, jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Kërkuesit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fushë Krujë dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhrit përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimit.

#### **4.2. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkese konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heq dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt: “Lirim me kusht”. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e pushimit i përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019. Në vitin 2017 konstatohen 3 vendime me këtë mënyrë disponimi që i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “ Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërsa vendimet e tjera janë të viteve 2018 dhe 2019.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heq dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt: “Lirim me kusht”. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet 470-477 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e pushimit i përkasin viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Në vitin 2017 konstatohen se 4 prej vendimeve të këtij viti janë vendime pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, dhe ndryshime ne ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “ Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë”, të ndryshuar.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heq dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt, “Lirim me kusht”, mosparaqitja e kërkuesit, në një rast se kërkuesi ishte liruar në momentin e gjykimit të kërkesës. Në gjykimin e një rasti ku i dënuari ka hequr dorë nga gjykimi i kërkesës, pa hyrë në fuqi kodi i ri i procedurës penale, gjykata në vendimin



nr. 817 akti, datë 12.06.2017 është shprehur se ka një vakum ligjor në lidhje me faktin nëse heqja dorë nga kërkesa, bën që gjykata pavarësisht kësaj vazhdon marrjen në shqyrtim të kërkesës apo duhet të pushojë gjykimin e çështjes. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj situatë, gjykata ka analizuar disa dispozita të K. Pr. Penale, që trajtojnë çështje të ngjashme (nenin 59 të K. Pr. Penale nën titullin "I dëmtuari akuzues" dhe për analogji mbështetet në vendimin nr. 28, datë 16.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese, dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 117, datë 03.04.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe nr. 7, datë 16.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, duke iu referuar neneve 470 – 477 të K. Pr. Penale.

Vendimet e pushimit që i përkasin viteve 2017, 2018, 2019. Vendimet e pushimit që i përkasin vitit 2017, janë të periudhës para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë", të ndryshuar.

#### **4.3. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me "deklarimin e papranueshëm të kërkesës", konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Në të gjitha rastet për të cilat është vendosur deklarim i papranueshëm i kërkesës, shkak i kësaj vendimmarrjeje ka qenë kryesisht heqja dorë nga kërkesa dhe në një rast mosparaqitja e kërkuarit. Vendimet në fjalë i përkasin 2018, 2019 dhe 2020.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë paraqitet vetëm një rast i deklarimit të kërkesës së papranueshme, që i përket vitit 2018. Gjyqtari ka arsyetuar dhe analizuar mosplotësimin e kohës së vuajtjes së dënimit prej  $\frac{3}{4}$  të dënimit nga kërkuari dhe mbi këtë arsye, duke vendosur si bazë ligjore nenet 379, 471/2, 477 të K. Pr. Penale ka disponuar me deklarim të papranueshëm.

#### **4.4. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me "rrëzim i kërkesës për lirim me kusht"/ "pranim i kërkesës për lirim me kusht", konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, gjykata ka disponuar pas analizimit, si të kriterëve objektive, ashtu edhe të kriterëve subjektive, në raport me rrethanat e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përmbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për

përfitimin e lirit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimit të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përmbushja e këtyre kriterëve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun. Referuar këtij shkak, konstatohet se:

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzimin e kërkesës, arsyeja bazohet kryesisht në mosprovueshmërinë e kriterëve subjektive të lirit me kusht, mospërmbushja e arsyeve të veçanta, natyra e veprës penale dhe vlerësimi i mosarritjes së qëllimit për edukimin e kërkuarit, ndërsa rezulton se kriteri objektiv i kërkesave për lirim me kusht, ai i vuajtjes së kohës fizike të burgimit, sipas nenit 64 të Kodit Penal është plotësuar.

Në veçanti, në një nga vendimet rezulton se kërkesa është rrëzuar për shkak të mosplotësimit të kriterit kryesor të vuajtjes së jo më pak se 2/3 e dënimit të kërkuar nga neni 64, paragrafi 1 i Kodit Penal. Në dy vendime, kërkesa është rrëzuar për shkak të kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 3 i K. Penal, për faktin se – në një rast kërkuar rezulton që të jetë përsëritës për një krim të kryer më parë me dashje dhe pikërisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, si dhe në rastin tjetër kërkuar po vuante dënimin penal të dhënë për veprën penale parashikuar nga neni 79/a i Kodit Penal, për të cilën nuk lejohet liri me kusht.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja bazohet kryesisht në mosprovueshmërinë e arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Shkaqet e rrëzimit të kërkesave paraqiten edhe të tilla si, ose vetëm tek mospërmbushja e arsyeve të veçanta dhe mosprovueshmëria e tyre, ose e kombinuar me natyrën e veprës penale, dhe vlerësimi i mosarritjes së qëllimit për edukimin dhe riintegrimin e kërkuarit, ose për shkak të ndëshkimit me masë disiplinore, si dhe shkak tjetër integrohet edhe koha e mbetur pa vuajtur që është e lartë në lidhje me dënimin e dhënë.

Në veçanti në 1 rast, kërkesa është rrëzuar për shkak të kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 3 i K. Penale, për faktin se kërkuar po vuante dënimin penal të dhënë për veprën penale për vrasje për gjakmarrje, parashikuar nga neni 78/a i K. Penal, për të cilën nuk lejohet aplikimi i lirit me kusht. Dhe në 4 raste të tjera kërkesat janë rrëzuar për shkak të kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 3 i K. Penal, pasi kërkuar rezulton që të jetë përsëritës për një krim të kryer më parë me dashje.

## Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, rezulton se ato bazohen kryesisht në mosplotësimin e kriterëve subjektive të lirimit me kusht, si dënimi i kërkuesve për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, mosvërtetimi i arsyeve të veçanta nga ana e të dënuarit, kohën e gjatë që i ka mbetur për të vuajtur, konkluzionin negativ të shërbimit të provës, nuk rezulton të jenë normalizuar marrëdhëniet me familjarët e viktimave ose të dëmtuarit e cila vlerësohet e nevojshme referuar veprës penale për të cilën kërkuesi është duke vuajtur dënimin, si dhe pasojës së ardhur, si dhe arsye shëndetësore.

Për t'u evidentuar se nga rastet për të cilat është vendosur rrëzimi, janë edhe dy raste kur kërkuesit kanë qenë të dënuar me burgim të përjetshëm.

Përveç sa më sipër, evidentohen edhe raste kur është disponuar me rrëzim për shkak të mosplotësimi të kriterit objektiv dhe pikërisht të vuajtjes së kohës fizike të burgimit sipas nenit 64 të K. Penal. Më konkretisht konstatohet në 6 raste, ku në dy prej tyre kërkuesit kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim të përjetshëm, Për këto raste, vihet re se megjithëse gjykata konstaton mosplotësimin e këtij kriteri objektiv, ka vijuar me arsyetimin e kriterëve të tjera të nenit 64 të K. Penal. Përsa i përket të dënuarve me burgim të përjetshëm që kanë kërkuar lirim me kusht, gjykata ka mbajtur qëndrimin se duke qenë se kërkuesi është dënuar me burgim të përjetshëm ai duhet të ketë vuajtur jo më pak se 35 vite burgim.

Ndër shkaqet e rrëzimit të kërkesave rezultojnë në tre çështje edhe kushtet ndaluese sipas nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal, në drejtim të kriterit përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe në drejtim të llojit të veprës penale (neni 79/c) e interpretuar referuar dispozitave të Kodit Penal në fuqi gjatë gjykimit.

### 4.4.1. Kriteri subjektiv:

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat dhe Krujë, është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit, e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se jo të gjitha vendimet kanë një standard arsyetimi në drejtim të qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa evidentohet analizë dhe konkludim në drejtim të të dhënave të ofruara nga raportet e I EVP dhe Shërbimit të Provës.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkues, konstatohet se në rast mosdakortësie nga ana e prokurorit apo kërkuesit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur kryesisht në të njëjtat prova të administruar gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

### 4.4.2. Kriteret objektive



#### 4.4.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit

Llogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, referuar interpretimit lidhur me parashikimin e nenit 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”.

#### Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentohet se përgjithësisht ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t’iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në interpretimin e parashikimit të dispozitës së nenit 64/1 të K. Penal, lidhur me përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, në përgjithësi i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar. Kështu nga 14 gjyqtarë të cilët kanë vendosur pranimin e kërkesave rezultojnë se 11 prej tyre kanë mbajtur këtë qëndrim. Ndërsa 3 të tjerë rezultojnë përkatësisht të kenë mbajtur fillimisht, në periudhën e vitit 2017 (për ata që kanë patur) qëndrimin sipas të cilit i referoheshin masës së dënimit të dhënë nga gjykata dhe në vendimet e mëpasshme të vitit 2018 rezulton se të njëjtit gjyqtar i janë referuar llogaritjes së kriterit bazuar në parashikimin e dispozitës penale për të cilën kërkuesi është dënuar. Lidhur me 3 gjyqtarët e fundit, referimi tek masa e dënimit e dhënë nga gjykata për 1 gjyqtar është ndjekur në 1 vendim nga 3 vendime gjithsej, gjyqtari tjetër është ndjekur në 1 vendim nga 2 vendime dhe gjyqtari i tretë e ka ndjekur këtë praktikë në 1 nga 2 vendime.

#### Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat evidentohet se nuk ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t’iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara evidentohet se 2 gjyqtarë nga numri i përgjithshëm 5, që kanë shqyrtuar kërkesa për lirim me kusht në interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, në të gjitha vendimmarjet e tyre, i referohen dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar. Ndërsa 3 gjyqtarët konstatohet se kanë ndjekur dy praktika përgjatë periudhës objekt inspektimi, edhe përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit referuar masës së dënimit që parashikon dispozita dhe kohës së dënimit të dhënë nga gjykata. Lidhur me 3 gjyqtarët e fundit, referimi tek masa e dënimit e dhënë nga gjykata për 1 gjyqtar është ndjekur në 4 vendime nga 8 vendime gjithsej, gjyqtari tjetër është ndjekur në 1 vendim nga 8 vendime dhe gjyqtari i tretë e ka ndjekur këtë praktikë në 1 nga 4 vendime.



## Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë evidentohet se nuk ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t'iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara për pranim të kërkesave për lirim me kusht, nga ana e gjyqtarëve në interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, lidhur me përllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, evidentohen disa praktika, një që i referohet masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar; të tjerë ose i njëjti gjyqtar që i referohen dënimit të dhënë nga gjykata dhe të tjerë që nuk i referohen asnjërit nga praktikat sa më sipër.

Lidhur me interpretimin e parë, konstatohet se ajo është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga 3 gjyqtarë, nga 6 gjyqtarë gjithsej. E njëjta praktikë është ndjekur edhe nga 1 gjyqtar tjetër në 12 vendime nga 15 vendime gjithsej, ku për 2 vendime<sup>27</sup> evidentohet se ka ndjekur praktikën tjetër duke iu referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata.

Përsa i përket 2 gjyqtarëve të tjerë, rezulton se 1 prej tyre ka përdorur praktikën e dytë e pasqyruar kjo në vendimin e vetëm të dhënë gjatë gjithë periudhës objekt inspektimi, ndërsa gjyqtari tjetër referuar mënyrës së arsytimit nuk rezulton të ketë ndjekur ndonjë nga praktikat e mësipërme. Ky i fundit<sup>28</sup>, përveç një vendimi që është më i hershmi në kohë nga vendimet e tjera, konstatohet të ndjekë vetëm përllogaritjen duke iu referuar vetëm kriterit 2/3 pavarësisht masës së dënimit të dhënë nga gjykata apo masës së dënimit që parashikon dispozita. Në vendimin e veçuar më sipër, konstatohet se ka ndjekur përllogaritjen referuar kriterit 3/4 që rezulton si i tillë edhe po t'i referohesh masës së dënimit të dhënë nga gjykata apo edhe masës së dënimit që parashikon dispozita. Në këtë vendim nuk konstatohet të ketë një arsyetim se përsëri i referohet këtij kriteri, ashtu si edhe në rastet e sipërpërmendura ku ka përdorur kriterin 2/3<sup>29</sup> edhe në raste të ngjashme me atë ku ka përdorur kriterin 3/4.

### Kërkuesi i dënuar me burgim të përjetshëm

<sup>27</sup> nr. 26, datë 07.05.2018, nr. 73, datë 22.07.2019, nr. 67, datë 18.07.2019.

<sup>28</sup> nr. 8/79, datë 22.02.2018; vendimin nr. 11/83, datë 19.03.2018; vendimin nr. 24, datë 23.03.2018; në vendimin nr. 5/74, datë 05.04.2018; vendimin nr. 25, datë 07.06.2017; nr. 33, datë 09.05.2017. Këto vendime i përkasin një gjyqtari i cili aktualisht nuk e gëzon statusin e magjistratit për shkak të daljes në pension, sipas vendimit të datës 07.05.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

<sup>29</sup> vendimin nr. 5/74, datë 05.04.2018 ku kërkuesi ishte dënuar me 22 vite burgim, vendimin nr. 25, datë 07.06.2017 ku kërkuesi ishte dënuar me 14 vite burgim, vendimin nr. 33, datë 09.05.2017, ku kërkuesi ishte dënuar me 12 vite burgim.

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë konstatohet se janë edhe 3 raste kur kërkuesi ka qenë i dënuar me burgim të përjetshëm, për të cilat për përcaktimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit zbatohen parashikimet e nenit 65 të K. Penal.

Nga këto kërkesa rezulton se dy prej tyre janë rrëzuar dhe në 1 rast, kërkesa është pranuar. 2 kërkesat për të cilat është vendosur rrëzim është shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar, ndërsa kërkesa tjetër është vendosur pranim nga 1 gjyqtar tjetër i ndryshëm nga ai që ka vendosur rrëzimet.

Lidhur me 2 rastet e rrëzimit<sup>30</sup>, konstatohet se përsa i përket periudhës minimum gjyqtari i është referuar kërkesave të ligjit aktual sipas të cilit kjo kohë përfshin periudhën 35 vjet burgim. Në të dy këto raste, konstatohet se kërkesa e të dënuarve ishte për dënime të dhëna në periudhën kur dispozita në fjalë e nenit 65/3 të K. Penal parashikonte si periudhë minimum periudhën prej 25 vjetësh me qëllim përfitim nga instituti i lirimit me kusht. Këto vendime kanë marrë formë të prerë me këtë disponim. Ndaj njërit vendim është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të formës së ankimit<sup>31</sup> dhe për tjetrin nuk ka patur ankim duke marrë formë të prerë me kalimin e afatit ligjor.

Lidhur me rastin e pranimit<sup>32</sup>, konstatohet se nga ana e gjyqtarit që e ka marrë në shqyrtim për kriterin e periudhës minimum prej 35 vitesh të parashikuar në nenin 65/3 të K. Penal në fuqi, në përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit, nuk i është referuar kësaj dispozite por dispozitës së vjetër e interpretuar dispozitë favorizuese për shkak se ka qenë në fuqi në kohën e dënimit të kërkuesit për të cilën ai ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht. Më konkretisht lidhur me këtë kriter gjyqtari ka arsyetuar se: *“Në rastin e marrë për shqyrtim në mbështetje të nenit 3 të Kodit Penal, të nenit 29 të Kushtetutës, bazuar në vendimet e Gjykatës Kushtetuese që trajtojnë parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, me nr. 35, datë 20.12.2005, vendimi nr. 4, datë 28.02.2006 dhe vendimi nr. 14, datë 17.04.2007 do të zbatohet pikërisht dispozita ligjore neni 65 i Kodit Penal i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995. Përsa u parashtrua më lart, gjykata pasi mori në shqyrtim kërkesën e kërkuesit, dokumentacionin e sjellë nga IEVP ... gjykata në mbështetje të nenit 65 të Kodit Penal çmon se kërkesa e kërkuesit është e bazuar në ligj dhe prova... Përfundimisht gjykata gjykon të pranojë kërkesë duke u shprehur për lirimin para kohe me kusht të kërkuesit....”*. ndaj këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar ankim nga prokurori dhe çështja rezulton ende e pashqyrtuar në Gjykatën e Apelit<sup>33</sup>. Lidhur me këtë vendimmarrje, konstatohet se ka ngjashmëri me rastin e trajtuar në lidhje me kriterin në fjalë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë që ka pranuar kërkesën e lirimit me kusht dhe që është trajtuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2022-

<sup>30</sup> vendimi nr. 55 akti, datë 04.10.2017 dhe nr. 61 akti, datë 09.10.2017. Në këto vendime është arsyetuar mospërbushja e kriterit të periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, 35 vjet, për të cilën nuk ka një arsyetim në drejtim të ndryshimit që ka pësuar dispozita në fjalë dhe më tej të jetë ngritur si diskutim për t'u analizuar si dispozita që duhet të zbatohet në rastin konkret. Kërkesat janë rrëzuar si për këtë kriter objektiv dhe për atë subjektiv.

<sup>31</sup> E nënshkruar vetëm nga mbrojtësi pa tagër.

<sup>32</sup> Vendimi nr. 6/123 Regjistri Themeltar, datë 14.01.2020.

<sup>33</sup> Referuar kohës së përpilimit të këtij raporti.

629, datë 14.06.2022, qëndrimi i të cilës është shprehur në pjesën ku është trajtuar vendimi përkatës i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

### **Gjykata e Apelit Tiranë**

Nga vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, konstatohet se lidhur me interpretimin sa më sipër, për përcaktimin e kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfituar lirimin me kusht, i referohet përllogaritjes në bazë të dënimit të parashikuar në dispozitën penale. Në vendimin e vetëm të Gjykatës së Apelit<sup>34</sup> që ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, kjo gjykatë lidhur me kriterin objekt trajtimi është shprehur se: *“Për vepra penale të kategorizuara si krime sanksioni për të cilat është deri në pesë vjet i dënuari duhet të ketë vuajtur jo më pak se 2/3 e dënimit. Ndërsa për vepra penale të kategorizuara si krime sanksioni për të cilat është mbi pesë deri në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita, i dënuari duhet të ketë vuajtur jo më pak se 3/4 e dënimit”*. Të njëjtin arsyetim e gjejmë edhe në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor<sup>35</sup> e cila mbi bazë të këtij arsytimi, ka pranuar përmbushjen e kriterit në fjalë, ndërsa ka disponuar rrëzimin për shkak të mosplotësimit të kriterëve subjektive lidhur me arsyetimin e veçantë, arritjes së qëllimit për edukimin e tij, si dhe gjithashtu nuk u provuan rrethana të reja pas dhënies së vendimit të rrëzimit të një kërkesë të mëparshme të të njëjtit kërkues. Lidhur me këtë arsyetim të fundit, nuk konstatohet të ketë një analizë konkrete nga gjykata e Apelit<sup>36</sup>. Ndaj vendimit në fjalë, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, për të cilën nuk kemi një vendim të zbardhur.

Nga vendimmarrjet që janë bërë objekt rekursi në Gjykatën e Lartë, konstatohet se në një rast të trajtuar, Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 00-2022-1817, datë 03.11.2022, ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me interpretimin në fjalë për përcaktimin e kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfituar lirimin me kusht. Bëhet fjalë për kërkuesin i dënuar me 4 vjet burgim për veprën penale “Trafikimi i lëndëve narkotike” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 22 të Kodit Penal, i dënuari ka paraqitur kërkesën për “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, e cila ka pranuar kërkesën me argumentin se i dënuari deri në ditën e shpalljes së vendimit ka vuajtur 3 vjet e 4 muaj nga dënimi i dhënë, pra me shume se  $\frac{3}{4}$  e dënimit, dhe i mbeten për të vuajtur 11 muaj e 28 ditë burgim. Mbi bazën e ankimit të prokurorit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit e cila ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, duke rrëzuar kërkesën e kërkuesit për lirim me kusht me argumentin se në kohën kur ka depozituar kërkesën për lirim me kusht nuk ka vuajtur  $\frac{3}{4}$  e dënimit, si dhe me mosplotësimin e arsyeve të veçanta. Ndaj vendimit në fjalë është ushtruar rekurs nga kërkuesi, dhe Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, por me tjetër arsyetim.

Gjykata e Lartë në qëndrimin e saj ka pranuar vetëm argumentin e Gjykatës së Apelit në drejtim

<sup>34</sup> Vendimi nr. 1102, datë 16.10.2019.

<sup>35</sup> Vendimi nr. 52 akti, datë 03.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

<sup>36</sup> Vendimi nr. 1102, datë 16.10.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

të arsyeve të veçanta duke u shprehur si një bindje e brendshme e gjykatës “Kjo çështje, në vlerësim të Kolegjit është bindje e brendshme e gjykatës së apelit dhe i referohet mënyrës së vlerësimit të fakteve dhe provave të paraqitura nga kërkuesi për të justifikuar kërkesën e tij Kolegji vlerëson se gjykata ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke u bazuar në ligj e në fakte”. Ndërsa ka patur një qëndrim të ndryshëm referuar përlllogaritjes së kohës së dënimit të vuajtur lidhur me interpretimin 2/3 apo 3/4 të dënimit me burgim për krime sipas nenit 64 të K. Penal. Kështu lidhur me këtë gjykata shprehet se: “Në lidhje me kriterin objektiv, për vuajtjen e jo më pak se 3/4 të dënimit të dhënë, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Tiranë ka interpretuar jo saktë dispozitën penale materiale, konkretisht neni 64 i K. Penal. Kolegji vlerëson se të dyja gjykatat e faktit i janë referuar detyrimit të kërkuesit për të vuajtur 3/4 e dënimit me burgim, ndërsa në fakt detyrimi i kërkuesit ka qenë për të vuajtur 2/3 e dënimit me burgim, duke marrë në konsideratë që dënimi përfundimtar i dhënë ndaj tij ka qenë 4 vjet burgim. Në këto kushte, pavarësisht kërkimit të kërkuesit që i është referuar vuajtjes prej 3/4 të dënimit, gjykatat duhet të zbatonin ndaj tij parashikimin e saktë sipas nenit 64/1 të KP, duke i zbatuar atij detyrimin për vuajtjen e 2/3 e dënimit të dhënë. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se kërkuesi e ka plotësuar kushtin objektiv që parashikon neni 64/1 i K. Penal, pasi rezulton se ai e ka vuajtur 2/3 e dënimit të dhënë me burgim”.

#### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat dhe Krujë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankime lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës për sa i përket përcaktimit të periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, në drejtim të kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

#### **4.4.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës për “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, në pjesën më të madhe konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Nga vendimet në fjalë, evidentohet se gjyqtarët i qëndrojnë praktikës së përlllogaritjes së masës së dënimit të vuajtur në zbatim të nenit 64/1 të K. Penal, deri në datën e dhënies së vendimit. Për të gjitha këto raste, qëndrimi i prokurorit të rrethit gjyqësor ka qenë për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit deri në datën e dhënies së vendimit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës për

“Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, në pjesën më të madhe konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës. Periudha e vuajtjes për të plotësuar kriterin objektiv merret parasysh deri në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, ndërsa dënimi i mbetur llogaritet deri në datën e shpalljes së vendimit.

Për të gjitha këto raste, qëndrimi i prokurorit të rrethit gjyqësor ka qenë për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilën është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës për “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Për të gjitha këto raste, qëndrimi i prokurorit të rrethit gjyqësor ka qenë për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit deri në datën e dhënies së vendimit.

### **Gjykata e Apelit Tiranë**

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt “lirim me kusht”, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. Përkundrazi në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet arsësimi të kësaj mënyre të proceduarit.

#### **4.4.2.3. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ajo e përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, evidentohet se në katër vendime kërkuar ka patur kohë, kohë e cila është bërë më pas objekt trajtimi për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit në përmbushje të kriterit të parashikuar

në nenin 64 të K. Penal. Nga këto 4 raste, evidentohet se për 2<sup>37</sup> prej tyre prokurorët kanë shprehur qëndrimin e mospërfshirjes së kohës së punës për përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, me argumentin e mosekzistencës së ndonjë akti ligjor apo nënligjor në fuqi që të njohë ditët e punës të kryera nga të dënuarit në burgje, si ditë vuajtje dënimi dhe njohjen e tyre si ditë burgimi., duke trajtuar konkretisht se ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligji nr. 40/2014, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar nuk kanë parashikuar punën si një veprim detyrues për të dënuarin, si dhe nuk kanë parashikuar njohjen e punës si ditë vuajtje dënimi apo konvertimin e punës së kryer në burg për efekt të shlyerjes së dënimit. Gjithashtu në vijim të argumenteve të tyre, prokurorët shprehen edhe për faktin se edhe në rregulloren e përgjithshme të burgjeve nuk ka një rregullim për marrëdhënien e punës, ndërsa janë parashikuar përfitime si përfitimin e lejes shpërblyese dhe se në këtë kontekst kryerja e punës do t’i shërbejë të dënuarit me qëllimin plotësimin e kriterëve për lirim me kusht. Dhe një nga prokurorët në argumentet e tij ka përmendur edhe urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm referuar një shkresë të vitit 2004, sipas të cilit ditët e punës nuk do të njiheshin për efekt të uljes së dënimit.

Ky qëndrim i prokurorëve nuk është pranuar nga gjykata të paktën për 1 rast ku qëndrimi i saj është shprehur qartë, ndërsa në rastin tjetër gjykata nuk ka arsyetuar konkretisht lidhur me këtë kohë pune duke qenë se ka patur arsyetim në drejtim të kriterëve të tjera për të cilat ka qenë e mjaftueshme konkludimi lidhur me kërkesën. Kështu për 1 nga rastet<sup>38</sup> gjykata në arsyetimin e saj për përfshirjen e kohës së punës, i është referuar dekretit n. 7298, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, duke arsyetuar për këtë dekret se “është në fuqi dhe nuk është shfuqizuar me ndonjë akt të mëvonshëm ligjor. Sipas këtij dekreti, i dënuari përfiton ulje dënimi me 3,9 ditë pune për çdo muaj për punën e kryer. Gjykata çmon se përse kohë ligjvënësi nuk ka ndërmarrë ndonjë nismë për shfuqizimin e këtij dekreti, apo për ndryshimin e tij në përputhje me ndryshimin e rrethanave sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe ligjore, si dhe përse kohë puna që ka kryer i dënuari nuk është shpërblyer në para, duke patur parasysht se askush nuk mund të detyrohet të punojë pa shpërblyer, Gjykata vlerëson se koha e dënimit e zbritur në bazë të këtij dekreti, duhet të llogaritet në afatin e dënimit me burgim të vuajtur. Gjykata vlerëson, se në total kërkuesi ka vuajtur 15 vjet, 10 muaj e 26 ditë. Pra, kërkuesi ka vuajtur jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për veprën penale të kryer”. Me anë të këtij vendimi gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shkak të arsyeve të veçanta. Ndaj vendimit ka patur ankim nga kërkuesi, por Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak se ankimi kishte mbetur pa objekt, kërkuesi e kishte vuajtur dënimin dhe ishte liruar.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk janë konkluduar për raste të përfshirjes në përlllogaritje të periudhës së përfituar me amnisti dhe falje.

<sup>37</sup> Vendimi nr. 181 akti, datë 07.11.2018 dhe vendimi nr. 419 akti, datë 22.05.2017.

<sup>38</sup> Vendimi nr. 181 akti, datë 07.11.2018.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ajo e përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

Midis gjykatës dhe prokurorisë rezulton se nuk ka patur qëndrim të ndryshëm lidhur me përfshirjen në periudhën në fjalë të kohës së punës në IEVP.

Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat evidentohet se vetëm në 10 vendime kërkuesi ka patur kohë pune në IEVP që janë bërë më pas objekt trajtimi për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit në përmbushje të kriterit të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk janë konkluduar për raste të përfshirjes në përlllogaritje të periudhës së përfituar me amnisti dhe falje.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ajo e përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP dhe me amnisti.

Midis gjykatës dhe prokurorisë rezulton se nuk ka patur qëndrim të ndryshëm lidhur me përfshirjen në periudhën në fjalë të kohës së punës në IEVP.

Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ku rezulton të jetë shprehur përfitimi i kohës së punës, evidentohet se në 13 vendime kërkuesi ka patur kohë pune e cila është bërë më pas objekt trajtimi për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit në përmbushje të kriterit të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk janë konkluduar për raste të përfshirjes në përlllogaritje të periudhës së përfituar me amnisti dhe falje.

### **Gjykata e Apelit Tiranë**

Për sa i përket kohës së punës në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk ka ndonjë rast që të jetë trajtuar në veçanti një përfitim i tillë. Por, nga vendimmarrjet e kësaj gjykate<sup>39</sup> nuk evidentohet qëndrim ndryshe kur janë shqyrtuar vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor që kanë përfshirë në përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit për përfitimin e lirimit me kusht, edhe kohën e punës.

#### 4.4.2.4. Kushtet ndaluese

Nga vendimet e administruara të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat, Krujë është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me **kushtet ndalues “përsëritës” dhe për shkak të veprës penale të parashikuar** në nenit 64 të K. Penal. Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuarit të administruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimit.

Për kriterin “përsëritës”, vlerësohet të jepen më poshtë qëndrimet e gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me diskutimet dhe trajtimet që kanë bërë rreth këtij kriteri.

Në 1 rast që i përket vendimit<sup>40</sup> të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat konstatohet se kërkuari ka paraqitur kërkesë për t’u liruar me kusht nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me burgim sipas vendimit të datës 10.03.2017 për veprat penale të parashikuar nga nenet 283/2 dhe 279/2 të K. Penal. Para këtij dënimi, rezultonte se kërkuari ishte dënuar edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal. Sipas vendimit, gjykata ka vënë në diskutim argumentin nëse kërkuari do të konsiderohet përsëritës. Lidhur me këtë prokurori ka mbajtur qëndrimin se *“Kërkuari duhet të trajtohet si përsëritës dhe për këtë shkak nuk duhet të përfitojë liri me kusht. i dënuari ka qenë i dënuar më parë, kjo në bazë të vendimit gjyqësor. Vepra penale për të cilën kërkuari është dënuar, parashikohet si krim, neni 291 i Kodit Penal. Brenda afatit të rehabilitimit (brenda dy vjetësh, neni 69/a), pra pa kaluar dy vite, d.m.th., i rehabilituar (qershor 2016), kërkuari ka kryer dy vepra penale të tjera, që nga ligji parashikohen si krime, nenet 283/1 e 279/2 të Kodit Penal. Po sipas vendimit, qëndrimi i kërkuarit dhe avokatit të tij “... pretenduan që ky dënim nuk mund të bëhet pengesë për lirimin me kusht në kuptim të nenit 64 të K. Penal sipas arsyetimit të palës kërkuese, fakti që dënimi i dhënë në vitin 2015 është amnistuar, bën atë automatikisht një person të padënuar, referuar sipas tyre në kuptim të nenit 71 “Amnistia” të Kodit Penal. Si argument, pala kërkuese solli faktin që edhe në vërtetimin e gjendjes gjyqësore, dënimi i dhënë në vitin 2015, nuk rezultoi i pasqyruar. Në lidhje me diskutimin në fjalë, gjykata ka pranuar qëndrimin e prokurorit duke e konsideruar përsëritës me arsyetimin se: “Sipas vendimit të dënimit për të cilën kërkuari po vuan aktualisht, vepra penale është kryer në datën 07.06.2016. Po ashtu provohet se kërkuari ka dhe një dënim tjetër në ngarkim të tij, i*

<sup>39</sup> Në rastin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1102, datë 16.10.2019, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 52, datë 03.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për rrëzim kërkesë, duke vendosur pranimin e kërkesës, rezultoi se në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është llogaritur si përfitim dhe koha e punës.

<sup>40</sup> Vendimi nr. 1, datë 19.03.2018.

56



dhënë më datë 30.03.2015, i parashikuar si krim, neni 291 i Kodit Penal. Gjithashtu, pranohet edhe fakti që dënimi i dhënë në mars 2015, është amnistuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 154/2015 "Për dhënie amnistie". Në nenin 69 të Kodit Penal, parashikohet që, quhen të padënuar, të gjithë personat e dënuar me burgim deri në 6 muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë, të cilët gjatë dy viteve nga dita e vuajtjes së dënimit, nuk kanë kryer vepër tjetër penale. Në rastin konkret, në interpretim e kuptim të dispozitës 69 në lidhje me nenin 64 të Kodit Penal, kërkuesi duhet të konsiderohet përsëritës. Sipas akteve, dita e përfundimit të vuajtjes së dënimit për kërkuesit, do të konsiderohet dita e hyrjes në fuqi të ligjit për amnistinë e vitit 2015, nga ku dhe dënimi i tij u amnistua. Por rezulton e provuar që nga dita e fundit e vuajtjes së dënimit të dhënë (vendimi nr. 160, datë 30.03.2015, pa kaluar dy vite kohë, kërkuesi kreu një tjetër krim, ky që po vuan aktualisht datë 07.06.2016, dhe kjo përbën pengesë që ai të përfitojë liri me kusht. Interpretimi që i bën pala mbrojtëse, dispozitës 71 të amnistisë, në lidhje me rastin në gjykim, nuk është i bazuar. Sipas palës mbrojtëse, fakti që xxx ka përfitur në mënyrë të plotë pjesën e pavuajtur të dënimit, nga amnistia e vitit 2015, ai duhet të trajtohet si i padënuar. Ky konkluzion i përgjellë për gjykatën nga pala mbrojtëse, si argument i trajtimit si jopërsëritës për xxx, nuk gjen mbështetje në kuptimin literal dhe doktrinor të nenit 69 të K. Penal. në nënyrë të shprehur në nenin 71 të Kodit Penal, parashikohet që, "...". Përcaktimet në këtë dispozitë, përjashtojnë çdo mundësi interpretimi, sipas mënyrës që pretendon pala mbrojtëse". Ndaj vendimit në fjalë nuk ka patur ankim dhe për këtë arsye, vendimi ka marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore përkatëse.

Në 1 rast tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë<sup>41</sup>, kjo e fundit e ka konsideruar të përmbushur mosekzistencën e kushtit ndalues "përsëritës", të qenit i rehabilituar sipas të dhënave të ofruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, duke arsyetuar se: "sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. x prot., kërkuesi rezulton me gjendje gjyqësore i rehabilituar 1 herë dhe i dënuar vetëm për veprën penale për të cilin po vuan dënimin pranë IEVP Fushë- Krujë". Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim duke marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore.

Për kriterin ndalues për shkak të veprës penale të parashikuar në nenet 64 dhe 65 të K. Penal, vlerësohet të jepen më poshtë qëndrimet e gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me diskutimet dhe trajtimet që kanë bërë rreth këtij kriteri.

Rasti i parë i përket një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë<sup>42</sup> ku i dënuari ka qenë i dënuar me burgim të përjetshëm, dhe ndër të tjera gjykata ka disponuar me rrëzim duke arsyetuar si shkak edhe faktin e të qenit para kushtit ndalues të lidhur me llojin e veprës penale. Kështu kërkuesi me vendimin e datës 24.11.1994 është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të "Vrasjes për motive të dobëta (xhelozie) parashikuar nga neni 84/a i K. Penal të kohës, dhe lidhur me këtë fakt, përsa i përket kriterit ndalues gjykata arsyeton se: "... vepra penale për të cilën ai është duke vuajtur dënimin sipas vendimit nr. 987, datë 24.11.1994 të Gjykatës

<sup>41</sup> Vendimi nr. 100 akti, datë 27.11.2018.

<sup>42</sup> Vendimi nr. 61 akti, datë 9.10.2017.

së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kryer kundër bashkshortes. Sipas dispozitave të sotme të Kodit Penal kjo veprë sanksionohet në nenin 79/c të tij, duke përbërë kësisoj edhe një kriter ndalues sanksionuar nga neni 65, pika 3 i Kodit Penal”. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim duke marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore.

Rasti i dytë është kur kërkuesi ishte dënuar për kryerjen ndër të tjera të veprës penale të “Vrasje me dashje e punonjësit të policisë” të parashikuar nga neni 79, gërma c i K. Penal, dhe nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor, gjyqtar tjetër nga sa më sipër<sup>43</sup> është argumentuar se vepra penale për të cilën kërkuesi është dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në momentin e fillimit të vuajtjes së dënimit nuk përbënte ndalim për të përfutur nga lirimi para kohe me kusht, sipas nenit 64 të K. Penal, ndërsa në vazhdim kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar. Gjykata shton më tej se në rastin konkret referuar nenit 477 të K. Pr. Penale dhe nenit 3 të K. Penal për kërkuesin do të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, duke pranuar për rrjedhojë se dënimi për këtë veprë penale nuk përbënte ndalim sipas nenit 64 të K. Penal. Ky qëndrim nuk është gjetur i drejtë nga Gjykata e Apelit, e cila ka konkluduar se vepra penale për të cilën kërkuesi ishte dënuar, përbënte ndalim pasi përfshihej në veprat penale që parashikon dispozita në fjalë. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se në bazë të aplikimit të institutit të veprimit në kohë të ligjit penal, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, do të zbatohet ligji i kohës që ka qenë në fuqi në momentin që i dënuari ka paraqitur në organin e gjykatës kërkesën e veçantë penale me objekt lirim me kusht. Gjykata vazhdon me argumentimin e saj, se duke qenë se faza e ekzekutimit të vendimit penal është një fazë e shkëputur nga procesi penal dhe deklarimi fajtor i subjektit të veprës penale, vlerësohet se duhet të zbatohet ligji penal material që është në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit, pasi ekzekutimi i dënimit lidhet me elementë që kanë të bëjnë me sjelljen e të dënuarit në institucionet e IEVP-së, me mundësinë që me sjelljen e tij të përfitohen ulje të dënimit ose leje shpërblyese, mundësinë e riintegritit të tij në shoqëri, me qëndrimin e tij ndaj veprës, me sjelljen me bashkëvuajtësit dhe me autoritetet shtetërore, me mundësinë e tij për t’u punësuar jashtë burgu, në varësi të kërkesës që do të ngrihet nga i dënuari dhe rrjedhimisht faktet që vlerësohen nga gjykata në këtë fazë janë të ndryshme nga ato që janë vlerësuar në momentin që i dënuari është shpallur fajtor. Këto qëndrime janë vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë<sup>44</sup> e cila ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit, se, në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal, gjen zbatim dispozita penale që është në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit, si dhe të faktit se shfuqizimi i normës konkretisht i pikës “c”, të nenit 79 të Kodit Penal nuk ka patur si qëllim dekriminalizimin e kësaj lloji vepre penale, sepse nuk ka më rrezikshmëri shoqërore, por, përkundrazi, me ndryshimet ligjore të bëra me ligjin nr. 144/2013, datë 02.05.2013, janë krijuar dy norma të reja, konkretisht ajo e parashikuar nga neni 79/a i Kodit Penal “Vrasja e funksionarëve publikë” dhe ajo e parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, duke parashikuar një mbrojtje më të posaçme këtyre subjekte kjo e shprehur edhe nga marzhet e dënimit të cilat janë më të rënda në minimumin e parashikuar. Për arritjen e

<sup>43</sup> Vendimi nr. 69 akti, datë 06.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

<sup>44</sup> Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2022-1617, i vendimit nr. (334), datë 15.12.2022 me kërkues Genc Tafili.

këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë është shprehur se ka mbajtur në konsideratë edhe vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që në lidhje me zbatimin e nenin 3 të Kodit Penal.

#### **4.4.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”**

##### **Koha e kushtit/provës:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Në vendimet e pranimit të lirimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se janë ndjekur praktika të ndryshme në përcaktimin e kohës së provës, e cila rezulton të jetë e barabartë ose më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit.

Kështu 4 gjyqtarë kanë ndjekur si praktikë gjatë gjithë periudhës së inspektimit, përcaktimin si kohë prove, një periudhë kohe të barabartë me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Në vendimmarrjet e tyre këta gjyqtarë arsyetojnë bazuar vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015.

12 gjyqtarë kanë ndjekur si praktikë përcaktimin si kohë prove një periudhë kohe më të madhe sesa dënimi i mbetur i pavuajtur i dënimit. Në grupin e këtyre 12 gjyqtarëve është konstatuar se 7 gjyqtarë në përcaktimin e kohës më të madhe, ndalen në dyfishin e kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit që nga disa gjyqtarë në vendimmarrjet e tyre mbështetet në arsyetimin e nenit 59/3 të K. Penal. Këtë bazë ligjore e gjejmë të shprehur vetëm në 2 nga 7 gjyqtarët. Gjyqtarët të cilët procedojnë me përcaktimin e një kohe më të madhe, jo e përcaktuar si dyfishi i dënimit, konstatohet se një pjesë arsyetojnë duke u mbështetur vetëm në pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, ndërsa ka edhe të tjerë të cilët nuk arsyetojnë lidhur me përcaktimin e kësaj periudhe.

##### **Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë, konstatohet se:**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konstatohet se jo nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Më konkretisht vetëm nga 6 prej 15 gjyqtarëve që kanë pranuar kërkesat për lirim me kusht, shprehen në dispozitiv mbi kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet se përcaktohet saktësisht pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Në vendimet e pranimit të lirimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se janë ndjekur praktika të ndryshme në përcaktimin e kohës së provës, e cila rezulton të jetë e barabartë ose më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Kështu nga 4 gjyqtarët që kanë disponuar me pranim kërkesë lirim me kusht, rezulton se 2 gjyqtarë në të gjitha vendimmarrjet e tyre në periudhën e inspektimit, kanë ndjekur praktikën e përcaktimit

59

të kohës së provës të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, ndërsa 2 gjyqtarët e tjerë krahas praktikës së sipërpërmendur, kanë ndjekur edhe praktikën e përcaktimit të kohës së provës më të madhe sesa dënimi i mbetur i pavuajtur. Kjo evidentohet në 2 vendime të 1 gjyqtari i cili ka përcaktuar si kohë prove dyfishin e dënimit të mbetur dhe tek 1 vendim të një gjyqtari tjetër i cili ka përcaktuar si kohë prove një kohë prove më e madhe sesa pjesa e mbetur e dënimit.

Përsa i përket arsytimit, konstatohet se në vendimet ku është përcaktuar koha e provës e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, gjyqtarët janë mbështetur në arsyetimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, ndërsa në vendimet ku është ndjekur praktika tjetër nuk evidentohet të ketë ndonjë arsyetim.

**Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë, konstatohet se:**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat konstatohet se nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Gjithashtu edhe në vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë konstatohet se përcaktohet saktësisht pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**

Në vendimet e pranimit të lirimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se janë ndjekur praktika të ndryshme në përcaktimin e kohës së provës, e cila rezulton të jetë e barabartë, më e madhe ose më e vogël sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit.

Kështu nga 7 gjyqtarët të cilët kanë disponuar me vendim pranimi lirimi me kusht, rezulton se gjatë gjithë periudhës së inspektimit, vetëm nga 1 gjyqtar është ndjekur praktika e përcaktimit të kohës së provës e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit dhe vetëm nga 2 gjyqtarë të tjerë është ndjekur praktika e përcaktimit të kohës më të madhe të provës sesa koha e dënimit e mbetur e pavuajtur, ku përfshihet në disa vendimmarrje edhe dyfishi i dënimit të mbetur.

Përsa u përket 4 gjyqtarëve të tjerë, konstatohet se kanë ndjekur praktika të ndryshme përgjatë veprimtarisë së tyre gjatë periudhës objekt i këtij inspektimi. 2 gjyqtarë kanë ndjekur të dy praktikatat e sipërpërmendura të 3 gjyqtarëve dhe 2 të tjerë prej 4 gjyqtarëve përveç këtyre dy praktikave kanë përfshirë edhe përcaktimin e një kohe më të vogël. Kjo e fundit e evidentuar vetëm në dy vendime që i përkasin dy gjyqtarëve të ndryshëm.

Lidhur me arsyetimin, konstatohet se në vendimet ku është përcaktuar koha e provës e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, gjyqtarët janë mbështetur në arsyetimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, ndërsa në vendimet ku është ndjekur praktika tjetër nuk evidentohet të ketë ndonjë arsyetim.

Në rastin e kërkuesit të dënuarit me burgim të përjetshëm<sup>45</sup>, nga ana e gjykatës që ka proceduar me pranimin e kërkesës, ka disponuar me përcaktimin e kohës së provës me 5 vjet. Në vendim nuk ka arsyetim lidhur me përcaktimin e kësaj periudhe kohe.

**Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë, konstatohet se:**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë konstatohet se jo nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Gjithashtu edhe në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet se nuk përcaktohet saktësisht pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

### **Gjykata e Apelit Tiranë**

Në këtë gjykatë, konstatohet se nuk ka patur raste ku të jetë diskutuar apo ngritur si diskutim si shkak ankimi, koha e provës. Në 1 rast<sup>46</sup> konstatohet se Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshim dhe pranim kërkesë për lirim me kusht dhe nga ky rast konstatohet se nga ana e gjykatës është përcaktuar si kohë prove një periudhë më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Kështu në këtë rast dënimi i mbetur ishte 2 vjet e 6 muaj dhe koha e provës e përcaktuar ishte 3 vjet. Referuar vendimmarrjes në fjalë, nuk konstatohet të ketë arsyetim lidhur me përcaktimin e kësaj kohe prove.

### **Qëndrimi i prokurorit:**

Nga leximi i vendimeve gjyqësore nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit në lidhje me kohën e provës dhe gjithashtu nuk evidentohet të jetë ushtruar ankim/rekurs në këtë drejtim.

#### **4.4.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo nga të gjithë gjyqtarët është ndjekur e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuar në nenin 60 të K. Penal.

Nga 15 gjyqtarë që kanë vendosur pranim të kërkesave për lirim me kusht, 3 prej tyre nuk kanë vendosur detyrimet gjatë kohës së provës sipas nenit 60 të Kodit Penal në vendimmarrjet e tyre.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo nga të gjithë gjyqtarët është ndjekur e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuar në nenin 60 të K. Penal.

---

<sup>45</sup> Vendimi nr. 6/123 Regjistri Themeltar, datë 14.01.2020.

<sup>46</sup> Nr. 1102 date 16.10.2019.

Më konkretisht referuar sa më sipër, për periudhën objekt inspektimi konstatohet se 1 gjyqtar ka ndjekur praktikën e përcaktimit të detyrimeve gjatë kohës së provës sipas nenit 60 të K. Penal, ndërsa 3 gjyqtarët e tjerë jo në të gjitha vendimet përcaktojnë detyrime sipas nenit 60 të K. Penal.

### **Gjykata e Rrethit Gjirokastrë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo nga të gjithë gjyqtarët është ndjekur e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të K. Penal.

Më konkretisht referuar sa më sipër, për periudhën objekt inspektimi konstatohet se 3 gjyqtarë kanë ndjekur praktikën e përcaktimit të detyrimeve gjatë kohës së provës sipas nenit 60 të K. Penal, ndërsa 2 gjyqtarë të tjerë jo në të gjitha vendimet përcaktojnë detyrime sipas nenit 60 të K. Penal.

Në rastin e kërkuarit të dënuar me burgim të përjetshëm<sup>47</sup>, me pranimin e kërkesës, nga ana e gjykatës është disponuar pas përcaktimit të kohës së provës edhe me përcaktimin e detyrimeve sipas nenit 60, pikat 9 dhe 10 të Kodit Penal.

### **Gjykata e Apelit Tiranë**

Referuar vendimit të vetëm të Gjykatës së Apelit<sup>48</sup> që ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, konstatohet se nuk është proceduar me urdhërime për detyrime për të dënuarin e vënë në provë, sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Në vendimet e tjera gjyqësore të Gjykatës së Apelit, ku është proceduar me lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore për pranimin e kërkesës lirim me kusht, dhe ku nuk ishte caktuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, nuk ka një qëndrim lidhur me këtë të fundit.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Në rastet e mësipërme nuk ka qëndrim të prokurorit për detyrimet gjatë kohës së provës, pasi ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë është bërë për shkaqe të tjera.

#### **4.4.5.2. Fillimi i afatit të provës:**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Mat dhe Krujë, të studiuara, konstatohet se në asnjë prej tyre nuk përcaktohet fillimi i afatit të provës.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 15 gjyqtarët, konstatohet se vetëm 4 prej tyre përcaktojnë në vendimet e tyre edhe fillimin e kohës së provës që është nga e nesërmja e

<sup>47</sup> vendimi nr. 6/123 Regjistri Themeltar, datë 14.01.2020.

<sup>48</sup> vendimi nr. 1102, datë 16.10.2019.

shpalljes së vendimit.

### **Gjykata e Apelit Tiranë:**

Në rastin e sipërcituar, të shqyrtuar nga Gjykata e Apelit ku është vendosur ndryshimi i vendimit të rrëzimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimi i kërkesës për lirim me kusht, lidhur me këtë çështje, nuk konstatohet që nga kjo gjykatë të ketë përcaktim për kohën e fillimit të provës.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

### **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimit të kërkesës “Lirim me kusht”**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës në tërësi jo të plotë<sup>49</sup> të administruar, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale të kësaj gjykate ku është pranuar kërkesa me objekt “Lirim me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës penale.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykimin është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuar.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga Prokurori i Apelit pjesëmarrës në seancë.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërisht të një urdhri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

---

<sup>49</sup> Dokumentacioni i sjellë nuk është i shoqëruar me inventarizim të akteve që pasqyrojnë të gjithë të dhënat për ekzekutimin për çdo rast.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “Lirim me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës penale.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “Lirim me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës penale.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga Prokurori i Apelit pjesëmarrës në seancë.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit



gjyqësor të formës së prerë, duke ia dërguar zyrës së shërbimit të provës, si dhe në rastin kur vendimi merr formë të prerë pa ankim.

**✚ Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirimi me kusht”, nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës, Elbasan dhe Kavajë, që përfshihen në Juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, ka rezultuar se:**

**1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale, dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundërvajtje penale. Gjithashtu asnjë prej kërkuesve në fjalë, të dënuar me burgim për krime nuk kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim të përjetshëm.

Të dënuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-së që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Peqin dhe IEVP Kosovë, Lushnjë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Durrës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Rrogozhinë.

Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjyqësore e përbërë nga një gjyqtar.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë evidentuar 6 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë evidentuar 7 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë janë evidentuar 6 gjyqtarë që kanë shqyrtuar kërkesat me objekt “lirim me kusht”.

Shortimi elektronik është përdorur si procedurë caktimi gjyqtari edhe në rastet e ndryshimit të gjyqtarit, për shkak të miratimit të heqjes dorë të gjyqtarit të caktuar me shortin fillestar, si edhe në rastet e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.

## **1.2. Në rastin e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë, konstatohet se:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan rezultojnë 75 kërkues të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”, pas një vendimmarrjeje të mëparshme për të njëjtën kërkesë.

Nga këto raste evidentohet se vetëm në 1 rast<sup>50</sup>, kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim mbi themelin e kërkesës/rrëzimit kërkesë nga gjykata e rrethit gjyqësor, dhe gjyqtari që i ka gjykuar është i njëjtë. Për gjykimin e këtyre dy kërkesave, gjyqtari është caktuar me short elektronik.

Për rastet e tjera kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim jopërfundimtar pushim gjykim/deklarim i papranueshëm për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Për këto raste gjyqtarët kanë rezultuar të ndryshëm në 1 rast dhe zgjedhja është bërë me short elektronik. Dhe për të tjerat, gjyqtari ka qenë i njëjtë. Për këto raste të fundit gjyqtari i parë është caktuar me short elektronik dhe i dyti me caktim për shkak të gjyqimit të mëparshëm, pa u përdorur procedura e shortit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës rezultojnë 10 kërkues të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”. Nga këto raste evidentohet se vetëm në 1 rast kërkesa e përsëritur është regjistruar gjatë gjyqimit të kërkesës së parë dhe për këtë rast, konstatohet se edhe kërkesa e dytë i është caktuar gjyqtarit që kishte të njëjtën kërkesë në gjykim, pa u proceduar me short. Për 9 rastet e tjera kërkesa e dytë është regjistruar pas vendosjes me vendim jopërfundimtar pushim gjykimi për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Për këto raste gjyqtarët kanë rezultuar të ndryshëm në 1 rast dhe zgjedhja është bërë me short elektronik edhe për përcaktimin e gjyqtarit për kërkesën e përsëritur.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë rezultojnë 5 kërkues të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”, pas një vendimmarrjeje të mëparshme për të njëjtën kërkesë. Për këto raste kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim jopërfundimtar pushim gjykim/deklarim i papranueshëm për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Gjyqtarët në 4 rastet kanë qenë të ndryshëm dhe janë caktuar me short elektronik. Ndërsa në 1 rast evidentohet që është i njëjtë dhe të caktuar me short elektronik për gjykimin e të dy kërkesave.

---

<sup>50</sup> Vendimi nr. 177, datë 18.07.2017 dhe vendimi nr. 43, datë 06.03.2018.

Vendimet gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Durrës dhe Kavajë, objekt i këtij inspektimi, për rastet të cilat janë bërë objekt apelimi, janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Durrës. Kjo e fundit i ka shqyrtuar këto apele me një trupë gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë, relatori i të cilës është përzgjedhur nëpërmjet shortit elektronik dhe plotësuar edhe me dy gjyqtarë të tjerë, sipas ndarjes së bërë për trupat me urdhër të Kryetarit të Gjykatës.

## **2. Palët pjesëmarrës në gjykim:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatohet se në gjykimet me objekt "lirim me kusht", si palë pjesëmarrëse thirren kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Gjatë gjykimit, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, konstatohet se janë ndjekur dy praktika.

Praktika e parë e ndjekur nga pesë gjyqtarë, sipas të cilit gjatë gjykimit janë thirrur si palë pjesëmarrëse thirren kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Për këto raste gjithmonë nga ana e gjyqtarëve gjatë gjykimit është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

Praktika e dytë e ndjekur nga ana e dy gjyqtarëve, sipas të cilit gjatë gjykimit përveç palëve më sipër, është thirrur edhe shërbimi i provës. Edhe në këto gjykime, krahas thirrjes së palës të shërbimit të provës, është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës. Edhe në këtë grup gjyqtarësh, është evidentuar që njëri prej tyre ka ndjekur edhe praktikën e parë.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, konstatohet se janë ndjekur dy praktika.

Praktika e parë e ndjekur nga njëri gjyqtar, sipas të cilit gjatë gjykimit janë thirrur si palë pjesëmarrëse kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Për këto raste gjithmonë nga ana e gjyqtarëve gjatë gjykimit është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

Praktika e dytë e ndjekur nga pjesa tjetër e gjyqtarëve, sipas të cilit gjatë gjykimit përveç palëve më sipër, është thirrur edhe shërbimi i provës. Edhe në këto gjykime, krahas thirrjes së palës të shërbimit të provës, është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

#### **2.1.Kërkuesi si palë pjesëmarrëse:**

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Durrës dhe Kavajë rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë, kërkuesi është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në të gjitha llojet e mënyrës së disponimit të gjykatës.

## **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është konstatuar se vetëm në 18 raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto raste kanë qenë kur nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për heqje dorë dhe nga gjykata është disponuar me pushim gjykimi/mospranim ankimi/deklarim i papranueshëm.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është konstatuar se vetëm në 23 raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto raste kanë qenë kur nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për heqje dorë dhe nga gjykata është disponuar me pushim gjykimi në një rast dhe deklarimin e papranueshmërisë së kërkesës në 22 rastet e tjera.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është konstatuar se vetëm në 17 raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto raste kanë qenë kur nga ana e gjykatës është vendosur moskompetenca tokësore 2 vendime, pushimi i gjykimit për shkak të heqjes dorë në 3 vendime dhe deklarimi i papranueshëm/mospranim në 12 vendime.

## **2.3. Gjykata e Apelit Durrës**

Referuar gjykimeve në Gjykatën e Apelit Durrës, konstatohet se përveç kërkuesit dhe prokurorit, është thirrur për të marrë pjesë IEVP. Në këto gjykime prokurori ka qenë i pranishëm, sikurse edhe kërkuesi është mbrojtur nga një avokat.

## **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht"**

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt "lirim me kusht" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga prokuroria pranë kësaj gjykate për të gjithë periudhën e inspektimit është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit nga seksioni i ekzekutimeve penale, që ka funksionuar në këtë periudhë. Në këtë seksion, të ngritur me urdhër të drejtuesit të prokurorisë, konstatohet se kanë qenë dy prokurorë deri në datën 14.04.2017, dhe në vazhdim referuar urdhrave të tjerë të nxjerrë nga drejtuesi i prokurorisë deri në datën 25.01.2018 përbërja e seksionit në fjalë është shtuar, duke shkuar në numër 3 dhe më tej në këtë seksion janë caktuar vetëm dy prokurorë që të do merreshin me ekzekutimin e vendimeve penale dhe përfaqësimin e organit të akuzës lidhur me këto çështje.

Seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale deri me urdhërin e datës 14.04.2017 ka funksionuar si seksion më vete, dhe më pas ky seksion është bashkuar me seksionin e hetimit dhe përfaqësimit në gjykim për veprat penale me të pandehur dhe të dëmtuar të mitur.

Caktimi i prokurorëve nga seksioni përkatës i ekzekutimeve të vendimeve penale, për përfaqësimin e prokurorisë në gjykimin e kërkesave “lirim me kusht” është bërë nëpërmjet shortit manual.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, nga prokuroria pranë kësaj gjykate deri në datën 25.02.2017, është proceduar me short manual, për caktimin e prokurorit përfaqësues në shqyrtimin e kërkesave “lirim me kusht”. Kjo mënyrë të proceduari, sipas informacionit të sjellë nga kjo zyrë, sollti një ndarje jo proporcionale dhe të paplanifikueshme në punën e prokurorëve për shkak dhe të ngarkesës së ndjekjes së çështjeve në hetim dhe gjykim. Për këtë shkak drejtuesi i prokurorisë me urdhërin e datës 08.09.2017 ka urdhëruar ndryshimin e praktikës, duke caktuar prokurorin e ekzekutimeve të vendimeve penale për përfaqësimin e prokurorisë në gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht”. Por edhe kjo mënyrë e të proceduarit ka krijuar ngarkesë të papërbalueshme të prokurorit të ekzekutimeve, duke passjellë edhe ndryshimin sërish të praktikës me urdhër të datës 19.04.2019 ku drejtuesi i prokurorisë urdhëroi caktimin e prokurorit me anë të ndarjes së tyre në mënyrë proporcionale. Sipas kësaj mënyre kërkesat në fjalë regjistroheshin në një regjistër elektronik dhe më pas bëhej ndarja e tyre pa procedurë shorti. Prokurorit që rezultonte pas ndarjes, i jepej një urdhër përfaqësimi nga drejtuesi i prokurorisë për përfaqësimin e çështjes në gjykatë.

Përgjatë kësaj periudhe, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë janë evidentuar mungesa dhe plotësim të organikës në vazhdimësi, me komandime tepër të shpeshta me periudha të caktuara kohe. Kështu më konkretisht për periudhën 3 vjeçare ka patur largime dhe komandime për 10 prokurorë. Dhe kjo ka passjellë edhe ndikimin e saj në problematikat e ngarkesës së krijuar dhe në mënyrën e të proceduarit për ndarjen e kërkesave në fjalë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga prokuroria pranë kësaj gjykate, përgjatë vitit 2017 është proceduar me caktim nga drejtuesi i prokurorisë ndër prokurorët pjesë e seksionit të ekzekutimeve të vendimeve penale (i quajtur seksioni për hetimin e veprave penale me persona të mitur, ekzekutimin e veprave penale dhe kërkesave në fushën e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë”), duke marrë në konsideratë ngarkesën e këtyre prokurorëve, ndërsa për vitet 2018 dhe 2019 e në vazhdim, caktimi i prokurorit është realizuar me short manual në seksionin me të njëjtin emërtim si më sipër.

Seksioni në fjalë, nga ku caktoheshin prokurorët për përfaqësimin e kërkesave “lirim me kusht”, deri në datën 27.02.2019 ka qenë i përbërë nga tre prokurorë, në vazhdim sipas urdhërit të drejtuesit datë 27.02.2019 ka qenë i përbërë nga 4 prokurorë, sipas urdhërit datë 18.05.2017 me tre prokurorë, sipas urdhërit datë 22.01.2018 nga 4 prokurorë, sipas urdhërit datë 30.01.2018 me 3 prokurorë, sipas urdhërit datë 17.04.2018 me 4 prokurorë dhe sipas urdhërit datë 18.12.2019 tre prokurorë.

### **Prokuroria e Apelit Durrës**



Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht" në Gjykatën e Apelit, konstatohet se është proceduar me anë të shortit manual ndërmjet 5<sup>51</sup> prokurorëve që konstatohen se kanë marrë pjesë në gjykimet me objekt "lirim me kusht", në periudhën e inspektimit.

#### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve 429, për 6 prej tyre është disponuar me shpallje moskompetence, për 65 me pushim kërkesë, për 79 prej tyre deklarim i papranueshëm, për 98 prej tyre mospranim, për 51 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 130 pranim kërkesë.

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 230 vendime, për 36 prej tyre me pushim kërkesë, për 95 prej tyre deklarim i papranueshëm, për 36 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 63 pranim kërkesë. Për këtë periudhë inspektimi nuk rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë të ketë disponuar me vendim për shpalljen e moskompetencës tokësore për kërkesa të të dënuarve me objekt "lirim me kusht".

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 124, për 13 prej tyre është disponuar me shpallje moskompetence, për 42 me pushim kërkesë, për 6 prej tyre deklarim i papranueshëm, për 6 mospranimin e kërkesës, për 26 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 31 pranim kërkesë.

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë dhe Durrës nuk konstatohet të ketë patur rast që të jetë disponuar lidhur me kërkesën e një të dënuari, për të cilin në vendimin e deklarimit fajtor dhe dënimit me burgim, të ishte disponuar edhe caktimi i një periudhe sigurie gjatë të cilës nuk lejohej zbatimi i nenit 64 të Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 65/a të K. Penal.

#### **4.1. Lidhur me arsyet, për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me shpallje moskompetence, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohet shpallja e moskompetencës, është transferimi i kërkuesit/të dënuarit nga IEVP Peqin në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kërkuesit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Peqin dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhërit përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimet.

<sup>51</sup> Ky numër prokurorësh ka ndryshuar, për shkak se dy prokurorë janë shkarkuar si rrjedhojë e procesit të rivlerësimit kalimtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
NJËSIA E INSPEKTORËVE

Nr. 56/29 Prot.

Tiranë, më 29. 12 .2023

**Raporti i Inspektimit**

**MBI KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK TË GJYKATAVE DHE ZYRAVE TË  
PROKURORIVE PRANË TYRE MBI TRAJTIMIN E KËRKESAVE ME OBJEKT  
“LIRIM ME KUSHT”**

në zbatim të

Vendimit nr. 1, datë 11.02.2020 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë, më 29. 12. 2023

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohet shpallja e moskompetencës, është transferimi i kërkuarit/të dënuarit nga IEVP Peqin në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kërkuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Durrës dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhërit përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimit.

### **4.2. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkesë, konstatohet se:**

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale.

Vendimet e pushimit në fjalë, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i përkasin viteve 2017 dhe 2018. Në vitin 2017 janë 10 vendime pushimi për shkak të shprehjes së vullnetit të kërkuarit për heqjen dorë nga gjykimi, të cilat i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet të 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja në të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është kryesisht për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale, dhe vetëm për 4 raste ka qenë për shkak të përfundimit të vuajtjes së dënimit dhe për shkak të përfitimit nga ligji për dhënie amnistie.

Vendimet e pushimit në fjalë, i përkasin viteve 2017 dhe 2018. Në vitin 2017 janë 18 vendime pushimi për shkak të shprehjes së vullnetit të kërkuarit për heqjen dorë nga gjykimi, të cilat i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet të 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.



4 rastet për të cilat është vendosur pushimi për shkaqet e tjera, i përkasin vitit 2017 dhe i përkasin periudhës para datës 01 gusht në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet të 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale.

Vendimet e pushimit në fjalë, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i përkasin viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Në vitet 2017 dhe 2018 janë 44 vendime pushimi për shkak të shprehjes së vullnetit të kërkuesit për heqjen dorë nga gjykimi, të cilat i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet të 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

### **4.3. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “deklarimin e papranueshëm të kërkesës”, konstatohet se:**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në këto raste arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë ka qenë kryesisht për shkak se kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa. Veçanërisht në 4 raste është vendosur me deklarami i papranueshëm, për shkak se kërkuesi nuk është paraqitur edhe pse kishte dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës, në 2 raste se kërkuesi ishte liruar, në 3 raste për shkak se kërkuesi ishte përsëritës për krime të kryera me dashje dhe në 1 rast për për shkak se kërkesa ka rezultuar haptazi e pabazuar në ligj, referuar mosparaqitjes nga kërkuesi të arsyes së veçantë. Për të gjitha këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale, të shoqëruar në disa raste me nenin 477 të K. Pr. Penale.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në këto raste arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë, ka qenë kryesisht për shkak se kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa. Veçanërisht në 5 vendime kërkuesi nuk është paraqitur edhe pse kishte dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës dhe në 2 vendime kërkuesi ishte liruar. Për të gjitha këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në të gjitha rastet arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë ka qenë se kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale.

### **4.4. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “mospranimin e kërkesës”, konstatohet se:**

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në këto raste arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë shkak në pjesën më të madhe të rasteve ka qenë se kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa. Veçanarisht në 5 raste evidentohet si shkak se kërkuesi ka kërkuar pushimin e gjykimit, në 5 raste se kërkuesi nuk u paraqit dhe në 1 rast se kërkuesi nuk plotësonte kriterin objektiv të  $\frac{3}{4}$  të vuajtjes nga dënimi me burgim<sup>52</sup>. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet me disponim “Mospranim i kërkesës” i përkasin të gjithë periudhës së inspektimit 2017-2020, ku nga këto 30 i përkasin periudhës pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Penale me ligjin me nr. 35/2017.

## **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Referuar vendimeve gjyqësore konstatohet se në 5<sup>53</sup> raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë ka qenë shkak mosplotësim i kriterit subjektiv – arsyes së veçantë sipas nenit 64 të K. Penal, dhe në 1<sup>54</sup> rast sepse kërkuesi kishte paraqitur dhe më parë kërkesë për lirim para kohe me kusht. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, vetëm nenin 64 të Kodit Penal, pa cituar dispozitë të Procedurës Penale.

Vendimet në fjalë i përkasin një gjyqtari dhe gjithashtu i përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019 dhe të gjithë periudhës pas datës 1 gusht 2017 të hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale sipas ligjit nr. 35/2017).

Në lidhje me rastet e disponimit me mospranim të kërkesës me arsyet e mosplotësimit të kriterit subjektiv në drejtim të arsyeve të veçanta, konstatohet se arsyetimi është mbështetur në analizën e të gjitha kriterëve bazuar në provat e administruar në gjykim, dhe duke konkluduar

<sup>52</sup> vendimi nr. 445, datë 28.05.2018, ku vendosur si bazë ligjore nenet 384, 471/2 dhe 477 të K. Pr. Penale,

<sup>53</sup> vendimi nr. 23/598 (11-2018-645), datë 12.02.2018, vendimi nr. (11-2017-1105) 34/613, datë 03.03.2017, vendimi nr. 11-2019-5577, datë 08.10.2019, vendimi nr. 11-2017-5599/473, datë 07.11.2017, vendimi nr. 11-2017-3701/267, datë 17.07.2017.

<sup>54</sup> Vendimi nr. 31/602, datë 12.02.2018, ku nga ana e gjyqtarit është proceduar duke u mbështetur në arsyetimin e periudhës 6 mujore referuar parashikimeve të nenit 477 të K. Pr. Penale.

në mospërbushjen e arsyeve të veçanta për të kaluar në disponim. Ky lloj disponimi për këto raste, nuk rezulton të jetë bërë objekt shqyrtimi në gjykatën e apelit.

Në lidhje me rastin e mospranimit të kërkesës për lirim me kusht me arsyen se kërkuesi kishte paraqitur edhe me parë kërkesë për lirim para kohe me kusht, gjykata e apelit pas shqyrtimit të ankimit të kërkuesit që ka kundërshtuar këtë vendim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, por për një shkak tjetër atë që lidhet me mosplotësimin e kriterëve të nenit 64 të K. Penal, në drejtim të kriterit subjektiv, arsyen e veçantë.

Në lidhje me rastin e mospranimit të kërkesës për lirim me kusht, me arsyen se përsëritjes së kërkesës pa kaluar afati i parashikuar në nenin 477 të K. Pr. Penale, vendimmarrja e gjykatës së rrethit gjyqësor është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit e cila nuk është shprehur lidhur me këtë mënyrë disponimi dhe gjithashtu nuk ka shqyrtuar këtë vendimmarrje në drejtim të këtij shkak. Gjykata e Apelit në këtë rast, megjithëse ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, ka anashkaluar argumentet dhe konkluzionin e kësaj gjykate duke analizuar të gjitha kushtet objektive dhe subjektive të institutit të lirit me kusht, dhe konkluduar mosplotësimin e arsyeve të veçantë.

**4.5. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/ “pranim i kërkesës për lirim me kusht”, konstatohet se:**


Në të gjitha këto raste, gjykatat kanë disponuar pas analizimit si të kriterëve objektive, ashtu edhe të kriterëve subjektive në raport me rrethanat e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për përfitimin e lirit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimit të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përbushja e këtyre kriterëve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun. Referuar këtij shkak, konstatohet se:

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuara në nenin 64 të K. Penal.

Veçanarisht në 7 prej vendimeve të rrëzimit të kërkesës, konstatohet se gjykata ka argumentuar faktin e të qenit përsëritës për një krim të kryer me dashje, krahas argumentit të mosplotësimi



të arsyeve të veçanta. Dhe në 1 prej vendimeve, është argumentuar fakti se kërkesa nuk është paraqitur nga i dënuari<sup>55</sup> por nga avokati i tij, i cili nuk kishte tagër përfaqësimi për kërkesën në fjalë.

Lidhur me vendimet ku gjykata ka disponuar për rrëzimin e kërkesës me arsyen se kërkuesi ka rezultuar përsëritës për një krim të kryer me dashje, konstatohet se janë ankimuar nga kërkuesi. Për këto ankime, Gjykata e Apelit Durrës në 1 rast ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor për shkak se e ka konsideruar të dënuarin të rehabilituar<sup>56</sup> dhe duke pranuar kërkesën për lirim me kusht, në 3 raste ka vendosur lënien në fuqi dhe në 3 raste ka vendosur mospranimin e ankimit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në vendimet ku gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Në veçanti në 1 prej tyre, konstatohet se gjykata ka argumentuar faktin se kërkuesi është përsëritës për krime të kryera me dashje dhe në 1 vendim rrëzimi ka argumentuar faktin e mosplotësimit të  $\frac{3}{4}$  të vuajtjes së dënimit, krahas argumentit të mosplotësimit të arsyeve të veçanta.

Në rastin e rrëzimit sepse kërkuesi ka rezultuar përsëritës për krime të kryera me dashje, është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe Gjykata e Apelit në përfundim të gjykimit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, duke bazuar arsyetimin e saj mbi të njëjtin kriter. Po ashtu dhe në rastin e rrëzimit të kërkesës për lirim me kusht për shkak të mosplotësimit të  $\frac{3}{4}$  të vuajtjes së dënimit, është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe Gjykata e Apelit në përfundim të gjykimit në lidhje me këtë ankim, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, duke arsyetuar plotësimin e kriterit objektiv të  $\frac{3}{4}$  të vuajtjes së dënimin në momentin e paraqitjes së kërkesës<sup>57</sup>.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin

---

<sup>55</sup> vendimi nr. 1087, datë 17.01.2018. Në vendim arsyetohet se kërkesa nuk është paraqitur nga i dënuari dhe se lidhur me këtë kërkesë nuk ka një akt përfaqësimi për mbrojtësin. Vendosur si bazë ligjore nenet 471, 477 të K. Pr. Penale dhe 64 K. Penal. Vendimi ka marrë formë të prerë datë 02.03.2018, pasi nuk është ankimuar.

<sup>56</sup> Për këtë rast dhe për të tjerat të cilat lidhen me arsyen e të rezultuarit përsëritës të kërkuesit për një krim të kryer me dashje, do të flitet më poshtë tek trajtimi i kushteve ndaluese.

<sup>57</sup> Për këtë rast, do të flitet më poshtë tek trajtimi i përlllogaritjes së kohës minimum i vuajtjes së dënimit.

e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Në 4 prej vendimeve të rrëzimit të kërkesës, konstatohet shkaku i ekzistencës së kriterit ndalues i të qenit përsëritës për një krim të kryer me dashje. Në lidhje me rastet e rrëzimit për këtë shkak, vetëm për tre vendime është ushtruar ankim nga kërkuesi/ i dënuari. Nga këto, rezulton se Gjykata e Apelit ka ndryshuar 1 vendim<sup>58</sup> duke vendosur edhe pranimin e kërkesës lirim me kusht, bazuar në një interpretim të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë përse i përket kriterit ndalues “përsëritës” sipas nenit 64 të K. Penal, në 1 rast ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi të kriterit ndalues dhe në 1 rast tjetër ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të formës<sup>59</sup>.

### **Gjykata e Apelit Durrës**

Lidhur me rastet që Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së faktit duke pranuar kërkesën për lirim, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe, është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruar në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm - kur arsyet e rrëzimit nga gjykata e rrethit gjyqësor ka qenë për mosplotësimin e arsyeve të veçanta dhe për 2 raste kur nuk është vlerësuar se nuk ndodhemi para kushtit të mosplotësimit të periudhës së vuajtjes së dënimit sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe kushtit ndalues “përsëritës” të parashikuar në të njëjtën dispozitë.

#### **4.5.1. Kriteri subjektiv:**

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë dhe Durrës, është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se të gjitha vendimet kanë një standard arsyetimi duke iu referuar qëndrimin të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehur me vendimin nr. 2/2015, në lidhje me shprehjen “arsye të veçanta”, duke bërë interpretimin në pika: *i) qëllimin e institutit të lirimit me kusht; ii) interpretimit tekstual të dispozitës, si dhe iii) hapat e nevojshme që gjykatat duhet të mbajnë në konsideratë në gjykimet me objekt:*

<sup>58</sup> vendimi nr. 10-2020-66, datë 16.01.2020, i Gjykatës së Apelit që ka ndryshuar vendimin nr.108 (11-2019-4207), datë 19.07.2019, që do të trajtohet më poshtë tek kushtet ndaluese.

<sup>59</sup> vendimi nr. 10-2018-2299/398, datë 04.12.2018, i Gjykatës së Apelit Durrës që ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 11-2018-3011/64, datë 14.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Rasti në fjalë do të trajtohet më poshtë tek kushtet ndaluese.

“Lirim me kusht”, administrimi i raporteve të IEVP dhe të shërbimit të provës, natyra e veprës penale, qëndrimi i personit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, kushtet familjare, si dhe në përfundimin planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e tij në shoqëri dhe qëndrimi që ka mbajtur i dënuari në raport me veprën penale të kryer.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin dhe konkludimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkues, konstatohet se në rast mosdakortësie nga ana e prokurorit apo kërkuesit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur kryesisht në të njëjtat prova të administruara gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

#### **4.5.2. Kriteret objektive**

##### **4.5.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit**

Llogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, referuar interpretimit lidhur me parashikimin e nenit 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan evidentohet se ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t’iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, lidhur me përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë evidentohet ndjekja e dy praktikave në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t’iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu 5 gjyqtarë në vendimmarrjet e tyre kanë ndjekur praktikën e interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, lidhur me përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, duke iu referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

Dhe 1 gjyqtar në vendimmarrjet e tij ka ndjekur si praktikën e mësipërme të 5 gjyqtarëve, ashtu edhe praktikën tjetër të referimit tek masa e dënimit e dhënë nga gjykata. Kështu gjyqtari në fjalë, rezulton se ka ndjekur praktikën e gjyqtarëve të tjerë në 64 vendime dhe praktika tjetër në 2 vendime. Referuar 2 vendimeve të fundit, konstatohet se pavarësisht praktikës së ndjekur, nga përllogaritja, koha minimum e vuajtjes së dënimit rezultonte se ishte përmbushur edhe duke iu referuar praktikës së përgjithshme. Për këto raste, konstatohet se vendimet kanë marrë formë të prerë pas kalimit të afateve ligjore, për mungesë të ushtrimit të ankimit nga ana e prokurorit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës evidentohet ndjekja e dy praktikave në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t'iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu 6 gjyqtarë në vendimmarrjet e tyre kanë ndjekur praktikën e interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, lidhur me përllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, duke iu referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

Dhe 1 gjyqtar në vendimmarrjet e tij ka ndjekur si praktikën e mësipërme të 6 gjyqtarëve, ashtu edhe praktikën tjetër të referimit tek masa e dënimit e dhënë nga gjykata.

### **Gjykata e Apelit Durrës**

Lidhur me qëndrimet sa më sipër, është konstatuar se nga Gjykata e Apelit, për përcaktimin e kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfutur lirin me kusht është ndjekur vetëm një praktikë, ajo e interpretimit sipas parashikimit në dispozitën përkatëse të veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar dhe për të cilën ka paraqitur kërkesën për lirim me kusht.

Kjo evidentohet qartë gjatë shqyrtimit mbi bazë ankimi të prokurorit lidhur me këtë interpretim, të 1 vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ku është ndjekur praktika e interpretimit të masës së dënimit të dhënë me vendimin gjyqësor, nga dënimi i të cilës kërkohet lirim me kusht. Kështu Gjykata e Apelit Durrës<sup>60</sup> është shprehur se: *“Gjykata e shkallës së parë në kundërshtim me nenin 64 të Kodit Penal ka aplikuar ndaj kërkuesit A. P., 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim kur duhet të aplikonte 3/4 të dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji. Kërkuesi rezulton se është dënuar me 5 vjet burgim për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal që ka një masë dënimi nga 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim e në këtë kontekst gjykata e shkallës së parë duhet të aplikonte 3/4 për masën e dënimit prej 5 vjet burgim të dhënë ndaj të dënuarit, kërkuesit ...”.*

---

<sup>60</sup> Vendimi nr. 338, datë 17.10.2017.

Rasti sa më sipër, është rasti i vetëm në të cilën është bërë objekt ankimi përlllogaritja e vuajtjes së dënimit referuar vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Kavajë, Durrës dhe Elbasan. Por edhe nga vendimet e tjera gjyqësore të Gjykatës së Apelit, nuk konstatohet që të ketë patur qëndrime të ndryshme rreth kësaj mënyre përlllogaritjeje të cilat janë hasur në vendimmarrjet e gjykatave të rretheve gjyqësore që janë ankimuar.

#### **4.5.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara në tërësi, për të cilat është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara në tërësi, për të cilat është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Në veçanti evidentohet në 1 rast<sup>61</sup> kur nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është proceduar me rrëzimin e kërkesës për shkak të mosplotësimit të kohës së vuajtur të dënimit që duhej të plotësohej në datën e paraqitjes së kërkesës, referuar parashikimeve të nenit 64 të K. Penal, për të përfituar lirim me kusht. Kështu gjykata ka arsyetuar se: *“Që i dënuari të gëzonte të drejtën e legjitimitetit për të paraqitur kërkesë me objekt lirim para kohe me kusht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duhet të kishte plotësuar kushtin primar, të kishte plotësuar në momentin e paraqitjes së kërkesës 42 (dyzet e dy) muaj burgim ,ose 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim duke mos llogaritur kohën e përfituar me amnisti dhe falje. Sipas akteve të paraqitura nga IEVP Rrogozhinë rezulton se deri më datë 27.10.2017 i dënuari xxx gjithsej ka vuajtur 3 vjet, 8 muaj burgim ,i dënuari në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim me datë 27.06.2017 ka vuajtur 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj që do të thotë se i dënuari xxx nuk ka plotësuar njërin nga kushtet kryesore të kërkesës për lirim me kusht, atë të vuajtjes jo më pak se ¾ e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet burgim, deri në maksimumin e parashikuar nga ligji”*. Ndaj vendimit në fjalë është ushtruar ankimi nga kërkuesi, dhe Gjykata e Apelit<sup>62</sup> ka pranuar këtë ankim duke arsyetuar ndër të tjera lidhur me kohën e mosplotësimit

<sup>61</sup> vendimi nr. 12-2018-257/55, datë 14.02.2018.

<sup>62</sup> vendimin nr. 10-2018-1047/168, datë 22.05.2018.



të periudhës së vuajtjes së dënimit, se: "... arsyetimi i gjykatës se në momentin e paraqitjes së kërkesës, kërkuesi nuk e kishte mbushur kohën e dënimit për të përfituar lirim me kusht, është i vërtetë, por gjykata nëse do ta kishte konstatuar në moment në referim të nenit 471/2 të K. Pr. Penale duhet ta kishte deklaruar të papranueshme kërkesën dhe jo të vazhdonte gjykimin. Me vazhdimin e gjyimit dhe me mbushjen e afateve për të përfituar lirim me kusht, kërkuetit nuk mund t'i mohohej e drejta për të përfituar nga kjo dispozitë, qëndrim i konsoliduar tashmë edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë." Nuk ka të dhëna që të jetë ushtruar rekurs.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara në tërësi, për të cilat është vendosur pranimi/rrëzimi i kërkesës "Lirim me kusht" për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Nga gjyqtarët të cilët kanë gjykuar kërkesat për lirim me kusht, konstatohet se një prej tyre në të gjitha vendimmarrjet e tij, ka ndjekur të njëjtën praktikë për përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të lirimit me kusht, duke iu referuar datës së kërkesës. Nuk janë evidentuar të ketë patur qëndrim të ndryshëm nga Gjykata e Apelit, lidhur me këtë praktikë, referuar rasteve të ankimit ndaj vendimeve të saj.

Lidhur me kriterin në fjalë, vlerësohet të evidentojmë në rast kur nga ana e prokurorit është ngritur si shkak ankimi, ndër të tjera, edhe mosplotësimi i periudhës prej  $\frac{3}{4}$  të dënimit duke iu referuar datës së paraqitjes së kërkesës. Rasti në fjalë i përket një të dënuari, të cilit i ishte pranuar kërkesa për lirim me kusht nga gjykata e rrethit gjyqësor. Gjykata e Apelit<sup>63</sup> lidhur me ankimin e prokurorit në drejtim të shkakut në fjalë, është shprehur se: "Po kështu nga aktet rezulton se i dënuari ka plotësuar kushtin tjetër ndalues me karakter objektiv të dispozitës konkretisht, ka vuajtur më shumë se  $\frac{3}{4}$  e masës së dënimit të dhënë pasi, sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të këtij të dënuari, të lëshuar nga IEVP Durrës me përlllogaritje të bëra me datën 14.05.2018, i dënuari nga dënimi i dhënë prej 7 vjet e 4 muaj burgim, ka vuajtur 05 vjet 8 muaj e 14 ditë burgim".

### **Gjykata e Apelit Durrës**

Referuar vendimmarrjeve të Gjykatës së Apelit Durrës konstatohet se qëndrimi i saj për përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, është për përlllogaritjen e saj deri në datën e shpalljes së vendimit. Ky qëndrim është shprehur qartë në rastin e sipërpërmendur, ku Gjykata e Apelit ka vendosur të ndryshojë vendimin e gjykatës

<sup>63</sup> Vendimi nr. 10-2018-2099, datë 14.11.2018.



së rrethit gjyqësor që kishte rrëzuar kërkesën pikërisht mbi bazën e argumentimit të mosplotësimit të këtij kriteri.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në të gjitha Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë dhe Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, nuk ka patur ankime lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatave të rretheve gjyqësore përsa i përket kufijve të përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

#### **4.5.2.3. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë dhe Durrës, nga të gjithë gjyqtarët është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

Ky qëndrim konstatohet se është mbajtur edhe nga Gjykata e Apelit Durrës në rastet kur ka shqyrtuar vendimet e pranimit/rrëzimit kur është analizuar përlllogaritja e kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të lirimit me kusht.

Gjithashtu, referuar vendimmarrjeve të tre rretheve gjyqësore, konstatohet se mbahet i njëjti qëndrim sa më sipër edhe nga prokuroria. Nuk konstatohen raste që përfitimi për shkak të punës në përlllogaritjen në kohën minimum të vuajtjes së dënimit, të jetë bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit Durrës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk janë konkluduar për raste të përfshirjes në përlllogaritje të periudhës së përfituar me amnisti dhe falje.

#### **4.5.2.4. Kushtet ndaluese:**

Nga vendimet e administruara të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë, Durrës është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me **kushtet ndalues “përsëritës” dhe për shkak të veprës penale të parashikuar** në nenit 64 të K. Penal. Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuarit të administruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimit.

Për kriterin në fjalë, është evidentuar në 5 raste vendim rrëzimi, që të jenë bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit, për të cilat për 2 ka vendosur ndryshim dhe pranim dhe për 3 të tjerat ka vendosur lënie në fuqi.

Për dy rastet e rrëzimit me vendim të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe për të cilën Gjykata e Apelit ka konkluduar në ndryshim vendimi duke pranuar kërkesën e ankuesit, konstatohet se:

Njëri rast i përket kërkesës së një të dënuari në shtetin italian, i cili kishte filluar vuajtjen e dënimit në Shqipëri pas njohjes së vendimit penal. Kërkuesi rezultonte se ishte dënuar në Itali për dy krime, në Shqipëri njohja për efekt ekzekutimi është bërë me një vendim gjyqësor dhe nga certifikata e gjendjes gjyqësore kërkuesi rezulton i padënuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ku është paraqitur kërkesa në fjalë, ka konkluduar në interpretimin e ndodhjes para kushtit “përsëritës” dhe për këtë arsye ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj vendimit rezulton të jetë ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Durrës e cila ka ndryshuar<sup>64</sup> vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor duke pranuar kërkesën për lirim me kusht duke arsyetuar se: *“Në lidhje me kushtin tjetër ligjor të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, për të cilin dhe është rrëzuar kërkesa nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit, ndryshe nga sa ka konkluduar gjykata e shkallës së parë, çmon se edhe ky kusht plotësohet pasi, kërkuesi (i dënuari) nuk rezulton të jetë përsëritës për vepra penale (krime) të kryera me dashje, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 07.03.2019 të lëshuar nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, që do të përbënte kusht ndalues për të përfutur nga kjo alternative ligjore. Fakti i dy dënimeve penale të formës së prerë në shtetin italian, nuk e bën atë përsëritës në krim për efekt të aplikimit të nenit 64 të Kodit Penal në fazën e ekzekutimit të dënimit në Shqipëri pasi, për efekt të transferimit të këtij të dënuari, dënimi i aplikuar në shtetin shqiptar është një i vetëm, pikërisht dënimi i bashkuar dhe konvertuar sipas legjislacionit shqiptar dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë.”* Ndaj këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar rekurs nga ana e prokurorit, në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është shqyrtuar ende.

Për rastin tjetër diskutimi për kriterin “përsëritës” është ngritur në drejtim të “rehabilitimit”. i dënuari/kërkues rezultonte të ishte dënuar në vitin 2011 për krim të parashikuar nga nenet 76, 25 dhe 22 të K. Penal duke u dënuar me 18 vjet burgim, ndërkohë që rezultonte nga dëshmia e penaltetit se ishte i padënuar dhe nga gjykata referuar vendimmarrjes së vitit 2011 ka konstatuar faktin se kërkuesi ka qenë më parë i dënuar me vendim të vitit 1999. Lidhur me këtë gjykata ka arsyetuar se: *“Si rrjedhojë kërkuesi do të konsiderohet si i dënuar më parë për një vepër penale të kryer me dashje në kuptim të nenit 64 të K. Penal, i cili parashikon se “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje”. Rehabilitimi merret në konsideratë nga gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për efekt të moskonsiderimit të saj si rrethanë rënduese, por kjo nuk shuan faktin që personi ka qenë më parë i dënuar në kuptim të nenit 64 të K. Penal. Ratio legis e këtij parashikimi ligjor është se personi nuk duhet të ketë qenë më parë i dënuar pavarësisht nëse është rehabilituar apo jo. Në kushtet kur kërkuesi është përsëritës, nuk plotësohet as kushti tjetër i domosdoshëm për aplikimin e nenit 64 të K. Penal.”* Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>65</sup>, e cila ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga gjykata e rrethit

<sup>64</sup> vendimi nr. 10-2020-66, datë 16.01.2020, i Gjykatës së Apelit Durrës.

<sup>65</sup> me vendimin nr. 10-2020-137/28, datë 28.01.2020, që ka ndryshuar vendimin nr. 880, datë 01.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke pranuar kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht.

gjyqësor lidhur me interpretimin në rastin konkret të të qenit përsëritës duke arsyetuar se: *“I dënuari nuk rezulton përsëritës sipas gjendjes gjyqësore të administruar në gjykim. Edhe vendimi i dënimit në të cilin referon gjykata pasqyron faktin se i dënuari është i rehabilituar në kohën e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë. Sipas nenit 69 të K. Penal rezulton se quhen të padënuar personat e dënuar të cilët kanë kaluar një kohë të caktuar pa kryer krime, dhe në rastin konkret gjykata e dënimit ka vlerësuar se kërkuesi është i padënuar për shkak të rehabilitimit. Kjo gjykatë nuk mund të bëjë një vlerësim ndryshe nga gjykata e dënimit për rrethana të trajtuara prej kësaj gjykate të cilat janë bërë tashmë të formës së prerë me lënien në fuqi të vendimit të dënimit nga gjykata më e lartë”*. Ndaj vendimit rezulton të jetë ushtruar rekurs nga prokurori i Apelit, në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është shqyrtuar ende.

Për dy rastet e tjera për të cilat është vendosur rrëzimi nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, konstatohet se:

Një rast i përket një të dënuari i cili rezulton të jetë dënuar për krimin e parashikuar në nenin 141 të K. Penal me 17 vjet burgim dhe më pas dënuar për një krim tjetër të parashikuar nga neni 189/1 i K. Penal. Gjykata e rrethit gjyqësor ka argumentuar se: *“I dënuari rezultoi se ai është i dënuar me parë për veprën penale të parashikuar nga neni 189/1 i K. Penal që parashikohen në K. Penal si krim, pra kërkuesi është përsëritës, gjatë kohës që kishte kryer një vepër penale dhe ishte dënuar e shmangur ekzekutimit të dënimit ka kryer një vepër tjetër penale krim (Shih vërtetimin e gjendjes gjyqësore të sjellë nga vetë kërkuesi) dhe sipas paragrafit të dytë të nenit 64 të K. Penal; “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje”, duke mos përmbushur në këtë rast një tjetër kusht ligjor ndalues i kërkuar nga neni 64 i K. Penal. Nga shqyrtimi në tërësi i të gjitha akteve provuese dhe fakteve të çështjes konkrete, gjykata krijoi bindjen që i dënuari, nuk përmbush plotësisht dhe njëkohësisht të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 64 të K. Penal për të përfutur lirimin e tij me kusht nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, për vetë kriteret specifike ligjore që përcakton dispozita konkrete procedurale penale, dhe si i tillë në vlerësimin e kushteve ligjore që nuk lejojnë në rastin konkret lirimin e të dënuarit me kusht.”*. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>66</sup>, e cila ka mbajtur të njëjtin lidhur me interpretimin në rastin konkret të të qenit përsëritës duke arsyetuar se: *“... kërkuesi figuron i dënuar me vendime gjyqësore të formës së prerë në periudha të ndryshme kohore (vitet 2005 dhe 2008) për krime të kryera me dashje dhe me të drejtë i është rrëzuar kjo kërkesë nga gjykata e shkallës së parë për shkak se kërkuesi nuk mund të lirohet me kusht mbasi figuron i dënuar përsëritës për krime të kryera me dashje”*.

Rasti i dytë, i përket një të dënuari që nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezultonte se ishte i padënuar, por nga intervistimi i familjarëve rezultonte i dënuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka konsideruar këtë fakt të fundit, si të provuar ekzistencën e kriterit ndalues duke arsyetuar ndër të tjera për rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se: *“I dënuari është i dënuar më*

<sup>66</sup> Vendimi nr. 10-2018-946 (150), datë 10.05.2018, i Gjykatës së Apelit ka vendosur, lënien në fuqi të vendimit nr. 13-2017-6293/1076, datë 18.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

parë, kusht ligjor i kërkuar në nenin 64 të K. Penal, i cili vlerësohet nëse është i rehabilituar për këtë dënim dhe që kërkuesi nuk e provoi një fakt të tillë për të konkluduar se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi lidhur me edukimin dhe risocializimin e të dënuarit në shoqëri. I dënuari nuk provoi para gjykatës një kusht tjetër thelbësor, ekzistencën e një arsyeje të veçantë”. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>67</sup>, e cila ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga gjykata e rrethit gjyqësor lidhur me interpretimin në rastin konkret të të qenit përsëritës duke arsyetuar se: “... referuar Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. 16 prot., datë 11.10.2017 rezulton se ndaj kërkuarit nuk ka dënime të tjera penale përveç dënimit të dhënë me vendimin nr. 1, datë 9.01.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Për këto arsye Gjykata e Apelit vlerëson se, plotësohet edhe kushti tjetër në lidhje me mosqenien përsëritës në krime të kryera me dashje. Në këtë pikë arsyetimi i gjykatës se kërkuesi ka qenë i dënuar më parë nuk provohet me aktet e administruara në dosje, pasi edhe në vetë vendimin me të cilin është dënuar kërkuesi, gjëndja gjyqësore e tij konstatohet ‘I pa dënuar’ dhe në referim të një interpretimi të zgjeruar të parashikimeve ligjore të nenit 390 të K. Pr. Penale, gjykata e shkallës më të ulët ka gabuar në vlerësimin e saj se i dënuari, ka qenë i dënuar edhe për një vepër tjetër penale”. Në përfundim, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi për shkak të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta.

Rasti tjetër, i përket një të dënuari që është dënuar në vitin 2014 për krimin e parashikuar nga neni 283/a-22 i K. Penal me 5 vjet burgim dhe për këtë kërkon lirim me kusht. Ky i dënuar rezulton sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore se është i dënuar edhe tre herë të tjera para vitit 1990 për krime të kryera me dashje. Gjykata e rrethit gjyqësor referuar këtyre të dhënave, e ka konsideruar si përsëritës të dënuarin kërkuar me arsyetimin se: “Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11, datë 19.05.2017 rezulton se kërkuesi i dënuari xxx, është dënuar më parë dhe tre herë të tjera për krime të kryera me dashje, pavarësisht se kërkuesi pretendon se është dënuar para vitit 1990, konkretisht për veprat penale të “Vjedhjes”, “Kundërshtim me dhunë të punonjësit të shtetit” dhe “Fyerjes për shkak të detyrës”, konkretisht vendimet e gjykatës Durrës nr. 47, datë 13.03.1982, nr. 51, datë 03.03.1984, dhe nr. 162, datë 14.06.1986 të gjykatës Elbasan. Së treti: Sipas nenit 64/3 të K. Penal nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a 79/b, 79/c, apo paragrafi i tretë i nenit 100. Nisur sa më sipër gjykata bazuar në nenin 64 të K. Penal konstaton se, i dënuari xxx nuk plotëson një nga kushtet detyruese të parashikuara nga neni 64/ i K. Penal (pa përmendur arsyet e tjera), pasi ai është i dënuar më parë për kryerjen e veprës penale që cilësohen si krime, për të cilat nuk lejohet lirimi me kusht, duke mos përmbushur në këtë rast kushtet ligjore thelbësore të lirimimit me kusht.” Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>68</sup>, e cila ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga gjykata e rrethit gjyqësor lidhur me interpretimin në rastin konkret të të qenit përsëritës duke arsyetuar se: “... I dënuari për efekt

<sup>67</sup> Vendimi nr.10-2019-258 (41), datë 14.02.2019, i Gjykatës së Apelit ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit penal nr. 67 (13-2018-3650), datë 20.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>68</sup> vendimi nr. 10-2018-160/24, datë 29.01.2018, Gjykata e Apelit ka vendosur, lënien në fuqi të vendimit nr. 438, datë 12.06.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

të kërkesës për lirim me kusht nuk konsiderohet përsëritës për krime të kryera me dashje. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 datë 19.05.2017 rezulton se kërkuesi i dënuari xxx është dënuar më parë dhe tre herë të tjera për krime të kryera me dashje, pavarësisht se kërkuesi pretendon se është dënuar para vitit 1990, konkretisht për veprat penale të "Vjedhjes", "Kundërshtim me dhunë të punonjësit të shtetit" dhe "Fyerjes për shkak të detyrës", konkretisht vendimet e Gjykatës Durrës nr. 47, datë 13.03.1982, nr. 51, datë 03.03.1984, dhe nr. 162, datë 14.06.1986 të Gjykatës Elbasan. Gjykata e Apelit, në mbështetje të nenit 69 të K. Penal, vlerëson se i dënuari quhet i padënuar më parë për shkak të kohës së kaluar që nga dënimi i fundit në vitin 1986 dhe deri në momentin kur ka kryer veprën penale, datë 29.05.2014, vepër për të cilën po vuan aktualisht dënimin. Gjithashtu i dënuari nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale pas dënimit të dhënë për faktin penal të vitit 2014." Në përfundim, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi për shkak të mosprovueshmërisë së arsyeve të veçanta.

Referuar vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan, Kavajë dhe Durrës nuk u evidentua në asnjë rast mosrespektimi i kushtit ndalues për shkak të veprës penale. Lidhur me këtë kriter, vlerësohet të parashtrohet një rast kur është ngritur si diskutim interpretimi lidhur me këtë kriter ndalues.

Rasti bën fjalë për një kërkues<sup>69</sup>, i cili ishte dënuar për kryerjen në vitin 2007 të veprës penale të parashikuar nga neni 78/1 i K. Penal, për vrasjen e bashkëshortes së tij, dhe nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është argumentuar fakti i përfshirjes së kësaj vepre në veprat penale për të cilat neni 64 i K. Penal parashikon ndalimin e përfitimit të lirit me kusht. Kështu më konkretisht, gjykata ka arsyetuar se: "Edhe pse formalisht vepra penale për të cilën është dënuar kërkuesi nuk përfshihet në kategorinë e veprave penale për të cilat nuk lejohet lirimi me kusht, për sa kohë që kualifikimi i faktit penal sipas ligjit të kohës ka qenë sipas nenit 78/1 të K. Penal, gjykata vlerëson se materialisht kërkuesi është në kushtet e ndalimit të lirit me kusht pasi ndalimi i nenit 64 të K. Penal nuk ka të bëjë thjesht me numërtimin e dispozitës por me marrëdhënien juridike që ka marrë në mbrojtje. Për sa kohë personat e dënuar për veprën penale të parashikuar në nenin 79/c të K. Penal përjashtohen nga e drejta për lirim me kusht pikërisht për shkak të marrëdhënies që ka marrë në mbrojtje kjo dispozitë, duke qenë se subjekt pasiv është personi që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, si dhe rrezikshmërisë shumë të lartë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, gjykata vlerëson se edhe kërkuesi xxx për sa kohë është dënuar për vrasjen e bashkëshortes së tij, nuk mund të përfitojë lirin me kusht. Edhe pse në kohën e kryerjes së veprës penale në vitin 2007 neni 64 i K. Penal nuk e parashikonte një ndalim të tillë, gjykata i referohet parashikimit aktual të nenit 64 të K. Penal për arsye se ligji i kohës zbatohet vetëm për sa i përket kryerjes së veprës penale në funksion të kualifikimit të faktit penal dhe përcaktimit të masës së dënimit, ndërsa për sa i përket kërkesave që i përkasin fazës së ekzekutimit të vendimit zbatohet ligji i kohës në të cilën

<sup>69</sup> vendimi nr. 11-2018-3011/64, datë 14.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

shqyrtohet kërkesa”. Ndaj vendimit në fjalë ka ushtruar ankim kërkuesi dhe nga Gjykata e Apelit<sup>70</sup> është vendosur mospranim për shkak se nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji.

#### **4.5.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”**

##### **Koha e kushtit/provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Në vendimet e pranimit të lirimimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi, është konstatuar se 3 gjyqtarë në vendimmarrje kanë përcaktuar një kohë prove të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim dhe 3 gjyqtarë kanë përcaktuar kohë të barabartë dhe më të madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Për këtë, konstatohet se nga gjyqtarët është arsyetuar në pjesën arsyetuese të vendimit, duke u mbështetur në qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Përsa i përket gjyqtarëve të cilët kanë disponuar referuar praktikës së kohës së provës më të madhe dhe të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, është konstatuar ndjekja e praktikës së njëjtë në një të njëjtën periudhë kohe. Konstatohet se fillimisht është ndjekur praktika e kohës më të madhe dhe më pas për të kaluar në ndjekjen e praktikës së përcaktimit të kohës së barabartë të provës me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, për të gjitha rastet e pranimit të kërkesës lirim me kusht.

Në 1 rast rezulton se vendimi lidhur me kohën e provës, është bërë objekt ankimi nga prokurori i cili ka argumentuar për periudhën e kushtit, duke referuar në ndryshimet që ka pësuar neni 59 i K. Penal, me ligjin nr. 36/2017. Më konkretisht prokurori në ankimin e tij argumenton se: “... me ligjin nr. 36/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi, janë bërë këto ndryshime në nenin 59 të Kodit Penal: Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje: 3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.” - Paragrafi 3 numërohet paragrafi 4 dhe ndryshohet si më poshtë: “4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmeja shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.” - Duke iu referuar paragrafit të 4 të nenit 64 të Kodit Penal, koha e provës, duhet të jetë afati prej 24 muaj dhe për të dënuarin duhet të caktohet si kohë prove afati prej 24 muaj, gjatë së cilës i dënuari duhet të përmbushë detyrimet e urdhëruara nga gjykata në bazë të nenit 60 të Kodit Penal”. Ankimi i prokurorit rezulton të jetë përkrahur edhe nga prokurori i apelit. Gjykata e Apelit në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor duke argumentuar se: “Neni 64 i K. Penal ka parashikuar se kur pranohet kërkesa e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, gjykata ka detyrimin që ndaj këtij të dënuari të caktojë dhe një kohë kushti në të cilën ky i dënuar nuk duhet të kryejë vepra të

<sup>70</sup> vendimi nr. 10-2018-2299/398, datë 04.12.2018 i Gjykatës së Apelit Durrës.

tjera penale. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2015 shkrehet se; “Në mungesë të një rregullimi ligjor mbi periudhën e kushtit dhe referim të qëllimit të institutit të lirimit me kusht, kjo kohë nuk mund të jetë më e shkurtër se koha që i mbetet për t’u vuajtur të dënuarit. Ky interpretim mbështetet edhe në argumentin se ndërkohë që çdo caktim i periudhës së kushtit përtej kohës së mbetur të dënimit do të konsiderohej si i pambështetur në ligj, rasti i kundërt, pra caktimi i një periudhe kohe më të shkurtër se koha e mbetur e dënimit, do të shkonte kundër qëllimit të institutit të lirimit me kusht si dhe do të ulte efektivisht masën e dënimit të dhënë nga gjykata me vendim të formës së prerë”, duke definuar në këtë përfundim detyrues për gjykatat si më poshtë; “Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht”.

Për sa më sipër kjo gjykatë vlerëson se në zbatim të vendimit Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2015, koha e provës që duhet ti caktohet të dënuarit Emirjan Ferko duhet të jetë 6 muaj e 6 ditë, aq sa është dhe koha e mbetur nga masa e dënimit me burgim të pavuajtur nga i dënuari”.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Në këtë gjykatë evidentohet se mbahet i njëjti qëndrim lidhur me disponimin mbi kohën e kushtit, qëndrimi që e barazon periudhën e kushtit me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit me burgim të dhënë për të dënuarin/kërkuuesin. Në këtë gjykatë është evidentuar edhe një vendim që nuk përcakton fare kohën e kushtit<sup>71</sup>. Në lidhje me këtë rast rezulton të mos jetë ushtruar ankimi as nga i dënuari dhe as nga prokurori.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Në këtë gjykatë lidhur me kohën e kushtit evidentohet se në tërësi mbahet qëndrimi i disponimit të një periudhe të barabartë me pjesën e mbetur të pavuajtur. Veçanërisht në 1 rast është evidentuar caktimi i një kohe kushti më të vogël sesa pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit dhe në 1 rast caktimi i një periudhe sa dyfishi i kohës së periudhës së mbetur të pavuajtur të dënimit. Në këto vendime citohet vendimi unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por nuk ka një argumentim konkret se përse përcaktohet si kohë prove një periudhë më e vogël apo sa dyfishi i kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit.

### **Gjykata e Apelit Durrës**

Në këtë gjykatë, lidhur me kohën e kushtit, konstatohet se në përgjithësi referuar vendimmarrjeve të ndryshimit dhe pranimit të kërkesës për lirim me kusht, është proceduar me disponimin për caktimin e një kohe prove të njëjtë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Në veçanti evidentohen dy vendime ku në njërin është disponuar me përcaktimin e kohës së

---

<sup>71</sup> Vendimi nr. 12-2017-1404/345, datë 13.09.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.



provës më të vogël<sup>72</sup> sesa periudha e mbetur e vuajtjes së dënimit dhe në tjetrën në përcaktimin e kohës së provës më të madhe<sup>73</sup> sesa periudha e mbetur e vuajtjes së dënimit.

Në lidhje me dy rastet e fundit të përcaktimit të kohës së kushtit, në vendimmarrjet e gjykatave nuk konstatohet të ketë arsyetim konkret në drejtim të kësaj kohe. Gjithashtu konstatohet se trupat gjykuese që kanë dhënë vendimet respektive, kanë ndjekur gjatë kësaj kohe edhe praktikën e përcaktimit të kohës së provës të njëjtë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Referuar të dhënave të administruara lidhur me vendimmarrjet dhe ankimet, është konstatuar vetëm në 1 rast, i sipërpërmendur, që periudha e kushtit të jetë bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit. Në rastet e tjera, ku përfshihen edhe rastet e evidentuara në Gjykatën e Apelit përsa i përket përcaktimit të kohës së provës, nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit nga leximi i vendimeve gjyqësore, dhe gjithashtu nuk evidentohet të jetë ushtruar rekurs në këtë drejtim.

### **Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë, konstatohet se:**

Në vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore konstatohet se në përgjithësi nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, por duke mos e përcaktuar saktësisht me vit, muaj dhe ditë. Në veçanti është vënë re se 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në të gjitha vendimmarrjet në pjesën e dispozitivit përcakton saktësisht kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Gjithashtu edhe në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet se nuk përcaktohet saktësisht pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

#### **4.5.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimit kanë disponuar lidhur me detyrime sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

---

<sup>72</sup> Vendimi nr. 10-2017-2808 (883), datë 16.11.2017. Sipas këtij vendimi, kërkuesit i është caktuar një periudhë kohe prove prej 6 muaj, ndërsa të dënuarit i kishin mbetur pa vuajtur 6 muaj e 20 ditë burgim deri në ditën e gjykimit. Lidhur me këtë vendim, nuk ka rekurs nga ana e prokurorit. Gjatë gjykimit në apel, prokurori i apelit ka qenë kundër pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

<sup>73</sup> Vendimi nr. 10-2020-66, datë 16.01.2020. Sipas këtij vendimi, kërkuesit i është caktuar një periudhë kohe prove 2 vjeçare, ndërsa të dënuarit i kishin mbetur pa vuajtur 1 vit, 9 muaj e 12 ditë burgim deri në ditën e gjykimit. Për këtë vendim rezulton se është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit që ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe lënien në fuqi të vendimit të kësaj të fundit. Në rekurs nuk evidentohet që të jetë cituar si argument kjo periudhë kohe.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi kanë disponuar lidhur me detyrimet sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Më konkretisht referuar sa më sipër, për periudhën objekt inspektimi konstatohet se 2 gjyqtarë në të gjitha vendimmarrjet e tyre, kanë proceduar me urdhërimin në dispozitiv të detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal; 1 gjyqtar në të gjitha vendimmarrjet e tij nuk procedon në dispozitiv me urdhërimin për përcaktimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal dhe 2 gjyqtarë në vendimet e tyre nuk mbajnë të njëjtin qëndrim në parashikimin e detyrimeve në drejtim të vendosjes në të gjitha rastet të detyrimeve. Në vendimmarrjet e këtyre dy gjyqtarëve konstatohen si raste të përcaktimit në dispozitiv të detyrimeve ashtu edhe të mospërcaktimit të ndonjë detyrimi sipas nenit 60 të K. Penal.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi janë shprehur lidhur me detyrimet sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Kështu nga 5 gjyqtarë të cilët kanë disponuar me vendim për pranimin e kërkesës për lirim me kusht, vetëm 2 shprehen në dispozitiv për detyrimet sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

### **Gjykata e Apelit Durrës**

Në vendimet e kësaj gjykate, në të cilat ka ndryshuar vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht, jo të gjitha trupat e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës kanë proceduar me përcaktimin në dispozitiv të detyrimeve sipas parashikimeve në nenin 60 të K. Penal. Kjo mënyrë e të proceduarit sipas trupave konstatohet se është e njëjtë për të gjithë vendimmarrjet e tyre përgjatë periudhës objekt i këtij inspektimi. Kështu nga 6 trupa që kanë proceduar me pranim të kërkesës për lirim me kusht, dy trupa nuk kanë përcaktuar në asnjë nga vendimmarrjet e tyre detyrime sipas nenit 60 të K. Penal.

Gjithashtu referuar vendimmarrjeve sa më sipër, konstatohet se në një rast<sup>74</sup> mbi bazë ankimi prokurori, gjykata ka shqyrtuar edhe shkakun e ankimit të prokurorit lidhur me përcaktimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal, duke plotësuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor me përcaktimin e detyrimit përkatës. Më konkretisht bëhet fjalë për një rast kur gjykata e rrethit gjyqësor kishte pranuar kërkesën për lirim me kusht dhe nuk kishte përcaktuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal. Ndaj këtij vendimi, prokurori i seancës në gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor ka ushtruar ankim në apel duke pretenduar ndër të tjera edhe mosrespektim nga ana e

---

<sup>74</sup> Vendimi nr. 10-2018-2099 (365), datë 14.11.2018 i Gjykatës së Apelit Durrës që ka lënë në fuqi vendimin nr. 257 (11-2018-3559), datë 11.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

gjykatës të kërkesave të nenit 60 të K. Penal në lidhje me vënien e të dënuarit në provë. Ky shkak është marrë në trajtim nga ana e Gjykatës së Apelit e cila e ka pranuar duke u shprehur në vendim se: *“Vendimi duhet të plotësohet duke u përcaktuar masat që duhet të respektojnë i dënuari gjatë kohës së provës, për të cilat nuk është shprehur gjykata e shkallës së parë”*, dhe duke disponuar lënien në fuqi me plotësimin se: *“I dënuari gjatë kohës së provës duhet të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Durrës dhe t’i nënshtrohet programit rehabilitues që do të hartohet nga kjo zyrë”*.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Referuar vendimmarrjeve të Gjykatës së Apelit, është evidentuar vetëm në 1 rast i sipërcituar ankimi i prokurorit lidhur me respektimin e parashikimit ligjor të përcaktimit të detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

#### **4.5.2.5.2. Fillimi i afatit të provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit. Më konkretisht nga 7 gjyqtarë, evidentohet se vetëm 4 prej tyre përcaktojnë në të gjitha vendimet parashikimin e kohës së fillimit të afatit të kushtit, ndërsa tek gjyqtarët e tjerë konstatohet se nuk ka qëndrueshmëri në këtë drejtim. Në vendimet e pranimi për të cilat është përcaktuar koha e fillimit të afatit të kushtit rezulton të jetë përcaktuar të nesërmen e shpalljes së vendimit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi nuk janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, jo të gjithë gjyqtarët të cilët kanë konkluduar me vendim pranimi janë shprehur lidhur me kohën e fillimit të afatit të kushtit e cila përcaktohet të nesërmen e shpalljes së vendimit. Më konkretisht nga 6 gjyqtarët që janë shprehur me vendim pranimi lirim me kusht, konstatohet se vetëm 1 prej tyre ka përcaktuar në të gjitha vendimmarrjet e tij kohën e fillimit të afatit të kushtit.

##### **Gjykata e Apelit Durrës**

Referuar vendimmarrjeve të Gjykatës së Apelit, konstatohet se nga 18 vendimet e saj, në të cilat ka ndryshuar vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht, në 15 prej tyre nuk përcaktohet fillimin i afatit të provës. Për rastet e tjera në të cilën është parashikuar fillimi i afatit të provës, është përcaktuar se ky afat fillon të nesërmen e shpalljes së vendimit.

## **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

## **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimit të kërkesës “Lirim me kusht”**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës në tërësi jo të plotë<sup>75</sup> të administruar, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale të gjykatës së rrethit gjyqësor ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirim i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirim i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirim e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga Prokurori i Apelit pjesëmarrës në seancë, duke filluar nga viti 2018. Ndërsa më parë bëhej nga prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor.

Në rastet kur lirim i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënie në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin

---

<sup>75</sup> Dokumentacioni i sjellë nuk është i shoqëruar me inventarizim të akteve që pasqyrojnë të gjithë të dhënat për ekzekutimin për çdo rast.

gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuksi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë, duke filluar nga viti 2018. Ndërsa më parë bëhej nga prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhëri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirimin me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuksi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhëri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga prokurori i apelit pjesëmarrës në seancë, duke filluar nga viti 2018. Ndërsa më parë bëhej nga prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor.

#### **✚ Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirimi me kusht”, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, që përfshihen në Juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, ka rezultuar se:**

##### **1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkuksi në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale, dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundërvajtje penale. Gjithashtu nga kërkuksit, konstatohet se 1 prej tyre ka qenë duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm.

Të dënuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-së Drenovë, Korçë që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me paraqitjen e kërkesave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen short elektronik për caktimin e gjyqtarit të vetëm që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjyqësore e përbërë nga një gjyqtar.

Shorti elektronik është përdorur si procedurë caktimi gjyqtari edhe në rastet e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke u caktuar në pjesën më të madhe sërish i njëjti gjyqtar që kishte gjykuar edhe kërkesën e mëparshme.

Gjithashtu shorti elektronik është përdorur për përcaktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Apelit Korçë, i plotësuar më pas edhe me dy gjyqtarë të tjerë, sipas ndarjes së bërë për trupat me urdhër të Kryetarit të Gjykatës. Gjykimi i kërkesave të tilla në Gjykatën e Apelit Korçë është bërë nga një trupë gjyqësore e përbërë nga tre gjyqtarë, si dhe në tre raste është plotësuar trupa me gjyqtarë të komanduar.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, kërkesat me objekt “Lirim me kusht” janë shqyrtuar nga 6 (gjashtë) gjyqtarë të dhomës penale, ku të përditësuar në 4 vite janë përfshirë 11 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën e Apelit nga dy trupa gjyqësore.

### **1.1. Në rastin e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë, konstatohet se:**

Për periudhën e inspektimit, kanë rezultuar 22 kërkues të cilët kanë paraqitur të njëjtën kërkesë “lirim me kusht”, pas një vendimmarrje të mëparshme lidhur me të. Në të gjitha këto raste, kërkesa e përsëritur është regjistruar pas vendosjes me vendim jopërfundimtar pushim gjykimi/deklarim i papranueshëm dhe në përfundim është vendosur “Pranimi i kërkesës”, “Rrëzimi i kërkesës” dhe “Deklarim i papranueshëm”.

Për këto raste, kërkesat janë shqyrtuar nga gjyqtarë të ndryshëm në 4 raste dhe për të tjerat, raste të tjera gjyqtari ka qenë i njëjtë. Për caktimin e gjyqtarit për të gjitha këto raste, është proceduar në të gjitha rastet me anë të shortit elektronik.

Gjithashtu është konstatuar një rast kur i njëjti kërkues ka paraqitur të njëjtën kërkesë për “lirim me kusht”, kur ende ishte në proces kërkesa me të njëjtin objekt. Në këtë rast, që është i vitit 2019 rezulton se gjyqtari i zgjedhur me short elektronik që ka shqyrtuar kërkesën e dytë me të njëjtin objekt ka qenë i njëjti që kishte në proces gjykimi kërkesën e parë, dhe ka proceduar në vazhdim me gjykime të veçanta duke disponuar për të dy kërkesat “Deklarimin e papranueshëm”.

### **2. Palët pjesëmarrëse në gjykim**

Referuar vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor, konstatohet se në gjykimet me objekt “Lirim me kusht”, si palë pjesëmarrëse thirren si rregull kërkuesi, prokurori dhe Institucioni i Vuajtjes së Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Gjatë gjykimit, nga ana e gjyqtarëve



është kërkuar dhe është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **2.1. Kërkuesi si palë pjesëmarrëse**

Kërkuesi si palë pjesëmarrëse, rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë në rrethin gjyqësor, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në të gjitha llojet e mënyrës së disponimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.

Në Gjykatën e Apelit Korçë, kërkuesi rezulton i asistuar nga mbrojtësi.

### **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse**

Lidhur me prokurorin si palë pjesëmarrëse, nga vendimet gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor është konstatuar se vetëm në dy raste, nga gjykata është proceduar pa pjesëmarrjen e prokurorit. Këto dy raste kanë qenë kur nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për heqje dorë dhe nga gjykata është disponuar me pushim gjykimi.

### **2.3. Gjykata e Apelit Korçë**

Referuar gjykimeve në Gjykatën e Apelit Korçë, konstatohet se përveç kërkuesit dhe prokurorit, është thirrur për të marrë pjesë IEVP. Në këto gjykime prokurori ka qenë i pranishëm, sikurse edhe kërkuesi është mbrojtur nga një avokat.

### **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”**

#### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, konstatohet se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të gjithë periudhën e inspektimit është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit që ka përfaqësuar çështjen në procesin e gjykimit, kur kërkuesi ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në ndryshim nga rregulli në fjalë, nëse prokurori i zyrës së prokurorisë Korçë i cili kishte qenë përfaqësues i prokurorisë në gjykimin e themelit, apo nëse kërkuesi ishte dënuar nga një gjykatë tjetër ku si përfaqësues prokurorie ka qenë një prokuror i një zyre tjetër prokurorie (jo i zyrës Korçë), caktimi i prokurorit në gjykimin me objekt “lirim me kusht” bëhej nga drejtuesi i Prokurorisë bazuar në ngarkesën e punës.

#### **Prokuroria e Apelit Korçë**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Apelit Korçë, konstatohet se është proceduar me anë të shortit manual, për shkak të mosdisponimit të sistemit elektronik për hedhjen e shortit. Prokuroria e Apeli ka patur në organikë dhe ka funksionuar për periudhën e inspektimit, me 2 prokurorë.

### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**



Nga vendimet gjyqësore të administruara, rezulton se për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve 207, për 5 prej tyre është disponuar me shpallje moskompetence, për 27 me pushim kërkesë, për 46 prej tyre deklarim i papranueshëm, për 65 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 64 pranim kërkesë.

Nga vendimet gjyqësore në fjalë konstatohet se nga ana e gjyqtarëve tregohet kujdesi për të evidentuar qartë, arsyet e konkludimit nga ana e tyre duke u mbështetur në pasqyrimin e rrethanave të faktit dhe analizës ligjore përkatëse.

Nga vendimet e gjykatës të rrethit gjyqësor nuk konstatohet të ketë patur rast që të jetë disponuar lidhur me kërkesën e një të dënuari, për të cilin në vendimin e deklarimit fajtor dhe dënimit me burgim, të ishte disponuar edhe caktimi i një periudhe sigurie gjatë të cilës nuk lejohej zbatimi i nenit 64 të Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 65/a të K. Penal.

#### **4.1. Lidhur me arsyet, për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me shpallje moskompetence, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës, është transferimi i kërkuarit/të dënuarit nga IEVP Drenovë, Korçë në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kërkuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Drenovë, Korçë dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhrat përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimit.

Gjykimi në këto seanca është zhvilluar në mungesë të kërkuarit dhe të pranishëm kanë qenë, përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe i IEVP-së Korçë, të cilët kanë mbajtur qëndrimin e tyre se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk është kompetente për gjykimin e këtyre kërkesave. Në vazhdim, pas marrjes së mendimit të palëve pjesëmarrëse në gjykim, nga ana e gjykatës është proceduar me marrjen e vendimit për shpalljen e moskompetencës.

#### **4.2. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkesë, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt; *"Lirim me kusht"*. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e pushimit në fjalë i përkasin viteve 2017 dhe 2018. Në vitin 2017 janë 23 vendime, nga të cilat 14 i përkasin periudhës pas datës 01 gusht, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.



**4.3. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “deklarimin e papranueshëm të kërkesës”, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt; “*Lirim me kusht*”. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, neni 471 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet në fjalë i përkasin viteve 2017, 2018, 2019. Në vitin 2017 është vetëm një vendim i tillë dhe i përket periudhës pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale sipas ligjit nr. 35/2017.

**4.4. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/ “pranim i kërkesës për lirim me kusht”, konstatohet se:**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**

Në të gjitha këto raste, gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka disponuar pas analizimit si të kritereve objektive, ashtu edhe të kritereve subjektive në raport me rrethanat e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Referuar këtyre vendimeve, konstatohet se nuk ka patur diskutime lidhur me kushtet ndaluese të parashikuara në nenet 64 dhe 65 të K. Penal apo përsëritjes së një kërkesë pa kaluar afati i parashikuara nga neni 477/2 i K. Pr. Penale.

Në gjykatën e rrethit gjyqësor, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përmbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për përfitimin e lirit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimin të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përmbushja e këtyre kritereve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun, i cili për të gjitha rastet rezulton të ketë qenë për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kritereve objektive të parashikuara në nenin 64 të K. Penal.

**Gjykata e Apelit Korçë**

Lidhur me rastet që Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së faktit duke pranuar kërkesën për lirim, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe, është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruar në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimin është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm.

#### **4.4.1. Kriteri subjektiv:**

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se të gjitha vendimet kanë një standard arsyetimi duke iu referuar qëndrimin të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehur me vendimin nr. 2/2015, në lidhje me shprehjen “arsye të veçanta”, duke bërë interpretimin në pika: i) qëllimin e institutit të lirimit me kusht; ii) interpretimit tekstual të dispozitës, si dhe iii) hapat e nevojshme që gjykatat duhet të mbajnë në konsideratë në gjykimet me objekt: “Lirim me kusht”, administrimi i raporteve të IEVP dhe të shërbimit të provës, natyra e veprës penale, qëndrimi i personit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, kushtet familjare, si dhe në përfundimin e planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e tij në shoqëri dhe qëndrimi që ka mbajtur i dënuari në raport me veprën penale të kryer.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin dhe konkludimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkues, konstatohet se në rast mosdakortësie nga ana e prokurorit apo kërkuesit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur kryesisht në të njëjtat prova të administruar gjatë gjyqimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

#### **4.4.2. Kriteret objektive**

##### **4.4.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë evidentohet se ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t’iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e gjyqtarëve në interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

Edhe nga vendimet e Gjykatës së Apelit, konstatohet se mbahet i njëjti qëndrim sa më sipër në interpretimin e dispozitës përkatëse për përcaktimin e kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfituar lirimin me kusht.

Përsa i përket përcaktimit të periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit kur kërkuesi ka qenë i dënuar me burgim të përjetshëm, konstatohet se kjo është evidentuar në një rast të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit dhe në fund në Gjykatën e Lartë<sup>76</sup>.

Në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor<sup>77</sup> evidentohet se në interpretimin e parashikimit të dispozitës 65/3 të K. Penal *“Ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim...”*, konstatohet se nga ana e gjyqtarit është bërë interpretimi i saj duke marrë në konsideratë ndryshimet e ligjit penal në drejtim të interpretimit favorizues. Kështu gjyqtari ka argumentuar se: *“Në rrethana të tilla, zgjatja e afatit të vuajtjes së dënimit nga 25 vjet në 35 vjet për t’i mundësuar kërkuesit paraqitjen e kërimit për lirim me kusht, vlerësohet në kuadër të ndryshimit të normës materiale, nenit 65 të Kodit Penal, se ky ndryshim paraqitet me rrethana rënduese për kërkuesin të dënuarin {xxx}, ndaj në këtë rast, gjykata vlerëson të aplikojë përmbajtjen me favorizuese të normës materiale penale që lidhet me të drejtat e të dënuarit në fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit dhe më konkretisht aplikimin e afatit ligjor 25 vjeçar, i cili për sa është parashtruar dhe argumentuar në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht rezulton jo vetëm se është përmbushur si kriter formal nga i dënuari, por dhe paraqitet i tejkaluar prej këtij të dënuari. ... Konkluzioni: Në respektim të kërkesave formale të neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal, rezulton se kërkuesi i dënuari {xxx} plotëson kriteret formale të ligjës për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht si dhe nuk paraqitet i dënuar për krime të kryera me dashje apo vepra të tjera penale, përveç këtyre që paraqiten. Kërkuesi i dënuari {xxx}, i nënshtrohet zbatimit të ligjit procedural penal në kohë dhe në hapësirë, i cili ka qenë në fuqi në momentin e transferimit të tij për vuajtjen e dënimit nga Republika e Italisë për në Republikën e Shqipërisë, i cili parashikonte vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim dhe vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme. Lidhur me këtë aspekt procedural, gjykata vlerësoi dhe çmoi se sanksionet e neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe vetë këto dispozita, identifikohen si dispozita procedurale dhe materiale, për sa kohë ndikojnë drejtpërsëdrejti në kohëzgjatjen e vendimit të dënimit, nocion i cili mbështetet edhe nga G.J.E.D.NJ si dhe neni 7 i Konventës. Si të tilla ato i nënshtrohen vlerësimit të tyre për parashikimet me favorizuese për të dënuarin, gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit”. Ndaj vendimit është ushtruar ankimi nga prokurori në Gjykatën e Apelit e cila ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me zbatimin e parimit të ligjit penal favorizues në rastin e një vendimmarrjeje gjatë fazës së ekzekutimit, duke arsyetuar se: “Po kështu, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka aplikuar dispozitat më favorizuese në lidhje me përmbushjen e afatit kohor për lirim me kusht. Ajo ka argumentuar se: “Kur ligji i ri është jofavorizues, parimi i ndalimit të fuqisë prapavepruese urdhëron që të aplikohet ligji i kohës së kryerjes së veprës penale. Në qoftë se ligji i ri është favorizues, në bazë të parimit të fuqisë prapavepruese favorizuese, do të aplikohet kjo e fundit. Në përcaktimin se cili ligj është më i favorshëm, ai i kohës së kryerjes apo ai i mëvonshmi, gjykata nuk mund të bëjë një kombinim të dispozitave të njërit dhe dispozitave të tjetrit”. Por pavarësisht nga kjo, Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka qenë konseguente për t’iu referuar ligjit të zbatueshëm, atë*

<sup>76</sup> vendimi nr. 00-2022-629 (63), datë 14.06.2022 i Gjykatës së Lartë.

<sup>77</sup> vendimi nr. 41-2019-642, datë 14.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

të kohës së kryerjes së veprave penale, mbasi kur analizon kriteret ndaluese për lirimin me kusht që parashikon neni 65 i Kodit Penal, gjykata është shprehur se: "I dënuari i nënshtrohet zbatimit të ligjit material penal në kohë dhe në hapësirë, duke mos rezultuar rast përjashtimor i kërkuar nga neni 78/a i Kodit Penal për paraqitjen e kërkesës së këtij lloji për lirim me kusht". Që do të thotë se nëse do të ishim në rastin e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal, do të ndodheshim në rast përjashtimor, që do të sillte mospranimin e kërkesës për lirimin me kusht. Pra dy kushte të parashikuara nga e njëjta dispozitë, njëherë zbaton ligjin penal të kohës kur është kryer vepra penale dhe për kushtin tjetër zbatohet ligji penal i kohës kur paraqitet dhe shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht". Mbi bazën e ankimi të kërkuar, çështja është gjykuar në Gjykatën e Lartë, e cila në drejtim të përcaktimit të periudhës së vuajtjes së dënimit për të dënuarin në rastin konkret, me burgim të përjetshëm në raport me zbatimin e parimit të ligjit penal favorizues, ka mbajtur qëndrimin e prokurorit dhe të gjykatës së apelit, duke arsyetuar se: "90. Në lidhje me pretendimin për zbatimin e ligjit penal favorizues, ky parim rregullohet nga neni 3/3 i K. Penal: "Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale." Zbatimi i ligjit penal favorizues është i detyrueshëm për gjykatat që janë duke gjykuar çështjen. Ato duhet të zbatojnë atë ligj që është më i favorshëm për të pandehurin, duke marrë në konsideratë ndryshimet e legjislacionit që nga momenti i kryerjes së veprës penale e deri në momentin kur i pandehuri gjykohet me vendim përfundimtar të formës së prerë. 91. Në rastin konkret, kërkuar ka pretenduar që për kërkesën e tij për lirim me kusht të mos zbatohet parashikimi i ligjit (nenet 64-65 të K. Penal) që ishte në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, por ligji i kohës së kryerjes së veprës penale. Ky pretendim është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka zbatuar ndaj kërkuar ligjin që ka qenë në fuqi në momentin e transferimit të tij për vuajtjen e dënimit nga Republika e Italisë për në Republikën e Shqipërisë, i cili parashikonte vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim dhe vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme. Rezulton se gjykata e shkallës së parë, në fakt, ka bërë një përzjerje të ligjit që rregullon lirimin me kusht, duke zbatuar herë ligjin e mëparshëm dhe herë ligjin në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës. Në lidhje me kohën e dënimit të vuajtur, gjykata e shkallës së parë i është referuar ligjit të kohës kur është kryer vepra penale, ndërsa në lidhje me kriteret ndaluese i referohet ligjit të kohës kur është duke u shqyrtuar kërkesa. 92. Kolegji vlerëson se në pretendimin për të përfutur lirimin me kusht, nuk gjen zbatim parimi i ligjit penal favorizues, parashikuar nga neni 3/3 i K. Penal. Ky parim gjen zbatim për ligjin penal material që zbaton gjykata e themelit kur gjykon çështjen penale në ngarkim të të pandehurit. Në kushtet kur kërkuar pretendon lirim me kusht, gjykata do të zbatojë ligjin që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke zbatuar kushtet dhe kriteret që kërkon dispozita penale konkrete. Kolegji vlerëson se është jashtë logjikës juridike që për lirimin me kusht të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, pasi instituti i lirimimit me kusht nuk ka lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale. 93. Logjika e ligjvënësit që ka parashikuar parimin e ligjit penal favorizues lidhet me sigurinë juridike dhe nevojën që shkelësi i ligjit kur kryen veprën penale të ketë parashikuar pasojat juridike të kësaj shkeljeje, për të cilat ai do të përgjigjet. Ndryshimi në terma të përqësuar të ligjit që dënon veprën e kryer prej tij, në një kohë të mëvonshme, nuk rëndon pozitën e shkelësit, pikërisht në kuadër të këtij parimi. Nga ana tjetër, nuk ka lidhje parimi i zbatimit të ligjit penal favorizues me institutin e lirimimit me kusht. i dënuari që pretendon lirimin me kusht duhet të zbatojë kushtet që

*kërkon ligji penal në kohën e paraqitjes së kësaj kërkesë për të përfitur nga lirimi me kusht. I dënuari nuk mund të pretendojë dhe as gjykata nuk mundet të zbatojë një ligj të ndryshëm nga ai që është në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht. 94. Për më tepër, Kolegji vlerëson se pavarësisht ligjit penal që zbatohet, kërkuesi nuk rezulton të përmbushë kushtet për lirim me kusht, pasi kushti ndalues i të mos qenit përsëritës për krime të kryera me dashje ka ekzistuar në çdo ligj dhe ky është kusht që nuk përmbushet prej tij”.*

#### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankim/rekurs lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës përse i përket përcaktimit të periudhës minimum të kohës së vuajtjes së dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, në drejtim të kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtjes kërkuesi.

Për efekt të nenit 65 të K. Penal, në rastin sikurse u përmend më sipër nga ana e prokurorit të seancës të gjykatës së rrethit gjyqësor është mbajtur qëndrimi i zbatimit të periudhës prej 35 vitesh siç e parashikonte dispozita e kodit penal në kohën e gjykimit. Mbi bazën e ankimit të këtij prokurori çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, ku prokurori i apelit ka përkrahur qëndrimin e prokurorit në drejtim të periudhës së kohës që duhet të vuante i dënuari në rastin konkret për të përfitur lirim me kusht. Në ankim prokurori është shprehur ndër të tjera lidhur me interpretimin e parimit të ligjit penal favorizues në një gjykim gjatë fazës së ekzekutimit se: “- *Lirimi me kusht lidhet ngushtësisht me fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Rregulla për lirimin me kusht parashikohen edhe në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 Për ekzekutimin e vendimeve penale. Pra kanë më tepër karakter procedural dhe rrjedhimisht parimi i zbatimit të ligjit penal favorizues në këtë rast nuk mund të zbatohet. - Çka do të thotë se nëpërmjet interpretimit korrekt të parashikimeve të nenit 65 të K. Penal, koha që i dënuari duhej të kishte vuajtjes dhe që më pas mund t'i drejtohej gjykatës për lirimin me kusht, duhej të ishte tridhjetë e pesë vjet burgim. Vetëm pasi të kishte vuajtjes të paktën 35 vjet burgim, i dënuari mund t'i drejtohej gjykatës për lirimin me kusht. - Pra, i dënuari, nuk ka vuajtjes më tepër se tridhjetë e pesë vjet analizuar arsyet e tjera që kërkohen nga kjo dispozitë, edhe pa u investuar në vjet burgim, dhe vetëm për këtë arsye kërkesa duhej të ishte rrëzuar, edhe pa hetim, në marrje raportesh të IEVP, apo të Zyrës së Shërbimit të Provës”.*

#### **4.4.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

Nga vendimet gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, për të cilën është vendosur pranimit/rrëzimit të kërkesës “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, në pjesën më të madhe konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës. Përveç praktikës në fjalë, janë evidentuar vendime në të cilat mbahet qëndrimi se përlllogaritja e kohës së vuajtjes duhet të përfshijë vetëm periudhën deri datën e paraqitjes së kërkesës. Këtë

praktikë e gjejmë tek një gjyqtar<sup>78</sup>, i cili rezulton se ka patur praktikë të njëjtë për të gjithë periudhën e inspektimit në çështjet në të cilat ka analizuar dhe konkluduar mbi përlllogaritjen e periudhës së vuajtjes së dënimit.

Referuar vendimmarrjeve të secilit prej gjyqtarëve që kanë trajtuar kërkesat me objekt “Lirim me kusht” për periudhën e inspektimit, është evidentuar ndjekja prej secilit prej tyre e të njëjtës praktikë në drejtim të periudhës kohore minimum të kohës së vuajtjes së dënimit.

Për të gjitha këto raste, qëndrimi i prokurorit të rrethit gjyqësor dhe atij të apelit ka qenë për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës.

Lidhur me qëndrimin e Gjykatës së Apelit, nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt “lirim me kusht”, nuk është evidentuar ndonjë rast që të jetë ndryshuar vendimi për shkaqe të përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. Përkundrazi në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatojmë arsyetim të kësaj mënyre të proceduari dhe më konkretisht: “..... Ankimi i prokurorisë, përmban po ato shkaqe që janë ngritur edhe në gjykim dhe që kanë marrë përgjigje në vendimin tërësisht të arsyetuar të gjykatës prandaj çmohet që ankimi nuk përmban shkaqe që të cenojnë vendimin e gjykatës i cili duhet të lihet në fuqi. Kërkesa e të dënuarit për lirim para kohe me kusht plotëson kriterin për vuajtjen e 3/4 të dënimit sepse: a) Plotësimi i këtij kushti konsiderohet i përmbushur në kohën që shqyrtohet kërkesa e të dënuarit nga gjykata, dhe jo në kohën e përpilimit të kërkesës. Kjo është mëse e kuptueshme nga leximi i dispozitës ligjore, si dhe nga fakti se mosshqyrtimi i kërkesë për arsye të çfarëdoforme nuk mund të pengojë të dënuarin për një përfitim të tillë, i cili lind që në datën e parë kur i dënuari plotëson 3/4 e dënimit. Po të shohësh, kërkesa e të dënuarit është regjistruar në gjykatë në datë 25.10.2016 dhe gjykuar në seancën e parë në datë 17.11.2016 dhe përfunduar gjykimi në datë 01.02.2017, që përbëjnë dhe veprimet administrative për gjykim”<sup>79</sup>; në një vendim tjetër të Gjykatës së Apelit Korçë<sup>80</sup>, është arsyetuar: “... Por edhe nëse nuk e llogaritim 36 ditë ulje dënimi për shkak të punës si dënim të vuajtur, përsëri me dënimin e vuajtur deri në datën e shpalljes së vendimit i dënuari ka vuajtur 3/4 e dënimit me burgim edhe pse nuk e ka vuajtur këtë periudhë në datën e depozitimit të kërkesës. Gjykata vlerëson për plotësimin ose jo të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 64 të K. Penal në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar dhe jo në momentin e depozitimit të kërkesës dhe për rrjedhim një kusht i caktuar mund të jetë plotësuar gjatë hetimit gjyqësor.”; në një vendim tjetër me të njëjtën trupë gjyqësore<sup>81</sup>, gjykata shprehet se: “Gjykata e Apelit vlerëson që paravarësisht se në momentin e depozitimit të kërkesës në gjykatë kërkuesi nuk ka plotësuar 3/4 e dënimit, ky kusht është plotësuar gjatë zhvillimit të gjykimit dhe për këtë arsye, kjo rrethanë nuk përbën shkak për

<sup>78</sup> Përmendim vendimin nr. 41-2017-974 (4/607), datë 01.03.2017; vendimin nr. 41-2017-2950, datë 04.09.2017.

<sup>79</sup> Vendimi nr. 38, datë 02.05.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë.

<sup>80</sup> vendimin nr. 107, datë 25.10.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë.

<sup>81</sup> Vendimi nr. 61, datë 08.05.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë,

rrëzimin e kërkesës, sikurse pretendohet në ankim.”; në vendimin tjetër<sup>82</sup>, Gjykata e Apelit shprehet se: “rezulton e provuar se kërkesa e të dënuarit për lirim para kohe me kusht plotëson kriterin për vuajtjen e ¾ të dënimit sepse: “a) plotësimi i këtij kushti konsiderohet i përmbushur në kohën që shqyrtohet kërkesa e të dënuarit nga gjykata, dhe jo në kohën e përpilimit të kërkesës. Kjo është mëse e kuptueshme nga leximi i dispozitës ligjore, si dhe nga fakti se mosshqyrtimi i kërkesës për arsye të çfarëdoshme nuk mund të pengojë të dënuarin për një përfitim të tillë i cili lind që në datën e parë kur i dënuari plotëson ¾ e dënimit.

Një nga vendimet sa më sipër të Gjykatës së Apelit, është bërë objekt rekursi në Gjykatën e Lartë, mbi ankimin e prokurorit të apelit edhe në drejtim të periudhës së përllogaritjes së kohës minimum të vuajtjes së dënimit të lidhur me datën e paraqitjes së kërkesës. Gjykata e Lartë<sup>83</sup> me vendimin nr. 00-2023-66, datë 13.01.2023 ka pranuar këtë qëndrim të Gjykatës së Apelit Korçë duke argumentuar se: “23. Në lidhje me pretendimin e prokurorisë se, i pandehuri nuk ka plotësuar kushtet formale në momentin që ka paraqitur kërkesën për ulje dënimi, por e ka plotësuar atë gjatë periudhës së gjyqimit, Kolegji vlerëson se, është një pretendim i pabazuar në ligj, për arsyen se aktet që merren për shqyrtim, si dhe plotësimi i afatit përkatës gjykata i merr parasysh kur administron aktet në gjykim, i cili mund të zgjasë për një periudhë të gjatë kohore, pasi duhet të merren prova, të kryehen raporte vlerësimi si nga ZVSHP, etj., të cilat më pas duhet të vlerësohen nga gjykata, dhe kërkuesi mund të kalojë pjesën e mbetur për të cilën kërkon lirimin me kusht duke zhvilluar gjykimin. Edhe në nenin 64 të K. Penal shprehja “Personi lirohet me kusht”, do të thotë se, kërkesa pranohet dhe personi lirohet pasi të zhvillohet një hetim gjyqësor dhe të shpallet vendimi dhe jo në momentin që paraqitet kërkesa. 24. Kushti për plotësimin e afateve të kërkuara për vuajtjen e dënimit nuk është ngushtësisht e karakterit formal në momentin që paraqitet kërkesa, siç mund të jetë firmosja e kërkesës nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij me prokurë. Gjykata deri në momentin që personi është në gjykim pranë saj, do të vlerësojë sjelljen e kërkuesit, pasi nëse ai plotëson të gjitha kushtet në momentin që paraqet kërkesën për lirimin me kusht p. sh., por ditën që do të shpallet vendimi kryen një vepër apo shkelje të rregullores në institucion, që ndikon në vlerësimin e gjykatës për pranimin apo jo të saj, gjykata nuk mund të jetë indiferente, dhe duhet ta konsiderojë në vendimmarrjen e saj”.

#### **4.5.2.3. Përfitimet që përfshihen në përllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

Në kohën minimum të përllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, jo nga të gjithë gjyqtarët është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

<sup>82</sup> Vendimi nr. 38, datë 02.05.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë.

<sup>83</sup> Trupa e kolegjit (Medi Bici kryesues, Sokol Binaj dhe Sandër Simoni anëtarë).



Për periudhat e përfitimit me paraburgim dhe të kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, praktika ka qenë e konsoliduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke u pranuar si nga prokuroria dhe gjykata, si periudha të përfshira në përllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit. Ndërsa qëndrime të ndryshme ka patur jo vetëm midis gjykatës, por edhe midis gjykatës dhe prokurorisë lidhur me përfshirjen në periudhën në fjalë, të kohës së punës në IEVP.

Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, evidentohet se vetëm në katër raste kërkuesi ka patur kohë pune në IEVP që është bërë më pas objekt trajtimi për përllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit në përmbushje të kriterit të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Më konkretisht përmendim: vendimin nr. 41-2017-310 (3/602 prot.), datë 01.02.2017; vendimin nr. 41-2017-1934 (239), datë 17.05.2017; vendimin nr. 41-2017-974 (4/607), datë 01.03.2017; vendimin nr. 41-2018-639 (4DA), datë 23.02.2018.

Nga katër vendimet në fjalë, vetëm në tre vendime<sup>84</sup>, gjykata e ka përfshirë kohën e punës në përllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit, ndërsa nuk rezulton e tillë në një vendim<sup>85</sup> që i përket një gjyqtari të ndryshëm nga gjyqtarët që kanë dhënë tre vendimet e sipërpërmendura.

Tek vendimet ku është përfshirë përllogaritja e kohës së punës, nuk evidentohet në të gjitha rastet qartë qëndrimi i prokurorit në drejtimin në fjalë, dhe gjithashtu nuk konstatohet një arsyetim lidhur me këtë përfshirje në zbatim të kriterëve të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Konstatohet se vetëm në një nga këto vendime, gjyqtari<sup>86</sup> argumenton se përse koha e punës duhet të përfshihet, duke arsyetuar se: *"... (nga kartela personale e të dënuarit rezulton se ai nuk ka përfituar nga instituti i faljes apo amnistisë, por ka përfituar {xxx} ditë ulje dënimi për shkak të punës së kryer. Meqenëse në ligj është parashikuar shprehimisht ndalimi për t'u konsideruar dënim i vuajtur dënimi i ulur për shkak të faljes ose amnistisë dhe nuk është përmendur dënim i ulur për shkak të punës së kryer gjykata çmon se në përputhje dhe me praktikën tashmë të konsoliduar nuk ka pengesë ligjore që dënimin e ulur për shkak të punës ta konsiderojë dënim të vuajtur për efekt të periudhës kohore të vuajtur që kërkohet në aplikimin e institutit të lirimit me kusht, ashtu siç konsiderohet dënim i vuajtur dënimi i ulur me vendim gjykate, në aplikim të nenit 63 të ligjit "Për të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve i ndryshuar.")*. Në këtë vendim të fundit, evidentohet qëndrimi i prokurorit në mënyrë të përmbledhur edhe në drejtim të mospërfshirjes së kohës së punës.

Në rastin kur gjyqtari nuk ka pranuar përfshirjen e kohës së punës, konstatohet se në vendim ka analizë dhe konkludim të qartë lidhur me këtë, duke u dakortësuar me argumentimin e prokurorit se puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Konkluzioni në fjalë, si nga prokurori dhe gjykata mbështetet në analizën e legjislacionit aktual, ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat

<sup>84</sup> vendimi nr. 41-2017-310 (3/602) prot., datë 01.02.2017; vendimi nr. 41-2017-1934 (239) prot., datë 17.05.2017; vendimi nr. 41-2018-639 (4DA), datë 23.02.2018.

<sup>85</sup> Vendimi nr. 41-2017-974 (4/607), datë 01.03.2017.

<sup>86</sup> Vendimi nr. 41-2017-1934 (239) prot., datë 17.05.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.



dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, i cili rregullon aktualisht të gjithë të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve duke shfuqizuar të gjitha aktet e mëparshme ligjore e nënligjore dhe VKM nr. 3003, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”. Gjithashtu qëndrimin e tyre, si prokurori dhe gjykata e kanë arsyetuar edhe mbi argumentet e paraqitura nga IEVP, duke e konsideruar këtë të fundit se nuk qëndron me arsyetimin se: *“Fakti i pretenduar nga përfaqësuesi i IEVP {xxx}, se është në fuqi një dekret i Presidiumit Popullor të vitit 1972 nuk qëndron, jo vetëm se është shfuqizuar nga legjislacioni aktual, po dhe për faktin se vetë ky dekret është shfuqizuar në vitin 1989 nga një dekret tjetër i Presidiumit Popullor me nr. 7289, datë 08.04.1989. Pra kur ligji aktual parashikon se një personi për punën e kryer në ambientet e burgut shpërblehet me paga dhe në të holla, kurrsesi nuk mund të lejohet që atij t’i ulen ditët e burgimit me një dekret të shfuqizuar prej mbi 25 vjetësh. Gjithashtu në rastin konkret duhet mbajtur parasysh fakti se për këtë shtetas nuk ka kontratë pune me drejtorin e institucionit që ky shtetas është lejuar që të punojë për kryerjen e një pune/aktiviteti të caktuar në ambientet e IEVP-së {xxx}”*.

Këtë qëndrim të prokurorit e gjejmë edhe në ankimin e tij, përkundrejt tre vendimeve të tjera, ku nga ana e gjykatës pranohet përfshirja e kohës së punës në përllogaritjen e kohës së vuajtjes për efekte të zbatimit të nenit 64 të K. Penal. Ndërsa nuk rezultoi i qartë, nga leximi i këtyre tre vendimeve, qëndrimi i prokurorit në seancë përkundrejt këtij kriteri.

Prokurori i apelit e ka përkrahur në të gjitha këto raste ankimin e prokurorit në drejtim të qëndrimit të tij për kohën e punës dhe në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Korçë në të gjitha rastet ka vendosur ta konsiderojë të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në drejtim të përfshirjes së kohës së punës në përllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit, duke argumentuar ndër të tjera se: *“... është e evidente se ka ekzistuar një Dekret i Presidentit të Kuvendit Popullor të RPSH me nr. 5011, datë 09.12.1972, i shfuqizuar nga Dekreti tjetër me nr. 7298, datë 08.04.1989, në zbatim të të cilit ka dalë Udhëzimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme datë 28.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë që aktivizohen në punë kur plotësojnë e tejkalojnë normën” dhe që rezultoi jo vetëm në fuqi por edhe i pashfuqizuar nga aktet që pretendohen në ankimin e prokurorit”*. Më tej, gjykata e apelit arsyeton se *“... është në interesat e shoqërisë, që një i dënuar, mund të fitojë ditë vuajtje dënimi me punë, sepse është edhe një mënyrë më shumë, për të përmbushur qëllimin madhor dhe shumë të vështirë të përmbushjes së misionit që ka dënimi si një raport i drejtë midis vuajtjes së tij (dënimit) por edhe mundësisë rehabilituese dhe riintegruese të të dënuarit në shoqëri”*.

Edhe për rastin në të cilën gjykata e rrethit gjyqësor ka mbajtur qëndrim tjetër nga tre rastet si më sipër, mbi bazën e ankimit të kërkuarit, vendimi është bërë objekt i trajtimit nga Gjykata e Apelit Korçë. Kjo e fundit<sup>87</sup> si edhe në vendimet sa më sipër ka mbajtur të njëjtin qëndrim për

---

<sup>87</sup> shih vendimin nr. 61, datë 01.06.2017 me anë të të cilës është vendosur ndryshimi i vendimit të rrëzimit dhe pranimi i kërkesës për “lirim me kusht”, duke argumentuar plotësimin e kohës së vuajtjes së dënimit prej 74 duke përfshirë përllogaritjen e kohës së punës.

përfshirje të kohës së punës, duke mos e konsideruar të drejtë qëndrimin e gjykatës së rrethit gjyqësor.

Ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit Korçë për tre vendime (ku në njërin prej tyre përfshihet edhe rasti i vetëm kur është mbajtur qëndrimi ndryshe), është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit rezultoi të jetë shprehur deri më tani<sup>88</sup> për dy raste<sup>89</sup>, duke e konsideruar të drejtë qëndrimin e prokurorit për mospërfshirje të kohës së punës. Kolegjet kanë konkluduar se ditët e punës nuk mund të llogariten në kohën e vuajtjes së dënimit për efekt të plotësimit të kushteve formale paraprake për të paraqitur kërkesën për lirim me kusht dhe kjo praktikë është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Në këto vendime arsyetohet: *“Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në nenin 34 parashikon se:.... “Të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria e institucionit, brenda dhe jashtë tij, duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera. Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”. Megjithëse ligji i sipërcituar, e ka të përcaktuar në mënyrë të qartë, se puna e të dënuarve shpërblehet dhe pagesa jepet si shpërblim në proporcion me punën e kryer, konform rregullave që përcaktohen në VKM, vërehet se vazhdon të zbatohet një praktikë, e cila është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Kjo është evidentuar dhe në Progres Raportin për Shqipërinë për vitin 2015 si dhe tek “Raporti mbi situatën e të drejtave të njeriut, të personave të privuar nga liria në Komisaritet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, për periudhën Korrik 2015 - Janar 2016” i Komiteti Shqiptar të Helsinkit (K.SH.H). ... “personat e dënuar që punojnë punë të ndryshme brenda organikës së burgut duhet të shpërblehen me pagë sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Në interpretim të parashikimeve ligjore, ata konsiderohen “punëmarrës” dhe duhet të trajtohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Neni 49, pika 2 e Kushtetutës së Shqipërisë, përcakton se: ..... “Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”. Ndërsa, në nenin 52, pika 1, të saj është sanksionuar se: ..... “Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.*

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk është evidentuar në asnjë rast që të jetë llogaritur koha e përfituar me amnisti ose falje.

---

<sup>88</sup> Referuar datës së përpilimit të këtij raporti.

<sup>89</sup> vendimi nr. 340, datë 16.12.2022 me përbërës të trupës së kolegjit (Sandër Simoni kryesues dhe anëtarë Medi Bici dhe Sokol Binaj) dhe nr. 00 – 2023 – 66, datë 13.01.2023 me përbërës të trupës së kolegjit (Medi Bici kryesues dhe anëtarë Sokol Binaj dhe Sandër Simoni).

#### 4.4.2.4 Kushtet ndaluese

Nga vendimet e administruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me **kushtet ndaluese “përsëritës” dhe “për shkak të veprës penale të parashikuar”** në nenit 64 të K. Penal. Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuarit të administruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjyqimit.

Në vlerësimin e kushtit ndalues përsëritës nga ana e gjykatës, në një rast të evidentuar, është diskutuar çështja e rehabilitimit të kërkuarit referuar nenit 69 të Kodit Penal, duke mos u konsideruar se ishte në kushtet e ndalimit dhe pranuar kërkesa<sup>90</sup>. Sipas këtij vendimi, kërkuari ka qenë i dënuar me burgim në vitin 1999 për veprën penale të parashikuar në nenin 189 të K. Penal të kryer në vitin 1998, dhe koha e dënimit i ka përfunduar po në vitin 1999. Më tej kërkuari është dënuar në vitin 2000 për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i K. Penal, duke u dënuar me gjobë. Dhe në vitin 2016 është dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal, me 4 vjet e 8 muaj burgim dhe për këtë dënim ka kërkuar lirim me kusht nga vuajtja e mëtejshme. Qëndrimi i prokurorit në seancën gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë ka qenë për t’u konsideruar në kushtin ndalues si përsëritës, duke u argumentuar se: “në kushtet kur kërkuari ka qenë dy herë i dënuar për krime të cilat janë kryer me dashje dhe është dënuar me vendim të formës së prerë, kërkesa nuk duhet të pranohet pasi jemi përpara kushtit ndalues në vlerësim të nenit 64/3 të K. Penal”, Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk është pranuar një qëndrim i tillë, duke e pranuar kërkesën për lirim me kusht, pas konstatimit të përmbushjes edhe të kriterëve të tjera të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Lidhur me kriterin ndalues të diskutuar, Gjykata ka arsyetuar se: “Në lidhje me kriterin ndalues të parashikuar në nenin 64 të K. Penal ku citohet se “nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje”, gjykata vlerëson se nga formulimi ligjor i këtij kriteri si dhe interpretimit literal të tij, ligjvënësi i referohet nocionit “i dënuar”. Nga ana tjetër ligji material penal në nenin 69 të K. Penal parashikon se në cilat raste personat do quhen të padënuar apo të rehabilituar, pasi e vetmja ndarje ligjore në këndvështrimin penal gjendja gjyqësore e personave të dënuar do të jetë e bardhë dhe se këta persona humbasin statusin e të dënuarit. Në rastin konkret referuar masave të dënimit që janë dhënë ndaj të dënuarit në dy vendimet e sipërcituara si dhe kohës që ka kaluar nga dita e vuajtjes së dënimeve rezulton dukshëm se janë plotësuar afatet kohore të parashikuara në nenin 69 të K. Penal nisur jo vetëm nga momenti i paraqitjes së kërkesës por edhe nga momenti i kryerjes së veprës penale për të cilën është dënuar aktualisht kërkuari {xxx}, rezulton i rehabilituar pra konsiderohet i padënuar. Sa më sipër ndryshe nga sa pretendon përfaqësuesi i prokurorisë se ndodhemi përpara kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64 i K. Penal, gjykata vlerëson se në rastin kur i dënuari rezulton i rehabilituar duhet të konsiderohet i padënuar, pasi fitimi i cilësisë të së qenurit i rehabilituar është një e drejtë që çon në çdo

<sup>90</sup> vendimi 672, datë 28.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

*përfitim ligjor dhe jo në privime nga këto përfitime ligjore në raste të caktuara*". Ndaj vendimit rezulton të jetë ushtruar ankimi nga prokurori, i cili ndër të tjera ka pretenduar edhe lidhur me kushtin ndalues të të qenit përsëritës të kërkuesit. Ankimi i prokurorit është përkrahur edhe prokurori i apelit, por ky qëndrim nuk është pranuar nga Gjykata e Apelit<sup>91</sup>, duke u argumentuar si gjykata e rrethit gjyqësor *"Se kërkuesi i plotëson kushtet e liritimit para kohe me kusht. Ajo kundërshton pretendimin e prokurorisë që kërkuesi nuk përfiton nga ky institut pasi ka qenë i dënuar më parë. Gjykata e Apelit arsyeton se dënimet e dhëna tashmë janë parashkruar duke iu referuar edhe dispozitave të parashikuara nga neni 69 i K. Penal"*. Duke mos qenë dakort me vendimin e Gjykatës së Apelit, prokurori i apelit ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke parashtruar të njëjtat argumente si edhe në apel. Gjykata e Lartë aktualisht nuk ka dalë me një vendim.

Gjithashtu diskutimi lidhur me kriterin "përsëritës" është evidentuar edhe në rastin e gjykimit të kërkesës së një të dënuari me burgim të përjetshëm<sup>92</sup>.

Faktet: i dënuari në fjalë rezultonte të ishte dënuar me vendim datë 20.01.1997, të Gjykatës së Milanos, me një vit e gjashtë muaj burgim për veprën penale falsifikimit të monedhave, parashikuar nga neni 455 i Kodit Penal Italian. Po kështu, me vendim nr. 38/99, datë 21.12.1999, të Gjykatës për Krime të Rënda në Milano, i cili ka marrë formë të prerë me vendimin datë 02.02.2001 të Gjykatës së Apelit Milano, është deklaruar fajtor për veprat penale të vrasjes me paramendim, në dy raste, mbajtje pa lejë të armëve luftarake, prodhim dhe shitje e narkotikëve, të parashikuara në Kodin Penal Italian, dhe është dënuar me burgim të përjetshëm. - Dënimet e mësipërme janë bashkuar në një dënim të vetëm, burgim të përjetshëm, me vendim nr. 73/2002, të Prokurorisë së Milanos. - Me vendim nr. 14, data e paqartë, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur njohja e vendimit penal të huaj, duke caktuar si dënim të vetëm për t'u vuajtur, atë me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi me vendim nr. 733, datë 10.06.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë. - Vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor me vendim nr. 38/99, datë 21.12.1999, të Gjykatës për Krime të Rënda në Milano, është kryer në datën 31.07.1997, pra, pas dhënies së vendimit datë 20.01.1997, të Gjykatës së Milanos.

Gjykata e rrethit gjyqësor ka konkluduar se i dënuari në rastin konkret nuk është përsëritës për krime të kryera me dashje, referuar kriterit "përsëritës" sipas nenit 64 të K. Penal. Prokurori e ka konsideruar si përsëritës, referuar dy vendimmarrjeve të gjykatës italiane.

Gjykata e Apelit ka konkluduar si përsëritës kërkuesin, duke arsyetuar se: *"Kështu, konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë Korçë megjithëse në pjesën hyrëse të vendimit, citon vendimet e dhëna në shtetin italian ndaj kërkuesit Gerd Gjinarari duke përmendur si të tilla dy vendime, i pari: për "Falsifikimin e monedhave", parashikuar nga neni 455 i Kodit Penal Italian, veprë kjo e parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal Shqiptar dhe i dyti: Për "Vrasje me paramendim*

<sup>91</sup> nr. 41, datë 03.04.2018, Gjykata e Apelit Korçë.

<sup>92</sup> vendimi me nr. 00-2022-629 (163), datë 14.06.2022.



në rrethana rënduese në dy raste”, “Mbajtje e armëve luftarake”, “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike në formën e organizimit dhe drejtimit të kësaj veprimtarie” dhe “Kryerje e krimit nga banda të armatosura”, vepra penale këto të parashikuara nga nenet 110, 575, 577 të Kodit Penal Italian, neneve 73 dhe 74 të ligjit Italian nr. 309/90 si dhe nenit 12 të ligjit Italian 197/91, vepra penale këto të parashikuara nga nenet 78-25, 78, 283/2, 333 dhe 334 të Kodit Penal Shqiptar, nuk përmend faktin se është dënuar dy herë dhe se kërkuesi Gerd Gjinarari është përsëritës për vepra penale të kryera me dashje. Gjykata e Shkallës së Parë Korçë në rastin në gjykim i referohet bashkimit të këtyre dy dënimeve nga Prokuroria e Milanos. Pra siç shihet, i dënuari Gerd Gjinarari ka qenë përsëritës në krime të kryera me dashje dhe ky fakt ka qenë dhe kushti ndalues për aplikimin e nenit 64 të K. Penal. Në kuptim të kërkesave të nenit 64 të Kodit Penal, ekziston pengesa ligjore të parashikuar nga kjo dispozitë, pasi kërkuesi është përsëritës në kryerjen e veprave penale me dashje. Fakti, se atij më pas i janë bashkuar të dy vendimet penale të mësipërme, nuk do të thotë se ai nuk është përsëritës”.

Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj, lidhur me sa më sipër ka arsyetuar se: “81. Rezulton se kërkuesi nuk përmbush as kushtin e të mos qenit përsëritës për krime të kryera me dashje, që përbën kusht ndalues për të përfutuar nga lirimi me kusht. Rezulton se kërkuesi Gerd Gjinarari, me vendimin e datës 20.01.1997, të Gjykatës së Milanos, Itali (Vendim që ka marrë formë të prerë në datën 16.03.1997), është dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim dhe 500.000 lireta gjobë, për veprën penale “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga neni 455 i Kodit Penal Italian, vepër kjo e parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal Shqiptar. Po kështu, kërkuesi Gerd Gjinarari është dënuar dhe me vendimin nr. 38/99, datë 21.12.1999, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Milano, Itali (i cili ka marrë formë të prerë me vendimin e datës 02.02.2001 të Gjykatës së Apelit Milano) me burgim të përjetshëm dhe dënime të tjera plotësuese. Fakti që këto dënime janë bashkuar në një të vetëm, nuk eliminon ekzistencën e të dyjave dënimeve dhe as faktin që ai është përsëritës për krime të kryera me dashje. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se interpretimi i kundërt nuk vlerësohet që rëndon pozitën e tij, siç pretendon mbrojtja, parim që do të analizohet në vijim prej Kolegjit”.

#### **4.4.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”**

**Koha e kushtit/provës:**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**

Në të gjitha vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi, është konstatuar se nga ana e gjyqtarëve është konkluduar se koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim. Për këtë, konstatohet se nga gjyqtarët është arsyetuar në pjesën arsyetuese të vendimit, duke u mbështetur në qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konstatohet se nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, por duke mos e përcaktuar saktësisht me vit, muaj dhe ditë.

## Gjykata e Apelit Korçë

Referuar vendimmarrjeve të kësaj gjykate, nuk ka patur raste të shqyrtimit të ndonjë ankimi lidhur me kohën e provës. Por edhe në rastet në të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur vetë pranimin e kërkesës për lirim me kusht, pas ndryshimit të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ka parashikuar në dispozitiv se koha e provës është e njëjtë me pjesën e pavuajtur të dënimit. Në vendimet e Gjykatës së Apelit konstatohet se nuk përcaktohet saktësisht pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit.

## Qëndrimi i Prokurorit

Lidhur me praktikën sa më sipër, përse i përket përcaktimit të kohës së provës, nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit nga leximi i vendimeve gjyqësore. Edhe referuar qëndrimit pas dhënies së vendimit, konstatohet se nuk ka patur asnjë ankim nga prokurori lidhur me këtë kriter dhe si i tillë të ishte bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit.

### 4.4.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, gjyqtarët kanë përcaktuar urdhërimin që i dënuari gjatë kohës së provës të mbajë kontakte të rregullta dhe t'i raportojë rregullisht Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku ai banon, por nuk janë pasqyruar në të gjitha rastet urdhërimet sipas nenit 60 të Kodit Penal.

Kështu rezulton se nga 64 vendime pranimi të kërkesës për lirim me kusht të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën objekt inspektimi është disponuar me urdhërim lidhur me nenin 60 të Kodit Penal në 16 raste.

Konstatohet që të njëjtët gjyqtarë, për periudhën objekt inspektimi kanë disponuar brenda një viti, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me disponimin me urdhërimin lidhur me nenin 60 të Kodit Penal. I njëjti gjyqtar në një vendim ka disponuar me urdhërim lidhur me nenin 60 të Kodit Penal dhe në 4 vendime nuk ka disponuar me urdhërim lidhur me nenin 60 të Kodit Penal<sup>93</sup>.

**Nga vendimet e Gjykatës së Apelit** që kanë ndryshuar 21 vendimet e rrëzimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në periudhën e inspektimit nga data 01.01.2017-31.01.2020, duke vendosur:

---

<sup>93</sup> Viti 2017 gjyqtari 1. Në 4 vendime nuk ka pasqyruar asnjë nga detyrimet e nenit 60 në katër vendime penale (vendimin penal 41-2017-310 (3/602 prot.), datë 01.02.2017; vendimin nr. 41-2017-1781 (222 DA) prot., datë 04.05.2017, vendimi nr. 41-2017-2098 (245) prot., datë 30.05.2017; Vendimi 41-2017-1945 (262 prot.,) datë 17.05.2017). Në një vendim ka pasqyruar një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal (vendimin penal Nr. 41-2017-1271(101) prot, datë 17.03.2017; )

Në vitin 2018 gjyqtari 1. Në 11 vendime nuk ka pasqyruar asnjë nga detyrimet e nenit 60 dhe në një vendim ka pasqyruar një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal.

Në vitin 2019 gjyqtari 2. Në 3 vendime nuk ka pasqyruar asnjë nga detyrimet e nenit 60 dhe në një vendim ka pasqyruar një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal.

“Pranimin e kërkesës për lirimin me kusht”, konstatohet se vetëm në 1 rast<sup>94</sup> është disponuar me urdhërimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

Në 20 vendimet e tjera të Gjykatës së Apelit ku nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, është disponuar me urdhërimin e moskryerjes së veprave të tjera penale dhe të kontaktit me shërbimin e provës. Ky urdhërim i fundit konstatohet edhe tek vendimi ku ishte parashikuar detyrim sipas nenit 60 të K. Penal.

Gjithashtu evidentohet se edhe në ato raste kur Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e pranimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, për të cilat nuk ishin parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, nuk ka evidentim nga ana e saj lidhur me këtë pikë.

Nga të gjitha rastet e administruara për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatën e Apelit, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

#### **4.4.2.5.2. Fillimi i afatit të provës**

Në të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë, me rastin e pranimeve të kërkesave për lirim me kusht, nuk është përcaktuar as në pjesën arsyetuese dhe as në dispozitiv, data e fillimit të afatit të provës.

#### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

### **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimit të kërkesës “Lirim me kusht”**

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale të gjykatës së rrethit gjyqësor ku është pranuar kërkesa me objekt “lirimi me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës në fjalë.

Në këtë zyrë prokurorie për periudhën e inspektimit, nuk ka patur seksion ekzekutimi të vendimeve penale dhe as prokuror të caktuar për ekzekutimin e vendimeve penale.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirimin me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimi kërkuesi.

---

<sup>94</sup> Vendimi nr. 12. Datë 20.02.2017, ku evidentohet se në pjesën arsyetuese gjyqtarët arsyetojnë për vendosjen e këtyre detyrimeve neni 60 i K. Penal pika 1. (Të ushtrorë një veprimtari profesionale, në bazë të kontratës së punës...).

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhri i ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm rezulton se është nxjerrë nga Prokurori i Apelit pjesëmarrës në seancë, duke filluar nga viti 2018. Ndërsa në vitin 2017 është bërë nga prokurori i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e Apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për lirim të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërish të një urdhri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Apelit.

✚ **Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirimi me kusht”, nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier, Berat, që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ka rezultuar se:**

### **1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale, dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundërvajtje penale. Gjithashtu asnjë prej kërkuesve në fjalë, të dënuar me burgim për krime nuk kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim të përjetshëm.

Të gjithë kërkuesit në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Fier, kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-ve. Ndërsa nga të gjithë kërkuesit të cilët kanë paraqitur kërkesë për lirim me kusht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, vetëm 3 prej tyre kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim në dënim alternativ “qëndrim në shtëpi” të parashikuar nga neni 59/a i K. Penal, të cilën e kanë përfituar me vendim gjykate gjatë kohës që kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP-së.

Referuar të dënuarve të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës me objekt “lirim me kusht” kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP, konstatohet se në përgjithësi institucioni i IEVP-së përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa. Kështu më konkretisht:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Fier.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka përfshirë në kompetencën e saj gjykimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” për të dënuarit që vuanin dënimin në IEVP Berat.





Referuar të dënuarve të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës me objekt “lirim me kusht” kanë qenë duke vuajtur dënimin në dënimin alternativ “qëndrim në shtëpi”, konstatohet se ka patur diskutime në drejtim të mbështetjes ligjore të përmbushjes së kriterit të dënuar me burgim sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal.

Në të tre këto raste qëndrimi i prokurorit, ka qenë i njëjtë për rrëzimin e këtyre kërkesave bazuar në arsyetimin se i dënuari nuk është duke vuajtur në IEVP, por është duke vuajtur dënimin me burgim në një alternativë tjetër dënimi, dhe për të cilin nuk mund të procedohet me një masë tjetër si ajo e nenit 64 të K. Penal, pasi vjen në kundërshtim me dispozitat e Kodit Penal dhe ligjin e shërbimit të provës, duke anashkaluar kompetencat e kësaj të fundit.

Për tre rastet në fjalë, për të cilat nga ana e gjyqtarëve<sup>95</sup> është proceduar me pranimin e kërkesës për lirin me kusht, është arsyetuar se “qëndrimi në shtëpi” sipas nenit 59/a të K. Penal është mënyrë e vuajtjes së dënimit me burgim, si alternativë e ekzekutimit të dënimit me burgim. Ndërsa për rastin për të cilën nga ana e gjyqtarit<sup>96</sup> është proceduar me rrëzimin e kërkesës për lirin me kusht, është arsyetuar se nuk mund të zëvendësohet një alternativë e dënimit me burgim, siç është qëndrimi në shtëpi me lirin me kusht për shkak se një veprim i tillë nuk ka asnjë bazë apo referencë ligjore në Kodin Penal dhe në ligjet e tjera.

Vendimet për tre rastet sa më sipër, i janë nënshtruar kontrollit në Gjykatën e Apelit Vlorë<sup>97</sup>, mbi bazën e ankimit të prokurorit/të dënuarit ku vetëm në dy prej tyre (një pranim dhe një rrëzim) është gjykuar lidhur me themelin e kërkesës, ndërsa për një nga rastet (pranim) janë konstatuar probleme procedurale që janë bërë shkak për prishje të vendimit dhe kthimit të çështjes për rigjykim me një trup tjetër gjykues. Për këtë të fundit në rigjykim në shkallë të parë, është vendosur rrëzimi i kërkesës, për shkak të mosparaqitjes së ankuesit dhe përfundimit të kohës së provës.

Për dy rastet e vendimeve gjyqësore të kontrolluara nga Gjykata e Apelit Vlorë<sup>98</sup>, kjo e fundit

---

<sup>95</sup> vendimi nr. 97, datë 18.03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe vendimi nr. 253, datë 30.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

<sup>96</sup> vendimi nr. 158, datë 20.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

<sup>97</sup> vendimin nr. 725, datë 21.11.2018 dhe vendimin nr. 44, datë 30.01.2018.

<sup>98</sup> Sipas vendimit nr. 725, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Apelit arsyetohet se: “Ndërkohë që nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë është rrëzuar kërkesa e të dënuarit me arsyetimin se ndaj tij është duke u zbatuar neni 59/a i K. Penal dhe ai është duke qëndruar në shtëpi. Ndërkohë, ky Kolegj çmon se është e vërtetë se i dënuari është aktualisht me qëndrim në shtëpi, por periudha e qëndrimit në shtëpi në referim të nenit 59/a të K. Penal llogaritet në periudhën e vuajtjes së dënimit dhe konsiderohet periudhë dënimi dhe për pasojë duhet të merret në konsideratë për efekt të aplikimit të lirit me kusht”.

Në vendimin nr. 44, datë 30.01.2018, të Gjykatës së Apelit arsyetohet se: “Gjykata e Shkallës së Parë ka evidentuar drejt se ligji penal dhe ai procedural penal në RSH nuk parashikojnë alternativa të dënimit me burgim, por alternativa të ekzekutimit të vuajtjes së dënimit me burgim. Kodi Penal, sipas nenit 29 paragrafi i parë, parashikon tri dënime kryesore, dënimin me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë. Referuar dispozitës së mësipërme, si dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 47/2012, datë 26.07.2012, gjykata ndaj personit të deklaruar fajtor për një vepër penale mund të caktojë vetëm një nga

dënimet e mësipërme. Në Kodin Penal, Kreu i 7-të është titulluar "Alternativat e Dënimit me Burgim". Titulli i këtij kreu duhet të interpretohet në harmoni me nenin 29 të këtij kodi si "Alternativa të ekzekutimit të dënimit me burgim", pasi në dispozitat vijuese të këtij kreu, nenet 58 e vijues, bëhet fjalë për mënyrën sesi do të veprohet për ekzekutimin e një dënimi me burgim të formës së prerë të dhënë nga gjykata.

Në këtë kontekst referimi i organit të akuzës vetëm në titullin e kreut dhe jo në përmbajtjen e dispozitave vijuese, konsiderohet i gabuar. Caktimi i një nga alternativave të dënimeve kryesore të parashikuara nga neni 29 i K. Penal në përputhje dhe me llojin dhe masën e dënimit për veprën penale konkrete, ezaurohet nga gjykata në çastin e caktimit të dënimit kryesor përfundimtar dhe, pas caktimit të dënimit përfundimtar me vendim të formës së prerë, mund të flitet vetëm për alternativa të ekzekutimit të këtij dënimi kryesor përfundimtar të caktuar nga gjykata.

Pikërisht mënyrën e vuajtjes së dënimit me burgim, Kodi Penal e ka parashikuar të mundshëm për t'u ekzekutuar me disa mënyra, të parashikuara nga nenet 58 e vijues të tij, në formën e gjysmëlirisë (neni 58 i K. Penal), pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë (neni 59 i K. Penal), qëndrimi në shtëpi (neni 59/a i K. Penal), etj.

Në nenin 59/a të Kodit Penal parashikohet shprehimisht: "Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushtë të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paafte nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësi familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjar, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord. Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi."

Ndërsa në nenin 31/4 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar parashikohet: "Kur gjykata vendos vuajtjen e dënimit të dhënë, me qëndrim në shtëpi, parashikuar në shkronjën "a" të nenit 59 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë për ekzekutim vendimin prokurorit dhe, në rast se ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe drejtorisë së këtij institucioni.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit me qëndrim në shtëpi dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjektë të tjera, privatë dhe shtetërore.

Shërbimi i provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi.

Shërbimi i provës harton programe për personin, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi.

Kur personi i dënuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, shërbimi i provës i rishikon këto detyrime, për të cilat i raporton menjëherë prokurorit.

(dy trupa të ndryshëm) ka mbajtur qëndrimin se qëndrimi në shtëpi e parashikuar në nenin 59/a të K. Penal është alternativë e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit me burgim, dhe përfundimi i kohës së qëndrimit në shtëpi do të përllogaritej sikurse do të përllogaritej nëse personi i dënuar do të qëndronte në IEVP. Në nenin 64 të K. Penal, parashikohet shprehimisht se personi i

---

*Nëse personi, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi, nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata, shërbimi i provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, i raporton prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon atij kërkesën për ndryshimin e detyrimit”.*

*Përsa më sipër, drejt ka argumentuar gjykata se caktimi i mënyrës së vuajtjes së dënimit me burgim nëpërmjet “qëndrimit në shtëpi” sipas nenit 59/a të Kodit Penal, nuk do të thotë se personi i dënuar ka mbaruar vuajtjen e dënimit me burgim, por periudha e mbetur për t’u vuajtur nëse është më pak se 2 vjet, mund të vijohet të vuhet jo në ambientet e IEVP, por në ambientet e shtëpisë së tij apo të një shtëpie të deklaruar prej tij. Ky interpretim del qartë dhe nga formulimi i dispozitës së mësipërme ku parashikohet: “gykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit”.*

*Dallimi i vuajtjes së dënimit me burgim në mënyrën klasike të saj nëpërmjet qëndrimit në ambientet e IEVP nga mënyra e vuajtjes nëpërmjet “qëndrimit në shtëpi” konsiston në faktin që i dënuari në rastin e dytë ka detyrimin të qëndrojë “i mbyllur” në ambientet e shtëpisë së deklaruar dhe të mos dalë prej saj vetëm në rastet e përcaktuara nga vendimi i gjykatës apo Shërbimi i Provës. Referuar dispozitave ligjore, një ditë e qëndrimit të përonit të dënuar në kushtet e “qëndrimit në shtëpi”, i llogaritet e barabartë me 1 ditë burgim.*

*Në të tilla kushte, për t’i dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në gjykim dhe ankim, Gjykata ka vlerësuar drejt se çështje ligjore që shtrohen për diskutim janë:*

- § A konsiderohet “personi i dënuar me burgim” në vuajtje e sipër të këtij dënimi personi që ndodhet në kushtet e “qëndrimit në shtëpi” sipas vendimit përkatës të gjykatës konform nenit 59/a të Kodit Penal?*
- § A duhet të përfundojë periudha e “qëndrimit në shtëpi” sipas nenit 59/a ndaj këtij personi dhe nëse po, cila do të jetë koha e përfundimit të këtij qëndrimi?*
- § A parashikon shprehimisht dispozita e nenit 64 të Kodit Penal dhe nenit 477 të Kodit të Proçedurës Penale që personi që paraqet kërkesën për lirim me kusht duhet të jetë duke vuajtur dënimin sipas mënyrës klasike të vuajtjes së këtij dënimi nëpërmjet qëndrimit në IEVP?*

*Në përgjigje të pyetjeve të mësipërme, Gjykata e Shkallës së Parë ka argumentuar me të drejtë se Kodi Penal në nenin 59/a të tij ka përcaktuar qartësisht se koha e “qëndrimit në shtëpi” konsiderohet si koha e vuajtjes së periudhës së mbetur pa u vuajtur, madje përcakton që kjo kohë duhet të jetë më pak se 2 vjet. Edhe neni 31/4 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në paragrafin e fundit parashikon shprehimisht se “personi, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi...”. Në të tilla rrethana nuk ka asnjë dyshim që personi që ndodhet në “qëndrim në shtëpi” është duke vuajtur dënimin me burgim. Koha e qëndrimit “në shtëpi” është pikërisht koha e dënimit me burgim që të dënuarit i ka mbetur pa vuajtur, e cila sipas nenit 59/a të Kodit Penal nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vjet. Përfundimi i kësaj kohe përllogaritet sikurse do të përllogaritej nëse personi i dënuar do të qëndronte në IEVP.*

*Lidhur me faktin nëse parashikojnë apo jo shprehimisht dispozita e nenit 64 të Kodit Penal dhe ajo e nenit 477 të Kodit të Proçedurës Penale që personi që paraqet kërkesën për lirim me kusht duhet të jetë duke vuajtur dënimin sipas mënyrës klasike të vuajtjes së këtij dënimi nëpërmjet qëndrimit në IEVP, nga përmbajtja e nenit 64 të Kodit Penal, rezulton se dispozita parashikon shprehimisht se “personi i dënuar me burgim” ka të drejtë që të kërkojë lirimin me kusht. Ligjvënësi ka ndrequr dhe formulimin e saj duke riformuluar shprehjen “lirim para kohe me kusht” me “lirim me kusht”, duke legjitimuar në paraqitjen e kësaj kërkesë çdo person që plotëson kushtin “i dënuari me burgim”. Ligji nuk i heq statusin e “të dënuarit me burgim” personit që ndodhet në “qëndrim në shtëpi”, madje ka parashikuar mekanizma të plotë lidhur me mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit me burgim në mënyrën e ekzekutimit të saj në këtë formë.*

*Përsa më sipër, Gjykata e Apelit e vlerëson të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Faktit se pretendimi i organit të akuzës që kërkuesit nuk mund t’i pranohet kërkesa, pasi nuk ndodhet në IEVP por në “qëndrim në shtëpi” nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore dhe si e tillë nuk duhet të vlerësohet nga gjykata”.*



dënuar me burgim ka të drejtë të kërkohej lirimi me kusht dhe se personit që ndodhet në “qëndrim në shtëpi” ligji nuk i heq statusin e “të dënuarit me burgim”.

Ndaj dy vendimeve sa më sipër të Gjykatës së Apelit, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi i të cilëve iu janë caktuar dy gjyqtarëve të ndryshëm në cilësinë e relatorit, nga të cilët për njërin është dalë me vendim datë 23.10.2023, por që nuk është zbardhur ende deri në ditën e përpilimit të këtij raporti.

Gjithashtu qëndrimin e Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>99</sup> lidhur me institutin e “lirimit me kusht” e gjejmë edhe tek një vendim tjetër gjyqësor, që i përket sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në të cilën është shprehur se gjatë “qëndrimit në shtëpi” i dënuari vazhdon normalisht vuajtjen e dënimit të tij, vetëm “mjedisi fizik” ku ai vuan dënimin ndryshon dhe për këtë shkak ligjvënësi parashikon edhe masa mbrojtëse shtesë në mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, ndërsa tek “lirimin me kusht” nuk ka interes vendi se ku personi e vuan dënimin, në burg apo në shtëpi, por vetëm plotësimi i kritereve të parashikuara nga neni 64 i K. Penal

Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen në short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjyqësore e përbërë nga një gjyqtar. Ky i fundit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është ndryshuar vetëm për shkaqe të dhënies së një vendimi jopërfundimtar si shpallja e moskompetencës; në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është ndryshuar vetëm për shkaqe të dhënies së një vendimi jopërfundimtar si shpallja e moskompetencës/pushim çështje/dhënie dorëheqje për shkak gjykimi në themel/heqje dorë/për shkaqe raporti shëndetësor; dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat është ndryshuar/ndryshuar vetëm për shkaqe të të qenit gjyqtar themeli/dhënies së një vendimi jo përfundimtar si pushim për shkak heqje dorë/përrjashtim me vendim gjyqësor/dorëheqje e pranuar/komandimi në një detyrë tjetër. Ndryshimi në të gjitha rastet e evidentuara në të tre gjykatat e rretheve gjyqësore është bërë sërish me anë të shortit elektronik.

---

<sup>99</sup> vendimin nr. 279, datë 30.11.2017 ku gjykata ka vendosur mospranim ankimi pas dorëheqjes së prokurorit. Nga vendimi rezulton që prokurori ka kërkuar përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe pas pranimit të kësaj kërkesë gjatë të cilës është administruar vendimi nr. 253, datë 30.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që ka vendosur lirimin me kusht të kërkuarit nga vuajtja e dënimit penal nr. 65, datë 08.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndryshuar me vendimin nr. 60, datë 19.04.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për pjesën e pavuajtur të këtij dënimi. Në këto kushte, prokurori ka arsyetuar se ankimit i mungonte objekti dhe për këtë arsye është kërkuar mospranimi i ankimit. Gjykata ka arsyetuar se: “Gjykata e Apelit Vlorë vlerëson të drejtë pretendimin e ngritur në ankim se instituti i “Lirimit me kusht” është i ndryshëm nga ai i alternativës tjetër të ekzekutimit të dënimit me burgim, sikundër është “qëndrimi në shtëpi”, parashikuar nga neni 59/a i K. Penal. Gjatë “qëndrimit në shtëpi” i dënuari vazhdon normalisht vuajtjen e dënimit të tij, vetëm “mjedisi fizik” ku ai vuan dënimin ndryshon dhe për këtë shkak ligjvënësi parashikon edhe masa mbrojtëse shtesë në mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës. Për “lirimin me kusht” nuk ka interes vendi se ku personi e vuan dënimin, në burg apo në shtëpi, por vetëm plotësimi i kritereve të parashikuara nga neni 64 i K. Penal. Në kushtet kur vendimi i lirimit me kusht është menjëherë i ekzekutueshëm, alternativa e “qëndrimit në shtëpi” nuk prodhon më pasojë juridike, pra nuk ka me efekt. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit nuk ka më objekt ankimi pasi alternativa e ekzekutimit të dënimit me burgim “qëndrimi në shtëpi” nuk prodhon më pasojë juridike për të dënuarin {xxx}”.

Gjithashtu shorti elektronik është përdorur si rregull<sup>100</sup> për përcaktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Apelit Vlorë, i plotësuar më pas edhe me dy gjyqtarë të tjerë. Gjykimi i kërkesave të tilla në Gjykatën e Apelit Vlorë është bërë nga trupë gjykuese e përbërë nga tre gjyqtarë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesat me objekt “lirim me kusht” janë shqyrtuar nga 6 gjyqtarë, në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Fier nga 8 gjyqtarë dhe në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Berat nga 8 gjyqtarë. Ndërsa në Gjykatën e Apelit Vlorë, vërehet se ka patur disa trupa gjyqësore, për periudhën objekt inspektimi.

**1.1.Në rastin e riparimit të kërkesës me të njëjtin objekt nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë/tretë, konstatohet se:**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë:**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë rezultojnë 6 të dënuar të cilët kanë përsëritur kërkesën “lirim me kusht”. Përsëritja e këtyre kërkesave evidentohet që është bërë ndërkohë që ishte duke u gjykuar kërkesa e parë dhe ende nuk ishte dalë me vendim gjyqësor. Vendimet gjyqësore në fjalë i përkasin vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor për kërkesat e 5 të dënuarve, dhe për kërkesat e 1 të dënuari vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, ndërkohë që ishte regjistruar kërkesa e dytë.

Nga këto raste konstatohet se vetëm për 1 të tillë kërkesat janë gjykuar nga i njëjti gjyqtar, ndërsa për të tjerat gjyqtarët kanë qenë të ndryshëm.

Në rastin e gjykimit të kërkesës së përsëritur nga i njëjti kërkues, rezulton se gjyqtari për kërkesën e parë ishte caktuar me short elektronik dhe për të dytën i njëjti gjyqtar ishte caktuar pa short. Për këtë rast evidentohet se për kërkesën e parë, është vendosur deklaram i papranueshëm për shkak të heqjes dorë nga gjykimi me arsyetimin se e njëjta kërkesë ishte në gjykim në të njëjtën gjykatë në një fazë më të avancuar. Ndërkohë që është vendosur për kërkesën e parë, është vazhduar gjykimi për kërkesën e dytë nga i njëjti gjyqtar i cili në përfundim ka vendosur pranimin e kërkesës. Të dyja vendimet kanë marrë formë të prerë për shkak mosankimimi.

Për rastet e tjera, konstatohet se caktimi i gjyqtarëve për shqyrtimin e kërkesave me të njëjtin objekt nga i njëjti i dënuar, është bërë me anë të shortit elektronik.

**Lidhur me rastet në të cilat kërkesa e dytë është regjistruar ndërkohë që nuk ishte përfunduar gjykimi nga gjykata e rrethit gjyqësor, konstatohet se:**

- Për rastet që u përket kërkesave të 3 të dënuarve, konstatohet se për kërkesën e dytë është përfunduar më parë gjykimi duke u vendosur pushim/deklaram i papranueshëm për shkak të heqjes dorë të kërkuesit, ndërsa gjykimi për kërkesën e parë ka vazhduar duke u vendosur në 1 rast pranimi i kërkesës lirim me kusht dhe për 2 raste rrëzimi i

<sup>100</sup> Për aq sa është evidentuar nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar.

kërkesës. Vendimi i pranimit dhe 2 vendime rrëzimi kanë marrë formë të prerë për shkak mosankimi brenda afateve ligjore, ndërsa për 1 rast vendim rrëzimi për shkak ankimi nga ankuesi është bërë objekt kontrolli nga Gjykata e Apelit, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht.

- Për rastin që i përket kërkesave të 1 të dënuari tjetër, konstatohet se për kërkesën e dytë gjykimi është përfunduar, pasi ka përfunduar gjykimi për kërkesën e parë, duke u vendosur deklaram i papranueshëm për shkak të deklaramit të kërkuarit për mosmarrje pjesë në gjykim. Në përfundim të gjykimit të kërkesës së dytë, është vendosur pranimi i kërkesës, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi brenda afateve ligjore.
- Për rastet që i përkasin kërkesave të 1 të dënuari konstatohet se për kërkesën e dytë gjykimi është përfunduar në të njëjtën datë me gjykimin për kërkesën e parë. Për kërkesën e dytë është vendosur deklaram i papranueshëm për shkak të heqjes dorë nga gjykimi dhe për kërkesën e parë është vendosur pranimi i kërkesës që ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi brenda afateve ligjore.

**Lidhur me rastet në të cilat kërkesa e dytë është regjistruar ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nuk kishte marrë formë të prerë, konstatohet se është vetëm 1 rast, për të cilën rezulton se janë caktuar me anë të shortit gjyqtarë të ndryshëm për shqyrtimin e kërkesave.**

- Për këtë rast, evidentohet se për kërkesën e parë është vendosur deklarami i papranueshëm për shkak mosparaqitje të kërkuarit megjithë dijeninë e tij dhe për kërkesën e dytë, është vendosur rrëzimi i kërkesës që ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi për shkak se nuk ka patur ankim.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier rezultojnë 103<sup>101</sup> të dënuar të cilët në disa raste rezultojnë të kenë paraqitur kërkesë me të njëjtin objekt dhe të cilat më pas janë marrë në shqyrtim nga ana e gjykatës. I njëjti kërkuar rezulton të ketë paraqitur më shumë se 2 kërkesa me të njëjtin objekt. Nga këto raste evidentohet se:

Në përgjithësi kur për kërkesën e parë është vendosur pushim/deklaram i papranueshëm/mospranim, për kërkesën e dytë caktohet i njëjti gjyqtar për ta shqyrtuar. Kjo praktikë nuk evidentohet të jetë ndjekur kur kërkesat me të njëjtin objekt të të njëjtit kërkuar janë regjistruar në të njëjtën datë apo në data të ndryshme dhe për të cilat nuk është dhënë ende vendimi lidhur me kërkesën e parë.

Nga këto vendime, konstatohet se për kërkesat e riparqitura e 3 të dënuarve, ato janë regjistruar në të njëjtën datë, ose me diferencë 1 ditë, duke marrë numra të ndryshëm dhe shorti

---

<sup>101</sup> Kjo referuar për aq sa mund të jenë të dhënat e plota në gjeneralitetet e kërkuarit në vendime, të cilat jo në të gjitha rastet kishin të pasqyruar gjeneralitetet e plota.

është hedhur në të njëjtën datë dhe orë, duke u caktuar gjyqtarë të ndryshëm të cilët kanë disponuar edhe në mënyrë të ndryshme. Kështu për secilën nga tre kërkesat, gjyqtari i parë që ka dalë me vendim ka vendosur deklarinimin e papranueshëm/pushim për shkak të evidentimit në seancë, për 2 nga këto raste, të një gjykimi tjetër më të avancuar në të njëjtën gjykatë, nga një gjyqtar tjetër dhe më pas gjyqtari tjetër ka vendosur pranim të kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit.

Nga këto vendime është konstatuar gjithashtu se për kërkesat e riparaqitura të 15 të dënuarve, konstatohet se kërkesat janë të regjistruar në data të ndryshme me diferencë kohore/muaj, duke u regjistruar në sistem me të njëjtin emër, dhe duke u hedhur në short sërish me të njëjtin emër, për rrjedhojë e të cilit janë caktuar gjyqtarë të ndryshëm. Këta gjyqtarë të caktuar me short, rezultojnë të jenë të njëjtët që kanë proceduar deri në përfundim të gjyqimit.

Në vijim lidhur me vendimet në fjalë, konstatohet se nga këto për kërkesat e riparaqitura të 4<sup>102</sup> të dënuarve, ato janë të regjistruar në data të ndryshme, por duke u regjistruar në sistem me emrin jo korrekt të kërkuesit, i cili është i pasqyruar ndryshe në vendim. Me këto të dhëna është bërë edhe hedhja në short duke u caktuar gjyqtarë të ndryshëm.

---

<sup>102</sup> 1. Vendimi nr. 461, datë 23.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues Q. Kërkesa është shortuar më datë 24.01.2017 nga kryetari, me emrin kërkues Q...o L...i, duke u caktuar gjyqtari 1. Disponuar me pushim.  
1/1. Vendimi nr. 1307, datë 24.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues Q. Kërkesa është shortuar më datë 06.04.2017 nga kryetari i njëjtë, me emrin kërkues Q... k L..a, duke u caktuar gjyqtare 2. Disponuar me pushim.

2. Vendimi nr. 296, datë 27.02.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues L. K. R. Kërkesa është shortuar më datë 15.12.2016 nga kryetari, me emrin kërkues si tek vendimi, duke u caktuar gjyqtar 1. Disponuar me pushim.

2/1. Vendimi nr. 1798, datë 30.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues K. R. Kërkesa është shortuar më datë 10.10.2017 nga kryetari i njëjtë, me emrin kërkues si tek vendimi, duke u caktuar gjyqtar 2. Disponuar me papranueshëm.

3. Vendimi nr. 1436, datë 14.09.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues E. Kërkesa është shortuar më datë 18.07.2017 nga kryetari, me emrin kërkues El.. A, duke u caktuar gjyqtar 1. Papranueshëm.

3/1. Vendimi nr. 1858, datë 06.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues E. Kërkesa është shortuar 17.10.2017 nga kryetari i njëjtë, me emrin kërkues Ev.. A duke u caktuar gjyqtar 2. Papranueshëm.

4. Vendimi nr. 233, datë 16.02.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues A. Kërkesa është regjistruar me nr. 322, datë 26.01.2017, shortuar nga llogaria e kryetarit më datë 26.01.2017, me emrin As.. D, duke u caktuar gjyqtari 1. Pushim.

4.1. Vendimi nr. 954, datë 05.06.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkues A. Kërkesa është regjistruar me nr. 734, datë 28.03.2017, shortuar nga llogaria e kryetarit të njëjtë më datë 28.03.2017 me emrin Ar.. D, duke u caktuar gjyqtar 2. Pranim dhe marrë formë të prerë pa u ankimuar.



Nga vendimet me të njëjtin kërkues dhe të njëjtin objekt, është evidentuar gjatë këtij inspektimi 1<sup>103</sup> rast që të ketë patur kërkesa të përsëritura brenda afatit 6 mujor nga data kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë, sipas parashikimeve të nenit 477 të K. Pr. Penale, por që për të cilën nuk është evidentuar si e tillë nga gjyqtari që ka trajtuar çështjen në themel duke vendosur edhe pranimin. Më konkretisht për kërkesën e parë është vendosur rrëzimi që ka marrë formë të prerë më datë 30.05.2017 dhe kërkesa e dytë është regjistruar më datë 05.09.2017 duke u caktuar një gjyqtar tjetër i cili ka vendosur pranimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi të fundit rezulton se është ushtruar ankim nga prokurori që ka mbajtur qëndrimin për rrëzimin e kërkesës, dhe Gjykata e Apelit ka vendosur mospranim për shkak të heqjes dorë të prokurorit të apelit, duke mos e shqyrtuar këtë çështje në themel. Lidhur me rastin konkret, do të vlerësohet verifikimi i mëtejshëm në kuadër të ligjit nr. 96/2016 duke patur në konsideratë periudhën kohore dhe statusin e magjistratit/magjistratëve, si dhe konstatimin e rasteve të tjera të të njëjtës natyrë sipas parashikimeve të nenit 117 të të njëjtit ligj.

Gjithashtu, nga vendimet me të njëjtin kërkues dhe të njëjtin objekt, është evidentuar edhe 1 rast, kur i njëjti gjyqtar si edhe në rastin më sipër ka proceduar me rrëzimin e kërkesës për shkak të mosrespektimit të kërkesës së parashikuar nga neni 477 i K. Pr. Penale, pasi kërkesa ishte përsëritur brenda afatit 6 mujor nga rrëzimi i kërkesës së mëparshme të dhënë nga një gjyqtar tjetër. Kërkuesi rezultonte të kishte paraqitur 3 kërkesa, ku për kërkesën e parë gjyqtari i caktuar me short elektronik kishte vendosur rrëzimin e kërkesës, për kërkesën e dytë është caktuar me short elektronik një gjyqtar i ndryshëm nga gjyqtari i parë i cili ka vendosur deklarinimin e papranueshëm për shkak të heqjes dorë nga kërkesa dhe për kërkesën e tretë rezulton të jetë caktuar sërish gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesën e dytë, pas ndryshimit të një gjyqtari tjetër të caktuar me short elektronik.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat rezultojnë 3 të dënuar të cilët kanë përsëritur kërkesën "lirim me kusht". Përsëritja e kërkesave rezulton të jetë bërë si përpara përfundimit të gjykimit të kërkesës paraardhëse, ashtu edhe pas.

Për këto raste, konstatohet se kërkesat vetëm nga një i dënuar janë shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar që ka gjykuar kërkesën e regjistruar më parë. I dënuari në rastin konkret rezulton se ka paraqitur 5 kërkesa me të njëjtin objekt "lirim me kusht". Në këtë rast, gjyqtari i parë ishte caktuar me short elektronik dhe më pas megjithëse kërkesa në vazhdim i është nënshtruar shortit elektronik duke u caktuar një gjyqtar i ndryshëm nga i pari, me urdhër të kryetarit çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarit të parë me shkakun e gjykimit të kërkesës së parë me vendim jopërfundimtar.

Kërkesat e dy të dënuarve të tjerë janë shqyrtuar nga gjyqtarë të ndryshëm, të caktuar me short elektronik.

---

<sup>103</sup> Vendimi nr. 2022, datë 24.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.



**Lidhur me kërkesat e përsëritura përpara përfundimit të gjykimit të kërkesës së parë,** konstatohen të jenë nga dy kërkuës. Për këto raste, konstatohet se për kërkesën e parë është vendosur pushimi për shkak të heqjes dorë/tërheqjes nga kërkesa dhe për kërkesën në vazhdim është vendosur rrëzim të kërkesës. Nga rastet e kërkesave të dy kërkuësve në fjalë, konstatohet se njëri prej kërkuësve ka paraqitur tre kërkesa me të njëjtin objekt “lirim me kusht” të cilët janë gjykuar nga gjyqtarë të ndryshëm të caktuar me short elektronik dhe tjetri 5 kërkesa të cilat janë shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar i caktuar fillimisht me short elektronik dhe pastaj me ndryshim. Për këtë të fundit, konstatohet se dy nga kërkesat janë të regjistruar madje edhe në të njëjtën ditë.

Për rastin e kërkuësit që ka paraqitur 3 kërkesa me të njëjtin objekt konstatohet se për kërkesën e parë është vendosur pushimi për shkak të tërheqjes së kërkesës nga kërkuësi, për të dytën është vendosur rrëzim kërkesë dhe pa marrë ende vendimi formë të prerë, konstatohet se është proceduar me regjistrimin e kërkesës së tretë me të njëjtin objekt, për të cilën sërish është vendosur rrëzimi i kërkesës. Për këtë të fundit konstatohet se është bërë ankim në Gjykatën e Apelit e cila ka vendosur pushimin për shkak të vdekjes së kërkuësit.

Për rastin e kërkuësit që ka paraqitur 5 kërkesa me të njëjtin objekt, për katër kërkesat nga ana e të njëjtit gjyqtar është vendosur pushim i gjykimit për shkak të heqjes dorë kërkuësi dhe për kërkesën e fundit, e njëjta gjyqtare ka vendosur me rrëzim kërkesë për shkak të mosplotësimit të arsyeve të veçanta. Ky vendim i fundit, mbi bazën e ankimit të kërkuësit, është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht.

**Lidhur me kërkesat e riparaqitura përpara përfundimit të gjykimit të kërkesës së parë,** konstatohen të jenë nga 1 kërkuës. Për kërkesën e parë është vendosur pushim për shkak të heqjes dorë nga kjo kërkesë, ndërsa për kërkesën e dytë është vendosur pranimi i kërkesës, e cila është lënë në fuqi edhe pas ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Në kohën kur nga kërkuësi është proceduar me kërkesën e dytë për lirim me kusht, ai ka qenë duke vuajtur dënimin me burgim në alternativën “qëndrim në shtëpi”, që ishte vendosur si e tillë në kërkesën e parë kur kishte paraqitur edhe kërkesën për “lirim me kusht” për të cilën kishte hequr dorë. Lidhur me këtë rast, për shkak të vendit të vuajtjes së dënimit ka patur diskutim në gjykim, e cila është trajtuar më sipër.

## **2. Palët pjesëmarrëse në gjykim:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për aq sa mund të evidentohet përveç kërkuësit, edhe prokurorit, konstatohet se janë thirrur edhe IEVP dhe Shërbimit i Provës. Pjesëmarrja e këtyre dy institucioneve, për aq sa mund të evidentohet nga vendimet gjyqësore nuk rezulton në të gjitha rastet<sup>104</sup>, megjithëse rezulton se në të gjitha këto gjykime janë administruar raportet përkatëse të këtyre dy institucioneve.

<sup>104</sup> Në vendimet e pranimi/rrëzimit të 3 gjyqtarëve dhe në 1 vendim të 1 gjyqtari.

## Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për aq sa mund të evidentohet në ato për të cilët është disponuar me pranim/rrëzim, përveç kërkuetit, edhe prokurorit, konstatohet se është thirrur gjithmonë si palë IEVP, ndërsa është administruar edhe raporti përkatës nga Shërbimi i Provës.

## Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

Referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për aq sa mund të evidentohet në to, konstatohet pjesëmarrje e prokurorit, krahas kërkuetit, por nuk ndiqet një praktikë e njëjtë përse i përket thirrjes së Shërbimit të Provës si palë. Nga të gjithë gjyqtarët që janë marrë me trajtimin e kërkesave me objekt "lirimin me kusht", konstatohet se vetëm nga njëri nuk thirret Shërbimi i Provës, megjithëse respektohet detyrimi për kërkimin dhe administrimin e raportit vlerësues lidhur me mundësinë e riintegrit të mundshëm në shoqëri të kërkuetit. Nga rastet e studiuara, është konstatuar një rast vendimi pranimi, kur nga ana e një gjyqtari<sup>105</sup> nuk ishte administruar raporti nga shërbimi i provës, si dhe gjithashtu nuk ishte administruar as kartela e të dënuarit nga IEVP, megjithëse kjo e fundit ishte paraqitur në seancë duke shprehur qëndrimin për pranimin e kërkesës. Kjo mënyrë e të proceduarit, është vlerësuar si moszbatim i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e Vendimeve Penale" nga ana e gjykatës së Apelit, që bazuar në nenin 428/ç të K. Pr. Penale, ka disponuar me prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim me një trup tjetër gjykues. Më konkretisht, Gjykata e Apelit<sup>106</sup> është shprehur se: "Gjykata e Apelit, bazuar në vendimin unifikues të cituar më lart, vlerëson se nga Gjykata e Shkallës së Parë Berat nuk është zbatuar ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", pasi nuk ka administruar në gjykim kopjen e kartelës së të dënuarit {xxx} të administruar nga IEVP Berat në lidhje me dinamikën e vlerësimit të sjelljes së tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së vuajtjes së dënimit, si dhe nuk ka kërkuar nga Shërbimi Vendor i Shërbimit të Provës raport sipas nenit 31/6, pika 3 të ligjit të sipërcituar. Në vendimin unifikues të cituar më lart Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë interpretuar nenin 64 të Kodit Penal, si dhe procedurën që duhet të ndjekë gjykata në shqyrtimin e këtyre kërkesave, provat që duhet të marrë si dhe drejtimin e hetimit gjyqësor. Rezulton që Gjykata e Shkallës së Parë Berat nuk ka kryer hetim gjyqësor në lidhje me përmbushjen ose jo të kriterëve të parashikuara nga neni 64 i K. Penal nga i dënuari {xxx}. Sipas ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", është detyrë e gjykatës që gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për librim para kohe të kërkojë nga IEVP vlerësimin dinamik të sjelljes së të dënuarit, si dhe nga Shërbimi Vendor i Provës raportin sipas nenit 31/6, pika 3, të ligjit, për pasojë duke qënë se këto detyra nuk janë zbatuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk mund të shprehet nëse kërkesa e kërkuetit është e bazuar në prova apo jo. Gjykata e Apelit vlerëson se këto prova nuk mund të merren në Gjykatën e Apelit pasi janë prova që merren kryesisht, nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerësohen prej

<sup>105</sup> vendimi nr. 75, datë 29.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

<sup>106</sup> vendimi nr. 387, datë 31.05.2018.

saj paraprakisht duke qënë se janë thelbësore në shqyrtimin e bazueshmërisë së kërkesës me objekt lirim para kohe. Për pasojë vendimi i ankimuar do të prishet dhe aktet do të dërgohen për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të zbatojë orientimet e vendimit unifikues të cituar më lart në lidhje me provat që duhet të marrë kryesisht gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesave me objekt lirim para kohe, si dhe interpretimin e “arsyeve të veçanta” që parashikon neni 64 i K. Penal si kriter për pranueshmërinë e kërkesave me objekt “lirim para kohe”.

## **2.1. Kërkuesi si palë pjesëmarrëse:**

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet në të gjitha llojet e mënyrës së disponimit të gjykatës, dhe kryesisht tek gjykimet të cilat përfundojnë me mënyrë disponimi pushim për shkak të heqjes dorë, mosparaqitje apo moskompetencë.

## **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse:**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Në vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për aq sa mund të evidentohet në to është konstatuar se në të gjitha rastet që është proceduar me vendim pranim/rrëzim, prokurori ka qënë i pranishëm duke shprehur qëndrimin e tij. Mungesa e prokurorit është konstatuar në 2 raste kur nga ana e gjykatës është vendosur deklaram i papranueshëm, megjithëse për aq sa evidentohet është proceduar me thirrjen e prokurorit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Në vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për aq sa mund të evidentohet në to është konstatuar se në të gjitha rastet që është proceduar me vendim pranim/rrëzim, prokurori ka qënë i pranishëm duke shprehur qëndrimin e tij. Mungesa e prokurorit është konstatuar në 28 raste kur nga ana e gjykatës është vendosur deklaram i papranueshëm dhe mospranim, si dhe në 1 rast shpallje moskompetence.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është konstatuar në të gjitha rastet, nga ana e gjykatës është proceduar me pjesëmarrjen e prokurorit.

## **2.3. Gjykata e Apelit Vlorë**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit konstatohet se përveç prokurorit dhe kërkuesit, është thirrur për të marrë pjesë edhe IEVP përkatëse kur kërkuesi vuan dënimin me burgim. Nga ana e kësaj gjykate është proceduar me shqyrtimin e kërkesës me objekt “lirim me kusht”, në prani të mbrojtësit të kërkuesit. Mbrojtësi ka qënë i caktuar nga vetë kërkuesi apo edhe kryesisht



nga ana e gjykatës.

### **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”**

#### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për të gjithë periudhën e inspektimit është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit nga seksioni i ekzekutimeve të vendimeve penale, që ka funksionuar në këtë periudhë, i cili ka qenë i bashkuar me seksionin për të mitur. Në këtë seksion ekzekutimi dhe për të miturit, gjithsej kanë qenë përfshirë tre prokurorë dhe në përfaqësimet e çështjeve me objekt “lirim me kusht” kanë marrë pjesë 2 prokurorë, të cilët janë caktuar sipas vlerësimit të drejtuesit të Seksionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale.

#### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit nga seksioni i ekzekutimeve të vendimeve penale. Nga praktika dokumentare e vendimeve gjyqësore në fjalë, konstatohet gjithashtu se rregullimi në fjalë në drejtim të caktimit të prokurorit përfaqësues nga seksioni i ekzekutimeve, nuk është respektuar në të gjitha rastet.

Kështu më konkretisht, konstatohet nga vendimet gjyqësore se si prokurorë pjesëmarrës në këto gjykime paraqiten 12 prokurorë. Nga këta prokurorë, 9 prej tyre, referuar informacionit të sjellë nga Zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i përkasin seksionit të ekzekutimeve, referuar urdhërave të drejtuesit të prokurorisë. Referuar këtyre urdhërave, për periudhën shkurt të vitit 2017 deri në prill të vitit 2018 seksioni i ekzekutimeve ka qenë i përbërë nga 3 prokurorë, njëri prej të cilëve ishte caktuar edhe në detyrën e drejtuesit të seksionit. Përgjatë kësaj periudhe, ka patur ndryshim të një prokurori për shkak të largimit nga kjo detyrë, duke u caktuar një prokuror tjetër dhe ky i fundit në vazhdim për shkak të kërkesës së tij, është zëvendësuar me një prokuror tjetër. Në prill të vitit 2018, seksioni është përbërë nga pesë prokurorë, njëri prej të cilëve i caktuar edhe si drejtues seksioni. Nga kjo përbërje vetëm 1 prokuror ishte nga seksioni i mëparshëm. Dhe në vazhdim evidentohet një ndryshim i përbërjes së prokurorit të ekzekutimit në shtator dhe në tetor 2019, për shkak të ndryshimit të drejtuesit të prokurorisë.

Përsa i përket procedurës së ndjekur për caktimin e prokurorit në gjykimet e zhvilluara me objekt “Lirim me kusht”, nuk jepen të dhëna të plota. Kështu sipas informacionit të përcjellë: - për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.02.2020 në këtë zyrë prokurorie, përfaqësimi në kërkesat në fazë ekzekutimi bëhej nga prokurorët e caktuar në seksionin e ekzekutimeve dhe caktimi i prokurorëve deri në datën 30.09.2019 bëhej me shënimin e drejtuesit të prokurorisë; - pas datës 30.09.2019 me nxjerrjen e udhëzimit nr. 87, datë 30.09.2019 të drejtuesit, kërkesat në fazë



ekzekutimi janë hedhur në short manual midis prokurorëve të caktuar në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale.

### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat**

Për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është proceduar me rregullin e përfaqësimit nga prokurori i cili ka përfaqësuar prokurorinë në gjykimin e të dënuarit në cilësinë e të pandehurit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Për kërkesat që paraqiteshin nga të dënuar të tjerë, për përfaqësimin në gjykim të kërkesave me objekt “lirim me kusht”, është ngarkuar prokurori i caktuar me ekzekutimet. Kjo mënyrë e të proceduarit është rregulluar me urdhërat përkatëse të drejtuesit, që kanë qenë në fuqi brenda periudhës së inspektimit.

Në këtë zyrë prokurorie, nuk ka patur seksione të veçanta për shkak të numrit të ulët të prokurëve.

### **Prokuroria e Apelit Vlorë**

Procedura e ndjekur për caktimin e prokurorit përfaqësues të organit të prokurorisë në çështjet me objekt gjykimi “lirim me kusht” për periudhën objekt inspektimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, ka qenë e njëjtë me atë të ndjekur edhe për gjykimet e tjera, kur një prokuror i caktuar përcaktohej me short manual për të përfaqësuar organin e prokurorisë pranë një kolegji penal të caktuar.

Procedura e hedhjes së shortit në Prokurorinë e Apelit Vlorë, zakonisht ndiqte atë të hedhjes së shortit për ndarjen e trupave gjykues nga Gjykata e Apelit Vlorë, duke u shmangur në çdo rast që i njëjti prokuror të përfaqësonte prokurorinë pranë të njëjtit trup gjykues, për më tepër se një vit kalendarik. Ky mekanizëm ka funksionuar i tillë pa ndryshime për të gjithë periudhën objekt kontrolli, ku nga kjo mënyrë e ndarjes së punës bënte përjashtim Drejtuesi i Prokurorisë, i cili merrte pjesë në një numër të më vogël çështjesh, ndër të cilat edhe çështje me objekt lirim me kusht.

#### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 34 vendime, për 8 prej tyre është proceduar me pranim kërkesë, për 12 prej tyre me rrëzim kërkesë, për 9 prej tyre me deklaram i papranueshëm, për 4 prej tyre me moskompetencë dhe për 1 prej tyre me pushim.

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 736 vendime, për 183 prej tyre është proceduar me pranim kërkesë, për 199 prej tyre me rrëzim kërkesë, për 244 prej tyre deklaram i papranueshëm, për 11 prej tyre moskompetencë, për 96 prej tyre pushim dhe për 3 prej tyre me mospranim.

Për kërkesat e regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 78 vendime, për 36 prej tyre është proceduar me pranim kërkesë, për 25 raste me rrëzim kërkesë, për 2 raste deklarim i papranueshëm, për 1 prej tyre me moskompetencë tokësore dhe për 14 prej tyre me pushim.

Nga vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat nuk konstatohet të ketë patur rast që të jetë disponuar lidhur me kërkesën e një të dënuari, për të cilin në vendimin e deklarimit fajtor dhe dënimit me burgim, të ishte disponuar edhe caktimi i një periudhe sigurie gjatë të cilës nuk lejohej zbatimi i nenit 64 të Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 65/a të K. Penal.

#### **4.1. Lidhur me arsyet, për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me shpallje moskompetence, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës, është vuajtja apo transferimi i kërkuarit/të dënuarit në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kërkuarit në 2 raste në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fier dhe në rastet e tjera transferimi është bërë pas regjistrimit të kërkesës. Në 1 nga këto raste evidentohet se ka patur vendimmarrje për shpallje moskompetence dy herë për të njëjtin kërkuar<sup>107</sup>. Kërkesa e parë e këtij kërkuari është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e cila ka shpallur moskompetencën për shkak se kërkuari është duke vuajtur dënimin në IEVP Fier, dhe në vazhdim kur po procedohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, kjo e fundit ka konstatuar se kërkuari ishte transferuar në IEVP Vlorë dhe për këtë arsye është vendosur të shpallej moskompetenca dhe dërgimin e akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në këtë gjykatë, gjykimi i çështjes me short i ka kaluar fillimisht një gjyqtari të ndryshëm nga gjyqtari që kishte vendosur shpalljen e moskompetencës dhe më pas i ka kaluar gjyqtarit që kishte vendosur shpalljen e moskompetencës. Në këtë gjykim është ngritur si diskutim çështja e deklarimit të moskompetencës pa u zhvilluar konflikti, por për shkak të heqjes dorë nga ana e kërkuarit është proceduar në përfundim me deklarim të papranueshëm.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës tokësore, është vuajtja apo transferimi i kërkuarit/të dënuarit në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Kërkuari në 1 rast në momentin e paraqitjes së kërkesës ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP

---

<sup>107</sup> vendimi nr. 741, datë 22.05.2019.

tjetër nga ajo që përfshihet në territorin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe në të gjitha rastet e tjera në momentin e paraqitjes së kërkesës, kërkuessit kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fier dhe më pas janë transferuar në IEVP tjetër nga ajo që përfshihet në territorin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpallja e moskompetencës tokësore është vendosur vetëm në 1 rast të gjykimit të kërkesës së 1 të dënuari dhe arsyeja për të cilën është vendosur është për shkak të vuajtjes së dënimit në një IEVP tjetër nga ajo ku shtrin kompetencat e veta Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Kërkuessi në rastin konkret ka qenë duke vuajtur dënimin në këtë IEVP, edhe në datën e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, me objekt "lirim me kusht".

### **4.2.Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkesë, konstatohet se:**

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, konstatohet se bëhet fjalë për 1 rast të vitit 2019, dhe se arsyeja e disponimit në këtë mënyrë është për shkak se kërkuessi ka hequr dorë dhe se prokurori është shprehur se ka një kërkesë tjetër që është duke u gjykuar në një fazë më të avancuar, duke kërkuar edhe pushim. Nga ana e gjykatës është proceduar në këtë mënyrë, duke vendosur si bazë ligjore nenin 1 të K. Pr. Penale,

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Referuar vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të konstatimit të tërheqjes nga kërkesa/heqjes dorë nga kërkesa, mosparaqitje, lirimit të kërkuessit i dënuar, ka ndërruar jetë.

Lidhur me shkakun e tërheqjes/heqjes dorë nga kërkesa konstatohet se për këtë shkak është vendosur si para ndryshimeve me ligjin me nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, lidhur me nenin 471/5 të K. Pr. Penale ashtu edhe më pas, duke vendosur si bazë ligjore nenet 379, 380, 290/1 të K. Pr. Penale dhe është proceduar në këtë mënyrë pothuaj nga të gjithë gjyqtarët.

Më konkretisht pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore sa më sipër, evidentohen vendimet e dy gjyqtarëve, përkatësisht njëri gjyqtar ka disponuar në këtë mënyrë në 6 raste dhe tjetri në 1 rast.

Lidhur me shkakun e lirimit, nga të gjithë vendimmarrjet konstatohet se kjo mënyrë disponimi është përdorur nga të gjithë gjyqtarët, gjithsej 6 gjyqtarë, të cilët kanë patur këto raste deri para



ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, sipas ligjit me nr. 35/2017. Ndërsa pas ndryshimeve e konstatohet tek një vendim i një gjyqtari.

Lidhur me shkakun e ndërrimit jetë, konstatohet tek 1 vendim që i përket vitit 2018.

Lidhur me shkakun e mosparaqitjes, konstatohet se pushim është vendosur në 1 rast të vitit 2017 para ndryshimeve ligjore të sipërpërmendur, por shkakun në fjalë ka qenë i shoqëruar edhe me tërheqjen nga kërkesa.

Nga të gjitha vendimet sa më sipër, është bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit duke u mbështetur në pretendimet e mbrojtësit të ankuesit, të zbatimit të gabuar në nenin 64 në mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës, vetëm një vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i datës 08.09.2017<sup>108</sup>. Në këtë vendim nga ana e gjykatës ishte proceduar me pushimin e çështjes për shkak të heqjes dorë nga kërkuesi dhe mbrojtësi i caktuar. Gjykata e Apelit<sup>109</sup> ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke arsyetuar se: *“Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur “Lënie në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. 1406, datë 08.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata është shprehur “Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me të drejtë, ka vendosur pushimin e çështjes penale, bazuar kjo në pikën 5, të nenit 417 të K. Pr. Penale, ndryshuar me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017”.*

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Referuar 2 vendimeve të kësaj gjykate, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkuesit se heqin dorë/tërhiqen nga kërkesa.

Vendimet e pushimit në fjalë, i përkasin viteve 2017, 2018, 2019, nga të cilat 13 vendime i përkasin periudhës pas datës 01 gusht 2017, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Këto vendime rezultojnë të jenë marrë nga disa gjyqtarë dhe konstatohet se vendosen baza ligjore të ndryshme, mbi të cilat është arsyetuar disponimi në këtë mënyrë.

Kështu në vitin 2017 ku janë 2 raste njëra para dhe pas datës 1 gusht 2017, të marrë nga dy gjyqtarë të ndryshëm, shkakun është i njëjtë, heqje dorë nga kërkuesi dhe disponimi i tyre bazohet në të njëjtën bazë ligjore, në nenin 387/1, 2 të K. Pr. Penale duke arsyetuar mbi mungesën e një rregullimi të posaçëm të situatës së shqyrtimit të kësaj lloji kërkesë dhe referimi tek rregullimi i përgjithshëm i rasteve të gjykimit në themel.

Në vitin 2018 konstatohen 9 raste të marrë nga katër gjyqtarë të ndryshëm<sup>110</sup>, shkakun është i

<sup>108</sup> nr. 1406, datë 08.09.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>109</sup> vendimi nr. 223, datë 10.04.2018.

<sup>110</sup> ku 1 gjyqtar paraqitet në 5 raste dhe tre të tjerët në 1 rast.



njëjtë, tërheqje dhe heqje dorë nga gjykimi. Baza ligjore e përdorur nga gjyqtarët është e ndryshme. Kështu gjyqtari i njëjtë në 5 raste i cili është i njëjti në vitin 2017 ka disponuar në 1 rast me bazë ligjore 387/2 të K. Pr. Penale si edhe në vitin 2017 dhe për 4 raste me bazë ligjore 328/f të K. Pr. Penale dhe 31/6 të ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar. Dy gjyqtarë të tjerë për 2 raste bazohen tek neni 387 i K. Pr. Penale dhe një nga gjyqtarët në vendimin e tij<sup>111</sup> që ka arsyetuar në këtë referim është konstatuar se argumenton “për shkak të mos rregullimit të posaçëm të situatës së shqyrtimit të kërkesave penale të kësaj natyre si dhe pasojave të heqjes dorë nga gjykimi, edhe në këto raste gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme që rregullojnë procesin penal dhe vendimmarrjet e gjykatës për përfundim të tij, dhe si të tilla vlerësohet se të njëjtët rregulla të parashikuar në nenin 387 të K. Pr. Penale zbatohen edhe në rastet kur shqyrtohen kërkesa penale gjatë fazës së hetimeve paraprake, gjykimit apo ekzekutimit”. Dhe gjyqtari tjetër, edhe ky për 1 rast, arsyeton për pushim,<sup>112</sup> me arsyetimin: “... duke argumentuar edhe faktin se për shkak të plotësimit të dosjes me aktet e domosdoshme nuk mund të vlerësohet pabazueshmëria e dukshme e çështjes në ligj. Gjykata arsyeton si më sipër, duke argumentuar edhe pse disponimi është i parashikuar nga neni 471, pika 2 e saj kërkon që gjykata që shqyrton këto kërkesa i shpall të papranueshme kur ato janë haptas të pabazuara ose përsëritje e kërkesave të rrëzuara më parë, përsëri kjo gjykatë vlerëson që të pushoj gjykimin e çështjes. Gjykata vazhdon në arsyetimin e saj se arrin në këtë përfundim në rrethanat kur palët tërhiqen dhe se në këto kushte përpara gjykatës nuk ka çështje për gjykim pasi nuk ka objekt kërkimi”.

#### **4.3. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “deklarimin e papranueshëm të kërkesës”, konstatohet se:**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Referuar vendimeve gjyqësore, konstatohet se ato i përkasin 1 rast në vitin 2017 dhe të tjerat në vitin 2019, dhe është disponuar bazuar në nenin 471/5 të K. Pr. Penale: - në vitin 2017 dhe në 2 raste të vitit 2019 për shkak të mosparaqitjes të kërkuesit megjithë dijeninë e tij dhe rastet e tjera në vitin 2019 për shkak të heqjes dorë. Disponimet për shkak të mosparaqitjes së kërkuesit janë të dy gjyqtarëve të ndryshëm, dhe të tjerat për shkak të heqjes dorë i përkasin gjyqtarëve dy gjyqtarëve të tjerë ku njëri prej tyre është i njëjtë me gjyqtarët e përmendur.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Referuar vendimeve gjyqësore, konstatohet se deklarimi i papranueshëm është vendosur për të njëjtat shkaqe si dhe kur është disponuar me pushim, por edhe për raste të tjera, mosplotësimit të afatit  $\frac{3}{4}$  e vuajtjes së dënimit, për shkak të kryerjes së krimit tjetër me dashje, se kërkuesi ka kryer një krim për të cilën është e ndaluar zbatimi i nenit 64 të K. Penal, për shkak të statusit të bashkëpunëtorit të drejtësisë që ka i dënuari. Të gjitha vendimet janë të viteve 2018, 2019,

<sup>111</sup> vendimi nr. 376, datë 19.12.2018.

<sup>112</sup> vendimi nr. 234, datë 19.09.2018.

2020, përveç një vendimi, i vitit 2017 pas ndryshimeve ligjore me ligjin nr. 35/2017 të kodit të procedurës penale për të cilin është disponuar me deklaram i papranueshëm për shkak lirimi të kërkuarit.

Për deklarimin e papranueshëm për shkaqet si edhe ato për të cilat ishte vendosur pushimi, nga ana e gjykatës është përdorur si bazë ligjore neni 471/5 i K. Pr. Penale, ndërsa për deklarimin e papranueshëm për shkaqet e tjera si mosplotësimi të afatit  $\frac{3}{4}$  të vuajtjes së dënimit<sup>113</sup>, për shkak të kryerjes së krimit tjetër me dashje<sup>114</sup>, se kërkuari ka kryer një krim për të cilin është e ndaluar zbatimi i nenit 64 të K. Penal, për shkak të statusit të bashkëpunëtorit të drejtësisë që ka i dënuari, nga ana e gjykatës<sup>115</sup> është proceduar duke u konkluduar bazuar në nenin 471/2 të K. Pr. Penale.

Lidhur me disponimin e deklarimit të papranueshëm për shkak të të qenit përsëritës, bazuar në nenin 471/2 të K. Pr. Penale është ngritur diskutimi në Gjykatën e Apelit e cila në vendimin e saj që ka pranuar këtë lloj vendimmarrje të gjykatës së rrethit gjyqësor, ka theksuar faktin se në kushtet e një pengese të tillë, nuk ka qenë e nevojshme marrja e provave në lidhje me personalitetin e të dënuarit, pasi ligji ka ndaluar shprehimisht lirimin me kusht të subjekteve përsëritës për krime me dashje.<sup>116</sup>

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat:**

Referuar vendimeve gjyqësore është konstatuar se ka patur 2 raste në të cilat është disponuar me deklaram i papranueshëm të kërkesës. Këto vendime kanë qenë të vitit 2018 dhe 2019 dhe i përkasin të njëjtit gjyqtar.

Në vendimmarrjen e vitit 2018, gjyqtari ka disponuar me deklaram të papranueshëm për shkak të tërheqjes së kërkesës nga kërkuari dhe mosplotësimi të kohës së dënimit referuar nenit 64 të K. Penal, duke e arsyetuar këtë si një kusht me qëllim shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht dhe duke e konsideruar kërkesën në kundërshtim me ligjin. Baza ligjore e përdorur në këtë rast

<sup>113</sup> Vendim nr. 1184, datë 25.06.2018, vendim nr. 1185, datë 25.06.2018, vendimi nr. 983, datë 28.05.2018.

<sup>114</sup> Vendimi nr. 1101, datë 13.06.2018, për të cilin është ushtruar ankimi për këtë shkak dhe është lënë në fuqi të Gjykatës së Apelit me vendimin nr. 761, datë 13.12.2018; 62-2019-739 (204), datë 12.02.2019. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankimi dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. 443, datë 11.07.2019; vendimi nr. 62-2019-2737 (725), datë 20.05.2019, vendimi nr. 1651, datë 02.10.2018, vendimi nr. 1382, datë 25.07.2018, vendimi nr. 541, datë 15.04.2019 – vendimi është ankimuar për këtë shkak dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor duke e konsideruar përsëritës. Vendimi nr. 23 datë, 13.01.2020, vendimi nr. 868, datë 14.05.2018, – edhe ky vendim mbi bazë ankimi të kërkuarit është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit e cila me vendimin nr. 634, datë 11.10.2018 ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor.

<sup>115</sup> vendimi nr. 753, datë 23.05.2019.

<sup>116</sup> vendim nr. 204, datë 12.02.2019.

nga gjyqtari është neni 471/2 i K. Pr. Penale.

Në vendimmarrjen e vitit 2019, gjyqtari ka disponuar me deklaram të papranueshëm për shkak të tërheqjes së kërkesës gjatë zhvillimit të gjykimit, bazuar në nenin 471/5 të K. Pr. Penale.

**4.4. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “mospranimin e kërkesës”, konstatohet se vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendimmarrje të tilla.**

Në 3 rastet e disponimit në këtë mënyrë konstatohet se janë dhënë nga i njëjti gjyqtar në vitin 2018, bazuar në të njëjtën bazë ligjore neni 471/5 i K. Pr. Penale dhe për arsye se kërkuesi është liruar në 1 rast dhe për arsye të tërheqjes nga kërkesa e kërkuesit në dy rastet e tjera. Këto vendime kanë marrë formë të prerë pasi nuk është ushtruar ankim brenda afatit ligjor të parashikuar.

**4.5. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/“pranim i kërkesës për lirim me kusht”, konstatohet se:**

**Gjykatat kanë disponuar me vendim “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/“pranim i kërkesës për lirim me kusht”, pas analizimit si të kriterëve objektive ashtu edhe të kriterëve subjektive, në raport me rrethanat e çështjes sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe në pjesën më të madhe duke bërë pjesë integrale të arsyetimit të vendimit edhe interpretimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.**

Në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përmbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për përfitimin e lirimimit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimit të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përmbushja e këtyre kriterëve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun. Referuar këtij shkak, konstatohet se:

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Në të gjitha rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, konstatohet se 10 raste kanë qënë për shkak të mosplotësimit të arsyeve të veçanta, 1 rast për shkak të të qenit përsëritës dhe 1 rast për shkak të mosplotësimit të  $\frac{3}{4}$  dhe arsyeve të veçanta. Për të gjitha këto raste, për të cilat nga ana e gjykatës është vendosur rrëzimi i kërkesës, qëndrimi i prokurorit ka qënë për rrëzim, përveçse 1 rasti për të cilën nga ana e prokurorit është shprehur për pranim të kërkesës.

Nga këto vendime rrëzimi, në 6 raste rezulton të jetë ushtruar ankim nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për 5 nga këto raste, rrëzimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka qënë për shkak të arsyeve të vecanta, ndërsa për 1 rast ka qënë për mospërmbushjen e kohës së vuajtjes së dënimit dhe arsyeve të veçanta. Lidhur me këto raste ankimi, nga Gjykata e Apelit Vlorë është vendosur

në 2 raste ndryshimi, duke vendosur pranimin e kërkesës; për 2 raste është vendosur lënie në fuqi; për 1 rast për të cilën rrëzimi ishte vendosur për shkak të mospërmbushjes së kohës së vuajtjes së dënimit është vendosur lënie në fuqi; për 1 rast tjetër për shkak të të qenit përsëritës, është vendosur mospranimi i ankimit për shkak lirimi të kërkuarit.

Lidhur me rastet që Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së faktit duke pranuar kërkesën për lirim, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruara në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Në të gjitha rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, konstatohet se 11 raste kanë qenë për shkak të të qenit përsëritës si kusht ndalues i parashikuar në nenin 64 të K. Penal, 1 rast ka qenë për shkak të përsëritjes së kërkesës pa kaluar afati 6 mujor nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi i rrëzimit për kërkesën e të njëjtit të dënuar me të njëjtin objekt sipas parashikimeve të nenit 477/2 të K. Pr. Penale dhe pjesa tjetër për shkak të mosplotësimit të arsyeve të veçanta.

Për të gjitha këto raste, për të cilat nga ana e gjykatës është vendosur rrëzimi i kërkesës, qëndrimi i prokurorit në 18 raste ka qenë për pranim të kërkesës.

Nga këto vendime rrëzimi, në rreth 85 raste rezulton të jetë ushtruar ankimi nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Vlorë. Lidhur me këto raste ankimi, nga Gjykata e Apelit Vlorë është vendosur në 49 raste ndryshimi, duke vendosur pranimin e kërkesës, për 44 raste është vendosur lënia në fuqi dhe për të tjerat është vendosur mospranimi i ankimit.

Lidhur me rastet që Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së faktit duke pranuar kërkesën për lirim, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe, është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruara në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm - kur arsyet e rrëzimit nga gjykata e rrethit gjyqësor kanë qenë për mosplotësimin e arsyeve të veçanta dhe për 1 rast kur nuk është vlerësuar se nuk ndodhemi para kushtit ndalues të të qenit përsëritës sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Në të gjitha rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzim, arsyeja ka qenë kryesisht për shkak të argumentimit prej saj të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuara në nenin 64 të K. Penal.

Në 6 prej vendimeve të rrëzimit të kërkesës, konstatohet se gjykata ka argumentuar faktin e të qenit përsëritës në kryerjen e një krimi me dashje. Në këto raste është proceduar në këtë mënyrë për shkak se nga ana e gjykatës është evidentuar fakti i të qenit përsëritës në kryerjen e një krimi me dashje, kusht ndalues sipas nenit 64/3 të K. Penal. Në 2 raste për shkak të çmuarjes të mosplotësimin të kohës minimale të vuajtjes së dënimit referuar nenit 64/1 i K. Penal. Në 1 rast për shkak të vlerësimit se nuk mund të procedohet me kërkesën për lirim me kusht të kërkuarit i cili është vuajtës i alternativës së dënimit “qëndrim në shtëpi” të parashikuar në nenin 59/a të K. Penal. Dhe rastet e tjera lidhen me vlerësimin nga ana e gjykatës të mosplotësimin të arsyeve të veçanta. Në këto të fundit konstatohet se nga ana e gjykatës është arsyetuar kyesisht lidhur me qëndrimin jo pendues/mohues të kërkuarit ndaj veprës penale të kryer e evidentuar në raportet e shërbimit të provës dhe IEVP, si edhe në gjykimin në fjalë; me rrezikshmërinë e veprës penale për të cilën është dënuar kërkuari, sjelljen e kërkuarit në IEVP referuar masave disiplinore të marra - duke i lidhur këto me krijimin e bindjes se me kohën e vuajtur të dënimit i është arritur qëllimit të dënimit dhe riedukuar dhe mundësinë e riintegrit të tij në shoqëri.

Nga të dhënat e marra evidentohet se nga të gjitha rastet kur nga ana e gjykatës është disponuar me vendim rrëzimi për shkak të mosplotësimin të arsyeve të veçanta, konstatohet se janë bërë objekt kontrolli në Gjykatën e Apelit mbi bazë ankimi nga ana e kërkuarit, dhe për 4 prej tyre është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht. Në 1 rast është vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe në një rast tjetër është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë të kërkuarit/ankuesit bazuar në faktin se vuajtja e dënimit kishte përfunduar.

Lidhur me rastet që Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e rrëzimit të gjykatës së faktit duke pranuar kërkesën për lirim, konstatohet se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruar në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm.

#### **4.5.1. Kriteri subjektiv:**

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat, është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit, e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se jo të gjitha vendimet kanë një standart arsyetimi në drejtim të qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa evidentohet analizë dhe konkludim në drejtim të të dhënave të ofruara nga raportet e IEVP dhe Shërbimit të Provës.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin dhe konkludimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkuar, konstatohet se në rast mosdakortësie nga ana e prokurorit apo kërkuarit është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur

kryesisht në të njëjtat prova të administruar gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

#### **4.5.2. Kriteret objektive**

##### **4.5.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit**

Llogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, referuar interpretimit lidhur me parashikimin e nenit 64/1 të K. Penal, "*jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni*".

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**


Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë evidentohet se ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t'iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi. Nga të gjithë gjyqtarët ndiqet e njëjta praktikë që i referohet masës së dënimit që parashikohet në Kodin Penal, për veprën penale për të cilën është dënuar kërkuesi.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, konstatohet se nuk ndiqet e njëjta praktikë. Kështu nga vendimmarrjet e studiuara, për periudhën e inspektimit evidentohen dy praktika, - praktika e parë që lidhen me përlllogaritjen e kohës minimale të vuajtjes së dënimit duke iu referuar masës së dënimit që parashikohet në Kodin Penal, për veprën penale për të cilën është dënuar kërkuesi dhe praktika tjetër duke iu referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata.

Lidhur me praktikën e parë, në vendimet e pranimit, evidentohet se është ndjekur nga të 7 gjyqtarët që kanë dhënë këto lloj vendimesh. Kjo praktikë rezulton se është ndjekur njëlloj nga 5 gjyqtarë, ndërsa 2 gjyqtarë evidentohet se kanë ndjekur në disa vendime edhe praktikën e dytë. 2 gjyqtarët në fjalë rezultojnë se e kanë ndjekur këtë praktikë kryesisht në vitin 2017 dhe më pas në vitet 2018, 2019, 2020 rezulton se praktika është e konsoliduar në ndjekjen e praktikës së parë. Evidentohet se praktika e dytë është ndjekur në 4 raste nga të gjitha vendimet e pranimit ku është analizuar ky kriter.

Lidhur me praktikën e parë, në vendimet e rrëzimit/deklarim i papranueshëm, evidentohet se është ndjekur nga 6 gjyqtarët që kanë dhënë këto lloj vendimesh. Kjo praktikë rezulton se është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga 5 gjyqtarë të cilët përfshihen në grupin e 5 gjyqtarëve që kanë ndjekur praktikën e parë në vendimet e pranimit të sipërcituara, dhe 2 gjyqtarë kanë



ndjekur në disa vendime edhe praktikën e dytë. Këta dy gjyqtarë të fundit, janë të njëjtët gjyqtarë të cilët kanë ndjekur praktikën e dytë edhe në vendimet e pranimit të sipërpërmendura. 2 gjyqtarët në fjalë rezultojnë ta kenë ndjekur praktikën e dytë në 7 vendime nga të gjitha vendimet e rrëzimit/deklarim i papranueshëm ku është evidentuar ky kriter. Nga këto 2 vendime i përkasin një gjyqtari dhe gjyqtarit tjetër i përkasin 5 vendime. Gjyqtari i fundit me 5 vendime rezulton se ndërkohë në 10 vendime rrëzimi ka ndjekur praktikën e parë, ndërsa gjyqtari tjetër në vendimet e rrëzimit ka ndjekur të njëjtën praktikë dhe nuk ka patur vendime të tjera rrëzimi ku të ketë ndjekur praktikën e parë.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë evidentohet se nuk ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t'iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi. Kështu 2 gjyqtarë nga 7 gjyqtarë i referohen për përcaktimin e kohës minimale të vuajtjes së dënimit, masës së dënimit që i është dhënë nga gjykata kërkuesit për të cilën kërkohet lirimi me kusht, ndërsa disa të tjerë i referohen masës së dënimit që parashikohet në Kodin Penal, për veprën penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Praktika e fundit, është mbajtur edhe Gjykata e Apelit Vlorë, e cila edhe në rastet kur ka shqyrtuar mbi bazë ankimi, vendimet e gjykatës së faktit që kishin ndjekur praktikën e parë, vlerësimin lidhur me këtë kriter formal e kanë bërë referuar masës së dënimit që parashikon vepra penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Në rastet për të cilat është evidentuar praktika e parë e përllogaritjes së kohës minimale të vuajtjes së dënimit sipas nenit 64/1 të K. Penal, konstatohet nga përllogaritjet se gjithsesi për këta të dënuar ishte përmbushur koha e vuajtjes së dënimit referuar masës së dënimit të parashikuar në dispozitën e veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi.

### **Gjykata e Apelit Vlorë**

Lidhur me praktikën sa më sipër, evidentohet se nga Gjykata e Apelit pranohen të dy praktikën. Në këtë gjykatë, ka trupa gjykatash të cilët përdorin arsyetim të qartë lidhur me këtë kriter, duke u ndalur në mënyrë konkrete në interpretimin e dispozitës në fjalë<sup>117</sup> referuar masës së dënimit

---

<sup>117</sup> Përmendim disa, nga rreth 22 vendime të Gjykatës së Apelit që ka proceduar me ndryshimin e vendimit të rrëzimit dhe pranimit të kërkesës për librim me kusht: vendimin e datës nr. 28, datë 23.01.2018, vendimi nr. 930, datë 27.03.2018, vendimi nr. 71, datë 13.02.2018, vendimi nr. 62-2018-4823, datë 20.12.2018, vendimi nr. 441, datë 11.07.2019, vendimi nr. 431, datë 09.07.2019, vendimi nr. 04, datë 14.01.2020, vendimi nr. 283, datë 09.05.2019, vendimi nr. 18, datë 22.01.2019, vendimi nr. 40, datë 30.01.2020, vendimi nr. 417, datë 04.07.2019, vendimi nr. 693, datë 19.12.2019, vendimi nr. 565, datë 16.10.2019; Vendime të Gjykatës së Apelit që kanë shqyrtuar vendimet e pranimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe kanë vendosur rrëzim: Vendimi nr. 20, datë 17.01.2018, vendimi nr. 60-2020-1899, datë 25.11.2020; Vendime të Gjykatës së Apelit që kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor: vendimi nr. 330, datë 28.05.2019, vendimi nr. 249, datë 23.04.2019, vendimi nr. 677, datë 01.11.2018, vendimi nr. 584, datë 26.09.2018, vendimi nr. 486, datë 03.07.2018, vendimi

që parashikon dispozita, ndërsa ka trupa të tjerë të cilët nuk shprehen saktësisht lidhur me këtë interpretim por që pranojnë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor që ka pranuar përlllogaritjen përkatëse referuar kriterit të parashikuar në nenin 64/1 të K.Penal si dhe duke e shoqëruar përlllogaritjen deri në shpalljen e vendimit, si moment kohor i referuar për kriterin në fjalë për të cilën do të flitet më poshtë konkretisht.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankime lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës përsa i përket përcaktimit të periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, në drejtim të kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

#### **4.5.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për efekte të zbatimit të nenit 64/1 të K. Penal, konstatohet se në përgjithësi nga gjyqtarët ndiqet praktika e përlllogaritjes së kohës në mënyrë të përditësuar, duke mos u ndalur tek momenti i paraqitjes së kërkesës, por duke vazhduar deri në momentin e shqyrtimit gjyqësor me paraqitjen e dinamikës së IEVP dhe deri në datën e dhënies së vendimit. Kjo praktikë është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit, e cila edhe vetë nga ana e saj kur ka proceduar me vendime ndryshimi duke pranuar kërkesën për lirimin me kusht, i është referuar në përlllogaritje afatit deri në momentin e vendimmarrjes së saj.


Nga vendimet në fjalë, evidentohet se vetëm një gjyqtar në të gjitha vendimet e tij, i qëndron praktikës së përlllogaritjes së masës së dënimit të vuajtur në zbatim të nenit 64/1 të K. Penal, deri në datën e paraqitjes së kërkesës.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për efekte të zbatimit të nenit 64/1 të K. Penal, konstatohet se në përgjithësi nga gjyqtarët ndiqet praktika e përlllogaritjes të kohës në mënyrë të përditësuar, duke mos u ndalur tek momenti i paraqitjes së kërkesës, por duke vazhduar deri në momentin e shqyrtimit gjyqësor me paraqitjen e dinamikës së IEVP dhe deri në datën e dhënies së vendimit. Kjo praktikë është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit, e cila edhe vetë nga ana e saj kur ka proceduar me vendime ndryshimi duke pranuar kërkesën për lirimin me kusht, i është referuar në përlllogaritje afatit deri në momentin e vendimmarrjes së saj. Gjithashtu referuar këtyre

---

nr. 657, datë 24.10.2018, vendimi nr. 626, datë 10.10.2018, vendimi nr. 773, datë 18.12.2018, vendimi nr. 143, datë 06.03.2019, vendimi nr. 271, datë 23.11.2017, vendimi nr. 60-2020-1458, datë 19.10.2020.





vendimmarrjeve të apelit, nuk konstatohet në ndonjë rast një qëndrim procedural ndaj kësaj praktike përlllogaritje të kohës së vuajtur të dënimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për efekte të zbatimit të nenit 64/1 të K. Penal, konstatohet se në përgjithësi ndiqet përlllogaritja e kohës në mënyrë të përditësuar, duke mos u ndalur tek momenti i paraqitjes së kërkesës, por duke vazhduar deri në momentin e shqyrtimit gjyqësor me paraqitjen e dinamikës së IEVP dhe deri në dhënien e vendimit. Në veçanti dy gjyqtarë kanë ndjekur praktikën e referimit tek data e kërkesës. Nuk janë evidentuar të ketë patur ankim lidhur me këto dy mënyra përlllogaritje që të jetë bërë objekt i shqyrtimit në gjykatë apeli.

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe në Gjykatën e Apelit, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankime lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës përsa i përket kufijve të përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

### **Gjykata e Apelit Vlorë**

Gjykata e Apelit, e cila edhe vetë nga ana e saj kur ka proceduar me vendime ndryshimi duke pranuar kërkesën për lirimin me kusht, i është referuar në përlllogaritje afatit deri në momentin e vendimmarrjes<sup>118</sup>. i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në rastet të cilat ka shqyrtuar vendimet

---

<sup>118</sup> vendimin nr. 20, datë 17.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë në të cilën kjo gjykatë shprehet: “Duke patur parasysh masën e dënimit të dhënë prej 5 vjet burgim, kohën e kryerjes së veprës penale, datën e arrestimit të të denuarit 12.01.2014, datën e vendimit të formës së prerë 23.12.2014 si dhe dinamikën e vuajtjes së dënimit, rezulton se, kërkuesi {xxx} në momentin e paraqitjes së kërkesës kishte vuajtur 3 vjet e 1 muaj e 18 ditë. Nga koha e paraburgimit ai ka përfituar 5 muaj e 21 ditë, ndërsa nga aktivizimi me punë atij i janë ulur 18 ditë burgim, pra nga dënimi i dhënë prej 5 vjet burgim, ai ka kryer deri në datën e paraqitjes së kërkesës gjithsej 43 muaj e 9 ditë, pra nuk e ka plotësuar  $\frac{3}{4}$  e dënimit, e cila është 45 muaj burgim, ndërsa në datën e dhënies së vendimit prej gjykatës ky afat është plotësuar. Por pavarësisht përmbushjes së këtij kriteri në datën e dhënies së vendimit të ankimuar, në rastin në shqyrtim mungojnë rrethanat e veçanta...”;

vendimin nr. 60-2020-1458, datë 19.10.2020, ku arsyetohet se:

“Sipas raportit të IEVP për dinamikën e vuajtjes së dënimit të të pandehurit del se ai ka vuajtur fizikisht 2 vjet e 7 muaj, nga koha e paraburgimit ka fituar 11 muaj e 14 ditë.

Pra gjithsej atij i kanë mbetur pa vuajtur nga periudha totale e dënimit në datën 27.09.2019, periudha prej 1 vit e 1 muaj e 16 ditë e cila është zvogëluar më tej deri në datën 22.11.2019 kur ka dhënë vendimin gjykata e shkallës së parë.

Duke iu referuar masës totale të dënimit prej 4 vjet e 8 muaj, periudhën e vuajtur të dënimit, del se i dënuari ka vuajtur  $\frac{3}{4}$  e dënimit të caktuar. Si rrjedhim ai plotëson kriterin formal të nenit 64 të K. Penal për periudhën e vuajtjes së dënimit”.

Vendimin nr. 60-2019-488, datë 26.02.2019, ku arsyetohet se: “1. Të ketë vuajtur jo më pak se  $\frac{3}{4}$  e dënimit për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji. Nga dita e shpalljes së vendimit datë 12.10.2018 i mbeten për të vuajtur edhe 4 vite e 11 muaj e 27 ditë burgim. Përsa më siper, rezulton se kërkuesi xxx deri ditën e shpalljes së vendimit ka vuajtur më shumë se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të dhënë, duke plotësuar kështu një nga kërkësat e parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal”;

e pranimit të gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjithashtu referuar këtyre vendimmarrjeve të apelit, nuk konstatohet në ndonjë rast një qëndrim procedural ndaj kësaj praktike përlllogaritje të kohës së vuajtur të dënimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në Gjykatën e Apelit, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankime lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës përsa u përket kufijve të përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt “lirim me kusht” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, konstatohet se referuar për aq sa mund të evidentohet në vendimet gjyqësore qëndrimi i prokurorit i mbështetur në argumente, tre prej tyre kanë mbajtur qëndrim të njëjtë në drejtim të faktit se për përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit do të jetë koha e paraqitjes së kërkesës. Dhe kur ka qenë rasti, këta prokurorë kanë ushtruar edhe ankim, por që gjithsesi nuk është konstatuar ndonjë vendimmarrje ndryshe e Gjykatës së Apelit e shprehur si më sipër dhe gjithashtu as qëndrim ndryshe e prokurorit të apelit e reflektuar në qëndrimin në seancë dhe në drejtim të rekursit.

Referuar këtyre rasteve të fundit të qëndrimin të disa prej prokurorëve që e lidhin përlllogaritjen e kohës së vuajtur të dënimit me kohën e paraqitjes së kërkesës, konstatohet se gjyqtarët në vendimet e tyre ku nuk e kanë pranuar këtë qëndrim të prokurorit dhe aty ku ka arsyetim, kanë argumentuar duke e lidhur tejkalimin e këtij afati me momentin e administrimit të provave, mbi të cilat vlerësohen kriteret ligjore ndër të cilat edhe afati i dënimit të vuajtur. Më konkretisht një gjyqtar<sup>119</sup> shprehet se: *“Përsa i përket kohës së vuajtur të dënimit gjykata por edhe prokurorja e konstatojnë vetëm në momentin e paraqitjes së dinamikës së vuajtjes së dënimit nga IEVP-ja dhe në datën që kjo dinamikë është paraqitur, kërkuesi i kishte plotësuar ¾ e dënimit”*; dhe në një tjetër se: *“Në lidhje me pretendimin e organit të prokurorisë se kërkuesi nuk kishte plotësuar ¾ e dënimit të dhënë në ditën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe për rrjedhojë kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar në ligj. Gjykata çmon se vlerësimi i plotësimin të kriterëve të parashikuara nga neni 64 i K. Penal, mund të bëhet vetëm pasi gjykata ka administruar provat e paraqitura nga palët. Në rastin konkret, kërkuesi në momentin e administrimit të provave, ka plotësuar kriteret ligjore për sa i përket afatit të dënimit të vuajtur dhe për rrjedhojë kërkesa e tij nuk mund të deklarohet e papranueshme”*<sup>120</sup>.

#### **4.5.2.3. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

<sup>119</sup> vendimi nr. 444, datë 09.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Ndaj vendimit në fjalë është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi, duke e konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor.

<sup>120</sup> vendimi nr. 1356, datë 23.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Ndaj vendimit në fjalë, është ushtruar ankim, por Gjykata e Apelit ka vendosur mospranim për shkak të heqjes dorë nga ana e prokurorit.

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier dhe Berat, nga të gjithë gjyqtarët është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP. Qëndrimi lidhur me kohën e paraburgimit dhe për shkak të kohës së punës së kryer nuk është kontestuar as nga prokurorët e seancës në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe as në Gjykatën e Apelit. Edhe kjo e fundit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Ndërsa rezulton një rast<sup>121</sup> kur nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimin për mospërfshirjen e periudhës së uljes së dënimit të përfituar me vendim gjyqësor dhe lidhur me këtë ka ushtruar edhe ankim. Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar këtë ankim, duke arsyetuar si të pabazuar referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, nuk janë evidentuar raste të përlllogaritjes në masën e dënimit të vuajtur, koha e përfituar me amnisti ose falje.

#### 4.5.2.4. Kushtet ndaluese:

Nga vendimet e administruara të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier, Berat, referuar kryesisht vendimeve të pranimit është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me ***kushtet ndaluese “përsëritës” dhe për shkak të veprës penale të parashikuar*** në nenit 64 të K. Penal.

Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuesit të administruara nga *vërtetimi i gjendjes gjyqësore*, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP, raporti i vlerësimit të Shërbimit të Provës dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimit.

Për kriterin në fjalë, është evidentuar në 2 raste vendim pranimi, 1 rast vendim rrëzimi dhe 3 raste vendim deklarim i papranueshëm, të gjitha të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që të jenë bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit.

Rasti i 1<sup>122</sup>, i dënuari rezulton të ishte dënuar më parë edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i K. Penal. Sipas prokurorit në seancë, në rastin konkret ndodheshim përpara kushtit ndalues të përsëritës për shkak se bëhej fjalë për krim me dashje, ndërsa nga ana e gjykatës arsyetohej se: *“Nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton se kërkuesi është dënuar më parë për një kundravajtje dhe për një krim të kryer nga pakujdesia. Në këto rrethana nuk*

---

<sup>121</sup> vendimi nr. 62-2019- 481, datë 30.01.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata e Apelit me vendimin nr. 364, datë 13.06.2019, vendosi lënien në fuqi të vendimit, ku ndër të tjera është arsyetuar se: *“Gjykata e Apelit konstaton se pretendimi i prokurorisë se në kohën e vuajtjes së dënimit nuk duhet të llogaritet koha e përfituar me ulje dënimi sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, është i pabazuar në nenin 64 të Kodit Penal të interpretuar si më lart nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues të cituar më lart”.*

<sup>122</sup> vendimi nr. 1793, datë 19.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

rezulton pengesa e parashikuar në pikën 3 të nenit 64 të K. Penal”. Mbi bazën e ankimit të prokurorit çështja është shqyrtuar edhe në Gjykatën e Apelit. Prokurori i apelit ka përkrahur ankimin e prokurorit të seancës. Gjykata e Apelit<sup>123</sup> në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me të njëjtin arsyetim “Nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. 17 prot. datë 29.8.2018, rezulton se kërkuesi, ka qenë i dënuar më parë me vendimin nr. 1380 prot., datë 30.5.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1190 prot., datë 17.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është dënuar me 8 muaj burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 273 dhe 290/2 të Kodit Penal. Nga ky akt rezulton se kërkuesi është dënuar më parë për një kundërvajtje dhe për një krim të kryer nga pakujdesia dhe në këto rrethana nuk rezulton pengesa e parashikuar në pikën 3 të nenit 64 të Kodit Penal”. Nuk ka të dhëna për ushtrim rekursi.

Rasti i dytë<sup>124</sup>: i dënuari rezultonte të ishte i dënuar më parë për disa vepra penale që sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore vendimet e dënimit datonin në vitet; 1974 për përvetësim pasurie i dënuar me 10 muaj burgim, 1977 për vepër penale në fushën ushtarake i dënuar me 18 muaj burgim dhe 2002 për vjedhje i dënuar me 5 muaj burgim. Sipas prokurorit në seancë, ndër të tjera për shkak të dënimeve sa më sipër, kërkuesi nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 64 të K. Penal, ndërsa nga ana e gjykatës nuk është pranuar një pretendim i tillë duke u arsyetuar se:

“Siç u evidentua edhe me lart kërkuesi është i rehabilituar për tre dënimet e para të evidentuara në vërtetimin e gjendjes gjyqësore nr. 16 prot., datë 10.05.2018”. Ndaj këtij vendimi, prokurori ka bërë ankim edhe lidhur me këtë kriter, dhe nga ana e Gjykatës së Apelit është arsyetuar se është i rehabilituar dhe nuk është përsëritës, “I dënuari të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 16 prot., datë 10.05.2018, rezulton se kërkuesi është tashmë i rehabilituar për 3 dënimet e para të pretenduara nga prokurori në ankim që përbëjnë shkak për rrëzimin e kërkesës”. Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes, i cili ka ngritur ndër të tjera edhe pretendimin lidhur me faktin se kërkuesi ka kryer edhe vepra të tjera penale. Gjykata e Apelit<sup>125</sup> nuk e ka pranuar këtë pretendim me të njëjtin arsyetim si edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Ndaj vendimit të apelit rezulton të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka ende një vendim.

Lidhur me vendimin e rrëzimit, bëhet fjalë për 1 vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier<sup>126</sup>, ku kjo e fundit ka arsyetuar për rrëzimin vetëm mbi bazën e këtij kriteri. Në vendimin e saj gjykata arsyetonte mbi ekzistencën e dy vendimeve gjyqësore të cilat më pas ishin bashkuar dhe gjatë kohës që kishte filluar ekzekutimin duke vuajtur këtë dënim mbi bazën e këtij vendimi bashkimi, kërkuesi ka paraqitur kërkesën për “lirim me kusht”. Ky qëndrim ka qenë edhe i prokurorit gjatë seancës gjyqësore. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, çështja është shqyrtuar

<sup>123</sup> vendimi nr. 281, datë 09.05.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>124</sup> vendimi nr. 1720, datë 12.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>125</sup> vendimin nr. 116, datë 21.02.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>126</sup> vendimi nr. 1038, datë 04.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

nga Gjykata e Apelit<sup>127</sup>, e cila ka arsyetuar se kërkuesi është dënuar paralelisht për të dy veprat penale dhe se ekzekutimi i tyre është bërë pas bashkimit të dënimeve në një dënim të vetëm dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet përsëritës. Më konkretisht gjykata është shprehur se: “... nga dinamika e vuajtjes së dënimit nuk rezulton që ai të jetë dënuar për një vepër penale, ta ketë vuajtur dhe më pas të ketë kryer një vepër tjetër të atij lloji apo të njëjtën vepër. Për më tepër që nga vendimi nr. 1015, datë 02.11.2016 ka rezultuar se kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar për faktin se gjatë ekstradimit të tij nga shtetasi italian për llogari të vendimit nr. 92, të datës 08.04.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë i është gjetur një pasaportë që ka rezultuar e falsifikuar. Pavarësisht faktit se ky shtetas është dënuar për kryerjen e disa veprave penale, kërkuesi në kuptim të ligjit nuk mund të konsiderohet përsëritës, pasi nuk rezulton ta ketë kryer veprën penale pas shlyerjes së dënimit, por se kjo vepër është kryer menjëherë pas saj, sipas organit të akuzës për t’iu fshehur drejtësisë dhe se konstatimi i saj më vonë nga ana e autoriteteve të drejtësisë në shtetin italian, nuk e klasifikon atë si përsëritës, në kuptim të dispozitës të parashikuar nga neni 64/3 i K. Penal. Kjo pasi duke iu referuar interpretimit sistematik të dispozitës dhe terminologjisë së përdorur nga legjislatori, do të konsiderohet përsëritës ai person, i cili do të kryejë një vepër penale të kryer me dashje, pasi të jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për veprën e parë dhe të ketë filluar ekzekutimin e dënimit. Në këtë rast i rëndësishëm për klasifikimin si përsëritës, është momenti i kryerjes së veprës penale dhe jo ai i konstatimit nga ana e autoriteteve të drejtësisë, që në këtë linjë arsyetimi i referohet kohës së vuajtjes së dënimit, ashtu sikundër një gjë e tillë parashikohet edhe në dispozitën materiale të parashikuar nga neni 64/4 i K. Penal, ku saktësohet se lirimi me kusht pezullohet kur personi, gjatë kohës së kushtit, kryen një tjetër vepër penale. Ndërkohë, rezulton se penalizohet, duke mos i dhënë të drejtën e përfitimit të lirimit me kusht ose duke ia revokuar atë, i dënuari i cili kryen një tjetër vepër penale gjatë vuajtjes së dënimit ose gjatë periudhës së kushtit, pasi është pikërisht sjellja e të dënuarit, kriteri bazë, mbi të cilin do të duhet të vlerësohet aplikimi ose jo i kësaj alternative dënimi”. Nuk ka të dhëna që të jetë ushtruar rekurs.

Lidhur me rastin e parë të deklarimit të papranueshëm<sup>128</sup>, konstatohet se kërkuesi gjatë kohës së vuajtjes së dënimit për të cilën kërkonte lirim me kusht, kishte kryer një krim tjetër me dashje, dhe pikërisht në periudhën kur kishte qenë me leje shpërblyese kishte kryer veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal. Gjykata e rrethit gjyqësor pas konstatimit të këtij fakti, e ka konsideruar kërkesën haptazi si të pabazuar për shkak të dënimit për krim tjetër me dashje të kërkuesit. Ankuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit<sup>129</sup>, e cila në përfundim ka vlerësuar si të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, duke arsyetuar se: Gjykata e Apelit konstaton se në gjykimin në shkallë të parë ndryshe nga sa pretendon ankuesi është shqyrtuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, në të cilin është parashikuar “Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me

<sup>127</sup> vendimi nr. 99, datë 19.02.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>128</sup> vendimi nr. 62-2019-739 (204), datë 12.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>129</sup> vendimin nr. 443, datë 11.07.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet”. Sipas nenit 1 të Kodit Penal nëse një vepër penale përbën krim apo kundravajtje përcaktohet në përmbajtjen e dispozitës penale. Nga përmbajtja e nenit 291 të K. Penal rezulton që ligji nuk ka parashikuar të jetë kundravajtje, për pasojë përbën krim. Nga ana subjektive kjo vepër penale konsumohet vetëm me dashje. Për pasojë bazuar në nenin 64 të K. Penal i dënuari i cili është dënuar për një krim tjetër me dashje, nuk përfiton nga zbatimi i nenit 64 të K. Penal dhe kërkesa e tij është e papranueshme. Gjykata e Apelit çmon se në kushtet e një pengese të tillë, nuk ka qenë e nevojshme marrja e provave në lidhje me personalitetin e të dënuarit, pasi ligji ka ndaluar shprehimisht lirin me kusht të subjekteve përsëritëse për krime me dashje, dhe i dënuari është në këto kushte”.

Lidhur me rastin e dytë të deklaramit të papranueshëm<sup>130</sup> konstatohet se kërkuesi është dënuar në vitin 2010 fillimisht për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, me 7 vjet e 4 muaj burgim. Gjatë gjykimit të kësaj kërkesë, kërkuesi ka qenë në mungesë. Më pas rezulton sërish të jetë dënuar me vendimin e vitit 2015 për krimin e vjedhjes më shumë se një herë me 1 vit e 8 muaj burgim. Vendimet në fjalë janë bashkuar me vendim gjyqësor të vitit 2017 dhe pastaj nga ana e kërkuesit është paraqitur kërkesë për lirim me kusht për dënimin e bashkuar që po vuante. Gjykata e rrethit gjyqësor e ka deklaruar të papranueshme kërkesën, duke arsyetuar se: “Në rastin konkret, kërkuesi është dënuar dy herë me vendime gjyqësore të formës së prerë për krime të kryera me dashje dhe për rrjedhojë ky i dënuar nuk mund të përfitojë lirim me kusht. Në lidhje me sa më sipër, gjykata, bazuar në nenin 471, pika 2 të K. Pr. Penale, sipas të cilit: “Kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin, e deklaron atë të papranueshme me vendim, i cili i njoftohet brenda pesë ditëve të interesuarit”, vlerëson se kërkesa e të dënuarit është haptazi e pabazuar, pasi në rastin konkret ekziston një nga kriteret ndaluese të parashikuara shprehimisht në ligj. Në këto kushte, gjykata vlerëson se kërkesa e të dënuarit, duhet të deklarohet e papranueshme”. Referuar vendimit në fjalë, gjykata ka konkluduar pas administrimit nga I EVP të vendimeve gjyqësore në bazë të të cilave kërkuesi po vuan dënimin. Vendimi në fjalë, i gjykatës së rrethit gjyqësor që ka vendosur deklaramin e papranueshëm të kërkesës, është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit<sup>131</sup> e cila e ka shqyrtuar çështjen në fjalë bazuar në ankimin e kërkuesit, duke argumentuar se: “Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, gjykata vlerëson se në paragrafin e tretë të kësaj dispozite parashikohet në mënyrë të shprehur kriteri ndalues për aplikimin e lirit me kusht në rastet kur kërkuesi është përsëritës për krime të kryera me dashje. Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se kërkuesi është dënuar dy herë me vendime gjyqësore të formës së prerë për krime të kryera me dashje dhe për rrjedhojë ky i dënuar nuk mund të përfitojë lirim me kusht, duke qenë se jemi përpara një kriteri ndalues për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal. Sa më sipër, Gjykata e Apelit Vlorë, çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur deklaramin të papranueshme të kërkesës është i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj”.

<sup>130</sup> vendimi nr. 541, datë 15.04.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>131</sup> vendimi nr. 60-2019-2297, datë 17.09.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Lidhur me rastin e tretë të deklarimit të papranueshëm<sup>132</sup> konstatohet se kërkuesi ka paraqitur kërkesën për lirim me kusht nga vuajtja e dënimit të mbetur për të cilën është dënuar në vitin 2016. Kërkuesi rezultonte se përpara këtij dënimi, kërkuesi ishte dënuar në vitin 2015 edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K. Penal me 2 muaj burgim. Gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur deklarimin e papranueshëm për shkak të kriterit ndalues “përsëritës” dhe ky qëndrim është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, edhe nga Gjykata e Apelit<sup>133</sup> e cila ka arsyetuar se: *“Nisur nga sa më sipër, rezulton se ligjvënësi ka parashikuar ndalim ligjor në shqyrtimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë, pasi ka shqyrtuar aktet e administruara në dosjen gjyqësore, ka vlerësuar se kërkesa e të dënuarit nuk gjen mbështetje në nenin 64 të Kodit Penal, pasi ai rezultoi i dënuar më parë (përsëritës) me një vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, me të drejtë gjykata e shkallës së parë pasi i është referuar nenit 471/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka disponuar për deklarimin e papranueshme të kërkesës së të dënuarit”.*

Gjithashtu lidhur me kushtin ndalues për shkak të veprës penale, vlerësohet të parashtrohet një rast kur është ngritur si diskutim interpretimi lidhur me këtë kriter ndalues.

Rasti i përket një kërkuesi i cili ishte dënuar me vendim të vitit 2005 nga gjykata e shkallës së parë dhe ndryshuar në vitin 2007 nga gjykata e apelit, për krim të kryer në datën 06.11.2004, të vrasjes me paramendim për gjakmarrje dhe armëmbajtje pa leje, e parashikuar nga nenet 78/2 dhe 278/2 sipas ligjit të kohës. Përveç dënimeve sa më sipër, kërkuesi rezultonte të ishte dënuar edhe më parë sipas vendimit të vitit 2022 të gjykatës së shkallës së parë për krimin e armëmbajtjes pa leje dhe pas shlyerjes së plotë të këtij vendimi ka kryer krimin e vrasjes në vitin 2004 për të cilin ka paraqitur kërkesën për lirim me kusht. Për kërkesën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier<sup>134</sup> ka vendosur rrëzim me argumentin ndër të tjera të ekzistencës së kriterit ndalues të të qënurit i dënuar më parë për një krim të kryer me dashje. Gjykata e Apelit<sup>135</sup> që ka shqyrtuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor në fjalë, mbi bazë ankimi të ankuesit ka argumentuar mbi bazueshmërinë e vendimit të rrëzimit, duke argumentuar ndër të tjera lidhur me kushtin ndalues lidhur me veprën penale të kryer *“kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të vrasjes me paramendim për motive gjakmarrje sipas dispozitës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimit, datë 06.11.2004. Me ndryshimet që ka pësuar Kodi Penal me ligjin nr. 144/2013, krimi i vrasjes me paramendim për motive gjakmarrje, nga parashikimi në paragrafin e dytë të nenit 78 të Kodit Penal, është parashikuar si dispozitë më vete në nenin 78/a të këtij Kodi. Në të tilla rrethana, pa hyrë në analizën e shkaqeve apo arsyeve të veçanta të pretenduara nga kërkuesi/i dënuari, rezulton se egziton një rrethanë ndaluese për pranimin e kësaj kërkesë, nisur nga natyra e veprës penale të kryer nga kërkuesi/i dënuari”,* si dhe lidhur me kushtin ndalues të të qënurit përsëritës duke u shprehur se: *“Po kështu, rezulton e provuar se kërkuesi/i dënuari sipas dëshmisë së penalitetit, rezultoi edhe më parë i dënuar përpara dhënies së këtij dënimi penal. Konkretisht, me vendimin nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ 2002 të*

<sup>132</sup> vendimi nr. 868, datë 14.05.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>133</sup> vendimi nr. 60-2018-3167, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>134</sup> vendimi nr. 1101, datë 13.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>135</sup> vendimi nr. 60-2018-3938, datë 13.12.2018.

Gjykatës së shkallës së parë kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe rezulton se krimin e vrasjes me paramendim për motive gjakmarrje e ka kryer në datën 06.11.2004 pas shlyerjes së këtij dënimi. Pra, rezulton e provuar se kërkuesi/i dënuari ka qenë më parë i dënuar për një krim të kryer me dashje, çka përbën një kriter tjetër ndalues për të kërkuar lirin para kohe me kusht. Për më tepër, pas atij dënimi, kërkuesi rezulton të ketë kryer të njëjtin krim, atë të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në funksion të kryerjes së një krimi akoma më të rëndë...”.

#### 4.5.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”

**Koha e kushtit/provës:**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, gjithsej 8 të dhëna nga 4 gjyqtarë, lidhur me kohën e kushtit të përcaktuar me rastin e lirit me kusht të të dënuarit, konstatohet se:

- 2 gjyqtarë përcaktojnë në dispozitiv se koha e provës është e barabartë me kohën e pavuajtur të dënimit, dhe për këtë i referohen vendimit të Kolegjeve të Bashkuara që gjën pasqyrim në pjesën arsyetuese. Tek njëri gjyqtar i cili rezulton në 2 vendime konstatohet edhe arsyetim lidhur me këtë kohë prove në pjesën e vendimit, ndërsa tek gjyqtari tjetër i cili rezulton në 3 vendime, përmendet pjesa e kohës së provës sipas arsyetimit të vendimit të kolegjeve, por nuk ka analizë dhe konkludim lidhur me këtë kohë prove.
- 2 gjyqtarët e tjerë nuk përcaktojnë në dispozitiv kohën e provës, pavarësisht se urdhërojnë që i dënuari që gjatë kohës së kushtit të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale me dashje. Kjo evidentohet për 1 gjyqtar në dy vendime dhe për 1 tjetër në 1 vendim, që kanë qenë edhe rastet kur këta gjyqtarë kanë proceduar me pranim kërkesë “lirim me kusht”.

Për këto raste, për aq sa mund të evidentohet nga praktikat e ekzekutimit<sup>136</sup> është evidentuar vetëm në 1 rast<sup>137</sup> që të jetë bërë objekt diskutimi nga zyra e shërbimit të provës, lidhur me përcaktimin e kohës së provës. Në vendimin në fjalë që ishte dërguar për ekzekutim nga prokurori, nuk ishte përcaktuar koha e kushtit jo vetëm në dispozitiv, por edhe në pjesën arsyetuese të vendimit dhe për këtë shërbimi i provës i është drejtuar me një shkresë zyrës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo e fundit me anë të një shkrese përcjellëse të nënshkruar nga drejtuesi i kësaj zyre i ka kthyer përgjigje zyrës së shërbimit të provës, duke përcaktuar vetë nga ana e saj se koha e provës do të jetë e barabartë me pjesën e pavuajtur të dënimit.

Në vendimet e pranimit sa më sipër, vetëm nga ana e 1 gjyqtari i cili nuk është asnjë nga dy gjyqtarët të cilët nuk përcaktojnë kohën e kushtit, vendoset konkretisht në dispozitiv, koha e

<sup>136</sup> Praktikrat nuk kanë qenë të inventarizuara për të evidentuar plotësinë e tyre.

<sup>137</sup> Vendimi nr. 449, datë 14.05.2019.



mbetur e pavuajtur të dënimit.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, gjithsej 180 të dhëna nga 8 gjyqtarë, lidhur me kohën e kushtit të përcaktuar me rastin e lirimit me kusht të të dënuarit, konstatohet se:

- 6 gjyqtarë përcaktojnë në dispozitiv si kohë prove një periudhë të barabartë me kohën e përllogaritur si kohë e pavuajtur e dënimit, por jo të gjithë nga ky grup gjyqtarësh arsyetojnë dhe konkludojnë për këtë në pjesën arsyetuese të vendimit.

Gjyqtarët të cilët arsyetojnë dhe konkludojnë evidentohen të jenë 3. Këta gjyqtarë konstatohet se i referohen asaj që është vendosur në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015.

Gjyqtarët të cilët përcaktojnë në pjesën arsyetuese lidhur me kohën e provës, por nuk analizojnë përse do të jetë kjo periudhë, megjithëse konstatohet që për analizën e arsyeve të veçanta referojnë tek vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, evidentohen të jenë 2.

- një gjyqtar nuk arsyeton dhe përcakton në pjesën arsyetuese lidhur me kohën e provës, dhe as ka referim në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë.
- një gjyqtar tjetër evidentohet se në 40 vendimet e tij të pranimit të evidentuara në periudhën objekt inspektimi, ka ndjekur praktika të ndryshme në përcaktimin e kohës së provës. Kështu janë evidentuar raste të përcaktimit të kohës së provës, sa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit; raste të përcaktimit të kohës së provës më shumë sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit; dhe raste të përcaktimit të kohës së provës më pak se pjesa e pavuajtur e dënimit.
- Një gjyqtar për periudhën e inspektimit rezulton se ka ndjekur praktikë të ndryshme lidhur me kohën e provës. Konstatohet praktika e përcaktimit të kohës së provës prej 2 vjetësh, më shumë se 2 vjet dhe praktika tjetër sa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Tek ky gjyqtar konstatohet se secila nga praktikat janë ndjekur në të njëjtën periudhë kohe, dhe dy praktikat e para janë evidentuar në periudhë kohe më parë sesa praktika e tretë e cila ka filluar në 2018 dhe nuk ka patur ndryshime përgjatë periudhës objekt inspektimi.

Për dy praktikat e parë evidentohet se nga ana e gjyqtarit nuk ka një arsyetim se përse përcaktohet kjo kohë, ndërsa në ndjekjen e praktikës së tretë gjyqtarja referon tek vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë.

Evidentohet se jo në të gjitha vendimet, në dispozitiv gjyqtarët shprehen konkretisht se cila është koha e mbetur e vuajtur e dënimit. Kështu 5 gjyqtarë shprehen konkretisht lidhur me kohën e mbetur të vuajtjes së dënimit, 1 gjyqtar në disa vendime shprehet për pjesën e mbetur dhe në disa të tjerë jo, dhe 1 gjyqtar tjetër nuk shprehet konkretisht për pjesën e pavuajtur të dënimit në

dispozitiv.

### Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, lidhur me kohën e provës së përcaktuar me rastin e lirimit me kusht të të dënuarit, konstatohet se nuk ndiqet e njëjta praktikë për përcaktimin e kësaj periudhe. Kështu disa gjyqtarë kanë si praktikë përcaktimin e kohës së provës të njëjtë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit penal, ndërsa praktika tjetër që ndiqet nga gjyqtarët e tjerë lidhet me përcaktimin e kohës së provës duke iu referuar një periudhe më madhe të kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit penal.

Më konkretisht referuar vendimeve gjyqësore nga 8 gjyqtarë të cilët janë shprehur me vendime pranimi, 5 prej tyre kanë ndjekur të njëjtën praktikë për përcaktimin e kohës së provës sa koha e mbetur e vuajtjes së dënimit. Tek këta gjyqtarët që përdorin si praktikë përcaktimin e kohës së provës të njëjtë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit penal, konstatohet se arsyetojnë në pjesën më të madhe referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015.

1 gjyqtar nga 8 raste vendime pranimi në të cilat ishte ndjekur prej tij praktika në fjalë, vetëm në 1 rast<sup>138</sup> evidentohet se ka ndjekur praktikën e përcaktimit të kohës së provës më të madhe sesa e koha e mbetur e vuajtur të dënimit, duke e arsyetuar në vendim lidhur me nenin 59 të K. Penal dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë. Më konkretisht në këtë të fundit, gjyqtari ka arsyetuar: *“Në lidhje me kohën e vënies në provë, gjykata në zbatim të Vendimit Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe me ndryshimet e bëra në nenin 59 të K. Penal, vlerëson që koha që i dënuari do të jetë në provë dhe do mbaj lidhje me shërbimin e provës të jetë e barabartë me dyfishin e dënimit të pakryer, pra me 10 (dhjetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë x 2 = 21 muaj. Në lidhje me këtë Gjykata e Lartë në vendimin e mësipërm ka theksuar: “Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht”. Në zbatim të këtij konkluzioni por dhe në analogji me nenin 59 të K. Penal pas ndryshimeve të fundit, gjykata duhet të urdhërojë që pas lirimit me qëllim rehabilitimin e plotë të të dënuarit ai të mbajë lidhje me shërbimin e provës për një periudhe kohore sa dyfishi i dënimit të mbetur pa vuajtur.”* Ndaj këtij vendimi nuk ka patur ankim, duke marrë formë të prerë brenda afateve ligjore. Ndërsa në rastet e tjera gjyqtari ka përcaktuar si kohë kushti periudhën e mbetur të vuajtjes së dënimit.

Tek gjyqtarët që përdorin si praktikë përcaktimin e kohës së provës më të madhe sesa kjo kohë,

<sup>138</sup> vendimi nr. 203, datë 25.07.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

nuk ka në të gjitha vendimet arsyetim lidhur me përcaktimin e kësaj periudhe kohe. Konstatohet se janë 2 gjyqtarë nga 8 gjyqtarë që kanë gjykuar çështje me objekt “Lirim me kusht”, që ndjekin praktikën në fjalë dhe në vendimmarrjet e tyre që i përkasin periudhës 2018, 2019, nuk konstatohet që të ketë arsyetim se kujt i referohen për përcaktimin e kohës së provës. Gjithashtu konstatohet se disa nga këto vendime janë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit mbi bazë ankimi prokurori, por nga Gjykata e Apelit nuk evidentohet të ketë një qëndrim/konstatim lidhur me periudhën e kohës së provës. Nuk evidentohet që të ketë patur ankim nga kërkuesi në rastet kur pranohet kërkesa për lirim me kusht, me kohë prove të përcaktuara më të madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit.

Nga gjyqtarët e kësaj gjykate evidentohet në përgjithësi tek vendimet e pranimit, përcaktimi në dispozitiv i kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit.

### **Gjykata e Apelit Vlorë**

Referuar vendimmarrjeve ku shprehen praktikat sa më sipër, konstatohet se kriteri i kohës së provës, është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, vetëm lidhur 1 rast i vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier<sup>139</sup> ku kishte përcaktuar kohën e provës me 2 vjet. Ka qenë kërkuesi ai i cili ka ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit<sup>140</sup> e ka marrë në shqyrtim, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor me arsyetimin se: “Gjykata e Apelit referuar nenit 64 të K. Penal “Lirimi me kusht” dhe nenit 59 të K. Penal “Pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë e të pandehurit” vlerëson se afati i provës në rastin objekt shqyrtimi duhet të jetë sa dyfishi i dënimit të mbetur pa u vuajtur nga i dënuari. Nisur nga fakti se të dënuarit i ka mbetur për të vuajtur rreth 12 muaj burgim, koha e provës është 24 muaj. Pretendimi i kërkuesit, të dënuarit Leone Duka se sipas vendimit unifikues koha e provës të jetë sa koha e mbetur e dënimit nuk qëndron për faktin se ky vendim parashikon kur ligji nuk shprehet për periudhën e provës. Neni 59 i K. Penal tashmë ka parashikuar që për dënime nën 2 vjet koha e provës është sa dyfishi i dënimit të mbetur”;

Dhe në vendimet me anë të të cilave është vendosur ndryshimi i vendimit të rrëzimit dhe pranimi i kërkesës për lirim me kusht, konstatohet se koha e provës së përcaktuar është ajo e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Gjithashtu jo në të gjitha vendimet, evidentohet që në dispozitiv gjyqtarët shprehen për përcaktimin e kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit.

### **Qëndrimi i prokurorit:**

Lidhur me praktikat sa më sipër, përse i përket përcaktimit të kohës së provës, nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit nga leximi i vendimeve gjyqësore. Por referuar qëndrimit pas dhënies së vendimit, konstatohet se nuk ka patur asnjë ankim nga prokurori lidhur me këtë

<sup>139</sup> vendimi nr. 500, datë 29.03.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>140</sup> vendimi nr. 253, datë 16.11.2017, i Gjykatës së Apelit Vlorë.



kriter dhe si i tillë të ishte bërë objekt diskutimi në Gjykatën e Apelit. Përveç rastit sa më sipër, ku ankues ka qenë kërkuesi.

#### **4.5.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës**

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, konstatohet se jo nga të gjithë gjyqtarët ndiqet e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuar në nenin 60 të K. Penal. Nga 4 gjyqtarë të cilët kanë shqyrtuar kërkesat për lirim me kusht, për periudhën e inspektimit, konstatohet se dy prej tyre, ndjekin të njëjtën praktikë në të gjitha vendimet e tyre, duke parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal. Ndërsa 2 të tjerët në të gjitha vendimet e tyre të pranimit të kërkesës për lirim me kusht, nuk shprehen për detyrime sipas nenit 60 të K. Penal. Vendimet e këtyre dy të fundit i përkasin periudhës pas ndryshimeve ligjore të Kodit Penal me nr. 36/2017.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, konstatohet se nuk është ndjekur e njëjta praktikë nga gjyqtarët lidhur me përcaktimin e detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të K. Penal.

- Konstatohet se edhe tek të njëjtët gjyqtarë, përkatësisht në 2 prej tyre praktika është e ndryshme.

Kështu për gjyqtarin i cili ka edhe numrin më të madh të pranimeve (nga 179 pranime, 83 pranime i përkasin këtij gjyqtari), konstatohet se në 23 vendime të viteve 2017 dhe 2018, nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal. Nga këto vendime vetëm 3 prej tyre janë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Penal me nr. 36/2017.

Për gjyqtarin tjetër i cili rezulton në 21 vendime, konstatohet se në 7 prej tyre nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal. Nga këto vendime vetëm 5 prej tyre janë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Penal me nr. 36/2017.

- Konstatohet se tek vendimet e 2 gjyqtarëve të tjerë nuk janë evidentuar përfshirje të detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal. Gjyqtarët përkatësisht rezultojnë si të tillë në 6 vendime që janë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të kodit penal me nr. 36/2017 dhe 1 vendim që është pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Penal me nr. 36/2017.

- Konstatohet se katër gjyqtarët e tjerë kanë përfshirë në të gjitha vendimet e tyre, për periudhën objekt inspektimi, detyrimet sipas nenit 60 të K. Penal.

##### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, konstatohet se jo nga të gjithë gjyqtarët ndiqet e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të K. Penal.

Nga 8 gjyqtarë të cilët kanë shqyrtuar kërkesat për lirim me kusht dhe kanë vendosur pranimin, për periudhën e inspektimit, konstatohet se 2 prej tyre ndjekin të njëjtën praktikë në të gjitha vendimet e tyre duke mos u proceduar me caktimin e detyrimeve pasi kanë pranuar kërkesën për lirim me kusht. Këto vendime, gjithsej 5+7 i përkasin periudhës pas ndryshimeve ligjore të Kodit Penal me nr. 36/2017.

Ndërsa evidentohet se 2 prej 8 gjyqtarëve që ndjekin praktikën e përcaktimit të një prej detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të K. Penal, në vendimmarrjet e tyre nuk kanë ndjekur të njëjtën praktikë. Kështu një gjyqtar evidentohet se, nga 2 vendime pranimi në 1 rast, nuk ka përcaktuar detyrime të tilla dhe gjyqtari tjetër nga 4 vendime pranimi në 2 raste, nuk ka proceduar me përcaktimin e detyrimeve. Këto vendime, i përkasin periudhës pas ndryshimeve ligjore të Kodit Penal me nr. 36/2017.

### **Gjykata e Apelit Vlorë**

Nga vendimet e Gjykatës së Apelit që kanë ndryshuar vendimet e rrëzimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe kanë pranuar kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht, evidentohet se në përgjithësi është urdhëruar parashikim i detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal. Në rreth 17 vendime nga 58, nuk është evidentuar parashikimi i detyrimeve sipas nenit 60, ndonëse në disa prej tyre evidentohet se në pjesën arsyetuese gjyqtarët arsyetojnë për vendosjen e këtyre detyrimeve. Në këto vendime urdhërohet moskryerja e veprave të tjera penale dhe detyrueshmëria e kontaktit me shërbimin e provës. Të gjitha vendimet në fjalë, i përkasin periudhës pas ndryshimeve ligjore të Kodit Penal me nr. 36/2017.

Çështjet për të cilat është vendosur ndryshimi i vendimit dhe pranimi i kërkesës për lirim me kusht, rezultojnë se janë shqyrtuar nga trupa të ndryshëm, rreth 13 trupa dhe nga këto trupa, rezultojnë se tre trupa në vendimmarrjet e tyre kanë proceduar si me përcaktim detyrimesh ashtu edhe me mospërcaktim detyrimesh për të liruarit me kusht.

Gjithashtu nga vendimet e Gjykatës së Apelit që kanë lënë në fuqi vendimet e pranimit, për të cilat nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, nuk ka evidentim nga Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e saj, lidhur me këtë pikë dhe as është evidentuar ankim lidhur me këtë nga ana e prokurorit.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal.

#### **4.5.2.5.2. Fillimi i afatit të provës**

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të studiuara, konstatohet se nga të gjithë gjyqtarët nuk arsyetohet dhe as përcaktohet në dispozitiv, koha e fillimit të provës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

Nga vendimet gjyqësore të pranimi të studiuara, konstatohet se nga të gjithë gjyqtarët nuk arsyetohet dhe as përcaktohet në dispozitiv, koha e fillimit të provës.

### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat**

Nga vendimet gjyqësore të pranimi të studiuara, konstatohet se tre gjyqtarë nga 10 gjyqtarët që janë marrë me trajtimin e kërkesave të lirimit me kusht, pas përcaktimit të kohës së provës, arsyetojnë dhe disponojnë edhe për kohën e fillimit të kësaj periudhe, duke përcaktuar si të tillë të nesërmen e shpalljes së vendimit.

### **Gjykata e Apelit Vlorë**

Në rastet e shqyrtuara nga Gjykata e Apelit ku është vendosur pranim kërkesë për lirim me kusht, lidhur me këtë çështje, nuk konstatohet që nga kjo gjykatë të ketë përcaktim për kohën e fillimit të provës.

### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

## **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimi të kërkesës “Lirim me kusht”**

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës jo të plotë<sup>141</sup> të vënë në dispozicion nga ana e Zyrës së Prokurorisë Vlorë, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimi të kërkesës për lirim me kusht. Nga këto të dhëna konstatohet se prokurori pjesëmarrës në gjykim është edhe prokurori i cili nxjerr urdhërin e ekzekutimit për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të pranimi për lirim me kusht. Këto urdhëra rezultojnë të jenë të së njëjtës datë me vendimin e pranimi, dhe i është drejtuar për ekzekutim IEVP dhe Shërbimit të Provës. Gjithashtu konstatohet se ky urdhër i dëgohet me shkresë përkatëse edhe të dënuarit dhe avokatit, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga praktika e vënë në dispozicion e Zyrës së Prokurorisë Vlorë, konstatohet se pasi vendimi merr formë të prerë, nxirret sërish urdhër ekzekutimi nga ana e prokurorit duke ia drejtuar Shërbimit të Provës, Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Dhomës së Avokatisë dhe vetë të dënuarit, si edhe Zyrës së Përmbarrimit. Urdhëri i ekzekutimit në fjalë, nxirret nga prokurori që nuk është gjithmonë i njëjti prokuror.

---

<sup>141</sup> Dokumentacioni i sjellë nga Zyra e Prokurorisë Vlorë, ka patur mangësi të drejtim të urdhërave të nxjerrë për ekzekutim. Në shkresat e kërkuara nga ana jonë janë kërkuar praktikat e plota të ekzekutimit, por gjithsesi nuk është sjellë i plotë.

Në rastet kur është Gjykata e Apelit e cila vendosur lirimin e kërkuesit, pasi ka vlerësuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, konstatohet se që mbi bazën edhe të urdhërimit në dispozitiv, vendimi dërgohet për ekzekutim në Zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e cila nxjerr urdhërin përkatës drejtuar IEVP për lirim dhe më pas edhe institucioneve të tjera të ngarkuar me ekzekutim.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës jo të plotë<sup>142</sup> të vënë në dispozicion nga ana e Zyrës së Prokurorisë Fier, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Nga këto të dhëna konstatohet se evidentohen raste kur prokurori pjesëmarrës në gjykim është edhe prokurori i cili nxjerr urdhërin e ekzekutimit për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të pranimit për lirimin me kusht, sikurse evidentohen edhe raste që prokurorët janë të ndryshëm. Referuar urdhërave të dërguar nga Zyra e Prokurorisë Fier, për aq sa është e mundur të evidentohet, për rastet e pranimit të kërkesave nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor rezultojnë se janë të njëjta me datën e vendimit të pranimit duke iu dërguar menjëherë për ekzekutim me shkresë IEVP. Gjithashtu referuar të njëjtave urdhërave, duke patur në konsideratë mungesën e praktikës së plotë, evidentohen raste kur nga ana e prokurorëve procedohet me nxjerrjen e urdhërit si për IEVP ashtu edhe për Shërbimin e Provës, ndërsa evidentohen edhe rastet kur nga ana e prokurorëve në urdhërin drejtuar IEVP nuk ka të dhëna që i është dërguar Shërbimit të Provës. Lidhur me këtë fundit, nuk mund të dalim në një konkluzion për shkak të praktikës së paplotë të ekzekutimit të dërguar nga ana e Zyrës së Prokurorisë Fier.

Nga praktika e vënë në dispozicion e Zyrës së Prokurorisë Fier, konstatohet se pasi vendimi merr formë të prerë, nxirret sërish urdhër ekzekutimi nga ana e prokurorit duke ia drejtuar Shërbimit të Provës, Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Dhomës së Avokatisë dhe vetë të dënuarit, si edhe Zyrës së Përmbartimit. Urdhëri i ekzekutimit në fjalë, nxirret nga prokurori që nuk është gjithmonë i njëjti prokuror që ka nxjerrë urdhërin e ekzekutimit të menjëhershëm.

Në rastet kur është Gjykata e Apelit e cila ka vendosur lirimin e kërkuesit, pasi ka vlerësuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, konstatohet se mbi bazën edhe të urdhërimit në dispozitiv, vendimi dërgohet për ekzekutim në Zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e cila nxjerr urdhërin përkatës drejtuar IEVP për lirim dhe më pas edhe institucioneve të tjera të ngarkuar me ekzekutim.

Referuar rasteve të pranimit të kërkesave për lirim me kusht, evidentohet se nga ana e gjyqtarit Piro Sota është ndjekur si praktikë nxjerrja e një urdhëri për lirim të menjëhershëm, i cili i

---

<sup>142</sup> Dokumentacioni i sjellë nga Zyra e Prokurorisë Fier, ka patur mangësi të drejtim të urdhërave të nxjerrë për ekzekutim. Në shkresat e kërkuara nga ana jonë janë kërkuar praktikat e plota të ekzekutimit, por gjithsesi nuk është sjellë i plotë. Nuk është evidentuar të ketë inventarizim.



dërgohet zyrës së prokurorisë që më pas është dërguar sipas prokurorit IEVP, Shërbimit të Provës, të dënuarit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Urdhëri përmban dispozitivin për lirim dhe kërkesit.

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës jo të plotë<sup>143</sup> të vënë në dispozicion nga ana e Zyrës së Prokurorisë Berat, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Nga këto të dhëna konstatohet se nga ana e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor vendoset në dispozitiv detyrimi për ekzekutim nga ana e prokurorit, duke u dërguar një kopje të vendimit përkatës. Edhe nga vendimmarrjet e Gjykatave të Apelit kur nga ana e tyre është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, përcaktohet detyrimi i prokurorisë për ekzekutim.

Nga praktika e nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit nga prokurori pjesëmarrës në gjykimin ku ishte pranuar kërkesa për lirim me kusht, mbi bazën e të cilës bëhet ekzekutimi i vendimit nga IEVP. Gjithashtu konstatohet se urdhëri i ekzekutimit nxirrej edhe për shërbimin e provës.

Në rastet kur pranimi i kërkesës për lirim dhe kërkesit është bërë nga Gjykata e Apelit, si rregull është proceduar me dërgimin e vendimit (shkurtimit) në Zyrën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat e cila ka vazhduar më tej me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit. Në një rast rezultoi se urdhër ekzekutimi është dërguar edhe nga Gjykata e Apelit për IEVP, dhe dërguar për dijeni Zyrës së Prokurorisë Berat. Për dy raste të vendimit të pranimit për lirim me kusht nga Gjykata e Apelit, evidentohet se është nxjerrë urdhër ekzekutimit nga Zyra e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat që për aq sa rezultoi nga akti përkatës mban datën e nesërme të shpalljes së vendimit dhe që për të cilat për shkak të konstatimit në përgjithësi të praktikave të paplota të lidhura me mënyrën e administrimit të akteve përkatëse të një praktike ekzekutimi vlerësohet verifikimi përkatës lidhur me veprimtarinë e magjistratëve.

#### **■ Lidhur me trajtimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht”, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që përfshihen në Juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka rezultuar se:**

##### **1. Paraqitja e kërkesës dhe procedimi me caktimin e gjyqtarit**

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim. Lidhur me këta të fundit, konstatohet se kanë qenë duke vuajtur dënim me burgim për krime ku përfshihet edhe dhuna si element përbërës i figurës së veprës penale, dhe nuk konstatohet në asnjë rast që të kenë qenë duke vuajtur dënim me burgim të dhënë për kundravajtje penale

---

<sup>143</sup> Dokumentacioni i sjellë nga zyra e prokurorisë Berat, ka patur mangësi të drejtim të urdhërave të nxjerrë për ekzekutim. Në shkresat e kërkuara nga ana jonë, janë kërkuar praktikave të plota të ekzekutimit, por gjithsesi nuk është sjellë i plotë. Nuk është evidentuar të ketë inventarizim.



dhe burgim të përjetshëm.

Të dënuarit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin pranë IEVP Tepelenë, që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Me paraqitjen e kërkesave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është proceduar me regjistrimin e kërkesës dhe më pas me hedhjen në short elektronik për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e saj. Gjykimi i kërkesave të tilla është bërë nga trupa gjyqësore e përbërë nga një gjyqtar.

Shorti elektronik është përdorur si procedurë caktimi e gjyqtarit edhe në rastet e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke u caktuar sërish i njëjti gjyqtar që kishte gjykuar edhe kërkesën e mëparshme dhe kishte vendosur pushimin e kërkesës.

Gjithashtu shorti elektronik është përdorur për përcaktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, i plotësuar më pas edhe me dy gjyqtarë të tjerë, sipas ndarjes së bërë me urdhër të Kryetarit të Gjykatës. Gjykimi i kërkesave të tilla në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë është bërë nga një trupë gjyqësore e përbërë nga tre gjyqtarë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, kërkesat me objekt “lirim me kusht” janë shqyrtuar nga 6 gjyqtarë të dhomës penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë nga dy trupa gjyqësore.

## **1.2. Në rastin e përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues lidhur me caktimin e gjyqtarit që do të trajtojë kërkesën e dytë, konstatohet se:**

Për periudhën e inspektimit, kanë rezultuar 12 kërkues të cilët kanë përsëritur të njëjtën kërkesë “lirim me kusht”, pas një vendimmarrje të mëparshme lidhur me të.

Nga këto raste, evidentohen 3 kërkues që kanë përsëritur kërkesën më shumë se një herë, nga ku rezulton se për kërkesat e mëparshme ishte vendosur me të dy llojet e vendimeve përfundimtare dhe jopërfundimtare. Gjithashtu për këto raste, është evidentuar se gjyqtarët që kanë shqyrtuar kërkesat kanë qenë të caktuar të gjithë dhe në të gjitha rastet me short elektronik, nga ku ka rezultuar se gjyqtari është i ndryshëm apo edhe i njëjti. Për këto raste nuk evidentohet të ketë patur ndryshim gjyqtari pas dorëheqjes së tij apo për shkak të gjykimit të mëparshëm. Më konkretisht:

Kërkues që ka paraqitur kërkesë 5 herë, konstatohet vetëm 1. Për kërkesën e parë është vendosur rrëzim, dhe në vazhdim është disponuar me rrëzim, pushim dhe mosshqyrtim. Kërkesat e këtij kërkuesi rezultojnë të shqyrtuara nga 3 gjyqtarë, ku më konkretisht shqyrtimi i kërkesës së parë, të dytë dhe të pestë është bërë nga i njëjti gjyqtar, kërkesa e tretë nga një gjyqtar i ndryshëm, si dhe kërkesa e katër nga një gjyqtar tjetër po i ndryshëm nga dy të

sipërcituarit. Të gjithë gjyqtarët rezultojnë të jenë caktuar në të gjitha këto raste, nga shorti elektronik. Për gjyqtarin e caktuar për shqyrtimin e kërkesës së katërt, konstatohet se ai është caktuar me short, pas caktimit të një gjyqtari tjetër i cili rezultonte të kishte pengesë ligjore për shkak të të qenit gjyqtar i gjykimit të themelit.

Kërkuesit që kanë paraqitur kërkesën 4 herë, konstatohen se janë dy. Lidhur me njërin kërkues, për kërkesën e parë është vendosur pushim, dhe në vazhdim është vendosur pushim, rrëzim dhe pranim. Kërkesat e këtij kërkuesi rezultojnë të jenë shqyrtuara të gjitha nga e njëjta gjyqtare e caktuar në të gjitha rastet me short elektronik. Lidhur me kërkuesin tjetër, për kërkesën e parë është vendosur pushim, dhe në vazhdim është vendosur rrëzim, pushim, papranueshmëri. Kërkesat e këtij kërkuesi rezultojnë të jenë shqyrtuara nga dy gjyqtarë të ndryshëm, përkatësisht i njëjti ka gjykuar kërkesën e parë dhe të dytë (përfundimtar, rrëzim) dhe i njëjti ka gjykuar kërkesën e tretë dhe të katërt. Të gjithë gjyqtarët për rastet e kërkesave të të dy kërkuesve janë caktuar me short elektronik.

Kërkuesit që kanë paraqitur kërkesën 3 herë konstatohen se janë dy. Lidhur me njërin kërkues për kërkesën e parë është vendosur rrëzimi, dhe më pas pushim e pranim, gjyqtari në këto raste ka qenë i ndryshëm për çdo kërkesë. Lidhur me kërkuesin tjetër për kërkesën e parë është vendosur pushim, dhe më pas në vazhdim pushim dhe rrëzim. Gjyqtarët që kanë shqyrtuar kërkesat kanë qenë të ndryshëm, përkatësisht i njëjti që ka vendosur dy herë pushim dhe gjyqtari tjetër që ka vendosur rrëzim. Të gjithë gjyqtarët për rastet e kërkesave të të dy kërkuesve janë caktuar me short elektronik.

Për 7 kërkuesit e tjerë, që kanë përsëritur kërkesën vetëm nga 1 herë, konstatohet se në 2 raste për kërkesat e tyre fillimisht është vendosur me vendim përfundimtar, rrëzim dhe më pas sërish me vendim përfundimtar rrëzim/pranim; në 4 rastet e tjera është vendosur fillimisht me vendim jopërfundimtar, moshqyrtim/pushim, moskompetencë për t'u proceduar në vazhdim me vendim përfundimtar, pranim; dhe në 1 rast për të dy kërkesat është proceduar me vendime jopërfundimtare pushim/moshqyrtim. Të gjithë gjyqtarët për rastet e kërkesave të secilit prej kërkuesve janë caktuar me short elektronik.

Për 2 rastet për të cilët është proceduar me vendime përfundimtare, konstatohet se gjyqtarët që kanë shqyrtuar kërkesat për secilin kërkues kanë qenë të ndryshëm dhe të caktuar me short elektronik.

Nga të gjitha rastet sa më sipër, kur për kërkesën paraardhëse të kërkuesit ishte vendosur me vendim themeli rrëzim, kërkesat e mëpasshme për të cilat sërish është proceduar me vendim themeli rrëzim/pushim, rezultojnë të regjistruara pas kalimit të afatit 6 mujor referuar parashikimeve të nenit 477 të K. Pr. Penale.

Lidhur me parashikimin e nenit 477 të K. Pr. Penale vlerësohet të evidentohet interpretimi i Gjykatës së Apelit gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Gjirokastrë<sup>144</sup> sipas të cilit kërkesa ishte rrëzuar për shkak të mosparaqitjes së asnjë prove nga ana e kërkuarit për provueshmërinë e kushtit procedural të mospasjes së një kërkesë të rrëzuar jo më afër se 6 muaj nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim. Gjykata e rrethit gjyqësor lidhur me këtë kërkesë procedurale shprehet se: “*Detyrimin për të provuar faktet juridike të kërkuara nga ligji, e ka kërkuari, i cili nuk pretendoi dhe provoi ekzistencën e fakteve të kërkuara nga neni 477 i K. Pr. Penale*”. Më tej, gjykata e konsideron këtë kusht procedural si kusht pa të cilin nuk mund të procedojë më tej me shqyrtimin e kërkesës dhe të shprehet lidhur me plotësimin e kushteve materiale të parashikuara në nenin 64 të K. Penal. Lidhur me këtë qëndrim të gjykatës së rrethit gjyqësor, nuk ka qenë dakort kërkuari i cili ka ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit<sup>145</sup> mbi bazë të këtij ankimi ka vlerësuar të procedojë me hetim të pjesshëm në drejtim të administrimit të vërtetimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me kërkesë të mëparshme të kërkuarit, nga i cili rezultoi se nuk kishte të tilla. Në vazhdim, gjykata pas prezantimit të këtij fakti, ka konkluduar se arsyetimi sa më sipër i gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparaqitjen e një prove nga kërkuari për kërkesë të mëparshme, vjen në kundërshtim dhe keqinterpretim të kërkesave procedurale që kërkon neni 477 i K. Pr. Penale. Ky konkludim nuk është shoqëruar me ndonjë arsyetim konkret dhe gjykata e Apelit më tej ka vazhduar me arsyetimin e plotësimin të kërkesave të tjera lidhur me kriteret objektive dhe subjektive dhe në përfundim ka vendosur ndryshimin e vendimit të rrëzimit dhe pranimit të kërkesës, duke urdhëruar lirin e menjëherëshëm të të dënuarit. Me vendimin për lirin me kusht, ka qenë dakort edhe prokurori i apelit i cili ka shprehur qëndrimin e tij gjatë seancës dhe për këtë arsye ndaj vendimit nuk ka patur rekurs.

## **2. Palët pjesëmarrëse në gjykim**

Referuar vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor, konstatohet se në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, si palë pjesëmarrëse thirren kërkuari, prokurori dhe Institucioni i Vuajtjes së Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP). Gjatë gjykimet, nga ana e gjyqtarëve është kërkuar dhe është administruar në të gjitha rastet kur është proceduar me pranim/rrëzim të kërkesës, edhe raporti i shërbimit të provës.

### **2.1. Kërkuari si palë pjesëmarrëse**

Kërkuari si palë pjesëmarrëse, rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë në rrethin gjyqësor, është i asistuar nga mbrojtës. Kjo evidentohet tek rastet kur është disponuar me pushim/moskompetencë, ndërsa në gjykimet ku është disponuar pranimit/rrëzimit të kërkesave për lirim me kusht gjykimi është zhvilluar me praninë e mbrojtësit të kërkuarit.

### **2.2. Prokurori si palë pjesëmarrëse**

Lidhur me prokurorin si palë pjesëmarrëse, nga vendimet gjyqësore është konstatuar se vetëm

<sup>144</sup> vendimi nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018.

<sup>145</sup> vendimi nr. 20-2018-369/45, datë 03.05.2018.

në tre raste, nga gjykata është proceduar në mungesë të prokurorit. Këto tre raste kanë qenë kur nga ana e kërkuarit është paraqitur kërkesë për heqje dore dhe nga gjykata është disponuar me mosshqyrtimin e kërkesës.

### **2.3. Gjukata e Apelit Gjrokastër**

Referuar 7 gjykimeve në Gjukatën e Apelit Gjrokastër, konstatohet se përveç kërkuarit dhe prokurorit, është thirrur për të marrë pjesë në 1 rast, edhe IEVP. Në këto gjykime prokurori ka qenë i pranishëm, sikurse edhe kërkuari është mbrojtur nga një avokat.

### **3. Caktimi i prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht"**

#### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjrokastër**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht", konstatohet se nga Prokuroria pranë Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Gjrokastër për të gjithë periudhën e inspektimit është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit që ka përfaqësuar çështjen në procesin e gjykimit, kur kërkuari ishte dënuar nga Gjukata e Rrethit Gjyqësor Gjrokastër. Në ndryshim nga rregulli në fjalë, nëse prokurori i Zyrës së Prokurorisë Gjrokastër i cili kishte qenë përfaqësues i prokurorisë në gjykimin e themelit, nuk ushtronte më detyrën në këtë zyrë prokurorie apo nëse kërkuari ishte dënuar nga një gjykatë tjetër ku si përfaqësues prokurorie ka qenë një prokuror i një zyre tjetër prokurorie (jo i zyrës Gjrokastër), caktimi i prokurorit në gjykimin me objekt "lirim me kusht" bëhej verbalisht nga drejtuesi i prokurorisë.


#### **Prokuroria e Apelit Gjrokastër**

Përsa i përket caktimit të prokurorit pjesëmarrës si palë në gjykimet me objekt "lirim me kusht" në Gjukatën e Apelit Gjrokastër, në Zyrën e Prokurorisë së Apelit Gjrokastër është proceduar me hedhjen me short manual referuar çështjeve penale të ardhura nga Gjukata e Apelit. Në këtë zyrë prokurorie ka patur vetëm 2 prokurorë deri në muajin korrik 2019, kohë kur çështjet në këtë prokurori janë përfaqësuar nga një prokuror i vetëm.

### **4. Nga vendimet gjyqësore të administruara, referuar mënyrës së disponimit konstatohet se:**

Nga vendimet gjyqësore të administruara, rezulton se për kërkesat e regjistruara në Gjukatën e Rrethit Gjyqësor Gjrokastër për periudhën e inspektimit, nga numri i përgjithshëm 59, për 4 prej tyre është disponuar me shpallje moskompetence, për 13 me pushim kërkesë, për 3 prej tyre mosshqyrtim i kërkesës, për 1 prej tyre deklarim i papranueshëm i kërkesës, për 12 prej tyre rrëzim kërkesë dhe për 26 pranim kërkesë.

#### **4.1. Lidhur me arsyet, për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me shpallje moskompetence, konstatohet se:**



Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilat është vendosur të deklarohej shpallja e moskompetencës, është transferimi i kërkesit/të dënuarit nga IEVP Tepelenë në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtron kompetencën e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Kërkesit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Tepelenë dhe më pas janë transferuar në IEVP të tjera sipas urdhrit përkatës për transferim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është administruar gjatë gjykimit.

Gjykimi në këto seanca është zhvilluar në një rast në mungesë të kërkesit dhe të pranishëm kanë qenë, përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe i IEVP Tepelenë, të cilët kanë mbajtur qëndrimin e tyre se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nuk është kompetente për gjykimin e këtyre kërkesave. Në vazhdim, pas marrjes së mendimit të palëve pjesëmarrëse në gjykim, nga ana e gjykatës është proceduar me marrjen e vendimit për shpalljen e moskompetencës.

#### **4.2. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me pushim kërkesë konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkesit se heq dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt, “Lirim me kusht”. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenet të 387 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e pushimit në fjalë i përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019. Në vitin 2017 të gjitha vendimet i përkasin periudhës para hyrjes në fuqi të dispozitave të ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “ Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **4.3. Lidhur me arsyet për të cilën nga ana e gjykatës është disponuar me “moshqyrtim të kërkesës dhe “deklarimin e papranueshëm të kërkesës”, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të shprehjes së vullnetit në gjykim nga ana e kërkesit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes penale me objekt “Lirim me kusht”. Për këto raste, gjykata ka vendosur si bazë ligjore për disponimin e saj, nenin 477 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimet në fjalë i përkasin viteve 2018, 2019.

#### **4.4. Lidhur me arsyet për të cilat nga ana e gjykatës është disponuar me “rrezim i kërkesës për lirim me kusht”/“pranim i kërkesës për lirim me kusht”, konstatohet se:**

Në të gjitha këto raste, gjykata ka disponuar pas analizimit si të kriterëve objektive, ashtu edhe të kriterëve subjektive, në raport me rrethanat e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal dhe interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin



unifikues me nr. 2/2015.

Referuar këtyre vendimeve, konstatohet se nuk ka patur diskutime lidhur me kushtet ndaluese të parashikuar në nenin 64 të K. Penal apo përsëritjes së një kërkesë pa kaluar afati i parashikuar nga neni 477/2 i K. Pr. Penale.

Në gjykatën e rrethit gjyqësor, objekt i këtij inspektimi kur nga ana e gjykatës është konkluduar se për të dënuarin përmbushen të gjitha kriteret objektive dhe subjektive për përfitimin e lirit me kusht, është proceduar me disponimin e pranimit të kërkesës e pasuar edhe me urdhërimet përkatëse për kohën e kushtit dhe detyrimet përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të K. Penal. Dhe në rastet kur nga ana e gjyqtarëve nuk është konkluduar përmbushja e këtyre kriterëve, gjyqtarët kanë proceduar me disponim të rrëzimit të kërkesës duke arsyetuar lidhur me shkakun.

Në rastet në të cilat gjykata ka disponuar me rrëzimin e kërkesës, arsyeja bazohet kryesisht në mosprovueshmërinë e kriterëve subjektive të lirit me kusht, mospërmbushja e arsyeve të veçanta, natyra e veprës penale dhe vlerësimi i mosarritjes së qëllimit për edukimin e kërkuesit për shkak të masave disiplinore, ndërsa rezulton se kriteri objektiv i kërkesave për lirim me kusht, ai i vuajtjes së kohës fizike të burgimit, sipas nenit 64 të Kodit Penal është plotësuar.

Në veçanti, në dy nga vendimet rezulton se kërkesa është rrëzuar për shkak të kriterit ndalues përsëritës të parashikuar nga neni 64, paragrafi 3 i K. Penal; në 1 vendim, kërkesa është rrëzuar për shkak të mosprovueshmërisë së kushtit të parashikuar nga neni 477/2 i K. Pr. Penale, vendim i cili më pas është prishur nga Gjykata e Apelit, duke vendosur pranimin e kërkesës dhe në 1 vendim tjetër kërkesa është rrëzuar, duke argumentuar ndër të tjera se, në vendimin e gjykatës që është deklaruar fajtor kërkuesi është aplikuar neni 65/a i Kodit Penal, periudha e sigurisë, duke vendosur që e drejta e lirit me kusht për kërkuesin të kushtëzohet me vuajtjen e 7 viteve burgim.

#### **4.4.1. Kriteri subjektiv:**

Lidhur me këtë kriter, në trajtimin e vendimeve është patur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij, në rrëzimin/pranimin e kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se të gjitha vendimet kanë një standard arsyetimi duke iu referuar qëndrimin të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehur me vendimin nr. 2/2015, në lidhje me shprehjen “arsye të veçanta”.

Pas konkludimit me vendim të gjykatës, lidhur me vlerësimin mbi provueshmërinë e arsyeve të veçanta për çdo kërkues, konstatohet se në rast mosdakordësie nga ana e prokurorit apo kërkuesit është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit ku kanë parashtruar argumentet e tyre. Në vazhdim Gjykata e Apelit e vënë në lëvizje nga apeluesi, e mbështetur kryesisht në të njëjtat prova të administruara gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka konkluduar mbi



ankimin, duke vlerësuar dhe krijuar edhe ajo bindjen e saj në provueshmërinë e arsyeve të veçanta.

#### **4.4.2. Kriteret objektive:**

##### **4.4.2.1. Periudha minimum e vuajtjes së dënimit**

Në përcaktimin e periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër evidentohet se ndiqet e njëjta praktikë në mënyrën sesi interpretohet dispozita në fjalë për t'iu referuar kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

Kështu nga vendimet e trajtuara evidentohet se nga ana e të gjithë gjyqtareve, në interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal, jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, i referohen masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar.

Edhe nga vendimet e Gjykatës së Apelit, konstatohet se mbahet i njëjti qëndrim sa më sipër në interpretimin e dispozitës përkatëse për përcaktimin e kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfituar lirin me kusht.

#### **Qëndrimi i prokurorit**

Nga prokurorët që kanë përfaqësuar çështjet me objekt "lirim me kusht" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, konstatohet se nga ana e tyre nuk ka patur ankim/rekurs lidhur me qëndrimin në fjalë të gjykatës përse i përket përcaktimit të periudhës minimum të kohës së vuajtur të dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal, në drejtim të kohës së detyrueshme që duhet të ketë vuajtur kërkuesi.

##### **4.4.2.2. Kufijtë e përlllogaritjes së periudhës së vuajtjes së dënimit referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara, për të cilat është vendosur pranim/rrëzim të kërkesës për "Lirim me kusht" për periudhën e inspektimit, konstatohet se përlllogaritja e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit ka përfshirë jo vetëm periudhën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudhën në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Referuar vendimmarrjeve të secilit prej gjyqtarëve që kanë trajtuar kërkesat për lirim me kusht për periudhën e inspektimit, është evidentuar ndjekja e një praktike si më sipër në drejtim të periudhës kohore minimum të kohës së vuajtjes së dënimit.

Për të gjitha këto raste, qëndrimi i prokurorit të rrethit gjyqësor dhe atij të apelit ka qenë për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit deri në datën e

dhënies së vendimit.

Nga vendimet gjyqësore të apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me objekt “lirim me kusht”, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar.

Në vendimin e vetëm të Gjykatës së Apelit<sup>146</sup> që ka ndryshuar vendimin e rrëzimit dhe pranimit e kërkesës për lirim me kusht, kjo gjykatë shprehet në arsyetimin e saj për plotësimin e kriterit të kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht. Ky kriter në rastin konkret është shqyrtuar dhe analizuar vetëm nga Gjykata e Apelit, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor<sup>147</sup> e kishte rrëzuar kërkesën për shkak të mosprovueshmërisë së kushtit procedural të parashikuar në nenin 477/2 të K. Pr. Penale duke mos u ndalur tek kriteri objektiv i kohës së vuajtjes së dënimit. Dhe në vazhdim në një vendim tjetër Gjykata e Apelit<sup>148</sup> (e njëjta trupë gjyqësore si edhe më sipër), analizon duke u shprehur për përmbushje të kriterit në fjalë referuar dinamikës së vuajtjes së dënimit deri në datën e shqyrtimit të kërkesës.

#### **4.4.2.3. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor të trajtuara, është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ajo e përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

Midis gjykatës dhe prokurorisë rezulton se nuk ka patur qëndrim të ndryshëm lidhur me përfshirjen në periudhën në fjalë të kohës së punës në IEVP.

Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, evidentohet se vetëm në 10 vendime kërkuesi ka patur kohë pune në IEVP që është bërë më pas objekt trajtimi për përlllogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit në përmbushje të kriterit të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Nga vendimet gjyqësore të trajtuara nuk evidentohet që në përlllogaritje të jetë përfshirë si përfitim koha e përfituar me amnisti apo me falje.

Nga vendimet e trajtuara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, siç e cituam edhe më sipër, është konstatuar edhe një rast i aplikimit të nenit 65/a të K. Penal. Referuar këtij rasti të

---

<sup>146</sup> vendimi nr. 20-2018-369/45, datë 03.05.2018.

<sup>147</sup> vendimi nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018.

<sup>148</sup> vendimi nr. 20-2018-1005/111, datë 05.12.2018.



trajtuar me vendimin<sup>149</sup>, vlerësohet në këtë pjesë të raportit të trajohet edhe mënyra sesi gjykata ka interpretuar përlllogaritjen për efekt të zbatimit të dispozitës në fjalë. Kështu më konkretisht gjykata është shprehur se: “*kërkuesi .... Është dënuar me vendimin nr. ... .... Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal, me 8 vjet e 6 muaj burgim, me të drejtë lirimi me kusht pasi të ketë vuajtur 7 vjet burgim. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit ..., rezulton se kërkuesi ka vuajtur 7 vjet 3 muaj, 27 ditë burgim deri në datën 09.02.2017 duke i mbetur dhe 1 vit 2 muaj e 3 ditë burgim për të vuajtur. Rezulton se në kohën e vuajtjes së dënimit është llogaritur edhe një vit ulje dënimi përfituar me amnistinë e datës 10.03.2014. Në këto kushte kërkuesi ka vuajtur 6 vjet, 3 muaj e 27 ditë burgim. Rezulton se në vendimin e gjykatës që është deklaruar fajtor është aplikuar neni 65/a i K. Penal “Periudha e sigurisë” duke vendosur që e drejta për lirim me kusht për kërkuesin të kushtëzohet me vuajtjen e 7 viteve burgim. Gjykata vlerëson se aplikimi i nenit 65/a i Kodit Penal nga Gjykata në vendimin e dënimit i ka kushtëzuar të drejtën kërkuesit që të paraqesë në gjykatë kërkesë me objekt lirim me kusht pa vuajtur 7 vite burgim. ... amnistia e cila është aplikuar tek kërkuesi, ka sjell si pasojë që kërkuesi nga 8 vite e 6 muaj burgim dhënë nga gjykata, të vuaj 7 vite e 6 muaj burgim, por nuk cenon vendimmarrjen e gjykatës që ka kufizuar të drejtën e lirimimit me kusht pa vuajtur i dënuari 7 vjet burgim. Në këto kushte gjykata vlerëson se nga kërkuesi ... nuk plotësohet kushti i vendosur në vendimin nr. ... .... Për vuajtjen e 7 viteve burgim dhe për këtë shkak do të disponojë me rrëzimin e kërkesës”.* Ndaj vendimin nuk rezulton të jetë ushtruar ankimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore përkatëse.

#### 4.4.2.4. Kushtet ndaluese

Nga vendimet e administruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është evidentuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me kushtet ndaluese “përsëritës” dhe për shkak të veprës penale të parashikuar në nenit 64 të K. Penal. Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke administruar vendimet e dënimit të kërkuesit të administruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore, kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga IEVP dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimit.

Lidhur me kushtet ndaluese, vlerësohet të evidentohet një rast<sup>150</sup>, kur kërkuesi rezultonte të ishte i dënuar me dy vendime penale, të cilat janë bashkuar në një dënim të vetëm dhe gjatë vuajtjes së këtij dënimi për dënimin e parë me vendim gjyqësor është vendosur shuarja e dënimit të parë për shkak të amnistisë, duke bërë që të vazhdohej vuajtja e dënimit të dytë. Gjatë vuajtjes së këtij dënimi, i dënuari ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht dhe gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, përfitimi nga amnistia që ka sjellë shuarjen e dënimit të parë, nga ana e gjykatës është konsideruar nse nuk e bën kërkuesin përsëritës për efekte të përfitimit të lirimimit me kusht. Kështu më konkretisht gjykata arsyeton se: “*Në lidhje me kushtin e dytë, rezulton se kërkuesi ka dy dënime penale dhënë njëri pas tjetrit për të cilat organi i akuzës ka*

<sup>149</sup> vendimi nr. 5, datë 09.02.2017.

<sup>150</sup> vendimi nr. 3, datë 27.01.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

kërkuar dhe gjykata ka bërë bashkimin e tyre në një dënim të vetëm. Rezulton se dënimi i parë është amnistuar dhe kërkuesi është duke vuajtur vetëm dënimin e dhënë për vendimin e dytë gjyqësor që e ka dënuar me 4 vjet e 8 muaj burgim. Gjykata vlerëson se qëllimi i dënimit penal dhe vuajtjes së tij është që nëpërmjet vuajtjes së dënimit, i dënuari të rehabilitohet dhe riintegrohet në shoqëri. Nëse i dënuari pas përfundimit të procesit të rehabilitimit, kryen një veprë tjetër penale, atëherë ndodhemi përpara faktit të mosarritjes së rezultatit rehabilitues dhe integrujes nga vuajtja e dënimit penal. Në këto kushte legjislatori ka vendosur si kusht mospërfitimin nga e drejta për të kërkuar lirim me kusht. Në rastin në shqyrtim nuk rezulton që kërkuesi të ketë vuajtur një dënim penal, dhe të mos jetë rehabilituar ose risocializuar, duke mostreguar kështu rrezikshmëri të lartë dhe mosintegrim të tij në shoqëri. Ekzekutimi i dënimit për veprën e mëparshme penale, e cila do ta ngarkonte kërkuesin me pasojën e mospërfitimit të përfitimit nga lirimi me kusht është shuar, për shkak amnistie. Të njëjtin qëndrim gjykata do ta mbante edhe nëse kërkuesi do të vuante një dënim të vetëm, i cili vinte si rezultat i bashkimit të dy dënimeve të mëparshme. Përsa më sipër, ky trup gjykues vlerëson se kërkuesi nuk është përsëritës duke plotësuar kushtin e vendosur në nenin 64/3 të K. Penal. Për sa më sipër gjykata vlerëson se nga kërkuesi plotësohet dhe kushti i mospasjes së një dënimi të mëparshëm". Mbi bazën e këtij arsyetimi lidhur me kushtin ndalues, dhe argumentimit të plotësisht të kushteve të tjera objektive dhe subjektive, nga ana e gjykatës është disponuar me pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Gjatë këtij gjykimi, prokurori ka shprehur qëndrimin e tij dakortësuar për pranimin e kërkesës. Ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor nuk është ushtruar ankim duke marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore. Në këtë këndvështrim, për këtë rast do të vlerësohet verifikimi i mëtejshëm në kuadër të ligjit nr. 96/2016 duke patur në konsideratë periudhën kohore dhe konstatimin e rasteve të tjera të të njëjtës natyrë sipas parashikimeve të nenit 117 të të njëjtit ligj.

#### **4.4.2.5. Disponimi i gjykatës me rastin e pranimit të kërkesës "lirim me kusht"**

##### **Koha e kushtit/provës:**

Në vendimet e pranimit të lirimit me kusht, të trajtuara për periudhën objekt i këtij inspektimi është konstatuar se janë ndjekur praktika të ndryshme në përcaktimin e kohës së provës, e cila rezulton të jetë e barabartë ose më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit.

Kështu 3 gjyqtarë kanë ndjekur si praktikë gjatë gjithë periudhës së inspektimit, përcaktimin si kohë prove, një periudhë kohe të barabartë me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Në vendimmarrjet e tyre këta gjyqtarë arsyetojnë bazuar vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015.

2 gjyqtarët e tjerë nga grupi i gjyqtarëve që kanë disponuar me pranim kërkesë për lirim me kusht, përveç praktikës së sipërpërmendur kanë ndjekur edhe praktikën e përcaktimit si kohë prove një periudhë kohe më të madhe sesa dënimi i mbetur i pavuajtur i dënimit. Kjo evidentohet tek njëri prej gjyqtarëve në 2 vendime, nga 3 vendime pranimi gjithsej dhe tek një gjyqtar tjetër në 1, nga 6 vendime të dhëna gjithsej. Në këto vendime ku përcaktohet koha e provës më e madhe, nuk konstatohet të ketë arsyetim.

**Përsa i përket përcaktimit lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, kur gjykatat disponojnë, konstatohet se:**

Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër konstatohet se jo nga ana e të gjithë gjyqtarëve shprehet në dispozitiv lidhur me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Më konkretisht 2 gjyqtarë nga 5 gjyqtarët që kanë pranuar kërkesat për lirim me kusht shprehen në dispozitiv mbi kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Gjithashtu nuk ka vendime të Gjykatës së Apelit në lidhje me përcaktimin e pjesës së mbetur të pavuajtur të dënimit.

**Gjykata e Apelit Gjirokastër**

Në këtë gjykatë, konstatohet se nuk ka patur raste ku të jetë diskutuar apo ngritur si diskutim si shkak ankimi, koha e provës.

Në 1 rast konstatohet se Gjykata e Apelit<sup>151</sup> ka vendosur ndryshim dhe pranim kërkesë për lirim me kusht dhe nga ky rast konstatohet se nga ana e gjykatës është përcaktuar si kohë prove një periudhë e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Arsytimi në rastin konkret i referohet vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 5/2015.

Në rastin e vetëm kur vendimi i pranimit të gjykatës së rrethit gjyqësor është bërë objekt ankimi për shkaqe të tjera të ndryshme nga koha e provës, Gjykata e Apelit<sup>152</sup> ka vendosur lënien në fuqi të vendimit duke mos trajtuar kohën e provës e cila nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ishte përcaktuar më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit.

**Qëndrimi i prokurorit**

Nga leximi i vendimeve gjyqësore nuk konstatohet ndonjë qëndrim i prokurorit në lidhje me kohën e provës, dhe gjithashtu nuk evidentohet të jetë ushtruar ankim/rekurs në këtë drejtim.

**4.4.2.5.1. Detyrimet gjatë kohës së provës**

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për periudhën objekt inspektimi, është konstatuar se në dispozitiv, nga të gjithë gjyqtarët që kanë disponuar me pranim të kërkesës, është ndjekur e njëjta praktikë për përcaktimin e një prej detyrimeve të parashikuar në nenin 60 të K. Penal.

**Gjykata e Apelit Gjirokastër**

Referuar vendimit të vetëm të Gjykatës së Apelit<sup>153</sup> që ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, konstatohet se është proceduar me urdhërim për detyrime për të dënuarin e vënë në provë, sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

<sup>151</sup> vendimi nr. 20-2018-396/45, datë 03.05.2018, i Gjykatës së Apelit.

<sup>152</sup> vendimi nr. 20-2018-1005/111, datë 05.12.2018, i Gjykatës së Apelit.

<sup>153</sup> vendimi nr. 20-2018-1005/111, datë 05.12.2018, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

## **Qëndrimi i prokurorit**

Në rastet e mësipërme nuk ka qëndrim të prokurorit për detyrimet gjatë kohës së provës, pasi ankimi në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë është bërë për shkaqe të tjera.

### **4.4.5.2. Fillimi i afatit të provës**

Nga vendimet gjyqësore të pranimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të studiuara, konstatohet se në asnjë prej tyre nuk përcaktohet fillimi i afatit të provës.

## **Gjykata e Apelit Gjirokastrë**

Në rastin e sipërcituar, të shqyrtuar nga Gjykata e Apelit ku është vendosur ndryshimi i vendimit të rrëzimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimit të kërkesës për lirim me kusht, lidhur me këtë çështje, nuk konstatohet që nga kjo gjykatë të ketë përcaktim për kohën e fillimit të provës.

## **Qëndrimi i prokurorit**

Nga të gjitha rastet e administruara për të tre gjykatat e rretheve gjyqësore, nuk janë evidentuar të dhëna që nga prokurori të jetë ushtruar ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparashikimin e afatit të fillimit të afatit të provës.

## **5. Ekzekutimi i vendimit të pranimit të kërkesës “Lirim me kusht”**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës në tërësi jo të plotë<sup>154</sup> të administruar, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Për periudhën e inspektimit, vendimet penale ku është pranuar kërkesa me objekt “Lirim me kusht” janë vënë në ekzekutim nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës penale.

Në praktikën e administruar lidhur me ekzekutimin, konstatohet se në të gjitha rastet që nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, nga ana e prokurorit që ka marrë pjesë në gjykim është urdhëruar në të njëjtën datë me vendimin gjyqësor, lirimi i menjëhershëm duke iu dërguar për ekzekutim në IEVP ku vuan dënimin kërkuesi.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm është vendosur nga Gjykata e Apelit, urdhri i ekzekutimit për lirim me kusht rezulton se është nxjerrë nga Prokurori i Apelit pjesëmarrës në seancë.

---

<sup>154</sup> Dokumentacioni i sjellë nuk është i shoqëruar me inventarizim të akteve që pasqyrojnë të gjithë të dhënat për ekzekutimin për çdo rast.

Në rastet kur lirimi i menjëhershëm ishte vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe mbi bazë ankimi, Gjykata e apelit kishte vendosur lënien në fuqi, nga ana e prokurorit të prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte nxjerrë urdhrin e ekzekutimi të menjëhershëm, është proceduar me nxjerrjen sërisht të një urdhri ekzekutimi për efekt të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

### III. Analiza e të dhënave të konstatuara

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive, është përqëndruar në drejtim të i) respektimit të legjislacionit material dhe procedural; ii) ecurisë së gjykimit të kësaj kërkesë në gjykatë më të lartë; iii) qëndrimit të organit të akuzës në seancë gjyqësore dhe ankimet apo rekursat ndaj vendimeve për të cilat gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë disponuar; iv) procedurave për caktimin e gjyqtarit apo prokurorit për trajtimin e kërkesave me objekt: “Lirim me kusht”; v) analizimit të procedurave të ekzekutimit të vendimit penal me objekt “Lirim me kusht” në funksion të evidentimit të fakteve nëse ka pasur vonesa apo zbatim të gabuar të legjislacionit procedural në fuqi në drejtim të cenimit të lirisë individuale të individit.

Analiza e këtyre të dhënave, është bazuar duke u ndalur konkretisht në interpretimin e dispozitave të ligjit penal material dhe procedural, si dhe të ligjit të ekzekutimeve të vendimeve penale që rregullojnë institutin e liritimit me kusht, duke patur në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

Lirimi me kusht përbën një nga mënyrat alternative të ekzekutimit të dënimit me burgim<sup>155</sup>, që rregullohet nga dispozitat penale materiale, konkretisht nenet 64, 65 dhe 65/a të Kodit Penal. Neni 64 i K. Penal bën rregullimin e përgjithshëm<sup>156</sup> të këtij instituti, duke parashikuar mundësinë e të dënuarit me burgim për të përfituar lirin me kusht, pas plotësimit prej tij të kushteve objektive dhe subjektive të vlerësueshme nga ana e gjykatës, dhe për të kaluar në rregullimin e veçantë të tij për të dënuarit me burgim të përjetshëm, në nenin 65 të këtij kodi dhe për moslejimin e zbatimit të këtij instituti kur ekzistojnë disa rrethana dhe të cilat vlerësohen nga gjykata në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar për deklarimin fajtor

<sup>155</sup> Kështu shprehen Kolegjet Penale të Gjykatës së Lartë, mbi institutin e liritimit me kusht, në vendimet si: Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2022-1617, i vendimit (334) datë 15.12.2022; vendimin e saj me nr. 00-2022-629 i vendimit (163), datë 14.06.2022, kërkues Gerd Gjinarari;

<sup>156</sup> Gjykata e Lartë në vendimin e saj me nr. 00-2022-629 i vendimit (163), datë 14.06.2022, kërkues Gerd Gjinarari (I dënuar me burgim të përjetshëm) ka pranuar referimin tek mënyra e përlogaritjes së kohës së dënimit të vuajtur dhe tek kushtet ndaluese të nenit 64 të K. Penal, duke u shprehur ndër të tjera se: “Kolegji vlerëson se kërkuesi në mënyrë të dukshme nuk plotësonte as kushtet objektive, si vuajtja e dënimit prej 35 vjetësh apo mosqenia përsëritës për krime të kryera me dashje. Pavarësisht se nga gjykatat e faktit nuk përcaktohet koha e saktë e dënimit të vuajtur nga kërkuesi, rezulton qartë se kjo kohë është nën masën 35 vjet që kërkon dispozita. Gjithashtu, në ndalim të parashikimit ligjor, nga gjykata e shkallës së parë është përfshirë në këtë masë edhe pjesa e dënimit të përfituar me amnisti”.

dhe dënimin me burgim të të pandehurit - sipas nenit 65/a të të njëjtit kod, të titulluar “periudha e sigurisë”.

Nenet 64 dhe 65 të K. Penal rezultojnë se kanë pësuar ndryshime, me ligjin nr. 36/2017, datë 30.03.2017, hyrë në fuqi më datë 21.05.2017<sup>157</sup>, e cila përkon edhe me periudhën objekt i këtij inspektimi. Ndërsa neni 65/a i K. Penal është shtuar si e tillë me ndryshimet ligjore të vitit 2012 dhe nuk ka pësuar ndryshime deri më sot.

Referuar periudhës objekt inspektimi deri në datën 21.05.2017, neni 64 i K. Penal ka patur këtë parashikim:

*“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:*

*- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;*

*- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim;*

*- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë deri në njëzet e pesë vjet burgim.*

*Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.*

*Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.*

*Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve”.*

Neni 65 ka patur këtë parashikim:

*“Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.*

*Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur:*

*Ka vuajtur jo më pas se 25 vjet burgim dhe gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij”.*

---

<sup>157</sup> Ligji në nenin 14 të tij ka parashikuar hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Ligji është publikuar në faqen zyrtare me nr. 98, datë 05.05.2017.

Me ligjin nr. 36/2017 të nenit 64 të K. Penal, iu bënë ndryshimet përkatëse në paragrafin e 1, pika 3, duke u riformuluar në “- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni” dhe duke u shtuar një paragraf në fund, i quajtur paragrafi i pestë me parashikimin “Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve. Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit, vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimit për lirim para kohe me kusht”. Ndërsa me të njëjtin ligj, në nenin 65 të K. Penal u ndryshua periudha e kohës së vuajtjes së dënimit që duhet të përmbushte i dënuari nga 25 vjet në 35 vjet burgim dhe shtuar një paragraf lidhur me ndalesat absolute për këta të dënuar e lidhur me llojin e veprës penale për të cilat ishin dënuar dhe kërkohej aplikimi i institutit të lirit me kusht.

Referuar raportit shoqëruar të ndryshimeve të Kodit Penal, lidhur me nenin 64 të K. Penal është vlerësuar se: “Ndryshimet në projektligj për lirim para kohe me kusht synojnë qartësimin e dispozitës sidomos në rastet e llogaritjes së kohës së vuajtur të dënimit, kur të dënuarit i lind e drejta për t’u drejtuar gjykatës më kërkesë për lirim me kusht. Amnistia dhe çdo falje ligjore nuk do të llogaritet në kohën e vuajtur të dënimit të të dënuarit. Me këtë rregullim evitohen problemet e konstatuara në praktikën gjyqësore. Me parashikimin në paragrafin 6 të këtij neni të detyrimit të gjykatës për të urdhëruar të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi rregullon problemet e konstatuar në zbatimin në praktikë të kësaj dispozite ku gjykatat mjaftoheshin duke vendosur në dispozitivin e vendimit vetëm vënien në shërbim prove të të dënuarit, po pa iu referuar detyrimeve të nenit 60 të këtij Kodi”. Ndërsa lidhur me nenin 65 të K. Penal, në raportin në fjalë është vlerësuar se: “Projektligji nisur nga disa raste të konstatuara në praktikë gjyqësore, parashikon që dhe të dënuarit me burgim të përjetshëm të kërkojnë lirim para kohe me kusht pasi të kenë vuajtur jo më pak se 35 vjet burg dhe gjatë kësaj periudhe të provës të kenë treguar sjellje shembullore duke përjashtuar nga ky rregull të dënuarit për veprat penale të vrasjes dhe të marrëdhënieve seksuale me të mitur. Rritja e kohës së vuajtjes së dënimit nga 25 vjet në 35 vjet për këtë kategori të dënuarish, bëhet duke u nisur nga konstatimet e praktikës gjyqësore, rrezikshmërinë e lartë që kanë këto vepra penale dhe autorët e tyre me vetë kuptimin e qëllimit të dënimit për të cilët, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me burgim të përjetshëm”.

Në Kodin e Procedurës Penale, në Kreun II janë parashikuar rregullat e shqyrtimit nga gjykata e çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve, ndër të cilat edhe për kërkesat “lirimin me kusht”. Për kërkesa të këtij lloji, në mënyrë të veçantë, në nenin 477 të K. Pr. Penale legjislatori ka parashikuar se: “1. Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirit me kusht, sipas kriterëve të caktuara në Kodin Penal. 2. Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë”.

Në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" në fuqi<sup>158</sup> në periudhën e kohës objekt të këtij inspektimi, neni 31/6 parashikon rregullim më konkret lidhur me mënyrën e të proceduarit nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës deri në dhënien e vendimit. Kështu referuar kësaj dispozite ishte parashikuar se:

*"I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.*

*Pas paraqitjes së kërkesës për lirimin me kusht, drejtori i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Në raport përcaktohet natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.*

*Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.*

*Kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit të dënuar, ia dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirimit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.*

*Personi i liruar me kusht duhet t'i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht.*

...

*Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht, ... "*

Lidhur me interpretimin e institutit të lirim me kusht, në drejtim të Jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, konstatohet se ka vetëm një vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara me nr. 2/2015. Në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar qëndrimin në drejtim të interpretimit të arsyeve të veçanta, në drejtim të përcaktimit të kohës së provës dhe detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal. Më konkretisht, Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar qëndrimin në

---

<sup>158</sup> Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 ka pësuar ndryshime me ligjin me nr. 100024, datë 27.11.2008 ku janë përfshirë parashikimet në nenin 31/6, më pas me ligjin me nr. 80, datë 15.11.2018 hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të fletores zyrtare me nr. 172, datë 05.12.2018, ku neni 31/6 ka ndryshuar në paragrafin 6 dhe janë shtuar në vazhdim dy paragrafë të tjerë të cilët nuk kanë prekur përmbajtjen e cituar më sipër lidhur me procedurën e gjykatës. Ligji me nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar, është shfuqizuar me ligjin nr. 79/2020 që është aktualisht në fuqi. Ligji me nr. 79/2020 ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare me nr. 136, datë 21.07.2020 që përkon me periudhën kohore jashtë periudhës së inspektimit.



drejtim të arsyeve të veçanta se: “Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit.”; në drejtim të kohës së provës se: “Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht”.

## 1. Respektimi i legjislacionit material dhe procedural

### 1.1. Lidhur me zbatimin e legjislacionit material:

Referuar parashikimit të nenit 64 të K. Penal, që një i dënuar me burgim të mund të përfitojë “lirimin me kusht”, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara shprehimisht në dispozitën në fjalë. Lidhur me këto kritere, ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë në një sërë vendimesh të saj<sup>159</sup>, ndërsa dy kriteret ai i vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit dhe të mos qënurit recidivist të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara<sup>160</sup>, janë objektivë (kriteri juridik), pasi bazohen mbi fakte të ndodhura dhe të provuara në aktet përkatëse të kohëshënuesit të dënimit dhe gjendjes gjyqësore; kriteri tjetër, ai i arsyeve të veçanta (kriteri subjektiv), të cilat tregojnë rehabilitimin e të dënuarit kërkon një interpretim dhe vlerësim rast pas rasti në bazë të provave që i paraqiten gjykatës.

Kjo natyrë e kritereve në fjalë, është vlerësuar për t’u mbajtur në konsideratë edhe në trajtimin e vendimeve gjyqësore objekte të këtij inspektimi, në drejtim të konkludimit lidhur me respektimin e legjislacionit material.

1.1.1. Në këtë këndvështrim, **përsa i përket kriterit subjektiv** në vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të rrëzimit/pranimit ku edhe është trajtuar, konstatohet se në përputhje me ligjin me nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, i ndryshuar dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, në vendime analizohen dhe konkludohet mbi këto kritere duke u mbështetur në provat e paraqitura nga kërkuesi, qëndrimi i prokurorit, raportet përkatëse të IEVP dhe Shërbimi i Provës. Ashtu siç është orientuar edhe nga vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në qëndrimin unifikues, konstatohet se në

<sup>159</sup> Përmendim: Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 10.01.2012, vendim nr. 72, datë 07.03.2012, vendim nr. 125, datë 02.05.2012, nr. 160, datë 08.06.2012, vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara me nr. 2/2015.

<sup>160</sup> Në këtë citim të Gjykatës së Lartë është shtuar vetëm pjesa e shtuar pas ndryshimeve të Kodit me ligjin nr. 143, datë 02.05.2013 lidhur me ndalimin e aplikimit të lirimit me kusht për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuar në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

vendimet gjyqësore objekt i këtij inspektimit, është marrë në konsideratë funksioni i secilit prej dy institucioneve në fjalë nëpërmjet analizës së raporteve të paraqitura prej tyre dhe konkludimit mbi krijimin e bindjes nëse i dënuari, me sjelljen dhe punën e tij është riedukuar dhe se është e mundur riintegrimi i të dënuarit në shoqëri. Dhe është mbi të njëjtat prova që nga ana e Gjykatës së Apelit, është vendosur në vazhdim lënie në fuqi apo ndryshim.

Nga të gjitha vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore, ku është vendosur rrëzim/pranim, referuar detyrimeve ligjore sipas ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", i ndryshuar dhe qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, vetëm në 1 rast është konstatuar mungesa e administrimit të raportit të shërbimit të provës. Bëhet fjalë për një vendim pranimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat<sup>161</sup> ku nga ana e gjyqtarit gjatë gjykimit nuk është kërkuar dhe as administruar raporti i shërbimit të provës, dhe as thirrur ky institucion si pjesëmarrës në gjykim. Gjithashtu në të njëjtin gjykim, megjithëse IEVP ishte thirrur si pjesëmarrës në gjykim dhe i ishte marrë mendimi mbi kërkesën, nuk ishte administruar në cilësinë e provës kartela e vuajtjes së dënimit. Vendimi në fjalë, mbi bazën e ankimit të prokurorit është bërë objekt kontrolli në Gjykatën e Apelit<sup>162</sup> e cila e ka konsideruar këtë si shkak, bazuar në nenin 428/ç të K. Pr. Penale për të prishur vendimin dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Gjykata e Apelit ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke e konsideruar vendimin gjyqësor të gjykatës së rrethit gjyqësor në moszbatim të ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, dhe e lidhur me pasojën e një hetimi të paplotë gjyqësor për të vlerësuar mbi bazueshmërinë e kërkesës së kërkuarit. Në vendimmarrjen e saj, Gjykata e Apelit i ka kushtuar rëndësi theksimit të detyrimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, edhe për zbatimin e orientimeve të vendimit unifikues të sipërcituar.

### 1.1.2. Përsa i përket kriterëve objektive, lidhur me:

**a. Vuajtjen e masës së kërkuar të dënimit,** konstatohet se ndeshen dy praktika në mënyrën sesi përllogaritet kjo periudhë, në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal "*- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni*" dhe në drejtim të shtrirjes së periudhës referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

**Në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës së sipërpërmendur,** një praktikë konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuari dhe praktika tjetër konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata. Praktika e parë është ndjekur nga pjesa më e madhe e gjyqtarëve referuar vendimmarrjeve pranimit/rrëzimit apo edhe deklarimit të papranueshmërisë. Kështu gjyqtarët e Gjykatave të

<sup>161</sup> vendimi nr. 75, datë 29.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

<sup>162</sup> vendimi nr. 387, datë 31.05.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Rretheve Gjyqësore<sup>163</sup> Vlorë, Korçë, Elbasan, Kavajë, Gjirokastrë, Shkodër, Lezhë dhe Tropojë, në të gjitha vendimmarrjet e tyre në periudhën objekt i këtij inspektimi, kanë ndjekur të njëjtën praktikë duke iu referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar. Ndërsa në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier, Durrës, Krujë, Mat, Tiranë rezultojnë ndjekja e dy praktikave, ku edhe këtu në pjesën më të madhe gjyqtarët e këtyre rretheve gjyqësore kanë ndjekur praktikën e parë.

Referuar gjyqtarëve në gjykatat e rretheve gjyqësore ku rezultojnë ndjekja e dy praktikave, evidentohet se për periudhën objekt inspektimi është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme praktika e parë: 6 gjyqtarë nga 7 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, 11 gjyqtarë nga 14 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2 gjyqtarë nga 5 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, 3 gjyqtarë nga 6 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, 5 gjyqtarë nga 7 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe 5 gjyqtarë nga 7 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Lidhur me praktikën e dytë, konstatohet se është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme vetëm nga 2 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është ndjekur, ndërsa në rrethet gjyqësore gjyqtarët të cilët kanë ndjekur praktikën në fjalë kanë ndjekur edhe praktikën e parë. Tek këta të fundit konstatohet se ndjekja e praktikës së dytë është më e paktë në numër vendimesh sesa ndjekja e praktikës së parë dhe kjo është vënë re gjatë gjithë periudhës objekt inspektimi.

Në ndjekjen e praktikave në fjalë, gjyqtarët kanë arsyetuar në vendimmarrjen e tyre dispozitën në fjalë, por duke e interpretuar ndryshe në mënyrën sesi ata e kuptojnë zbatimin e saj.

Gjithashtu evidentohet vetëm në një gjykatë, dhe pikërisht në atë të Krujës, ku i njëjti gjyqtar në vendimet e tij nuk i referohet interpretimit të asnjë prej praktikave sa më sipër. Nga vendimmarrjet e këtij gjyqtari, nuk ka një arsyetim në mënyrën sesi gjyqtari i referohet periudhës së vuajtjes së dënimit për efekt të periudhës minimum të parashikuar nga neni 64 i K. Penal, por nga ana e këtij gjyqtari referimi bëhet në përgjithësi<sup>164</sup> tek 2/3 e dënimit për përcaktimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit pavarësisht nga masa e dënimit me burgim që parashikonte dispozita apo e dhënë nga ana e gjykatës.

Ndjekja e dy praktikave të para, nga gjykatat e rretheve gjyqësore nuk është bërë objekt ankimi nga prokurorët e rretheve gjyqësore dhe nga vendimmarrjet e të gjithë gjykatave të apeleve nuk vihet re ndonjë qëndrim i qartë në këtë drejtim. Nga këto vendimmarrje, evidentohet se ka trupa gjykatash të cilët përdorin arsyetim të qartë lidhur me praktikën që ndiqet, duke u ndalur në mënyrë konkrete në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita, ndërsa ka trupa të tjerë të cilët nuk shprehen saktësisht lidhur me interpretimin që ndjekin, por që pranojnë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor që ka pranuar përlllogaritjen përkatëse në të dy praktikat.

<sup>163</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk ka trajtuar kërkesa me objekt "lirim me kusht".

<sup>164</sup> Vetëm tek një vendim evidentohet  $\frac{3}{4}$  por që sërish nuk ka një interpretim që do të vlerësonte ndjekjen e një praktike si edhe gjyqtarët e tjerë të gjykatave të rretheve gjyqësore të sipërpërmendura.

Referuar parashikimit të dispozitës në fjalë, sipas interpretimit gramatikor dhe logjik që mund të bëhen në rastin konkret, konstatohet se mund të gjejnë vend të dy praktikat si më sipër. Kjo është evidentuar edhe nga studimi i kryer nga magjistratë në vitin 2010<sup>165</sup>. Sipas këtij studimi, që vjen pas ndryshimeve të rëndësishme të ndodhura në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale<sup>166</sup> me anë të të cilit është krijuar për herë të parë Institucioni Shtetëror i Shërbimit të Provës, konstatohet se është vënë re se në grupin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë ndeshur dy grupe mendimesh që përkojnë me dy praktikat sa më sipër. Referuar këtij konstatimi, mendimi i përlllogaritjes së kohës së dënimit sipas masës së dënimit të dhënë, përkrahet nga një grup i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Lidhur me parashikimin e dispozitës në fjalë, në drejtimin e përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit objekt i këtij shqyrtimi, ka edhe një qëndrim nga një grup tjetër magjistratësh, në vitin 2020<sup>167</sup>. Ky grup magjistratësh kanë shprehur qëndrimin e tyre që përkon me praktikën e referimit në masën e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer<sup>168</sup>, ndërsa nuk është evidentuar praktika konkrete që është hasur nga vendimmarrjet të cilat janë shqyrtuar për efekt të analizës.

Aktualisht nga vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë<sup>169</sup> evidentohet 1 rast kur interpretimi i nenit 64 në drejtimin në fjalë, është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qartë praktikën që duhet të ndiqet sipas vendimit të trupës gjyqësore. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegësh dhe i përket shqyrtimit të kërkesës së një të dënuari për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike” të parashikuar nga neni 283/a/1 i K. Penal i dënuar me 4 vjet burgim, për të cilën si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Apeli Tiranë në përlllogaritjen e vuajtjes së dënimit kanë mbajtur praktikën e parë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita përkatëse për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi. Ndërsa nga ana e Gjykatës së Lartë është vlerësuar se referimi sipas praktikës së parë, nuk është interpretim i saktë i nenit 64 të K. Penal, por interpretimi sipas praktikës së dytë. Kolegji penal ka mbështetur këtë arsyetim në interpretimin ndryshe të dispozitës.

Një interpretim i tillë i kolegjit penal, referuar të dhënave të administruara për efekt të këtij inspektimi, përkon me praktikën e ndjekur nga një numër i vogël magjistratësh dhe pavarësisht se nuk është e karakterit unifikues që të mund të jetë e detyrueshme për të gjitha rastet sipas

<sup>165</sup> [untitled \(osce.org\)](#) Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim- 2008

<sup>166</sup> ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar,

<sup>167</sup> Manual mbi dënimet alternative në Republikën e Shqipërisë - 2020

<sup>168</sup> Në manualin në fjalë, grupi i autorëve është shprehur se: “... duhet të dallohet se për efektet e përcaktimit të periudhës minimale të përgjithshme apo teorike të vuajtjes së dënimit me burgim, nuk do të merret masa e dënimit me burgim e dhënë nga gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit. Përkundrazi, për këtë kriter të zbatimit të premisë fillestare të hipotezës së normës (praemisa majore), do të merret marzhi maksimal i parashikuar apriori në ligj për veprën e kryer. Pasi konkludohet se kemi të bëjmë me kundravajtje penale, sikurse ka kualifikuar gjykata veprën në vendimin përfundimtar, atëherë mbi këtë dënim të individualizuar do të zbatohet periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim (praemisa minor). ...”.

<sup>169</sup> vendimin e saj nr. 00-2022-1817, date 3.11.2022

parashikimit të nenit 438/4 të K. Penal, do të ketë impaktin e saj tek magjistratët e praktikës tjetër. Ky vendim si vendim i kolegjit të Gjykatës së Lartë do të vlerësohet nga magjistratët si një burim i së drejtës në drejtim të interpretimit të dispozitës në fjalë, për atë kohë sa për zgjidhjen e këtyre çështjeve, ligji është i paqartë si dhe mungojnë vendimet njësuere nga Kolegjet e Gjykatës të Lartë.

### **Lidhur me parashikimet e nenit 65 të K. Penal, për të dënuarin me burgim të përjetshëm**

Nga vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore për periudhën objekt i këtij inspektimi janë evidentuar katër raste kur kërkuesi ka qenë i dënuar me burgim të përjetshëm, për të cilën për përcaktimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit janë zbatuar parashikimet e nenit 65 të K. Penal. Zbatimi i parashikimeve të kësaj dispozite është bërë nga gjyqtarët në dy raste, duke iu referuar parashikimit të kësaj dispozite para ndryshimeve në ligjin me nr. 36/2017 ku masa e dënimit që kërkohet të kishte vuajtur kërkuesi për të përfituar lirim me kusht ishte 25 vjet burgim. Dhe në dy rastet e tjera, gjykata ka konkluduar se kërkuesi duhet të kishte vuajtur 35 vjet burgim.

Në të katër rastet, kërkuesi ka kërkuar përfitimin nga lirimi me kusht lidhur me vuajtjen e dënimit të dhënë para ndryshimeve të dispozitës në fjalë dhe për dy rastet<sup>170</sup> gjyqtarët e gjykatave të rretheve gjyqësore kanë zbatuar ligjin e kohës kur është kryer vepra penale duke interpretuar parimin e ligjit penal favorizues të parashikuar nga neni 3/3 i K. Penal.

Për 1 nga këto raste çështja mbi bazë ankimi prokurori është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Korçë e cila nuk ka qenë dakort me këtë qëndrim të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe duke proceduar me ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës. Çështja në vazhdim është dërguar në Gjykatën e Lartë mbi bazën e rekursit të kërkuesit, ku në përfundim kolegjii i Gjykatës së Lartë<sup>171</sup> ka pranuar si të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit lidhur me interpretimin e ligjit të zbatueshëm, duke konkluduar se gjykata do të duhet të zbatojë ligjin që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke zbatuar kushtet dhe kriteret që kërkon dispozita penale konkrete dhe duke e konsideruar jashtë logjikës juridike që për lirimin me kusht të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, pasi instituti i lirimit me kusht nuk ka lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale.

Lidhur me rastin tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ku është disponuar me pranimin e kërkesës, dhe ku për kohën e dënimit të vuajtur është referuar tek neni 65 i K. Penal para ndryshimeve që parashikonte 25 vjet burgim për përfitimin e lirimit me kusht, çështja mbi bazë ankimi prokurori është dërguar në Gjykatën e Apelit dhe nuk ka përfunduar ende shqyrtimi. Por referuar interpretimit të kolegjit të Gjykatës së Lartë të sipërcituar, edhe për rastin në fjalë për kërkesën e të dënuarit me burgim të përjetshëm vuajtja e dënimit do të duhej të përllogaritej për 35 vjet, si zbatimi i duhur referuar shqyrtimit të kërkesave të tilla që përfshijnë fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

<sup>170</sup> vendimi nr. 6/123 regjistri themeltar, datë 14.01.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.  
vendimi me nr. 41-2019-642, datë 14.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

<sup>171</sup> Vendimi nr.00-2022-629 (63), datë 14.06.2022, i Gjykatës së Lartë.

Referuar rasteve në fjalë, ku evidentohet zbatim i gabuar i ligjit penal material lidhur me nenin 65 të K. Penal, për 1 prej tyre për të cilën është disponuar edhe nga Gjykata e Lartë, është proceduar nga ILD ndaj magjistratit gjyqtar para përfundimit të këtij inspektimi dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është vendosur shkarkimi i këtij magjistrati. Vendimi është bërë përfundimtar pas vendimit të KPA<sup>172</sup> që ka shqyrtuar ankimin e magjistratit ndaj vendimit për masën disiplinore. **Ndërsa për rastin tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, nga ana e ILD është proceduar duke filluar hetimin disiplinor sipas vendimit nr. 705/1 prot., datë 22.05.2020 për shkelje të rënda profesionale parashikuar në nenin 140/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe më pas për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit<sup>173</sup>, me vendimin nr. 1870/14 prot., datë 13.02.2023 të ILD është disponuar me vendim për përfundimin e hetimit disiplinor.**

**b. Momenti kohor që do të merret në konsideratë referuar kohës së paraqitjes së kërkesës**

Gjithashtu një çështje e rëndësishme e evidentuar gjatë trajtimit të vendimmarrjeve objekt i këtij inspektimi, lidhur me përllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit të detyrueshëm për të patur të drejtë përfitimi të lirimit me kusht, **është edhe momenti kohor që do të merret në konsideratë referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.**

Përsa i përket këtij drejtimi, konstatohet se janë ndeshur dy qëndrime. Njëri sipas të cilës përllogaritja e kohës së vuajtjes së dënimit duhet të përfshijë vetëm periudhën kohore deri në datën e paraqitjes së kërkesës dhe tjetra se në këtë përllogaritje përfshihet jo vetëm periudha deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudha në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Përkrahësit e qëndrimit të parë, në vendimmarrjet e tyre arsyetojnë duke u nisur nga interpretimi i ngushtë i dispozitës, sipas të cilit të dënuarit i lind e drejta për të paraqitur kërkesë për librim me kusht, nëse më parë ka përmbushur periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, ndërsa përkrahësit e qëndrimit të dytë arsyetojnë duke u nisur nga një interpretim më i zgjeruar në funksion të qëllimit të këtij instituti sipas të cilit përmbushja e këtij kushti do të konsiderohet i përmbushur në kohën e shqyrtimit të kërkesës të të dënuarit nga gjykata, dhe jo në kohën e përpilimit të kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, konstatohet se në pjesën më të madhe nga gjyqtarët mbahet qëndrimi i dytë. Qëndrimi i parë, konstatohet se është mbajtur: nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nga 2 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në disa vendime dhe të cilët më pas kanë kaluar në ndjekjen e qëndrimit të dytë, nga 2 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>172</sup> vendimi nr. 3, datë 07.12.2022, juridiksion disiplinor.

<sup>173</sup> vendimi nr. 2, datë 31.05.2022, i KPA, juridiksion disiplinor me anë të të cilës është vendosur mospranim i ankimit të magjistratit ndaj vendimit të KLGJ për caktimin e masës disiplinore shkarkim nga detyra, në një procedim tjetër disiplinor të iniciuar nga ILD.

Ndërsa qëndrimi i dytë, konstatohet se është mbajtur nga të gjithë gjyqtarët e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elbasan, Krujë, Gjirokastrë, Lezhë, Tropojë, Shkodër.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet e prokurorëve ndaj vendimeve të pranimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt “lirim me kusht”, ku ndër të tjera nga ana e prokurorëve është pretenduar për mospërbushje të kushtit të plotësimit të kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. Raste të tilla, janë vënë re kryesisht në Gjykatën e Apelit Korçë ku të gjithë prokurorët që kanë përfaqësuar prokurorinë në kërkesa me objekt “lirim me kusht”, kanë mbështetur ankimin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Korçë për përllogaritjen e kohës minimum deri në datën e paraqitjes së kërkesës. Dhe po kështu edhe në 1 rast në Gjykatën e Apelit Durrës, ku prej prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ushtruar ankim pikërisht lidhur me këtë kriter objektiv. Në Gjykatën e Apelit Vlorë, është vënë re në rastet e ankimeve të tre prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të cilët janë shprehur gjithmonë në qëndrimet e tyre para gjykatës për përllogaritje të masës së dënimit të vuajtur deri në datën e paraqitjes së kërkesës. Për këto raste, ashtu si edhe në rastet e Gjykatës të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të Apelit Korçë, këto qëndrime të këtyre prokurorëve nuk janë pranuar.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimin e kërkuesit ndaj vendimeve të rrëzimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt “lirim me kusht, ku shkak i rrëzimit ka qenë pikërisht mospërbushja e kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, janë evidentuar në tre raste qëndrimi, një i Gjykatës së Apelit Durrës<sup>174</sup> dhe dy të Gjykatës së Apelit Korçë<sup>175</sup> mbi konkludimin prej saj të përbushjes së këtij kriteri me vazhdimin e gjykimit.

Gjithashtu është për t’u evidentuar se edhe në vendimmarrjet e Gjykatës së Apelit, edhe kur nuk ka patur ankim lidhur me kushtin në fjalë, nga ana e trupave gjyqësore është arsyetuar duke u mbështetur në mënyrën e të proceduarit të përditësuar lidhur me përllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit.

Lidhur me parashikimin e dispozitës në fjalë, në drejtimin e përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit objekt i këtij shqyrtimi, ka edhe një qëndrim nga një grup tjetër magistratësh, në një studim të bërë në vitin 2020<sup>176</sup>. Ky grup magistratësh kanë shprehur qëndrimin e tyre që përkon me përllogaritjen e përditësuar të vuajtjes së dënimit me burgim. Lidhur me këtë qëndrim, autorët arsyetojnë se “... megjithëse është korrekt me shkronjën e ligjit, nuk i shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë ratio-s së institutit, as gjykatës, as të dënuarit dhe aq më pak shoqërisë. Ndaj vlerësojmë se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që –

<sup>174</sup> vendimi nr. 10-2018-2099, datë 14.11.2018.

<sup>175</sup> vendimi nr. 38, datë 02.05.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimi nr. 107, datë 25.10.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë.

<sup>176</sup> Manual mbi dënimet alternative në Republikën e Shqipërisë – 2020.

në rast se në momentin e shqyrtimit vlerëson se afati është plotësuar – të vendosë pranimin e saj për shqyrtim në zgjidhjen në themel të kërkesës. ... sakaq konstatohet se kjo mënyrë formaliste interpretimi detyron vuajtjen e dënimit me burgim edhe me gjashtë muaj për një të dënuar që potencialisht nuk duhet të vuajë më dënim me burgim. Rezultati i këtij interpretimi është padyshim antikushtetues dhe i paligjshëm”.

Aktualisht nga vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë evidentohet 1 rast kur interpretimi i nenit 64 të K. Penal në drejtimin në fjalë, është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qëndrimin e saj. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegjes<sup>177</sup> dhe jo unifikues, ku është arsyetuar se shprehja “personi lirohet me kusht”, do të thotë se, kërkesa pranohet dhe personi lirohet pasi të zhvillohet një hetim gjyqësor dhe të shpallet vendimi dhe jo në momentin që paraqitet kërkesa. Gjykata ka arsyetuar edhe më tej se ky kusht i plotësimit të afateve të kërkuara për vuajtjen e dënimit nuk është ngushtësisht e karakterit formal në momentin që paraqitet kërkesa, por se gjykata deri në momentin që personi është në gjykim pranë saj, do të duhet të vlerësojë sjelljen e kërkuarit deri në shpalljen e vendimit ndaj të cilit nuk duhet të jetë indiferente.

Ndërkohë që rezulton se në vendime të mëparshëm të kolegjeve<sup>178</sup>, Gjykata e Lartë argumenton plotësimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit duke e lidhur përlllogaritjen me momentin e depozitimit të kërkesës. Kështu në vendimin nr. 00-2017-576 (108), datë 05.07.2017 kolegji shprehet se: “Plotësimi i kalimit të periudhës përkatëse të vuajtjes së dënimit me burgim, është një element ligjor që duhet të verifikohet nga ana e gjykatës në çastin e paraqitjes së kërkesës”, dhe në nr. 00-2021-1066, i vendimit (125) datë 07.12.2021, kolegji argumenton se: “Në lidhje me vendimin e rekursuar, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Durrës ka disponuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material. Neni 64 i Kodit Penal parashikon se të dënuarit i lind e drejta për të kërkuar lirim me kusht, kur plotëson apo ka vuajtur më shumë se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të caktuar ndaj tij. Në rastin konkret, rezulton se në datë 20.06.2016, kur është paraqitur kërkesa e të dënuarit për “lirim me kusht”, nuk ishte plotësuar një nga kushtet ligjore të parashikuara në këtë dispozitë – vuajtja e  $\frac{3}{4}$  të dënimit të dhënë ndaj tij, me 25 vjet burgim. ... Në rrethanat e sipërcituara, Kolegji çmon se në rastin konkret nuk plotësohet kushti i përcaktuar në nenin 64 të Kodit Penal – vuajtja e jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë, kusht ky që duhet të jetë plotësuar në momentin e depozitimit të kërkesës,

<sup>177</sup> nr. regjistri 87000-01328-00-2017 dhe nr. vendimi 00-2023-66, datë 13.01.2023, me trup gjykues (Medi Bici kryesues, Sokol Binaj dhe Sandër Simoni anëtarë).

<sup>178</sup> nr. 00-2017-576 (108), datë 05.07.2017, me trup gjykues Edmons Islamaj, Guxim Zenelaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Tom Ndreca dhe me nr. 00-2021-1066 i vendimit (125) datë 07.12.2021, me trup gjykues Ilir Panda, Albana Boksi, Klodian Kurushi, që ka trajtuar rekursin e prokurorit ndaj një vendimi të Gjykatës së Apelit që është jashtë periudhës objekt i këtij inspektimi. Vendimi në fjalë është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese mbi bazën e kërkesës së të dënuarit, e cila në vendimin e saj me nr. 63, datë 27.05.2022 është shprehur se: “Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në asnjë moment nuk ka bërë rivlerësim të faktit ose vlerësim të provave të marra në shqyrtim në gjykatat më të ulëta. Ai kolegji, pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes ka arritur në përfundimin se ndodhet në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe me këtë arsye ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor”.



*dhe jo gjatë gjykimit në apel ku objekt shqyrtimi është ligjshmëria e vendimit të gjykatës së shkallës së parë”.*

Grupet e magistratëve, gjyqtarë dhe prokurorë, përkrahës të dy qëndrimeve, siç evidentohen në aktet procedurale përkatëse, mbështeten në arsyetimet e tyre në argumente ligjorë si në drejtim të interpretimit literal të dispozitës, ashtu edhe në drejtim të qëllimit të vetë institutit. Këto qëndrime, janë bërë objekt diskutimi si në drejtim të shqyrtimit procedural ashtu edhe studimor, dhe aktualisht duke iu referuar edhe numrit të vendimeve, evidentohet se qëndrimi mbizotërues është ai i përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal, deri në momentin e shpalljes së vendimit, pas shqyrtimit në themel të kërkesës “lirim me kusht”. Një qëndrim i tillë megjithëse logjik dhe në funksion të qëllimit të institutit të lirimit me kusht, mbart me vete kujdesin e shtuar që duhet të kenë magistratët gjyqtarë që gjykojnë këto çështje për të shmangur zvarritjet e paarsyeshme të procesit, të cilat mund të bëhen “të qëllimshme” për të arritur gjatë procesit limitin kohor të përmbushjes së afatit minimum dhe të detyrueshëm të kohës së përfitimit të vuajtjes së dënimit nga i dënuari që kërkon lirimin me kusht. Nga vendimet gjyqësore të trajtuara nuk u evidentuan zgjatje të procesit, të tilla që të mund të përmbushnin të gjitha kriteret ligjore të parashikuar në nenin 124 të ligjit me nr. 96/2016 të ndryshuar, për t’u proceduar më tej me fillimin e një hetimi disiplinor.

Lidhur me qëndrimet sa më sipër, në konsideratat që edhe midis vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë ka qëndrim të ndryshëm, vlerësohet si e rëndësishme autoriteti i Gjykatës së Lartë për unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme.

### **c. Përfitimet që përfshihen në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit**

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që është trajtuar në vendimmarrjet objekt i këtij inspektimi është edhe shqyrtimi se çfarë është përfshirë në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit.

Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit, në praktikën e shqyrtimit të kërkesës me objekt “lirim me kusht”, është evidentuar në përgjithësi përfshirja e kohës së përfituar me paraburgim, kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor dhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP. Por kjo praktikë nuk rezulton të jetë e njëjtë në të gjitha gjykatat kryesisht në drejtim të përfshirjes së kohës së punës.

Kështu në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Vlorë, Fier, Berat, Elbasan, Kavajë, Durrës, Tiranë, Mat, Krujë, Gjirokastrë, Tropojë, Shkodër<sup>179</sup>, nga të gjithë gjyqtarët është përfshirë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP. Në përgjithësi qëndrimi në fjalë i gjyqtarëve nuk është kontestuar as nga prokurorët e seancës në gjykatat e rretheve gjyqësore në fjalë dhe as në gjykatat e apeleve që përfshijnë në kompetencën e tyre shqyrtimin e gjykatave të rretheve

<sup>179</sup> Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka patur raste kur i dënuari të ketë kryer punë dhe për këtë arsye nuk ka patur vlerësim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk ka patur raste të trajtimit të kërkesave “lirim me kusht”.

gjyqësore të sipërpërmendura. Edhe kjo e fundit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe gjykata e rretheve gjyqësore në ato raste kur ka shqyrtuar përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit.

Veçanarisht referuar vendimmarrjeve të rretheve gjyqësore të sipërpërmendur, 2 nga 4 prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët kanë përfaqësuar prokurorinë në 4 gjykimet me objekt "lirim me kusht" ku kërkuesi ka patur kohë pune, kanë mbajtur qëndrimin se kjo kohë nuk duhet të përfshihet në përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit nga instituti i lirit me kusht. Prokurorët në këto raste kanë mbështetur qëndrimin e tyre në argumentimin e mosekzistencës së ndonjë akti ligjor apo nënligjor në fuqi që të njohë ditët e punës të kryera nga të dënuarit në burgje, si ditë vuajtje dënimi dhe njohjen e tyre si ditë burgimi, duke trajtuar konkretisht se ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", si dhe ligji nr. 40/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998", "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, nuk kanë parashikuar punën si një veprim detyrues për të dënuarin, si dhe nuk kanë parashikuar njohjen e punës si ditë vuajtje dënimi apo konvertimin e punës së kryer në burg për efekt të shlyerjes së dënimit. Gjithashtu në vijim të argumenteve të tyre, prokurorët shprehen edhe për faktin se edhe në rregulloren e përgjithshme të burgjeve nuk ka një rregullim për marrëdhënien e punës, ndërsa janë parashikuar përfitime si përfitimin e lejes shpërblyese dhe se në këtë kontekst kryerja e punës do t'i shërbejë të dënuarit me qëllimin plotësimin e kriterëve për lirim me kusht. Dhe një nga prokurorët në argumentet e tij ka përmendur edhe urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm referuar një shkresë të vitit 2004, sipas të cilit ditët e punës nuk do të njiheshin për efekt të uljes së dënimit. Ky qëndrim i prokurorëve nuk është pranuar nga gjykata të paktën për 1 rast ku qëndrimi i saj është shprehur qartë, ndërsa në rastin tjetër gjykata nuk ka arsyetuar konkretisht lidhur me këtë kohë pune duke qenë se ka patur arsytim në drejtim të kriterëve të tjera për të cilat ka qenë e mjaftueshme konkludimi lidhur me kërkesën. Kështu për 1 nga rastet<sup>180</sup> gjykata në arsyetimin e saj për përfshirjen e kohës së punës, i është referuar Dekretit nr. 7298, datë 08.04.1989 "Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën", duke arsyetuar për këtë dekret se "është në fuqi dhe nuk është shfuqizuar me ndonjë akt të mëvonshëm ligjor. Sipas këtij dekreti, i dënuari përfiton ulje dënimi me 3,9 ditë pune për çdo muaj për punën e kryer. Gjykata çmon se përse kohë ligjvënësi nuk ka ndërmarrë ndonjë nismë për shfuqizimin e këtij dekreti, apo për ndryshimin e tij në përputhje me ndryshimin e rrethanave sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe ligjore, si dhe përse kohë puna që ka kryer i dënuari nuk është shpërblyer në para, duke patur parasysh se askush nuk mund të detyrohet të punojë pa shpërblyer, gjykata vlerëson se koha e dënimit e zbritur në bazë të këtij dekreti, duhet të llogaritet në afatin e dënimit me burgim të vuajtur. Gjykata vlerëson, se në total kërkuesi ka vuajtur 15 vjet, 10 muaj e 26 ditë.

<sup>180</sup> vendimi nr. 181 Akti, datë 07.11.2018. Me anë të këtij vendimi gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shkak të arsyeve të veçanta. Ndaj vendimit ka patur ankim nga kërkuesi, por Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak se ankimi kishte mbetur pa objekt, kërkuesi e kishte vuajtur dënimin dhe ishte liruar.

*Pra, kërkuesi ka vuajtur jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për veprën penale të kryer”.*

Vendimet gjyqësore në fjalë, ku qëndrimi i prokurorit ka qenë për mospërfshirjen e kohës së punës në kohën e përlllogaritjes së masës së dënimit që kërkohet për plotësim të kushteve të nenit 64 të K. Penal, konstatohet se nuk janë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit në drejtim të këtij kriteri dhe si të tilla nuk kemi një vlerësim për këto raste.

Në kërkesat e trajtuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë konstatohet se praktika ka qenë e konsoliduar duke u pranuar si nga prokuroria dhe gjykata, si periudha të përfshira në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, atë të paraburgim dhe të kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor. Ndërsa qëndrime të ndryshme ka patur jo vetëm midis gjykatës, por edhe midis gjykatës dhe prokurorisë lidhur me përfshirjen në periudhën në fjalë, të kohës së punës në IEVP.

Konstatohet se nga 3 gjyqtarë të cilët kanë trajtuar 4 kërkesa për lirim me kusht, ku në dinamikën e vuajtjes së dënimit janë përfshirë edhe kohë pune në IEVP, vetëm 1 gjyqtar në 1 vendim<sup>181</sup> ka mbajtur qëndrimin për mosllogaritje të kohës së punës si përfitim në masën e dënimit të vuajtur. Përsa i përket prokurorëve, konstatohet se të gjithë kanë patur të njëjtin qëndrim për mospërfshirje si përfitim të kohës së punës së kërkuesit në IEVP. I njëjti qëndrim është përkrahur edhe nga prokurorët e apelit gjatë përfaqësimit të çështjes në Gjykatën e Apelit, ku kanë mbështetur argumentet e prokurorëve të rrethit gjyqësor. Por ky qëndrim nuk është pranuar nga asnjë prej trupave gjyqësorë që kanë gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë, edhe në rastin e shqyrtimit të vendimit të gjyqtarit i cili ka mbajtur qëndrimin e mospërfshirjes së kohës së punës<sup>182</sup>.

Si gjyqtari dhe prokurorët të cilët kanë patur qëndrimin e mospërfshirjes si përfitim të kohës së punës së kërkuesit në IEVP, janë mbështetur në argumentin se puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuar me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, bazuar në analizën e legjislacionit në fuqi, ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, i cili rregullon aktualisht të gjithë të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve duke shfuqizuar të gjitha aktet e mëparshme ligjore e nënligjore si Dekret i Presidiumit Popullor të vitit 1972 ku bazohej edhe qëndrimi i përfshirjes së kohës së punës sipas IEVP.

Gjyqtarët të cilët kanë patur qëndrimin e përfshirjes si përfitim të kohës së punës të kërkuesit në IEVP, janë mbështetur në argumentin se pas shfuqizimit të Dekretit të Presidentit të Kuvendit Popullor të RPSH me nr. 5011, datë 09.12.1972, ka dalë Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme datë 28.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje

<sup>181</sup> vendimi 41-2017-974 (4/607), datë 01.03.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

<sup>182</sup> vendim nr. 61, datë 01.06.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë me anë të të cilit është vendosur ndryshimi i vendimit të rrëzimit dhe pranimit i kërkesës për “lirim me kusht”, duke argumentuar plotësimin e kohës së vuajtjes së dënimit prej ¾ duke përfshirë përlllogaritjen e kohës së punës.

të lirisë që aktivizohen në punë kur plotësojnë e tejkalojnë normën” që rezulton në fuqi dhe i pashfuqizuar nga aktet e pretenduar në ankim nga prokurori. Gjykata ka shtuar në argumentet e saj, edhe arsyetimin se kjo mënyrë e përfitimit në ditë vuajtje dënimi është edhe një mënyrë më shumë, për të përmbushur qëllimin e dënimit si një raport i drejtë midis vuajtjes së tij nga njëra anë dhe mundësisë rehabilituese dhe riintegruese të dënuarit në shoqëri, nga ana tjetër.

Diskutimi lidhur me përfshirjen e kohës së punës, është bërë objekt trajtimi nga Gjykata e Lartë, mbi bazën e rekursit të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Gjykata e Lartë rezulton të jetë shprehur deri më tani<sup>183</sup> për dy raste<sup>184</sup>, duke e konsideruar të drejtë qëndrimin e prokurorit për mospërfshirje të kohës së punës. Kolegjet kanë konkluduar se ditët e punës nuk mund të llogariten në kohën e vuajtjes së dënimit për efekt të plotësimit të kushteve formale paraprake për të paraqitur kërkesën për lirimin me kusht dhe se kjo praktikë është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Për këtë konkludim, kolegjet janë mbështetur në argumentin si edhe më sipër se, bazuar në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në nenin 34, puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Lidhur me këto të fundit, nga ana e Gjykatës janë përmendur dy VKM me nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” ku është parashikuar se për të burgosurit e dënuar do të zbatohen të njëjtat akte ligjore dhe nënligjore që shërbejnë ndër të tjera edhe për rregullimin e kohëzgjatjes dhe marrëdhënieve të punës, dhe VKM nr. 396, datë 27.07.2000 “Për njohjen e periudhës së sigurimit për efekt pensioni dhe aksidenti në punë të të dënuarve me burgim” ku është parashikuar niveli i pagës mbi të cilën do të sigurohet i dënuari. Gjithashtu për arritjen e konkluzionit sa më sipër, Gjykata e Lartë është mbështetur edhe në Progres Raportin për Shqipërinë për vitin 2015 si dhe tek “Raporti mbi situatën e të drejtave të njeriut, të personave të privuar nga liria në komisariatet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, për periudhën Korrik 2015-Janar 2016” i Komiteti Shqiptar të Helsinkit (K.SH.H), si edhe në vendimit nr.100, datë 05.04.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku është konkluduar se personat që vuajnë dënimin në burgje apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar pranë këtyre institucioneve, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e punonjësve që punojnë dhe ndodhen jashtë këtyre institucioneve; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar sipas parashikimeve ligjore respektive.

Nga leximi i vendimit nr. 100, datë 05.04.2018 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>185</sup>, i referuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, konstatohet se është arsyetuar ndër

---

<sup>183</sup> Referuar datës së përpilimit të këtij raporti.

<sup>184</sup> vendimi nr. (00-2022- 1648) 340, datë 16.12.2022, me përbërës të trupës së kolegjit (Sandër Simoni kryesues dhe anëtarë Medi Bici dhe Sokol Binaj) dhe nr. 00-2023-66, datë 13.01.2023, me përbërës të trupës së kolegjit (Medi Bici kryesues dhe anëtarë Sokol Binaj dhe Sandër Simoni).

<sup>185</sup> <https://kmd.al/ep-content/uploads/2019/02/Vendim-nr.-100-date-5.04.2018-ex-officio-kunder-DPB.pdf>



të tjera në mbështetje të konkluzionit të arritur mbi diskriminimin e të dënuarve në drejtim të punësimit, edhe mbi një urdhërim të Prokurorit të Përgjithshëm i njëjti i përdorur në arsyetim edhe nga prokurori në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i sipërpërmendur. Lidhur me këtë nga Komisioneri argumentohet se: “Komisioneri konstaton se, për punën e kryer në burgje janë krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore lidhur me përfitim nga puna. Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërblehen sipas vendimit nr. 228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave... Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që punojnë punë të ndryshme në burgje përfitojnë ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr. 7289, datë 08.04.1989... referuar shkresës me nr. 3233 prot., datë 08.10.2004 të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, theksohet se, në kuadrin ligjor në fuqi nuk ka asnjë rregullim të veçantë sipas të cilit të lejohet konvertimi i ditëve të punës së kryer në burg për efekt të shlyerjes së dënimit. Edhe Dekreti nr. 7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, konsiderohet i shfuqizuar. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, me anë të kësaj shkrese urdhëroi prokurorët që marrin pjesë në gjykimin e çështjeve me objekt njohjen e ditëve të punës për efekt të uljes së dënimit të kërkojnë rrëzimin e kërkesës së të dënuarve si të pabazuar në ligj. Gjithashtu, urdhëroi që prokurorët që ndjekin ekzekutimin e vendimeve penale të ushtrojnë kontroll për evidentimin e rasteve të ngjashme dhe të urdhërojnë korigjimin e evidencave të administratës të burgjeve respektive për këtë praktikë të gabuar të njohjes së ditëve të punës për efekt të shlyerjes së dënimit. Në këtë këndvështrim, për sa më sipër, Komisioneri vëren se personat e dënuar që kryejnë punë të ndryshme në burg, nuk trajtohen njëjloj dhe janë të diskriminuar në raport me shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut. Po ashtu, edhe vetë IEVP-të nuk operojnë në të njëjtën mënyrë, ndonëse parashikimet ligjore janë të njëjta për të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Republikën e Shqipërisë. Pra, nuk kemi një praktikë të unifikuar dhe nga vetë këto institucione”.

Nga shkresa me nr. 3232 prot., datë 08.10.2003 e Prokurorit të Përgjithshëm, konstatohet se ajo i është dërguar Prokurorive të disa Rretheve Gjyqësore Tiranë, Elbasan, Krujë, Lezhë, Tepelenë dhe Burrel, nisur nga disa problematika që janë hasur nga kontrolli e verifikimi i disa vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Elbasan me objekt “njohjen e ditëve të punës në masën e dënimit”, në drejtim të paligjshmërisë së tyre, pasi kanë ulur në mënyrë të padrejtë dënimin e të gjykuarve që vuajnë dënimin. Në këtë shkresë është argumentuar kjo paligjshmëri ndër të tjera mbështetur në arsyetimin se “në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat e trajtimit të të dënuarve me burgim” nuk bëhet fjalë për konvertimin e punës së kryer në burg për efekt të shlyerjes së dënimit. Nisur nga ky fakt si dhe nga fakti tjetër se edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 63, datë 09.03.2000, në të cilën nuk rezulton asnjë rregullim i veçantë për këtë lloj marrëdhënie, bëhet evident fakti se dekreti nr. 7298, datë 08.04.1999 është shfuqizuar”, dhe në vazhdim në këtë shkresë është formuluar urdhërimi: “1. Prokurorët që do të marrin pjesë në gjykimin e çështjeve me objekt njohjen e ditëve të punës për efekt të uljes së dënimit, të kërkojnë rrëzimin e kërkesës së të dënuarve si të pabazuar në ligj...”

Përveç diskutimit lidhur me përfshirjen e kohës së punës, konstatohet se janë evidentuar në dy raste **çështje të përfshirjes së uljes së dënimit në zbatim të ligjit për trajtimin e të dënuarve**. Në një rast rezulton se pretendimi është ngritur nga prokurori në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në një rast tjetër në Gjykatën e Apelit. Lidhur me këto dy raste, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin e përfshirjes së uljes së dënimit në përllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur që kërkohet për të përfutuar mundësinë e lirit me kusht, si një përfitim që nuk përjashtohet nga ligji penal. Një nga këto raste, mbi rekursin e prokurorit është bërë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata e Lartë<sup>186</sup>, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe gjykatat si më sipër, duke argumentuar se *“Në zbatim të nenit 64 të Kodit Penal, Kolegji evidenton se ligji në lidhje me masën e dënimit të vuajtur parashikon vetëm se, nuk përfshihet koha e përfutuar nga i dënuari me amnisti apo me falje. Në rastin konkret, i dënuari rezulton se ka përfutuar ulje dënimi në zbatim të ligjit për trajtimin e të dënuarve, përfitim ky që nuk përjashtohet nga ligji penal (neni 64 i cituar më lart)”*.

Lidhur me qëndrimet sa më sipër, mbi atë se çfarë do të përfshihet në kohën minimum të përllogaritjes së vuajtjes së dënimit, nga studimi i magjistratëve në vitin 2010, ata janë shprehur se *“Në lidhje me këtë moment janë shfaqur dy shkolla mendimi. Përkrahësit e shkollës së parë të mendimit përkrahin idenë se qëllimi i vetë ligjvënësit në parashikimin e kësaj dispozite ka qenë referuar termi “kohë efektive e vuajtur e dënimit”. Si rrjedhim i kësaj, këta përkrahës janë të mendimit se pavarësisht formulimit ligjor, përllogaritja e kohës së dënimit duhet bërë referuar vetëm kohës efektive të vuajtur nga shtetasi duke përjashtuar çdo lloj ulje apo përfitimi tjetër. Përkrahësit e shkollës së dytë të mendimit i referohen në mënyrë strikte formulimit ligjor të dispozitës si dhe interpretimit literal të saj. Sipas këtyre përkrahësve nuk do të llogaritet në dënimin e vuajtur vetëm koha e përfutuar nga i dënuari me amnisti nga Kuvendi ose me falje me Dekret të Presidentit të Republikës. Të gjitha uljet e tjera që i dënuari i përfiton për shkak të ligjit, si llogaritja e paraburgimit (me 1.5 ditë), ose përfitimi i disa ditëve në varësi të kohës së punës dhe volumit të punës së kryer nga i dënuari në institucion apo uljet që përfitojnë të dënuarit me vendim gjykate të cilat nuk mund të jenë më shumë se 90 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe jo më shumë se 45 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së lartë, llogariten në kriterin ligjor të kërkuar për një të dënuar i cili kërkon lirin me kusht. Po kështu, sipas këtyre përkrahësve edhe pse formulimi i kësaj pjese të dispozitës mund të kishte një mospërputhje me vetë interpretimin logjik të përmbajtjes së dispozitës, pikërisht kjo ka qenë fryma dhe qëllimi i ligjvënësit. Kjo pasi ligjvënësi i kishte patur të gjitha mundësitë që në ndryshimet e fundit që i janë bërë kreut mbi alternativat e dënimit me burgim, të kishte përjashtuar nga llogaritja e vuajtjes së dënimit dhe përfitimet e tjera të të dënuarve, përveç amnistisë dhe faljes, meqenëse ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” kishte dalë pas parashikimit fillestar të nenit 64 të Kodit Penal”*.

---

<sup>186</sup> Vendimi nr. 00-2022-1785, datë 22.12.2022, kërkuar Valmir Shaqiri kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Referuar të dhënave sa më sipër, evidentohen interpretime të ndryshme të gjykatave lidhur me përfshirjen e kohës së punës në përllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur e cila i jep mundësi kërkuarit të përfitojë lirimin me kusht dhe jo të gjitha këto interpretime referuar ecurisë procedurale të ankimit, janë bërë objekt i shqyrtimit nga Gjykata e Lartë e cila në dy vendime të dhëna nga e njëjta trupë gjyqësore, e ka konsideruar praktikën e përfshirjes së kohës së punës si përfitim për efekt përllogaritje në bazë të nenit 64 si një praktikë që është në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe të identifikuar qartë që rregullon këtë marrëdhënie pune të të dënuarit në IEVP. Në këto kushte, vlerësohet e rëndësishme autoriteti i Gjykatës së Lartë për unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme.

#### **d. Kushtet ndaluese:**

#### **Të mos qënurit përsëritës të të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara**

Këto dy kritere objektive janë konsideruar si kushte ndaluese nga ana e gjykatave në analizën e vendimmarrjeve të tyre, duke u përfshirë në pjesën arsyetuese të vendimit. Referuar këtyre vendimeve, për të konkluduar lidhur me kushtet ndaluese, gjykatat janë mbështetur në vendimmarrjet për të cilat kërkohet lirimi me kusht përse i përket kushtit të kryerjes së veprave penale të përcaktuara, për t'u proceduar më tej me verifikimin e kushtit "përsëritës" nëpërmjet vërtetimit të gjendjes gjyqësore, kartelës personale të të dënuarit të paraqitur nga IEVP, të të dhënave nga Raporti i Shërbimit të Provës, dhe nga vetë kërkuari.

Lidhur me këto kushte ndaluese konstatohen diskutime të cilat janë bërë objekt shqyrtimi në drejtim të interpretimit të tyre.

Lidhur me kushtin "përsëritës" është konstatuar se ka patur diskutim në drejtim të interpretimit të termit "përsëritës" duke e parë në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuar nenit 69/a të Kodit Penal, të amnistisë për njërin nga dënimet, të bashkimit të dënimit, si dhe në këndvështrim të veprimeve të kundërligjshme si elemente të figurës së krimit. Ndërsa lidhur me kriterin tjetër, konkludimi ka qenë i qartë duke u ndalur në konstatimin nëse vepra penale për të cilën është dënuar kërkuari bën pjesë në veprat penale të përcaktuara shprehimisht në dispozitë.

**Përse i përket diskutimit në drejtim të interpretimit të termit "përsëritës" referuar institutit të rehabilitimit,** në të gjitha vendimmarrjet e rretheve gjyqësore ku është bërë objekt shqyrtimi, konstatohen qëndrime të ndryshme.

Qëndrimi i parë, mbështetet në argumentin se sipas qëllimit të dispozitës "lirimi me kusht", është se kërkuari nuk duhet të ketë qenë më parë i dënuar pavarësisht nëse është rehabilituar apo jo, dhe se rehabilitimi merret në konsideratë në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për efekt të moskonsiderimit të saj si rrethanë rënduese, por kjo nuk shuan faktin që kërkuari ka qenë më parë i dënuar në kuptim të nenit 64 të K. Penal. Këtë qëndrim e kemi konstatuar nga dy gjyqtarë të ndryshëm të së njëjtës gjykatë në dy vendimmarrjet përkatëse dhe nga 1 gjyqtar të një rrethi gjyqësor tjetër. Njëri prej dy gjyqtarëve të të njëjtës gjykatë, të sipërpërmendur, në një vendimmarrje tjetër ku është ngritur sërish i njëjti diskutim, ka ndryshuar qëndrim dhe duke

pranuar qëndrimin tjetër në vazhdim.

Qëndrimi i dytë, të cilën e konstatojmë në tre gjyqtarë të gjykatave të rretheve gjyqësore të ndryshëm midis tyre dhe nga gjyqtari i qëndrimit të parë, mbështeten në marrjen në konsideratë të rehabilitimit të kërkuesit për dënimin e mëparshëm për efekt të parashikimeve të nenit 64 të K. Penal, sipas të cilit nëse brenda afatit të parashikuar në nenin 69/a të Kodit Penal, i dënuari kryen edhe një vepër tjetër penale për dënimin e të cilës, kërkon lirimin me kusht, kërkuesi do të konsiderohet si përsëritës dhe e kundërta nuk do të konsiderohet përsëritës. Ky qëndrim i fundit, referuar vendimeve gjyqësore objekt i këtij inspektimi ku është ngritur diskutimi rreth termit “përsëritës”, është pranuar nga të gjitha Gjykatat e Apelit<sup>187</sup> ku është diskutuar çështja e rehabilitimit në kuadër të interpretimit të kushtit ndalues “përsëritës” të parashikuar në nenin 64 të K. Penal.

Përsa i përket qëndrimi të prokurorit, referuar vendimeve të rretheve gjyqësore, konstatohen qëndrime të ndryshme, si edhe më sipër. Për ato raste, kur qëndrimi i prokurorit të seancës në gjykatën e rrethit gjyqësor është ai i mosmarrjes në konsideratë të institutit të rehabilitimit të kërkuesit për dënimin e mëparshëm, është ushtruar ankimi i cili është përkrahur edhe nga prokurori i apelit, por në të gjitha këto raste ky qëndrim nuk është pranuar nga Gjykata e Apelit. Për të gjitha këto raste, nga prokurori i apelit është ushtruar rekurs duke u ngritur si pretendim interpretimi i termit “përsëritës”, por ende deri më sot nuk ka një qëndrim nga Gjykata e Lartë.

Referuar qëndrimeve sa më sipër lidhur me diskutimin në drejtim të termit “përsëritës” referuar institutit të rehabilitimit, konstatohet se nga studimet e disa magjistratëve mbi dënimet alternative, ndër të cilët edhe të lirit me kusht, në vitet 2010 dhe 2020, janë evidentuar të dy qëndrimet në fjalë dhe lidhur me to janë bërë konkludimet përkatëse. Sipas studimit të vitit 2010, magjistratët kanë vërejtur se *“ligjvënësi nuk bën një ndarje se çfarë dhe kur mund të përfitojë personi i rehabilituar. Kjo pasi e vetmja ndarje ligjore në këndvështrimin penal është në persona të dënuar dhe persona të padënuar ose të rehabilituar dhe se fitimi i cilësisë së të qenit i rehabilituar është një e drejtë që të çon tek çdo përfitim ligjor dhe jo në privime nga këto përfitime ligjore në raste të caktuara. Pra, në këtë këndvështrim vetëm gjatë kohës që do të quhen të dënuar për krime të kryera me dashje shtetasit nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga neni 64 i Kodit Penal, kurse për të gjitha rastet e tjera ata nuk kanë asnjë lloj pengese që t'i drejtohen gjykatës dhe të përfitojnë kur plotësohen edhe kriteret e tjera ligjore.<sup>188</sup>”* Në studimin pasues, të vitit 2020, magjistratët shprehen duke iu referuar qëndrimit të studimit në vitin 2010 dhe duke konkluduar. se: *“Në literaturën shqiptare mbi dënimet alternative është argumentuar se personi i rehabilituar nuk mundet të konsiderohet më i dënuar, dhe se ai i ka rifituar të gjitha të drejtat dhe statusin të cilat i privoheshin pikërisht nga dënimi edhe pas vuajtjes së tij. Për rrjedhojë konkludohet se, kjo kategori personash nuk kanë asnjë pengesë*

<sup>187</sup> Shih vendimin nr. 41, datë 03.04.2018, Gjykata e Apelit Korçë, vendimin nr. 10-2018-160/24, datë 29.01.2018, Gjykata e Apelit Durrës, vendimin nr. 10-2020-137/28, datë 28.01.2020, vendimin nr. 116, datë 21.02.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>188</sup> Shih “Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim”, OSCE 2010, autorë Prof. Dr. Arta Mandro-Balili, Marsida Xhaferllari, Gerd Hoxha, Admir Belishta, fq.72-73.



*ligjore që t'i drejtohen gjykatës. pajtohemi plotësisht me një zgjidhje të tillë dhe mbi të gjitha një interpretim të tillë konstruktiv mbi institutin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal. Personi i rehabilituar për shkak të ligjit konsiderohet i padënuar dhe për rrjedhojë nuk do të mundet të interpretohet sikur është recidivist. Kjo do të thotë se ky subjekt nuk ka ndalesë ligjore për të përfitur nga lirimi me kusht si dënim alternativ”<sup>189</sup>.*

**Përsa i përket diskutimit në drejtim të interpretimit të termit “përsëritës” referuar përfitimit nga amnistia** lidhur me vuajtjen e mëtejshme të dënimit tjetër të kërkuesit, nga ai për të cilën kërkohet lirimi me kusht, janë vënë re qëndrime të ndryshme në dy raste të ngjashme të gjyqtarëve të rretheve gjyqësore të cilat kanë passjellë konkludime të ndryshme lidhur me këtë kusht ndalues.

Në rastin e parë<sup>190</sup>, kërkuesi ishte dënuar për një krim dhe brenda afatit të rehabilitimit kishte kryer edhe një krim tjetër për të cilën kërkonte lirim me kusht, si dhe në vazhdim për dënimin e parë kishte përfitur nga amnistia. Gjykata në qëndrimin e saj, nuk ka pranuar argumentet e kërkuesit se për shkak të amnistisë lidhur me dënimin e parë, kërkuesi nuk quhet më i dënuar, duke e konsideruar si të pabazuar mbështetjen për këtë rast në nenin 71 të K. Penal “amnistia”. Ashtu si edhe prokurori, gjykata mbështesin qëndrimin se kërkuesi është “përsëritës” referuar institutit të rehabilitimit të parashikuar në nenin 69 të K. Penal duke e filluar përlllogaritjen për rastin konkret të lidhur me amnistinë nga dita e fundit e vuajtjes së dënimit të parë kur ka hyrë në fuqi ligji për amnistinë.

Rasti i dytë<sup>191</sup>, kërkuesi ishte dënuar për dy krime njëra pas tjetrit, dhe pasi këto vendime kanë marrë formë të prerë është bërë bashkimi i tyre dhe duke vazhduar vuajtjen e këtij dënimi të vetëm. Në vazhdim, për dënimin e parë kërkuesi ka përfitur amnistinë dhe kërkuesi ka vijuar vuajtjen e dënimit të dytë dhe për këtë ka paraqitur në gjykatë kërkesë për lirim me kusht. Në këtë rast, gjykata ka mbajtur qëndrimin se kërkuesi nuk është përsëritës për krim të kryer me dashje, pasi ekzekutimi i dënimit për veprën e mëparshme penale, e cila do ta ngarkonte kërkuesin me pasojën e mospërfitimit të përfitimit nga lirimi me kusht është shuar, për shkak amnistie.

Në të dy rastet si më sipër, megjithëse kërkuesi ka qenë në të njëjtat rrethana nga ana e gjyqtarëve është konkluduar ndryshe përsa i përket kushtit ndalues “përsëritës” për një krim të kryer me dashje duke u mbështetur në interpretimin e institutit të amnistisë nga vuajtja e dënimit të mëparshëm nga dënimi për të cilën kërkohet lirim me kusht. Referuar institutit të amnistisë sipas parashikimeve të nenit 71 të K. Penal, në këndvështrimin e rasteve që po trajtojmë, i dënuari përfiton përjashtimin nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit, por në këtë dispozitë nuk parashikohet se personi në rastin konkret quhet i padënuar. Për ndryshimin

---

<sup>189</sup> Shih “Manual mbi dënimet alternative në Republikën e Shqipërisë”, maj 2020, autorë Daniela Sulaj, Edlira Petri, Florjan Kalaja, Ornela Naqellari, Romeo Merruko; fq. 236.

<sup>190</sup> Vendimi nr. 1, datë 19.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Nuk ka patur ankim dhe ka marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore.

<sup>191</sup> Vendimi nr. 3, datë 27.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Nuk ka patur ankim dhe ka marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore.

e statusit, duhet t'i referohemi institutit të rehabilitimit të parashikuar nga neni 69 i K. Penal ku parashikohen afatet përkatëse të cilat fillojnë të përlllogariten nga dita e përfundimit të vuajtjes së dënimit me burgim. Një nga llojet e përfundimit të vuajtjes së dënimit është edhe me anë të amnistisë. Në këtë këndvështrim, për rastin e dytë, do të vlerësohet verifikimi i mëtejshëm në kuadër të ligjit nr. 96/2016 duke patur në konsideratë periudhën kohore dhe konstatimin e rasteve të tjera të njëjtës natyrë sipas parashikimeve të nenit 117 të njëjtit ligj.

**Përsa i përket diskutimit në drejtim të interpretimit të termit “përsëritës” referuar bashkimit të dënimit,** është konstatuar referuar rastit kur ekzekutimi i dënimit për të cilën kërkohet lirimi me kusht ka filluar pas bashkimit me një vendim gjyqësor, të vendimeve gjyqësore me anë të cilave është dënuar kërkuesi, duke u përfshirë edhe rasti i njohjes së vendimeve penale të huaja me një vendim penal të gjykatës shqiptare.

Rasti i parë është evidentuar në 1 vendim gjyqësor të gjykatës së rrethit gjyqësor, dhe nga kjo e fundit është pranuar qëndrimi i prokurorit se ekzistenca e dy vendimeve e bënte kërkuesin që të ndodhej para kushtit ndalues “përsëritës”. Gjykata e Apelit<sup>192</sup> e cila ka shqyrtuar këtë çështje mbi bazën e ankimit të kërkuesit, nuk ka pranuar këtë qëndrim, duke argumentuar se duke iu referuar interpretimit sistematik të dispozitës dhe terminologjisë së përdorur nga legjislatori, do të konsiderohet përsëritës ai person, i cili do të kryejë një vepër penale të kryer me dashje, pasi të jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për veprën e parë dhe të ketë filluar ekzekutimin e dënimit. Në këtë rast, vazhdon arsyetimin gjykata e apelit, i rëndësishëm për klasifikimin si përsëritës, është momenti i kryerjes së veprës penale dhe jo ai i konstatimit nga ana e autoriteteve të drejtësisë, që në këtë linjë arsyetimi i referohet kohës së vuajtjes së dënimit, ashtu sikundër një gjë e tillë parashikohet edhe në dispozitën materiale të parashikuar nga neni 64/4 i K. Penal, ku saktësohet se lirimi me kusht pezullohet kur personi, gjatë kohës së kushtit, kryen një tjetër vepër penale. Lidhur me këtë rast nuk është evidentuar që të jetë bërë rekurs.

Lidhur me linjën e arsyetimit sa më sipër, mund të përmendim rastin e trajtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku kërkuesi rezultonte të ishte i dënuar për një krim, i cili më pas është bashkuar me një dënim tjetër për një krim të kryer pas dënimit të mëparshëm dhe fillimit të ekzekutimit të dënimit të këtij dënimi. Në vazhdim, nga kërkuesi është paraqitur kërkesë për lirim me kusht nga vuajtja e dënimit të bashkuar dhe nga gjykata e rrethit gjyqësor<sup>193</sup> dhe apeli<sup>194</sup> është konsideruar përsëritës, pavarësisht bashkimit të dënimeve.

Rasti i dytë në 1 vendim të një gjykate të rrethit gjyqësor tjetër dhe nga kjo e fundit është pranuar qëndrimi i prokurorit se ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të dënimit të shtetit të huaj me anë të cilave kërkuesi është dënuar për krime dhe të cilat i janë njohur me një vendim gjyqësor në Shqipëri, do të konsiderohen se e vendosin kërkuesin përpara rrethanave të kushtit

<sup>192</sup> Shih vendimi nr. 99, datë 19.02.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>193</sup> Shih vendimi nr. 62, datë 09.06.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

<sup>194</sup> Vendimi nr. 142, datë 17.05.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

të ndalimit “përsëritës”. Gjykata e Apelit<sup>195</sup> e cila e ka shqyrtuar rastin konkret, mbi ankimin e të pandehurit, nuk e ka pranuar këtë qëndrim duke argumentuar se fakti i dy dënimeve penale të formës së prerë në shtetin italian, nuk e bën atë përsëritës në krim për efekt të aplikimit të nenit 64 të Kodit Penal në fazën e ekzekutimit të dënimit në Shqipëri pasi, për efekt të transferimit të këtij të dënuari, dënimi i aplikuar në shtetin shqiptar është një i vetëm, pikërisht dënimi i bashkuar dhe konvertuar sipas legjislacionit shqiptar dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ndaj vendimit rezultojnë të jetë bërë rekurs nga prokurori, por nuk është shqyrtuar ende<sup>196</sup>. Lidhur me këtë diskutim, evidentohet se Kolegji i Gjykatës së Lartë në një vendim referuar një kërkuesi tjetër<sup>197</sup> janë shprehur se “fakti që këto dënime janë bashkuar në një të vetëm, nuk eliminon ekzistencën e të dyjave dënimeve dhe as faktin që ai është përsëritës për krime të kryera me dashje”.

**Përsa i përket diskutimit në drejtim të interpretimit të termit “përsëritës” në këndvështrim të veprimeve të kundërligjshme si elemente të figurës së krimit,** është konstatuar në 2 raste. Në rastin e parë<sup>198</sup> kur kërkuesi ishte dënuar edhe për nenin 290/2 të K. Penal, përpara se të kryente krimin për të cilën ishte dënuar dhe kërkonte lirim me kusht. Prokurori ka mbajtur qëndrimin se në rastin konkret kërkuesi ndodhej përpara kushtit ndalues “përsëritës”, ndërsa nuk është pranuar nga gjykata e rrethit gjyqësor e cila ka arsyetuar se neni 290/2 i K. Penal është një krim i kryer nga pakujdesia. Gjykata e Apelit e cila ka shqyrtuar këtë çështje mbi bazën e ankimit të prokurorit ku është parashtruar si argument ndër të tjera edhe pretendimi në fjalë që është përkrahur nga prokurori i apelit, ka pranuar të njëjtin qëndrim dhe argumentim si edhe gjykata e rrethit gjyqësor. Lidhur me këtë rast nuk është evidentuar që të jetë bërë rekurs.

Po kështu edhe në rastin tjetër<sup>199</sup>, kërkuesi rezultonte të ishte i dënuar për krimin e parashikuar nga neni 290/1 i K. Penal para se kërkuesi të dënohej edhe për krimin tjetër për të cilën kishte paraqitur kërkesën për lirim me kusht. Në këtë rast, gjykata e rrethit gjyqësor ka mbajtur qëndrimin se kërkuesi ishte “përsëritës” referuar kushtit ndalues të parashikuar nga neni 64 i K. Penal, ndërsa Gjykata e Apelit në qëndrimin e saj pavarësisht se ka lënë në fuqi vendimin e rrëzimit, e ka përdorur këtë dënim të mëparshëm për të argumentuar në drejtim të arsyeve të

---

<sup>195</sup>Shih vendimin nr. 10-2020-66, datë 16.01.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, ku njëri nga gjyqtarët rezultojnë të ketë qenë kundër. Dy gjyqtarët e tjerë që kanë vendosur pranimin e kërkesës, rezultojnë të mos kenë statusin aktual të magjistratit për shkak të shkarkimit përfundimtar me vendim të KPA-së.

Referuar qëndrimin të kolegjit të Gjykatës së Lartë i cituar më poshtë, me nr. 00-2022-629 i Vendimit (163), datë 14.06.2022, lidhur me veprimtarinë e magjistratëve në kuadër të vlerësimit mbi shkelje të mundshme disiplinore sipas ligjit me nr. 96/2016, nuk mund të procedohet për shkak të humbjes së statusit të dy gjyqtarëve të cilët kishin vendosur me shumicë ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës “lirim me kusht”.

<sup>196</sup> Referuar kohës së përpilimit të këtij raporti.

<sup>197</sup> Vendimi nr. 00-2022-629 i Vendimit (163), datë 14.06.2022, i Gjykatës së Lartë, me kërkues Gerd Gjinarari

<sup>198</sup>Vendimi nr. 1793, datë 19.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe vendimin nr. 281, datë 09.05.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>199</sup> vendimi nr. 108 (2120), datë 24.04.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimi nr. 191 (50-2019-1415), datë 17.07.2019, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

veçanta, ndërsa lidhur me kushtin ndalues “përsëritës” arsyeton se është krim i kryer nga pakujdesia. Nuk ka të dhëna për ushtrim rekursi.

**Lidhur me kushtin ndalues “kryerjes së veprave penale të përcaktuara shprehimisht në dispozitë”**, konstatohen tre vendime gjyqësore ku është bërë objekt diskutimi i interpretimit të veprës penale të kryer nga kërkuesi, kualifikimi i të cilit me ndryshimet e Kodit Penal ka pësuar ndryshime si dispozitë.

Rasti i parë është kur kërkuesi ishte dënuar për kryerjen në vitin 2007 të veprës penale të parashikuar nga neni 78/1 i K. Penal, për vrasjen e bashkëshortes së tij, dhe nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor<sup>200</sup> është argumentuar se edhe pse formalisht kjo vepër nuk përfshihej në kategorinë e veprave penale për të cilat nuk lejohet lirimi me kusht, materialisht vlerësohet se është në kushtet e ndalimit të lirimimit me kusht duke patur në konsideratë marrëdhënien juridike që është marrë në mbrojtje nëpërmjet parashikimit të veprimit si vepër penale, tashmë e materializuar në nenin 79/c të K. Penal. Gjykata vazhdon në argumentin e saj se edhe pse në kohën e kryerjes së veprës penale në vitin 2007 neni 64 i K. Penal nuk e parashikonte një ndalim të tillë, gjykata i referohet parashikimit aktual të nenit 64 të K. Penal për arsye se ligji i kohës zbatohet vetëm për sa i përket kryerjes së veprës penale në funksion të kualifikimit të faktit penal dhe përcaktimit të masës së dënimit, ndërsa, për sa i përket kërkesave që i përkasin fazës së ekzekutimit të vendimit zbatohet ligji i kohës në të cilën shqyrtohet kërkesa. Ndaj vendimit rezulton të jetë ushtruar ankim nga kërkuesi, por nga Gjykata e Apelit është vendosur mospranim për shkak të formës së ankimit të paraqitur.

Rasti i dytë i përket një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë<sup>201</sup> ku i dënuari ka qenë i dënuar me burgim të përjetshëm, dhe ndër të tjera gjykata ka disponuar me rrëzim duke arsyetuar si shkak edhe faktin e të qenit para kushtit ndalues të lidhur me llojin e veprës penale. Kështu kërkuesi me vendimin e datës 24.11.1994 është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të “Vrasjes për motive të dobta (xhelozie) parashikuar nga neni 84/a i K. Penal të kohës, dhe lidhur me këtë fakt, për sa i përket kriterit ndalues gjykata arsyeton se: “... *vepra penale për të cilën ai është duke vuajtur dënimin sipas vendimit nr. 987, datë 24.11.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kryer kundër bashkëshortes. Sipas dispozitave të sotme të Kodit Penal kjo vepër sanksionohet në nenin 79/c të tij, duke përbërë kështu edhe një kriter ndalues sanksionuar nga neni 65, pika 3 e Kodit Penal*”. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim duke marrë formë të prerë me kalimin e afateve ligjore.

Rasti i tretë është kur kërkuesi ishte dënuar për kryerjen ndër të tjera të veprës penale të “Vrasje me dashje e punonjësit të policisë” të parashikuar nga neni 79, gërma c i K. Penal, dhe nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, gjyqtar tjetër nga sa më sipër<sup>202</sup> është argumentuar se vepra penale për të cilën kërkuesi është dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në momentin e fillimit të vuajtjes së dënimit nuk përbënte ndalim për të përfituar nga lirimi para

<sup>200</sup> vendimi nr. 11-2018-3011/64, datë 14.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>201</sup> Vendimi nr. 61 akti, datë 09.10.2017.

<sup>202</sup> Vendimi nr. 69 akti, datë 06.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

kohe me kusht, sipas nenit 64 të K. Penal, ndërsa në vazhdim kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar. Gjykata shton më tej se në rastin konkret referuar nenit 477 të K. Pr. Penale dhe nenit 3 të K. Penal për kërkuesin do të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, duke pranuar për rrjedhojë se dënimi për këtë veprë penale nuk përbënte ndalim sipas nenit 64 të K. Penal. Ky qëndrim nuk është gjetur i drejtë nga Gjykata e Apelit, e cila ka konkluduar se vepra penale për të cilën kërkuesi ishte dënuar, përbënte ndalim pasi përfshihej në veprat penale që parashikon dispozita në fjalë. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se në bazë të aplikimit të institutit të veprimit në kohë të ligjit penal, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, do të zbatohet ligji i kohës që ka qenë në fuqi në momentin që i dënuari ka paraqitur në organin e gjykatës kërkesën e veçantë penale me objekt lirim me kusht. Gjykata vazhdon me argumentimin e saj, se duke qenë se faza e ekzekutimit të vendimit penal është një fazë e shkëputur nga procesi penal dhe deklarimi fajtor i subjektit të veprës penale, vlerësohet se duhet të zbatohet ligji penal material që është në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit, pasi ekzekutimi i dënimit lidhet me elementë që kanë të bëjnë me sjelljen e të dënuarit në institucionet e IEVP-së, me mundësinë që me sjelljen e tij të përfitohen ulje të dënimit ose leje shpërblyese, mundësinë e riintegritit të tij në shoqëri, me qëndrimin e tij ndaj veprës, me sjelljen me bashkëvuajtësit dhe me autoritetet shtetërore, me mundësinë e tij për t'u punësuar jashtë burgu, në varësi të kërkesës që do të ngrihet nga i dënuari dhe rrjedhimisht faktet që vlerësohen nga gjykata në këtë fazë janë të ndryshme nga ato që janë vlerësuar në momentin që i dënuari është shpallur fajtor. Këto qëndrime janë vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë<sup>203</sup> e cila ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit, se, në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal, gjen zbatim dispozita penale që është në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit, si dhe të faktit se shfuqizimi i normës konkretisht pikës “c”, të nenit 79 të Kodit Penal nuk ka patur si qëllim dekriminalizimin e kësaj lloji veprë penale, sepse nuk ka më rrezikshmëri shoqërore, por, përkundrazi, me ndryshimet ligjore të bëra me ligjin nr. 144/2013, datë 02.05.2013, janë krijuar dy norma të reja, konkretisht ajo e parashikuar nga neni 79/a i Kodit Penal “Vrasja e funksionarëve publikë” dhe ajo e parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal “Vrasja e Punonjësve të Policisë së Shtetit”, duke parashikuar një mbrojtje më të posaçme këtyre subjekteve, kjo, e shprehur edhe nga marzhet e dënimit të cilat janë më të rënda në minimumin e parashikuar. Për arritjen e këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë është shprehur se ka mbajtur në konsideratë edhe vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me zbatimin e nenin 3 të Kodit Penal.

Rasti i katërt është kur kërkuesi është dënuar në vitin 2007 përfundimisht, për krim të vrasjes me paramendim për gjakmarrje sipas dispozitës penale neni 78/2 i K. Penal, në fuqi në kohën e kryerjes së krimit të datë 06.11.2004 dhe në vitin 2018 ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht. Gjykata e rrethit gjyqësor<sup>204</sup> ka vendosur rrëzim me argumentin ndër të tjera të ekzistencës së kriterit ndalues të të qënurit i dënuar më parë për një krim të kryer me dashje duke e lidhur me nenin 78/a të Kodit Penal, pavarësisht se kjo dispozitë nuk ka qenë e

<sup>203</sup> Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2022-1617 i vendimit (334), datë 15.12.2022, me kërkues Genc Tafili.

<sup>204</sup> Vendimi nr. 1101, datë 13.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

parashikuar në nenin 64 të K. Penal në kohën e kryerjes së veprës penale. Gjykata e Apelit<sup>205</sup> që ka shqyrtuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor në fjalë, mbi bazë ankimi të ankuesit ka argumentuar mbi bazueshmërinë e vendimit të rrëzimit, ashtu si edhe gjykata e rrethit gjyqësor duke e lidhur krimin e kryer me dispozitën që e parashikon aktualisht si neni 78/a i K. Penal dhe që si i tillë parashikohet si kusht ndalues referuar nenit 64/3 të K. Penal.

Referuar qëndrimeve të tilla në drejtim të interpretimeve të kushteve ndaluese, vlerësohet e domosdoshme njësimi i tyre me qëllim të orientimit mbi zbatimin e legjislacionit procedural dhe material në kërkesa me objekt "lirim me kusht".

### **1.1.3. Përcaktimi i kohës së kushtit dhe i detyrimeve për t'u përmbushur gjatë kësaj kohe**

Në kuadër të parashikimeve sipas legjislacionit material, vlerësohet që të trajtohet në këtë pjesë edhe disponimet nga ana e gjykatës lidhur me kohën e provës dhe detyrimet për t'u përmbushur gjatë kësaj kohe.

Përsa i përket kohës së kushtit, referuar vendimeve gjyqësore objekt i këtij inspektimi është konstatuar ndjekja e praktikave të ndryshme lidhur me përcaktimin e kësaj kohe, duke mos caktuar gjithmonë kohë provë të barabartë me pjesën e mbetur pa vuajtur referuar vendimit unifikues.

Kështu një praktikë është për përcaktimin e kohës së kushtit për periudhën e kohës së mbetur të vuajtjes së dënimit. Kryesisht ata që ndjekin këtë praktikë referojnë në pjesën arsyetuese vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë.

Praktika tjetër e evidentuar nga vendimet gjyqësore, është për përcaktimin e kohës së kushtit më të madhe sesa periudha e kohës së mbetur të vuajtjes së dënimit, ku përfshihen edhe rastet e përcaktimit të kohës së kushtit sa dyfishi i kohës së mbetur. Nga vendimet gjyqësore ku është përcaktuar koha e kushtit më e madhe sesa periudha e kohës së mbetur, konstatohet se nuk ka arsyetim lidhur me këtë përcaktim. I njëjti konstatim vihet re edhe tek pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore ku koha e kushtit është përcaktuar sa dyfishi i periudhës së kohës së mbetur të vuajtjes së dënimit. Tek ato vendime ku është konstatuar arsyetim, gjyqtarët kanë mbështetur përcaktimin e kohës së provës, referuar nenit 59 të K. Penal.

Një praktikë tjetër e evidentuar është edhe ajo e përcaktimit të kohës së provës më të vogël sesa periudha e kohës së mbetur të vuajtjes së dënimit. Në vendimet gjyqësore ku është konstatuar kjo praktikë, nuk evidentohet arsyetim nga ana e gjyqtarëve.

Dy praktikat e para janë hasur pothuaj në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, përveç Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Korçë, Vlorë dhe Kavajë, ku është evidentuar vetëm praktika e parë.

Praktika e tretë është hasur në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Fier, Krujë dhe Durrës.

---

<sup>205</sup> Vendimi nr. 60-2018-3938, datë 13.12.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Nga vendimmarrjet e disa gjyqtarëve, është evidentuar edhe praktikë e përzier në drejtim të evidentimit të ndjekjes të disa praktikave nga ato të sipërcituara. Për një nga këto raste<sup>206</sup>, ku është evidentuar ndjekja e të tre praktikave të tilla, është vlerësuar fillimi i verifikimit për magjistratët përkatës në drejtim të provueshmërisë së elementëve përbërës të shkeljeve të mundshme disiplinore.

Gjithashtu lidhur me praktikën sa më sipër, për përcaktimin e kohës së provës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë tek dy gjyqtarë është konstatuar se në të gjitha vendimmarrjet e tyre të pranimit të lirimimit me kusht nuk përcaktojnë në dispozitiv kohën e kushtit, megjithëse shprehen për këtë periudhë si një periudhë gjatë të cilës nga ana e të dënuarit duhet të mbahen kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejnë veprë tjetër penale. Po kështu, konstatohet edhe tek 1 vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Për 1 nga këto raste, referuar praktikës së ekzekutimit<sup>207</sup> dhe pikërisht të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga shërbimi i provës i është kërkuar prokurorisë përcaktimi i periudhës së provës, për të cilën prokuroria e ka përcaktuar nga ana e saj duke proceduar me një kthim përgjigje sipas të cilës koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit.

Për praktikën e mësipërme të konstatuar në gjykatat e rretheve gjyqësore, evidentohet se në pak raste koha e provës së përcaktuar është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit. Këto raste evidentohen kur gjykata e rrethit gjyqësor ka disponuar për caktimin e kohës së provës më të madhe sesa pjesa e mbetur e pavuajtur e dënimit me burgim dhe të barabartë. Në rastin e parë ankimi është bërë nga kërkuesi dhe në rastin e dytë ankimi është bërë nga prokurori.

Për rastin e parë, gjykata e rrethit gjyqësor<sup>208</sup> kishte vendosur si kohë prove 2 vjet duke mos argumentuar lidhur me këtë dhe ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi i cili i referohet për këtë vendim unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015. Gjykata e Apelit Vlorë<sup>209</sup> ka disponuar me lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor duke arsyetuar se vendimi unifikues nuk zbatohet në rastin konkret sepse ligji shprehet për periudhën e provës dhe pikërisht neni 59 i K. Penal që ka përcaktuar se për dënime nën 2 vjet koha e provës është sa dyfishi i dënimit të mbetur.

Për rastin e dytë, gjykata e rrethit gjyqësor kishte vendosur si kohë prove periudhën e barabartë me kohën e mbetur të vuajtjes së dënimit dhe ndaj këtij vendimi ka bërë ankim prokurori i cili i referohet argumentimit të dispozitës 59 të K. Penal, tashmë i ndryshuar me ligjin nr. 95/2017. Ankimi është përkrahur edhe nga prokurori i apelit, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës<sup>210</sup> nuk e ka pranuar, duke argumentuar qëndrimin unifikues të Gjykatës së Lartë sipas të cilit në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.

---

<sup>206</sup> Rasti i vendimmarrjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>207</sup> Për aq sa ka qenë e mundur të evidentohet në kushtet e mungesës së inventarizimit të dokumentacionit të dërguar.

<sup>208</sup> vendimi nr. 500, datë 29.03.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>209</sup> vendimi nr. 253 datë 16.11.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>210</sup> vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 10-2017-2767 (878) datë 14.11.2017.

Përsa i përket qëndrimit të Gjykatave të Apelit në rastet kur nga ana e saj është proceduar me ndryshim vendim rrëzimi dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht, konstatohet se në përgjithësi gjykatat kanë proceduar me caktimin e kohës së kushtit të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit. Në 1 rast, është evidentuar që Gjykata e Apelit Durrës<sup>211</sup> ka proceduar me caktimin e kohës së kushtit më të vogël sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit dhe në 1 tjetër, Gjykata e Apelit Tiranë<sup>212</sup> ka proceduar me caktimin e kohës së kushtit më të madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur të dënimit. Në të dy këto vendime nuk ka arsyetim lidhur me përcaktimin e kësaj periudhe kohe.

Konstatimi i disa praktikave të tilla gjatë gjithë periudhës së inspektimit me shtrirje pothuaj në pjesën më të madhe të gjykatave të rretheve gjyqësore, ngre diskutimin e moszbatimit të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015. Sipas parashikimeve të nenit 438/4 të K. Pr. Penale, vendimi unifikues është i detyrueshëm për gjykatat për gjykimin e çështjeve të ngjashme dhe mosreferimi me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose për shkak të paaftësive të dukshme profesionale do të përbënte shkelje disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Po t’i rikthehemi vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015, konstatohet se në pjesën arsyetuese është shprehur qëndrimi unifikues lidhur me kohën e provës sipas të cilit “Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht”. Por referuar dispozitivit të vendimit në fjalë, konstatohet se nga ana e kolegjeve nuk është proceduar me ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit sipas të cilit koha e provës është përcaktuar referuar parashikimeve të nenit 59 të K. Penal të kohës, që referonte një periudhë kohe vënie në provë prej 18 muaj deri në 5 vjet. Kjo është konstatuar edhe nga pakica e 7 gjyqtarëve të kolegjeve të cilët kanë dalë kundër vendimmarrjes së shumicës. Në qëndrimet e njërit prej gjyqtarëve të pakicës, është shprehur qëndrimi dakortësues i tij me praktikën e gjykatës për referimin e nenit 59 të K. Penal, me arsyetimin se kështu në kushtet e boshllëkut ligjor, të paktën në rastin konkret jemi para një interpretimi të zgjeruar të ligjit dhe jo para krijimit të një ligji të ri, i cili është jashtë funksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë. Ndërsa gjyqtarët e tjerë të pakicës në interpretimin e tyre, dakortësohen me arsyetimin e shumicës në pjesën arsyetuese të vendimit duke e lidhur shtrirjen e kohës së kushtit sa koha e mbetur e vuajtjes së dënimit, si kohë në funksion të kapërcimit të vështirësive për riintegrimin social të të dënuarit dhe se caktimi i një kohe përtej kohës së mbetur të dënimit, do të konsiderohej i pambështetur në ligj, ndërsa caktimi i një periudhe kohe më të shkurtër do të shkonte kundër qëllimit të institutit të lirimimit me kusht, si dhe do të ulte efektivisht masën e dënimit të dhënë nga gjykata me vendim të formës së prerë. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga prokurori përfaqësues i Prokurorisë në Gjykatën e Lartë dhe nga mbrojtësi i kërkuarit.

Ekzistenca në vendimin unifikues i këtij kontradiktorialiteti midis qëndrimit unifikues dhe disponimit dhe mendimin e pakicës, krijon paqartësi në zbatimin e tij referuar parashikimeve

<sup>211</sup> vendimi nr. 10-2017-2808 (883), datë 16.11.2017.

<sup>212</sup> nr. 1102, datë 16.10.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë.



të nenit 438/4 të K. Pr. Penale. Në vijim të kësaj, konstatohet se edhe ndryshimet ligjore të cilat pasuan vendimin në fjalë, nuk krijuan qartësi në drejtim të përcaktimit të kohës së provës. Kështu sipas relacionit shoqërues, ndryshimet në nenin 59 të K. Penal në drejtim të kohës së provës i kanë lidhur me zgjidhjen e problematikave edhe lidhur me kohën e kushtit të nenit 64 të K. Penal<sup>213</sup>, ndërsa në fakt kur shikon dispozitën konkrete të neneve 59 dhe 64 të K. Penal, nuk gjendet një korrelacion i tillë referuar interpretimit sistematik dhe logjik të saj.

Janë këto rrethana në drejtim të interpretimit të nenit 64 të K. Penal, të cilët kanë paraprirë dhe shoqëruar veprimtarinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, subjekte të këtij inspektimi në shqyrtimin e kërkesave me objekt "Lirim me kusht". Referuar sa më sipër, si parashikimeve ligjore dhe qëndrimit unifikues si burime të së drejtës ku mbështetet veprimtaria e magjistratëve, konstatohet se ka paqartësi në interpretimin e përcaktimit të kohës së kushtit, ndërsa është gjithëpranuar fakti i boshllëkut ligjor të kësaj kohe.

Në këtë drejtim, ndonëse referuar të dhënave nga inspektimi i kryer shumica e gjyqtarëve në të gjitha rrethet gjyqësore dhe gjykatat e apeleve kanë pranuar qëndrimin unifikues në qëndrimet e tyre, ndër të cilët është vënë re edhe ndryshimi i praktikës së gjyqtarëve në drejtim të kësaj praktike duke krijuar qëndrueshmëri në vazhdim, me qëllim shmangien e abuzivitetit në kushtet e boshllëkut ligjor të përcaktimit të kohës së provës, vlerësohen si tepër të domosdoshme ndryshimet ligjore përkatëse apo edhe një vendim për ndryshimin e praktikës ligjore, në drejtim të përcaktimit të kohës së kushtit.

Gjithashtu diskutime ngre edhe mospërcaktimi i kohës së provës në dispozitivin e gjykatës dhe kjo në drejtim të ekzekutimit të vendimit të gjykatës që ka disponuar "lirim me kusht". Vendimi gjyqësor, ashtu siç e parashikon edhe dispozita përkatëse, neni 383 i K. Pr. Penale përbëhet nga disa pjesë dhe moszbatimi i kësaj dispozite shkakton pavlefshmëri të vendimit, duke krijuar në vazhdimësi pasoja në drejtim të ekzekutimit të saj. Në rastet e evidentuara, gjithsej në 3 raste tek dy gjyqtarë, konstatohet se nga ana e prokurorit nuk është treguar diligenca e duhur për të proceduar nëpërmjet ankimit, por se nga ana e tyre është proceduar me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit sipas dispozitivit të gjykatës. Nga këto raste, evidentohet vetëm për 1 rast të jetë bërë objekt diskutimi nga shërbimi i provës, i cili i është drejtuar prokurorit me interpretim lidhur me kohën e provës në kushtet kur kjo kohë nuk ishte përcaktuar as në pjesën arsyetuese dhe as në dispozitiv. Prokurori ka proceduar duke përcaktuar vetë kohën e provës sa pjesa e

---

<sup>213</sup> Në raportin mbi ndryshimet ligjore është parashikuar se: "Qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e Kodit Penal të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim është shmangia nga vuajtja e dënimit të personave me rrezikshmëri të pakët apo kur kushtet shëndetësore apo mendore të autorit të veprës penale, mënyra e jetesës veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punësimin janë të një natyre të tillë që krijojnë bindjen, bazuar në prova, që ndaj këtij autori të veprës penale, gjykata duhet të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim, duke vendosur zëvendësimin e dënimit me burg me dënime alternative. Këto ndryshime dhe zbatimi i drejtë i tyre nga gjykata do të ndikojë dhe në uljen e numrit të të dënuarve me burgim për vepra penale me rrezikshmëri të vogël dhe zbatimin më të gjerë të dënimeve alternative. Këto ndryshime në projektligj do të ndikojnë në rritjen e rolit të Shërbimit të Provës për të dënuarit për të cilët gjykata vendos lirin e tyre me kusht".



mbetur e vuajtjes së dënimit. Një mënyrë e tillë e të proceduarit, vlerësohet si një tejkalim i funksionit kushtetues të prokurorit pasi përcaktimi i kohës së provës referuar nenit 64 të K. Penal është pjesë e vendimmarrjes së gjykatës.

#### **1.1.4. Përcaktimi i detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.**

Referuar vendimeve gjyqësore objekt i këtij inspektimi, konstatohet se jo në të gjitha rastet kur është pranuar kërkesa për “lirim me kusht”, është proceduar edhe me përcaktimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Është për t'u evidentuar se vetëm në 3 Gjykata të Rretheve Gjyqësore përkatësisht Tropojë, Elbasan dhe Gjirokastrë, të gjithë gjyqtarët të cilët kanë vendosur pranimin e kërkesave për lirim me kusht, në të gjitha vendimmarrjet e tyre janë shprehur për detyrimet gjatë kohës së provës sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Në gjykatat e rretheve gjyqësore të tjera, është evidentuar se gjyqtarët të cilët rezultojnë të kenë proceduar me përcaktimin e detyrimeve pas vendimmarrjes për pranimin e kërkesës së lirimit me kusht, janë rreth 31 nga 65 gjyqtarë gjithsej që kanë marrë vendime për pranimin e kërkesës së lirimit me kusht.

Në gjykatat e apeleve evidentohet se jo në të gjitha këto gjykata evidentohen se nga ana e gjyqtarëve është proceduar me përcaktim të detyrimeve sipas nenit 60 të K. Penal. Referuar vendimmarrjeve me anë të të cilave është vendosur ndryshim dhe pranim kërkesë “lirim me kusht” evidentohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është proceduar me përcaktim detyrimi, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është proceduar me përcaktim detyrimi në 1 vendim të saj, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë në 1 vendim evidentohet se është proceduar me përcaktim detyrimi dhe në Gjykatat Vlorë, Durrës dhe Korçë janë evidentuar si përcaktim dhe jo përcaktim të detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal. Në një rast në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>214</sup>, konstatohet se përcaktimi i detyrimit është bërë objekt ankimi nga prokurori dhe si i tillë objekt shqyrtimi nga gjykata e cila pasi ka disponuar për lënien në fuqi të vendimit të pranimit të kërkesës lirim me kusht, ka disponuar edhe me plotësimin e vendimit, duke përcaktuar detyrimet sipas nenit 60 të K. Penal.

Për t'u theksuar se në të gjitha vendimet e të gjitha gjykatave të apeleve që kanë lënë në fuqi vendimet e pranimit, për të cilat nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, nuk ka evidentim nga kjo gjykatë në vendimmarrjen e saj, lidhur me këtë pikë.

Referuar të dhënave në drejtim të mospërcaktimit të detyrimeve, duke patur në konsideratë edhe periudhën e inspektimit, konstatohet se evidentohen në pjesën më të madhe në vendimmarrjet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 36/2017 që ka ndryshuar Kodin Penal. Deri në këtë periudhë, konstatohet se detyrimi për përcaktimin e evidetyrimeve në rastin e vendimmarrjeve që pranonin kërkesën për lirim me kusht, buronte nga qëndrimi unifikues i Gjykatës së Lartë në vendimin me nr. 2/2015. Sipas këtij vendimi, ishte unifikuar qëndrimi se: “Në rastin kur gjykata pranon

<sup>214</sup> Vendimi nr. 10-2018-2099 (365), datë 14.11.2018, i Gjykatës së Apelit Durrës.

kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal” dhe në vazhdim, pas ndryshimeve në Kodin Penal në kuadër të rregullimit të problematikës në fjalë të krijuar sipas raportit shoqërues të projektligjit<sup>215</sup>, ky detyrim buronte nga vetë neni 64 i K. Penal, në të cilën parashikohej se: “Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi”.

Sipas vendimit unifikues deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve të kodit penal me nr. 36/2017, dhe ndryshimeve në fjalë të cilat përfshinë edhe nenin 64 të K. Penal, gjykatat kanë qenë të detyruara për të proceduar me përcaktimin e një ose më shumë detyrimeve në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Mozbatimi i vendimit unifikues, referuar detyrimit të parashikuar në nenin 438/4 të K. Pr. Penale dhe dispozitës përkatëse materiale të Kodit Penal, janë të natyrës së shkeljes disiplinore dhe si të tilla janë të vlerësueshme në kuadër të procedurave përkatëse të parashikuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **1.2. Lidhur me zbatimin e legjislacionit procedural:**

Kërkesa me objekt “Lirimi me kusht” është e natyrës së kërkesave që i përkasin fazës së ekzekutimeve dhe si të tilla, i nënshtrohen rregullave proceduralë që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale që i përkasin kësaj faze dhe të plotësuar edhe me ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në fuqi në periudhën objekt i këtij inspektimi.


Referuar vendimmarrjeve të gjykatave, konstatohet se gjyqtarët në vendimmarrjet e tyre kanë proceduar mbështetur në bazën ligjore sa më sipër.

Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim, të cilët, me përjashtim të tre prej tyre, kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë IEVP-së që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Në tre rastet e përjashtuar si më sipër, rezulton se kërkuesit në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim në dënim alternativ “qëndrim në shtëpi” të parashikuar nga neni 59/a i K. Penal, të cilën e kanë përfutur me vendim gjykate gjatë kohës që kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP-së. Këto tre raste janë evidentuar pranë

---

<sup>215</sup> Në këtë raport citohet se: “Me parashikimin në paragrafin 6 të këtij neni të detyrimit të gjykatës për të urdhëruar të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi rregullon problemet e konstatuar në zbatimin në praktikë të kësaj dispozite ku gjykatat mjaftoheshin duke vendosur në dispozitivin e vendimit vetëm vënien në shërbim prove të të dënuarit, po pa iu referuar detyrimeve të nenin 60 të këtij Kodi”.



të njëjtës gjykatë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat<sup>216</sup> dhe gjatë shqyrtimit të tyre, është ngritur diskutimi nga ana e prokurorit në drejtim të mbështetjes ligjore të përmbushjes së kriterit të dënuar me burgim sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal.

Sipas prokurorit në gjykimet e të tre kërkesave, është mbajtur qëndrimi i mospranimit për shkak se kërkuesi nuk ishte duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP-së, si një kusht i domosdoshëm referuar parashikimeve të Kodit Penal dhe ligjit për shërbimin e provës, pasi anashkalon edhe kompetencat e kësaj të fundit.

Qëndrimi i prokurorit është përkrahur në një nga këto gjykimet në gjykatën e rrethit gjyqësor, nga një gjyqtar i ndryshëm nga gjyqtarët që kanë gjykuar dy kërkesat e tjera. Nga ana e gjykatës në këtë rast është arsyetuar se nuk mund të zëvendësohet një alternativë e dënimit me burgim, siç është qëndrimi në shtëpi me lirimin me kusht për shkak se një veprim i tillë nuk ka asnjë bazë apo referencë ligjore në Kodin Penal dhe në ligjet e tjera. Ndërsa dy gjyqtarët e tjerë në dy gjykimet e tjera ku kanë pranuar kërkesën për lirim me kusht kanë arsyetuar se nuk ka rëndësi mënyra e vuajtjes së dënimit, por vetëm fakti që kërkuesi është i dënuar me burgim dhe se “qëndrimi në shtëpi” sipas nenit 59/a të K. Penal është mënyrë e vuajtjes së dënimit me burgim, si alternativë e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Qëndrimi i prokurorit nuk është përkrahur nga Gjykata e Apelit Vlorë për dy raste ku është gjykuar në themel çështja e ngritur në drejtim të faktit që kërkuesi ishte duke vuajtur dënimin me burgim në dënimin alternativ “qëndrim në shtëpi”. Gjykata e Apelit, në dy trupa të ndryshëm kanë mbështetur qëndrimin e tyre duke arsyetuar se qëndrimi në shtëpi i parashikuar në nenin 59 të K. Penal është alternativë e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit me burgim, e cila nuk i heq kërkuesit statusin e “të dënuarit me burgim”, status i cili kërkohet shprehimisht sipas nenit 64 të K. Penal për të patur të drejtë për të kërkuar lirim me kusht. Gjithashtu edhe në një gjykim tjetër Gjykata e Apelit Vlorë me një trupë tjetër gjyqësore, është shprehur lidhur me natyrën e institutit të “lirim me kusht” se nuk ka interes vendi se ku personi e vuan dënimin, në burg apo në shtëpi, por vetëm plotësimi i kriterëve të parashikuara nga neni 64 i K. Penal.

Diskutimi në fjalë, është ngritur në Gjykatën e Lartë e cila nuk ka dalë ende me një vendim të zbardhur.

Qëndrimi i Gjykatës së Lartë në këto raste do të jetë shumë i rëndësishëm, referuar diskutimit në fjalë, nëse një person i dënuar me burgim, ekzekutimi i vendimit të të cilit është vendosur të bëhet me anë të alternativës siç është ai i “qëndrimit në shtëpi”, a mund të kërkojë lirimin me kusht, kur plotësohen kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 64 të K. Penal.

Duke e interpretuar në mënyrë strikte nenin 64 të K. Penal, konstatohet se sipas saj mundësinë

---

<sup>216</sup> vendimi nr. 97, datë 18.03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, vendimi nr. 253, datë 30.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, vendimi nr. 158, datë 20.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

për të kërkuar këtë lloj alternative të ekzekutimit të dënimit, e kanë të gjithë personat të cilët janë të dënuar me burgim. Dispozita në fjalë, nuk ka parashikim të mëtejshëm nëse kërkuesi do të duhet të jetë duke vuajtur këtë dënim me burgim në një Institucion të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Alternativat e dënimit me burgim “lirim me kusht” dhe “qëndrimi në shtëpi”, kanë të përbashkët midis tyre, përveç mbikëqyrjes në komunitet, edhe faktin e aplikimit të tyre gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim. Në dispozitën përkatëse, neni 59/a të K. Penal ku rregullohet alternativa e dënimit “qëndrimi në shtëpi” është parashikuar në paragrafin e fundit ndër të tjera, mundësia e revokimit dhe e zëvendësimit të kësaj alternative kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Dispozita parashikon zëvendësimin me ndëshkim tjetër, e cila mund të interpretohet edhe si një alternativë dënimi tjetër e zbatueshme gjatë fazës së ekzekutimit dhe kur plotësohen kushtet konkrete. Revokimi dhe zëvendësimi i tij për shkak të mungesës së kushteve nuk është parashikuar në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale si në atë të kohës<sup>217</sup> së vendimeve objekt i këtij inspektimi dhe në atë aktual<sup>218</sup>, e cila ka parashikuar edhe procedurën konkrete në rastet e këtyre hapave proceduralë të ndryshimit të vendimit të kësaj alternative dënimi vetëm në rastet e shkeljes së detyrimeve të caktuara në vendimin e gjykatës<sup>219</sup>. Për këtë mënyrë të proceduarit me revokim dhe zëvendësim, ligji në fjalë ka parashikuar se për këtë mund të procedohet vetëm me kërkesë të prokurorit drejtuar gjykatës, e kuptueshme referuar kuptimit të vetë kësaj alternative dënimi.

Referuar kuadrit ligjor material dhe procedural të alternativave të dënimit sa më sipër, duke i konsideruar si alternativa të ekzekutimit të dënimit me burgim, është e pranueshme kalimi i të dënuarit me burgim nga një alternativë dënimi në tjetrën, vetëm pas konstatimit të mosplotësisht të kushteve apo detyrimeve të vendosura nga gjykata kur ka caktuar alternativën e parë të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe nisur nga kjo qasje, është parashikuar se një kërkesë të tillë mund ta bëjë vetëm prokurori në gjykatë, e cila nga ana e saj mund të procedojë me disponim “revokim” apo “zëvendësim” të alternativës së dënimit me një tjetër.

### 1.2.1. Pjesëmarrja në gjykim:

Referuar vendimeve gjyqësore përfundimtare të gjykatave të rretheve gjyqësorë, për aq sa mund të evidentohet konstatohet se, si pjesëmarrës në gjykim përveç palëve kërkuesi dhe prokurorit, nuk ndiqet e njëjta praktikë lidhur me thirrjen e Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) dhe Shërbimit të Provës, ndërsa evidentohet se në përgjithësi nga ana e gjyqtarëve është proceduar me administrimin e raporteve përkatëse të këtyre dy institucioneve.

Në dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale të kohës që rregullonte konkretisht mënyrën e të proceduarit me paraqitjen

<sup>217</sup> nr. 8331, datë 21.04.1998 i ndryshuar.

<sup>218</sup> ligji nr. 79/2020.

<sup>219</sup> nenet 31/4 dhe 31/10 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar; nenet 38/8 dhe 40 të ligjit nr. 79/2020.

e kërkesës për lirim me kusht, është parashikuar se gjykatat me anë të një kërkesë i drejtohen dy institucioneve IEVP dhe Shërbimit të Provës për të paraqitur raportet përkatëse. Ligji në fjalë me procedurën në fjalë, përcakton qartë kompetencat si të drejtorit të IEVP-së, ashtu edhe të Shërbimit të Provës<sup>220</sup>.

Referuar ligjit në fjalë, për gjykatën është e detyrueshme që të procedojë me kërkesën drejtuar dy institucioneve për përgatitjen e raporteve dhe paraqitjen e tyre, me qëllim që nga ana e gjykatës të administrohet si provë dhe përdorur për marrjen e vendimit të saj për pranimin/rrëzimin e kërkesës.

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, nga gjykatat e rretheve gjyqësore kur është gjykuar kërkesa në themel, është proceduar në përgjithësi me administrimin e raporteve në fjalë. Vetëm në një rast<sup>221</sup> të një vendimi të gjykatës së rrethit gjyqësor është evidentuar mosadministrimi nga IEVP i vlerësimit dinamik të sjelljes së të dënuarit dhe i raportit të shërbimit të provës dhe i kartelës së të dënuarit, e cila është konsideruar nga Gjykata e Apelit si moszbatim i nenit 31/6 pika 3 të ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Për Gjykatat e Apeleve është evidentuar mënyra e të proceduarit si rregull të thirrjes së IEVP në gjykimet e kërkesave “lirim me kusht” në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në Gjykatën e Apelit Korçë; në Gjykatën e Apelit Gjirokastër konstatohet se nga 7 raste ku janë shqyrtuar ankimet lidhur me kërkesat për lirim me kusht është proceduar vetëm në 1 herë thirrja e IEVP-së; Në gjykatat e tjera nuk evidentohet të jetë thirrur IEVP apo Shërbimi i provës.

### **1.2.2. Kërkuesi dhe prokurori si palë ndërgjyqëse:**

Përsa i përket kërkuesit, nga vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore rezulton se jo në të gjitha rastet e gjykimeve në fjalë, kërkuesi ka patur një avokat. Kjo evidentohet kryesisht tek gjykimet të cilat përfundojnë me mënyrë disponimi pushim/mospranim/deklarim i papranueshëm për shkak të heqjes dorë, mosparaqitje, moskompetencë. Tek vendimet pranim/rrëzim konstatohet se jo në të gjitha gjykimet në gjykatat e rretheve gjyqësore evidentohet se kërkuesi është mbrojtur nga një avokat. Për t’u veçuar Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Mat, Krujë dhe Gjirokastër në të cilat evidentohet se në vendimet e pranim/rrëzim në të gjitha rastet kërkuesi ka patur të pranishëm avokat.

Ndërsa në gjykimet në Gjykatat e Apeleve është konstatuar zhvillimi në prani të mbrojtësit të kërkuesit, i cili është caktuar nga vetë kërkuesi apo kryesisht nga ana e gjykatës.

Përsa i përket prokurorit, nga vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore rezulton se në të gjitha rastet që është proceduar me vendim pranim/rrëzim, prokurori ka qenë i pranishëm duke shprehur qëndrimin e tij, ndërsa nuk konstatohet një gjë e tillë në të gjitha rastet kur për shkak të heqjes dorë të kërkuesit nga kërkesa është vendosur deklarim i

<sup>220</sup> vendimi unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>221</sup> shih vendimin nr. 387, datë 31.05.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë që ka prishur vendimin nr. 75, datë 29.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim me një trupë tjetër.

papranueshëm/pushim/mospranim apo edhe në rastin kur është vendosur moskompetencë. Ndërsa është për t'u veçuar se në të gjitha vendimmarrjet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Berat, Lezhë, Tropojë dhe Krujë. Ndërsa në gjykimet në Gjykatat e Apeleve është konstatuar zhvillimi në prani të prokurorit.

Në dispozitat procedurale të zbatueshme për gjykimet e kërkesave "lirim me kusht" që përfshihen në fazën e ekzekutimeve, dhe konkretisht nenit 471/4 të K. Pr. Penale është parashikuar konkretisht pjesëmarrja e detyrueshme e mbrojtësit dhe e prokurorit.

### **1.3. Mënyra e disponimit:**

Nga vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore është konstatuar se për periudhën e inspektimit, është disponuar: me pranim kërkesë, me rrëzim kërkesë, me pushim, me mospranim, me deklaram i papranueshëm dhe me shpallje moskompetence".

**1.3.1. Gjykatat kanë disponuar me shpallje moskompetence,** për shkak të vuajtjes apo transferimit të kërkuarit/të dënuarit në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtronte kompetencat e saj gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Në pjesën më të madhe, shpallja e moskompetencës nga gjykatat e rretheve gjyqësore është evidentuar për rastet e transferimit të kërkuarit/të dënuarit në një IEVP tjetër jashtë territorit ku ushtronte kompetencat e saj gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa. Ndërkohë që në të gjitha këto raste kërkuari në datën e paraqitjes së kërkesës ka qenë në IEVP që përfshihej në territorin ku ushtronte kompetencat e saj gjykata e rrethit gjyqësor ku ishte paraqitur kërkesa.

Nga rastet në të cilat shpallja e moskompetencës është vendosur për shkak të ndryshimit të vendit të vuajtjes së dënimit të të dënuarit pas paraqitjes së kërkesës prej tij, evidentohet një rast<sup>222</sup> kur për shkak të ndryshimit të vendit të vuajtjes së dënimit/kthimit sërish në IEVP të të dënuarit gjatë kohës kur çështja ishte për gjykim në gjykatën tjetër ku ishin kaluar aktet, përsëri është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kthimi i akteve në gjykatën fillestare që kishte vendosur shpalljen e moskompetencës. Në këtë të fundit, megjithëse ishte ngritur si diskutim nëse mund të pranonte kompetencën për gjykimin e kësaj çështjeje referuar procedurës që ishte ndjekur, nuk është shqyrtuar për shkak të heqjes dorë të kërkesës nga i dënuari dhe përfundimit të gjyimit për rrjedhojë, me deklaram të papranueshëm<sup>223</sup>.

Gjykatat e rretheve gjyqësore në vendimmarrjet e tyre, janë mbështetur në argumentim bazuar në nenin 477 të K. Pr. Penale dhe në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale në fuqi në kohën e vendimmarrjes. Ndërsa nuk evidentohet që vendime të tilla të jenë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatat e Apelit.

---

<sup>222</sup> me vendimin nr. 605, datë 01.04.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila për të njëjtin shkak transferimi të të dënuarit në IEVP Vlorë, me vendimin nr. 741, datë 22.05.2019, ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e akteve sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e cila ka dalë më pas me vendimin nr. 1129, datë 20.06.2019 "deklaram i papranueshëm të kërkesës" për shkak të heqjes dorë të kërkuarit.

<sup>223</sup> Vendimi me nr. 1129, datë 20.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në nenin 477 të K. Pr. Penal ku parashikohet shprehimisht kompetenca për lirim me kusht, është përcaktuar se kompetente për gjykimin e kërkesave të tilla është gjykata e rrethit gjyqësor që përfshin vendin e ekzekutimit të kërkesit. Në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale me nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar, parashikohej se i dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, kishte të drejtë të paraqiste kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Dhe në lidhje me moskompetencën, zbatohen dispozitat e përgjithshme në Kodin e Procedurës Penale, nenet 83 - 91, ku nuk parashikohet ankim ndaj tyre dhe zgjidhje nga Gjykata e Lartë të mosmarrëveshjes së ngritur nga gjykata të cilës i kanë kaluar aktet me vendim shpallje moskompetence.

Nga parashikimet procedurale në fjalë, nuk ka rregullim konkret lidhur me rastet kur kërkuesi ndryshon vendin e vuajtjes së dënimit pas paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe vendi i ri i vuajtjes së dënimit nuk përfshihet në kompetencën e gjykatës ku është regjistruar kërkesa.

Lidhur me çështjen e kompetencës në rastet e ndryshimit të vendit të vuajtjes së dënimit pas regjistrimit në gjykatën e rrethit gjyqësor, të kërkesës “lirim me kusht”, konstatohet se është ngritur si diskutim dhe është trajtuar edhe nga Gjykata e Lartë, kur ka shqyrtuar mosmarrëveshjet e ngritura për kompetencat në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, referuar nenit 91 të K. Pr. Penale, duke dalë edhe me vendimin njësuës nr. 4, datë 12.01.2023. Në këtë vendim Kolegji Penal ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes. Sipas vendimit në fjalë, Kolegji ka vlerësuar marrjen e vendimit njësuës, për shkak të konstatimit se ndërmjet trupave gjykuese të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen në fjalë dhe për shkak të paraqitjes së një sërë çështjeve të tjera mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me objektin në fjalë. Në këtë vendim, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se për përcaktimin e gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e dënimit, duhet t'i bëhet referim momentit të paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit në shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit, kompetencë që nuk mund të ndryshojë sa herë ndryshon vendi i vuajtjes së dënimit me burgim të kërkuarit, sipas IEVP-së përkatëse. Për mbështetjen e këtij konkluzioni, Kolegji arsyeton se: *“Kolegji çmon, t'i referohet parimit bazë të së drejtës procesuale të “perfection jurisdictionis”, sipas të cilit kompetenca e gjykatës përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe ndryshimet e situatës faktike, që mund të ndodhin pas këtij momenti, nuk pasjellin ndryshimin e gjykatës kompetente. Ky parim garanton dhe minimumin e nevojshëm të sigurisë dhe stabilitetit për personin e dënuar, në mënyrë që kërkesa e tij të shqyrtohet nga gjykata e ekzekutimit (gjyqtari natyral), e konstituuar si e tillë në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të mos ndryshojë (kushtëzohet) në varësi të ekzigjencave dhe emergjencave të organit administrativ të ekzekutimit të vendimeve penale. ... Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës së ekzekutimit bëhet mbi bazën e një raporti (marrëdhënieje) të karakterizuar prej stabilitetit, midis të dënuarit dhe institucionit në të cilin ndodhet, duke përjashtuar që të marrë përparësi thjesht prania fizike e kërkuarit në*



*çfarëdolloj instituti, e përcaktuar për arsye të rastësishme dhe momentale (si p. sh: ato të lidhura me situata tranziti gjatë transferimit nga një institut në tjetrin etj..) dhe që nuk sigurojnë minimumin e stabilitetit të nevojshëm për krijimin e një raporti midis autoriteteve dhe të dënuarit, të përshtatshëm për shqyrtimin e personalitetit të tij në këtë fazë. Sa më sipër, ... gjykata e vendit të ekzekutimit ku ishte paraqitur për herë të parë kërkesa ka të drejtën dhe detyrimin të vazhdojë me shqyrtimin e saj në themel dhe nuk është në përputhje me dispozitat procedurale penale shpallja e moskompetencës tokësore prej saj”.*

Këtë qëndrim e gjejmë edhe në disa vendime<sup>224</sup> të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar mosmarrëveshjet e ngritura nga gjykatat lidhur me kompetencën në shqyrtimin e kërkesave “lirim me kusht”. Këto vendime i përkasin si periudhës para vendimit njëses dhe pas vendimit njëses. Në vendimet e marra pas vendimit njëses, konstatohet se nga ana e kolegjeve bëhet referim edhe tek vendimi njëses sa më sipër.

**1.3.2. Përsa i përket disponimit me pushim,** referuar vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është për shkak të konstatimit të tërheqjes nga kërkesa/heqjes dorë nga kërkesa, mosparaqitje pa shkak e kërkuarit megjithë dijeninë e tij apo edhe në rastet kur është konstatuar lirimi i kërkuarit nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, dhe kur i dënuari ka ndërruar jetë.

Me këtë lloj disponimi, konstatohet se është proceduar nga pothuaj të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore<sup>225</sup> edhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kur janë ndodhur përpara shkaqeve kryesisht të heqjes dorë/tërheqjes nga kërkesa apo mosparaqitjes. Është për t’u theksuar se një nga këto raste vendimmarrje pushimi për shkak të tërheqjes së kërkesës, është

<sup>224</sup> Ndër të tjera:

Vendimi nr. 00-2022-1226, datë 11.10.2022, me kërkuar Petraq Kote, me objekt “lirim me kusht”, ku çështja e kompetencës ishte ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas shpalljes së moskompetencës tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për shkak të transferimit të të dënuarit në një IEVP tjetër pas datës së regjistrimit të kërkesës në këtë gjykatë. Trupi gjykues Ilir Panda, Sokol Binaj, Sandër Simoni.

Vendimi njëses nr. 4, datë 12.01.2023, me kërkuar Riza Çera, me objekt “aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ/qëndrim në shtëpi”, ku çështja ishte ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas shpalljes së moskompetencës tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkak të transferimit të të dënuarit në një IEVP tjetër pas datës së regjistrimit të kërkesës në këtë gjykatë. Kolegji me përbërje Ilir Panda, Albana Boksi, Medi Bici, Sokol Binaj, Sandër Simoni.

Vendimi nr. 00-2023-226, datë 03.02.2023, me kërkuar Isak Vrapit, me objekt “lirim me kusht”, ku çështja e kompetencës ishte ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas shpalljes së moskompetencës tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për shkak të transferimit të të dënuarit në një IEVP tjetër pas datës së regjistrimit të kërkesës në këtë gjykatë. Trupi gjykues Medi Bici, Sokol Binaj, Sandër Simoni.

Vendimi nr. 00-2023-404, datë 09.03.2023 me kërkuar Rezo Agbari, me objekt “lirim me kusht”, ku çështja e kompetencës ishte ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas shpalljes së moskompetencës tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për shkak të transferimit të të dënuarit në një IEVP tjetër pas datës së regjistrimit të kërkesës në këtë gjykatë. Trupi gjykues Ilir Panda, Albana Boksi, Medi Bici.

<sup>225</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk ka patur raste të disponimit me pushim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk ka patur raste të shqyrtimit të kërkesave “lirim me kusht”.

bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit<sup>226</sup> e cila ka pranuar si të drejtë vendimmarrjen e gjykatës së rrethit gjyqësor, duke argumentuar bazuar në nenin 417/5 të K. Pr. Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017.

Neni 471 i K. Pr. Penale si dispozitë e veçantë që parashikonte mënyrën e disponimit nga gjykata për kërkesat në fazën gjatë ekzekutimit të vendimeve penale, si para ashtu edhe pas ndryshimeve procedurale penale me ligjin nr. 35/2017, nuk parashikonte konkretisht sesi procedohej për shkaqet e mësipërme, dhe as llojin e disponimit “pushim”.

Me ndryshimet sipas ligjit nr. 35/2017, legjislatori duke shtuar një paragraf në nenin 471 të K. Pr. Penale parashikoi posaçërisht se në rastet kur kërkuesi nuk paraqitej në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithë dijeninë e tij për datën dhe orën e saj, si edhe kur hiqte dorë nga kërkesa apo ndryshonte objektin e saj, gjykata do të duhej të dispononte me papranueshmëri. Me këtë mënyrë do të duhej të procedohej me hyrjen në fuqi të ligjit në fjalë, kur konstatoheshin rrethanat e përshkruara në dispozitë.

Nisur nga të dhënat sa më sipër, vlerësohet e rëndësishme që nga ana e gjykatave të respektohet mënyra e të proceduarit nga neni 471 i K. Pr. Penale edhe në drejtim të disponimit me deklaram të papranueshëm sipas parashikimeve të paragrafit 5 të dispozitës në fjalë.

**1.3.3. Përsa i përket disponimit me “deklarimin e papranueshëm të kërkesës”,** referuar vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore, arsyeja për të cilën gjykata ka disponuar në këtë mënyrë është referuar paragrafëve 2 dhe 5 të nenit 471 të K. Pr. Penal, sipas shkakut të rezultuar gjatë gjykimit. Gjyqtarët kanë vendosur të deklarojnë të papranueshme kërkesën referuar paragrafit 2, ashtu siç parashikon dispozita në fjalë - duke e konsideruar haptazi të pabazuar kur kanë konstatuar se kërkuesi nuk ka plotësuar kohën e dënimit të vuajtur të përcaktuar në nenin 64 të K. Penal që i jep mundësinë për të përfitur nga lirimi me kusht, për shkak të kryerjes së një krimi tjetër me dashje, për shkak të statusit të bashkëpunëtorit të drejtësisë së të dënuarit; si dhe për shkak të përsëritjes të një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur në të njëjtat fakte. Përsa i përket bazës ligjore paragrafit 5, të nenit 471 të K. Pr. Penale, kjo është përdorur nga gjyqtarët ashtu siç parashikon dispozita në fjalë, në rastet kur kanë konstatuar se kërkuesi nuk është paraqitur pasi është liruar nga burgu, apo kur kërkuesi ka hequr dorë/tërhequr kërkesën.

Gjithashtu është evidentuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, që 1 gjyqtar ndodhur para shkaqeve të parashikuar në paragrafin 5, të nenit 471 të K. Pr. Penale, në vendimet e periudhave pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 pasi deklaronte papranueshmërinë e kërkesës në pikën 1, vazhdonte në pikën 2 të dispozitivit me disponimin për pushimin e kërkesës.

Lidhur me këtë mënyrë disponimi në drejtim të kriterit objektiv të mospërbushjes së kohës së vuajtjes së dënimit, është konstatuar në 1 rast interpretimi që Gjykata e Apelit<sup>227</sup> i ka bërë natyrës së kësaj mënyre disponimi që nuk gjykon kërkesën në themel. Është pikërisht kjo natyrë e këtij

<sup>226</sup> vendimi nr. 223, datë 10.04.2018 i Gjykatës së Apelit Vlorë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit gjyqësor Fier.

<sup>227</sup> vendimin nr. 10-2018-1047/168, datë 22.05.2018, i Gjykatës së Apelit Durrës.

disponimi që duhet patur në konsideratë nga gjyqtarët, pasi legjislatori në nenin 477/2 të K. Pr. Penale llojin e disponimit të gjykimit në themel si “rrëzimi” e lidh me pamundësinë e përsëritjes së kërkesës për lirim me kusht nëse nuk ka kaluar periudha 6 mujore nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës të ketë marrë formë të prerë.

**1.3.4. Përsa i përket disponimit me mospranim,** konstatohet se vetëm në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Fier, Durrës, Elbasan ka vendimmarrje të tilla të cilat i përkasin të gjithë periudhës së inspektimit dhe se shkaqet ku bazohet vendimmarrja lidhet me mosparaqitjen e kërkuarit pasi është liruar nga vuajtja e dënimit me burgim, për arsye të heqjes dorë/tërheqjes së kërkesës, të mosplotësimit të kohës së caktuar të vuajtjes së dënimit referuar parashikimeve të nenit 64 të K. Penal për të mundësuar përfitim të lirit me kusht, si edhe të përsëritjes së një kërkesë të rrëzuar, mbështetur në të njëjtat fakte. Gjithashtu në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është evidentuar se është disponuar në këtë mënyrë edhe për shkak të mosplotësimit të kriterëve të nenit 64 të K. Penal e lidhur me kriterin subjektiv të arsyeve të veçanta. Për këto raste, gjyqtarët kanë proceduar me bazë ligjore nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale duke referuar sipas shkaqeve të parashikuara shprehimisht paragrafëve 2 ose 5, ose edhe duke përdorur si bazë ligjore vetëm nenin 64 të K. Penal.

Për 1 nga këto raste ku shkak ishte për shkak të përsëritjes së kërkesës pa kaluar afati i parashikuar në nenin 477 të K. Pr. Penale, vendimmarrja e gjykatës së rrethit gjyqësor<sup>228</sup> është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit e cila nuk është shprehur lidhur me këtë mënyrë disponimi dhe gjithashtu nuk ka shqyrtuar këtë vendimmarrje në drejtim të këtij shkak. Gjykata e Apelit në këtë rast, megjithëse ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, ka anashkaluar argumentet dhe konkluzionin e kësaj gjykate duke analizuar të gjitha kushtet objektive dhe subjektive të institutit të lirit me kusht, dhe konkluduar mosplotësimin e arsyes së veçantë.

Referuar dispozitave materiale dhe procedurale të rregullimit të institutit të lirit me kusht, për periudhën objekt inspektimi, nuk parashikohet disponimi “mospranim”. Nga vendimmarrjet e trajtuara objekt i këtij inspektimi, konstatohet se kjo mënyrë disponimi është përdorur si në rastet e gjykimit jo në themel të kërkesës ashtu edhe kur është gjykuar çështja në themel, për të cilat legjislatori ka parashikuar rregullimet për disponimet me pranim, rrëzim, deklaram i papranueshëm.

**1.3.5. Përsa i përket disponimit me “mosshqyrtim”,** konstatohet se kjo është evidentuar vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në vitet 2018 dhe 2019, dhe se shkaqet ku bazohet vendimmarrja në të gjitha këto raste lidhet me shprehjen e vullnetit në gjykim nga ana e kërkuarit se heqin dorë nga gjykimi i çështjes me objekt “Lirim me kusht”.

Referuar dispozitave materiale dhe procedurale të rregullimit të institutit të lirit me kusht, për periudhën objekt inspektimi, nuk parashikohet disponimi “mosshqyrtim”, dhe për këtë

<sup>228</sup> Vendimi nr. 31/602, datë 12.02.2018, ku nga ana e gjyqtarit është proceduar duke u mbështetur në arsyetimin e periudhës 6 mujore referuar parashikimeve të nenit 477 të K. Pr. Penale.

vlerësohet e rëndësishme që nga ana e gjykatave të respektohet mënyra e të proceduarit nga neni 471 i K. Pr. Penale edhe në drejtim të disponimit me deklarim të papranueshëm sipas parashikimeve të paragrafit 5 të dispozitës në fjalë.

**1.3.6. Gjykatat kanë disponuar me vendim “rrëzim i kërkesës për lirim me kusht”/”pranim i kërkesës për lirim me kusht”,** pas analizimit si të kriterëve objektive ashtu edhe të kriterëve subjektive, në raport me rrethanat e çështjes sipas parashikimeve të nenit 64 të K. Penal, dhe në pjesën më të madhe duke bërë pjesë integrale të arsyetimit të vendimit edhe interpretimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues me nr. 2/2015.

Gjykatat kanë disponuar me rrëzim kërkesë kryesisht për shkak të argumentimit nga ana e tyre të mosprovueshmërisë të arsyeve të veçanta që të tregonin se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, ndërsa është pranuar plotësimi i kriterëve objektive të parashikuar në nenin 64 të K. Penal. Gjithashtu si shkak për rrëzimin e kërkesës, është konstatuar edhe mosplotësimi i kohës së caktuar të dënimit të parashikuar nga neni 64 i K. Penal për të përfutur lirimin me kusht, ekzistenca e kriterit ndalues në drejtim të përsëritjes për një krim të kryer me dashje apo llojit të veprës penale për të cilën ishte dënuar kërkuesi që kërkonte lirimin me kusht, të përsëritjes së kërkesës pa kaluar afati 6 mujor nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi i rrëzimit për kërkesën e të njëjtit të dënuar me të njëjtin objekt sipas parashikimeve të nenit 477/2 të K. Pr. Penale, në një rast të vlerësimit se nuk mund të procedohet me kërkesën për lirimin me kusht të kërkuetit i cili është vuajtës i alternativës së dënimit “qëndrim në shtëpi” ; në një rast është konstatuar edhe disponimi me rrëzim edhe për shkak të moslegjitimitit të kërkuetit, pasi kërkesa ishte paraqitur nga mbrojtësi; dhe në një rast tjetër<sup>229</sup> është konstatuar si shkak rrëzimi fakti se ndaj kërkuetit në vendimin e gjykatës që është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim, është aplikuar neni 65/a i Kodit Penal, periudha e sigurisë.

Referuar parashikimeve ligjore vendimi i pranimit/rrëzimit të kërkesës përbën vendimmarrje që e zgjidhin çështjen në themel dhe si të tilla ato përmbajnë bazën ligjore të zgjidhjes së çështjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së saj. Këto vendimmarrje dallojnë nga vendimmarrjet e tjera si deklarim i papranueshëm apo pushim të cilat nuk e zgjidhin çështjen në themel dhe nuk i jep përgjigje kërkuetit lidhur me të drejtën materiale të pretenduar. Këto vendimmarrje nuk kanë ndryshime thjesht formale, por edhe thelbësore pasi janë të lidhura me pasojat që pasojnë vendimmarrjet përkatëse. Mund të përmendim këtu, parashikimin e nenit 477/2 të K. Pr. Penale që përcakton një afat kohor që duhet të tejkalohet para se të procedohet me një kërkesë të re lirim me kusht. Është për këtë arsye që nga legjislatori janë parashikuar konkretisht rastet se kur nga ana e gjykatës do të duhet të procedohet me vendim jopërfundimtar në një gjykim të kërkesës gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal, ku përfshihet edhe instituti i lirit me kusht. Për rrjedhojë është e rëndësishme zbatimi me korrektësi i parashikimeve

<sup>229</sup> i vetmi rast i evidentuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në vendimin nr. 5, datë 09.02.2017.

ligjore edhe në drejtim të mënyrës së të proceduarit përsa i përket kërkesave “lirim me kusht”.

#### 1.4. Ecuria e gjykimit të kërkesës në gjykatë më të lartë

Referuar vendimeve gjyqësore objekt të këtij inspektimi, konstatohet se objekt i ankimit në një gjykatë më të lartë janë bërë kryesisht vendimmarrjet për pranimin/rrëzimin e kërkesës, përkatësisht nga prokurori për rastet e vendimmarrjeve për pranimin dhe nga ana e kërkuarit për rastet e rrëzimeve. Ankimet kanë ndjekur procedurën e parashikuar në ligjin procedural si në drejtim të paraqitjes, kompetencës dhe të shqyrtimit të saj.

Referuar vendimmarrjeve të gjykatave të apeleve, konstatohen qëndrime të ndryshme lidhur me aspekte materiale apo procedurale të shqyrtimit të kërkesës së lirimit me kusht. Për t'u theksuar, si një konstatim i përgjithshëm me rastin e gjykimeve në apel të lidhur me rastet e ndryshimit nga Gjykatat e Apeleve të vendimeve të rrëzimit të gjykatave të rretheve gjyqësore kur këto kanë të bëjnë kryesisht me mosplotësimin e kriterëve subjektive, rezultojnë se vlerësimi mbi të cilën është arritur në konkludim ndryshe është bërë mbi bazën e të njëjtave provave të administruara në gjykatën e faktit, por duke i interpretuar ndryshe në drejtim të krijimit të bindjes së tyre si gjyqtarë se me vuajtjen e dënimit është arritur qëllimi i edukimit dhe se riintegrimi në shoqëri i të dënuarit është i mundshëm.

Lidhur me këto ankime, nuk ka ndonjë vendim njësoj/ndryshues i praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Ashtu siç është përmendur edhe më sipër, nga Kolegji i Gjykatës së Lartë është nxjerrë një vendim njësoj me nr. 4, datë 12.01.2023 që lidhet me kompetencën e gjykimit të kërkesave gjatë fazës së ekzekutimit, ku përfshihet edhe instituti i lirimit me kusht.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kushtetuese ka detyrimin të garantojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duke ushtruar këtë veprimtari pa cenuar pavarësinë e këtij pushteti dhe pa zëvendësuar një organ gjyqësor. Në mbështetje të nenit 145, pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo dispozitë sanksionon parimin e pavarësisë së brendshme të gjyqtarit në ushtrimin e funksionit të tij. Në kuptim të kësaj pavarësie, gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, gjyqtari në zbatimin e një dispozite ligjore për një çështje specifike konkrete i jep asaj edhe interpretimin, edhe kuptimin e tij.

Në këtë kuadër, arrihet në konkluzionin se gjykata të ndryshme mund të arrijnë në përfundime të ndryshme. ILD paraprakisht vlerëson se jurisprudenca nuk mbetet e pandryshueshme, por përkundrazi ajo evoluon në thelb, dhe parimi i administrimit të mirë të drejtësisë nuk nënkupton imponimin e konsistencës strikte të praktikës gjyqësore. Këto qëndrime apo interpretime të ndryshme nga ana e gjykatave janë një rezultat i pritshëm dhe i pashmangshëm i procesit të interpretimit të dispozitave ligjore dhe përshtatjes së tyre me situatat materiale që ato synojnë të mbulojnë. **Megjithatë këto qëndrime të ndryshme nga ana e gjykatave mund të pranohen kur sistemi i brendshëm ligjor është në gjendje të zgjidhë vetë mosmarrëveshjet, ose duke vendosur me të njëjtën qasje, si dhe duke balancuar nevojën për zhvillimin e praktikës gjyqësore me parimin e sigurisë juridike.**

Përgjatë këtij procesi inspektimi tematik janë konstatuar një sërë çështjesh për të cilat gjykata të ndryshme mbajnë qëndrime dhe interpretime të ndryshme. Këto çështje lidhen me disa aspekte të interpretimit dhe zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal në kuadër të: (i) përcaktimit të periudhës kohore referuar datës së paraqitjes së kërkesës “lirim me kusht”/datës së gjykimit që do të merret në konsideratë në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, për efekte të përfitimit të lirimit me kusht; (ii) përcaktimit të mënyrës së interpretimit të parashikimit të paragrafit të parë, të nenit 64 të Kodit Penal në lidhje me togfjalëshin: “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; “- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”; në aspekt të dënimit të dhënë nga gjykata apo dënimit që parashikon dispozita penale për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi; (iii) lidhur me përfshirjen e kohës së punës në përlllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur e cila i jep mundësi kërkuesit të përfitojë lirimin me kusht; (iv) interpretimit të kushtit ndalues “përsëritës” të parashikuar në nenin 64, paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuar parashikimeve të nenit 69/a të Kodit Penal; (v) përcaktimi i kohës së kushtit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban në konsideratë faktin se përcaktimi i politikave penale është kompetencë ekskluzive e pushtetit legjislativ dhe për rrjedhojë parashikimi i rregullave apo normave në lidhje me institutin e lirimit me kusht është një e drejtë e organit legjislativ, i cili gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi dhe është në diskrecionin e tij, brenda konceptit të politikës penale. Por në të njëjtën kohë, interpretimi dhe zbatimi i saj i përket organeve të pushtetit gjyqësor.

Në nenin 141 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht kompetenca e Gjykatës së Lartë që të shqyrtojë çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ndërkohë, për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet sipas ligjit. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të zhvillojë; të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme.

Në këtë aspekt, roli i Gjykatës së Lartë është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria. Procesi i ndryshimit dhe njësimimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë, dhe detyrimi i gjykatave të zakonshme për të zbatuar vendimet *nomofilatike*, nga ana tjetër, i shërbejnë vlerave të uniformitetit dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës. Në këtë kuadër Gjykata e Lartë duke vlerësuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara paraprakisht nga ana e saj si sasia, koha, apo natyra e qëndrimeve apo interpretimeve të ndryshme të mbajtura nga gjykata më të ulta, duhet të adresojë nevojën për siguri juridike, duke ushtruar funksionin e saj kushtetues në kuadër të harmonizimit të së drejtës, si dhe koherencës në kuadër të vazhdueshmërisë së orientimeve jurisprudenciale. Ky funksion mund të realizohet si në kuadër të ushtrimit të kompetencës të saj nëpërmjet zhvillimit të praktikës gjyqësore në

lidhje me çështjet e trajtuara në Raportin e Inspektimit (apo të tjera), apo edhe njësimit apo ndryshimit të saj sipas parashikimeve të nenit 141, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **1.4.1. Qëndrimi i organit të akuzës në seancë gjyqësore dhe ankimet apo rekursat ndaj vendimeve për të cilat gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë disponuar**

Referuar vendimeve gjyqësore, konstatohet se në përgjithësi prokurori si palë ndërgjyqësore ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me kërkesën “lirim me kusht”, dhe në vlerësimin e tij ka ushtruar ankimin përkatës.

Rastet për të cilat nga ana e prokurorit është mbajtur qëndrimi për rrëzimin e kërkesës për “lirim me kusht” janë mbështetur në arsyet kryesisht të lidhura me kriterin subjektiv të mosprovueshmërisë së arsyeve të veçanta, ashtu sikurse janë vënë re për raste të tjera edhe për mosplotësimin e kriterëve objektive të lidhur me vendin e vuajtjes së dënimit, përlllogaritjen e masës së dënimit që duhet të ketë vuajtur kërkuesi për të përfituar lirimin me kusht dhe kushtet ndaluese.

Në rastet kur qëndrimi i prokurorit të seancës në gjykatën e rrethit gjyqësor ka qenë i lidhur me këto kritere objektive, është bërë apel brenda afatit ligjor duke e paraqitur në gjykatën kompetente. Apeli i ushtruar konstatohet se kryesisht lidhen me përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit që kërkohet sipas nenit 64 të K. Penal duke iu referuar datës së paraqitjes së kërkesës, e evidentuar në ankimin e ushtruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit që kërkohet sipas nenit 65 të K. Penal e evidentuar në ankimin e ushtruar nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Korçë dhe Krujë; përlllogaritjes së kohës së punës, e evidentuar në ankimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë; në interpretimin e kushtit ndalues përsëritës, e evidentuar në ankimet e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tropojë, Elbasan, Durrës, Fier; në interpretimin e mënyrës së vuajtjes së dënimit me burgim, e evidentuar në ankimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat.

Më tej, mbi bazë të këtij ankimi, prokurori i apelit ka mbajtur qëndrimin e tij në vlerësim të qëndrimit të prokurorit të seancës, për të vlerësuar më tej qëndrimin e tij për kryerjen e rekursit. Rekursat e ushtruara konstatohet se kryesisht lidhen me përlllogaritjen e kohës së punës dhe përlllogaritjes së masës së dënimit të caktuar për të vuajtur sipas nenit 64 të K. Penal referuar datës së paraqitjes së kërkesës, e cila evidentohet e ushtruar nga Prokuroria e Apelit Korçë, me mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim të kërkuesit, e cila evidentohet e ushtruar nga Prokuroria e Apelit Vlorë, me interpretimin e kushtit ndalues përsëritës për kryerjen e një krimi të kryer me dashje me rastin e bashkimit të dënimeve, e cila evidentohet e ushtruar nga Prokuroria e Apelit Durrës.

## **2. Procedurat për caktimin e gjyqtarit apo prokurorit për trajtimin e kërkesave me objekt: “Lirim me kusht”**

### **2.1. Caktimi i gjyqtarit**



206

Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Gjykimi i kërkesave të tilla, është bërë nga trupa gjykuese e përbërë nga një gjyqtar.

Ky i fundit, është ndryshuar përkatësisht vetëm për shkaqe kur për të njëjtin kërkues dhe për të njëjtin objekt kërkese që po shqyrtohej ishte dhënë më parë nga një gjyqtar tjetër një vendim jopërfundimtar si shpallja e moskompetencës/pushim çështje; dhënie dorëheqje për shkak gjykimi në themel/heqje dorë për shkaqe të tjera/për shkaqe raporti shëndetësor/komandimi në një detyrë tjetër. Ndryshimi referuar shkaqeve të sipërpërmendura, përveç shkakut të përsëritjes së kërkesës, në të gjitha rastet e evidentuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, është bërë sërish me anë të shortit elektronik.

Përsa i përket rasteve të përsëritjes së kërkesës nga i njëjti kërkues dhe me të njëjtin objekt, janë vënë re mënyra të ndryshme të të proceduarit për caktimin e gjyqtarit që do të gjykonte kërkesën e re. Kjo mënyrë e të proceduarit evidentohet të ketë qenë e ndryshme si nga njëra gjykatë në tjetrën, ashtu edhe në të njëjtën gjykatë, si dhe e evidentuar si në rastet kur kërkesa e përsëritur është regjistruar pas një kërkesë të mëparshme për të cilën ishte disponuar me vendim jopërfundimtar/përfundimtar, ashtu edhe kur kërkesa përsëritej ndërkohë që nuk kishte përfunduar së shqyrtuari kërkesa pararendëse. Referuar këtyre mënyrave të ndryshme të të proceduarit, konstatohet se në përgjithësi nuk bëhet një verifikim fillestar nëse bëhet fjalë për të njëjtin kërkues që paraqet kërkesë me të njëjtin objekt dhe për të cilin ka përfunduar ose jo shqyrtimi i kërkesave, për të proceduar më tej me caktimin e gjyqtarit që do të gjykojë kërkesën e re. Për rrjedhojë, evidentohen raste kur kërkesa e përsëritur është shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar, duke u proceduar me kalimin drejtëpërdrejt të kërkesës tek gjyqtari që gjykonte/kishte gjykuar me vendim të mëparshëm jopërfundimtar pa iu nënshtruar shortit elektronik, pas verifikimit të kryer, apo duke u proceduar fillimisht me caktimin e një gjyqtari me anë të shortit elektronik si rregull dhe ndryshimit të gjyqtarit të caktuar me këtë mënyrë me gjyqtarin që kishte gjykuar kërkesën pararendëse. Ashtu sikurse janë evidentuar edhe raste kur kërkesat e përsëritura janë shqyrtuar nga gjyqtarë të ndryshëm, kur kërkesat i janë nënshtruar rregullit të përgjithshëm të caktimit të gjyqtarit me short elektronik dhe proceduar nga gjyqtari që caktohej pavarësisht nëse kërkesa ishte e përsëritur.

Përsa i përket mënyrës së të proceduarit për caktimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Apeleve, konstatohet se është proceduar si rregull me short elektronik duke përcaktuar gjyqtarin relator, dhe plotësuar trupa më pas edhe me dy gjyqtarë të tjerë. Gjykimi i kërkesave të tilla në Gjykatat e Apeleve është bërë nga trupë gjykuese e përbërë nga tre gjyqtarë.

Për procedurën e caktimit të gjyqtarëve, në ligjin në fuqi për periudhën objekt inspektimi dhe aktualisht i pandryshuar lidhur me objektin e këtij trajtimi, dhe konkretisht ligji me nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25 parashikohet se ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, i cili realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit. Për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short, sipas ligjit është ngarkuar Këshilli i Lartë Gjyqësor me miratimin e



rregullave të hollësishme.

Në periudhën objekt inspektimi nuk ka patur akt të KLGJ<sup>230</sup> lidhur me parashikimin e rregullimit konkret të këtij parashikimi ligjor, por konstatohet se ka patur një akt të ish KLD-së, vendimi me nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, i cili është zbatuar nga gjykatat. Zbatimi i këtij vendimit të ish KLD-së është pranuar edhe nga vetë KLGJ gjatë nxjerrjes së aktit të tyre me nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”<sup>231</sup>. Gjithashtu është për t’u theksuar se në dy raste nga 33 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ku është bërë ndryshimi i gjyqtarit, sipas RIV është përcaktuar zbatimi i këtij vendimi të ish KLD-së.

Vendimi i ish KLD-së në fjalë, është bërë objekt diskutimi për zbatim në kërkesat e të dënuarit gjatë fazës së ekzekutimit kur këto kërkesa ishin të përsëritura dhe për të cilat ishte proceduar me një vendim jopërfundimtar, nga një gjyqtare në një gjykatë tjetër të rrethit gjyqësor sipas të cilës interpretohej se vendimi rregullonte vetëm ndarjen me short të çështjeve gjyqësore civile sipas Kodit të Procedurës Civile dhe se nuk përfshinte rregullimin e mënyrës së të proceduarit për caktimin e gjyqtarit për këto lloj kërkesash. Për këtë gjyqtarja i është referuar parashikimit konkret të dispozitës përkatëse të vendimit të ish KLD-së, nenit 5 ku përcaktohej se: “Çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve, ku nga përmbajtja e padisë është i mundur identifikimi se është e njëjta çështje përjashtohen nga shorti dhe i kalojnë automatikisht të njëjtit gjyqtar, ...”.

Gjithashtu në vijim të këtij interpretimi, konkludonte se edhe vendimi aktual i KLGJ-së për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore, nuk përfshinte rregullimin e caktimit të gjyqtarit për kërkesat e përsëritura gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, për të cilat nga gjykata ishte disponuar më parë me vendim jopërfundimtar. Gjyqtarja për këtë arsyeton se: “a) vetëm në Kodin e Procedurës Civile është e përcaktuar shprehimisht vendimi jopërfundimtar dhe konkretisht jepet në nenin 127 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “Vendimet jopërfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata ose gjyqtari në rastet e parashikuara në këtë Kod i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si dhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit

<sup>230</sup> Vendimi i KLGJ nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”.

<sup>231</sup> MBLEDHJE E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË (klgj.al). Në këtë mbledhje të datës 29.12.2022 është miratuar vendimi i sipërcituar i KLGJ për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore dhe sipas procesverbalit të mbledhjes, në relativitetin e anëtares së KLGJ lidhur me projektvendimin përkatës, është cituar se: “Aktualisht gjykatat realizojnë ndarjen e çështjeve me short përmes shortit elektronik, bazuar në rregullat e përgjithshme të kodeve të procedurave përkatëse si dhe mbi rregullat e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”. Ndonëse vendimi i KLD-së parashikon rregulla të përgjithshme të cilat nuk bien ndesh me rregullimet e kodeve të procedurave, nisur nga ndryshimet ligjore të pësuar në 2016 mbi kuadrin e plotë ligjor për organizimin e gjykatave dhe organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë, vlerësohet e nevojshme vendimarrja për miratimin e rregullave të detajuara dhe të përditësuara për mënyrën e ndarjes së çështjeve me short”.

*gjqësor të filluar". Në Kodin e Procedurës Penale nuk ka asnjë parashikim ligjor që të përcaktojë kuptimin e vendimit jopërfundimtar në gjykimet penale, si e tillë, nga gjyqtarja ... nuk mund t'i bëhet vendimit të KLGJ, një interpretim me analogji të Kodit të Procedurës Civile dhe t'i jepet kuptim edhe kërksave penale që gjykohen sipas Kodit të Procedurës Penale;".*

Diskutimi sa më sipër ka qenë brenda gjykatës, midis 2 gjyqtarëve ku është ngritur fillimisht nga gjyqtari i parë deklarimi i moskompetencës funksionale të gjykimit të kërkesës duke ia dërguar aktet gjyqtares që kishte disponuar më parë me pushim të kërkesës për shkak të heqjes dorë, dhe në vijim kjo e fundit ka parashtruar mosmarrëveshjen me vendim para Gjykatës së Lartë.

Lidhur me çështjen në fjalë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë sipas vendimit nr. 00-2023-521 datë 28.03.2023 është shprehur se vendimi i KLGJ aktualisht në fuqi nuk trajton vetëm ndarjen me short të çështjeve gjyqësore civile dhe se për këtë i referohet parashikimit konkret të këtij rregullimi në pjesën IV, ku në pikën 1, përcaktohet ndër të tjera se: *"Përjashtohen nga ndarja me short: ... c) çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, si edhe çdo vendim tjetër, që pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procesit gjyqësor të filluar sipas ligjit; ..."*, dhe duke vazhduar me interpretimin se referuar këtij teksti do të përjashtohen nga ndarja me short të gjitha çështjet për të cilat nuk është zgjidhur çështja në themel, sikundër edhe vendimi i pushimit për shkak të heqjes dorë nga kërkuesi. Gjithashtu Kolegji është ndalur edhe në interpretimin se në Kodin e Procedurës Penale nuk ka asnjë lloj papajtueshmërie lidhur me shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë ekzekutimit nga i njëjti gjyqtar, *"përkundrazi, nëse do të veprohej sikundër ka vepruar gjyqtarja parashtruese në këtë rast, do të krijohet një praktikë e gabuar, e cila do t'i jepte mundësi palëve kërkuese që nëpërmjet heqjes dorë nga gjykimi i kërkesve në fazë ekzekutimi, kërkesa këto të cilat mund të paraqiten në çdo moment nga pala, të përzgjidhte gjyqtarin që do të gjykojë çështjen e saj, duke shmangur shortin fillestar. ... 35... Zgjidhja e mosmarrëveshjes për gjykimin e çështjes midis dy gjyqtarëve të ndryshëm në të njëjtën gjykatë, gjyqtarit të cilit i është caktua nëpërmjet shortit elektronik shqyrtimi i një kërkesë të përsëritur së palës dhe gjyqtarit i cili kishte disponuar më parë pushimin e gjykimit të çështjes. Në bazë të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", kjo kërkesë e përsëritur e kërkuetit, duhet të ishte përjashtuar nga ndarja me short".*

Qëndrimi i Kolegjeve lidhur me interpretimin e rregullimit sa më sipër që i është bërë në pjesën IV, përjashtimit nga ndarja me short, është përputhje me qëllimin e parashikimit të këtij rregullimi, referuar relatimit të projektvendimit të vendimit në fjalë. Kështu sipas procesverbalit të mbledhjes së KLGJ, relatorja lidhur me këtë rregullim është shprehur se: *"Kreu IV "Përjashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti". Listohen çështjet gjyqësore të cilat nuk i nënshtrohen procedurës së shortimit elektronik si dhe procedura e evidentimit të tyre dhe ndarjen e përgjegjesisë brenda gjykatës me qëllim llogaridhënien dhe transparencën e procesin për të evituar çdo paqartësi dhe aplikim jo të njëjtë. Çështjet që nuk i nënshtrohen shortit janë çështje për të cilat ligjet e posaçme dhe ligjet procedurale kanë parashikuar ndryshe, të tilla si çështjet urgjente të cilat i kalojnë gjyqtarëve të listës së miratuar nga kryetari i gjykatës, çështjet penale për të cilat është pranuar gjykimi i shkurtuar të cilat gjykohen nga gjyqtari i seancës*

*paraprake sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, si dhe çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, të cilat i kalojnë të njëjtit trup gjykues”.*

Nisur nga sa më sipër, konstatohet se për ndarjen e çështjeve në përgjithësi është proceduar me ndjekjen e rregullimit të përgjithshëm me shortim sipas ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e funksionimit të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Lidhur me rastet e kërkesave të përsëritura, të trajtuara më sipër ku evidentohen edhe praktika të ndryshme të ndjekura nga gjykatat e rretheve gjyqësore, konstatohet se tashmë ka një rregullim konkret të procedurës së ndarjes së çështjeve në gjykatë, referuar detyrimit ligjor dhe si i tillë i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha gjykatat ku përfshihen pa përjashtim të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve<sup>232</sup>.

## **2.2. Caktimi i prokurorit:**

Për përfaqësimin e prokurorisë së rrethit gjyqësor në kërkesat me objekt “lirim me kusht”, konstatohet se në prokuroritë Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Lezhë, Tropojë, Shkodër ku kanë qenë ngritur seksione ekzekutimi të vendimeve penale apo kanë patur të caktuar prokuror ekzekutimi, është ndjekur si rregull të proceduarit me caktimin e prokurorit nga ky seksion apo të prokurorit të ekzekutimit të zyrës së prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku shqyrtohej kërkesa. Për caktimin e prokurorit ndër prokurorët e seksionit të ekzekutimeve, për përfaqësimin e prokurorisë në kërkesat për lirim me kusht për periudhën objekt inspektimi, është proceduar kryesisht me anë të shortit manual duke u evidentuar edhe caktim nga drejtuesi i prokurorisë për një periudhë kohe në vitin 2017, dhe në zyrën e prokurorisë Lezhë është proceduar me anë të ndarjes së çështjeve me objektin në fjalë, në mënyrë të barabartë.

Në prokuroritë e rretheve gjyqësore ku nuk ka patur seksion ekzekutimi apo prokuror të përcaktuar për ekzekutimin, siç është rasti i Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Korçë, Gjirokastër dhe Mat caktimi i prokurorit për përfaqësimin në gjykatë, bëhej ndër prokurorët e zyrës së prokurorisë pranë gjykatës ku zhvillohej gjykimi i kërkesës. Prokurori në rastin konkret, do të ishte prokurori i cili kishte përfaqësuar çështjen në procesin e gjyqimit, kur kërkuesi ishte dënuar nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Korçë, Gjirokastër dhe Mat dhe nëse kërkuesi ishte dënuar nga një gjykatë tjetër ku si përfaqësues prokurorie ka qenë një prokuror i një zyre tjetër prokurorie, caktimi i prokurorit në gjykimin me objekt “lirim me kusht” do të bëhej nga radhët e prokurorisë së zyrës Korçë, Gjirokastër dhe Mat. Caktimi i prokurorëve në këto raste të fundit do të bëhej nga drejtuesi i prokurorisë bazuar në ngarkesën e punës.

E njëjta mënyrë e të proceduarit për caktimin e prokurorit, si edhe në Korçë, etj., është ndjekur edhe në zyrën e Prokurorisë Berat, e lidhur me të njëjtin prokuror që kishte marrë pjesë në gjykimin e deklarimit fajtor dhe dënimit të kërkuesit, por me ndryshim në rastet kur prokurori

---

<sup>232</sup> MBLEDHJE E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË (klgj.al), datë 29.12.2022, Pika 2 e rendit të ditës me objekt: “Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

në fjalë nuk ishte më pjesë e organikës së zyrës së prokurorisë apo kur kërkuesi ishte i dënuar nga një gjykatë tjetër, për përfaqësimin në gjykim të kërkesave me objekt “lirim me kusht”, është ngarkuar prokurori i caktuar me ekzekutimet.

Në Zyrat e Prokurorive të Rrethit Gjyqësor Kavajë, Krujë për periudhën objekt i këtij inspektimi është vënë re ndjekja e disa mënyrave të të proceduarit – shorti ndërmjet të gjithë prokurorëve, për të kaluar më pas në caktimin e prokurorit të ekzekutimeve dhe më tej në Kavajë me ndarjen e çështjeve me objekt “lirim me kusht” ndërmjet prokurorëve në mënyrë proporcionale.

Refeuar informacionit të marrë lidhur me ndarjen e çështjeve me objekt “lirim me kusht”, nga ana e prokurorive Tiranë dhe Krujë, është argumentuar mungesa e mundësisë për të proceduar me short elektronik, për shkak mosfunksionimi të këtij sistemi, dhe argumenti tjetër se në sistemin e shortimit të çështjeve penale që funksionon për prokuroritë nuk ka një rubrikë për shortimin elektronik të këtyre kërkesave. Gjithashtu nga zyrat e disa prokurorive, si ajo e Kavajës dhe Krujës është identifikuar si problematikë e mosprocedimit me short, për shkak të organikës së prokurorëve, ndryshimeve të numrit të prokurorëve dhe ndarjes joproportionale si rrjedhojë e të proceduarit me short.

Në Prokuroritë e Apeleve për caktimin e prokurorit përfaqësues të prokurorisë në gjykimin e kërkesave “lirim me kusht”, është proceduar me anë të shortit manual. Në disa zyra prokurorie të Apelit Vlorë dhe Shkodër, është specifikuar se procedura e shortit manual ka ndjekur atë të hedhjes së shortit për ndarjen e trupave gjyqësore të Gjykatës së Apelit përkatëse. Dhe në zyrat e tjera, me short procedohej referuar çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Apelit dhe për të cilën ishte bërë njoftimi përkatës në prokurori.

Për procedurën e caktimit të prokurorit e lidhur me ndjekjen e çështjeve, konstatohet se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, ligjin me nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhërin nr. 03, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, i ndryshuar, shpërndarja e çështjeve në prokurori, bëhet me anë të shortit elektronik, e cila drejtohet dhe mbikëqyret nga drejtuesi i prokurorisë që mund të parashikojë një raport tjetër të ndarjes së prokurorëve me qëllim sigurimin e një shpërndarjeje të drejtë të ngarkesës mes prokurorëve. Referuar Raportit Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi gjendjen e kriminalitetit të vitit 2017, rezulton se në vitin 2017 është bërë e mundur teknikisht që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të realizonin nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve ndarjen e çështjeve me short në formë elektronike. Kjo theksohet edhe në Raportin Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi gjendjen e kriminalitetit të vitit 2018 dhe të vitit 2022<sup>233</sup>, ndërsa evidentohet se nuk ka një funksionim të tillë të modulit në Prokurorinë e

<sup>233</sup> Në këtë raport, Prokurori i Përgjithshëm shprehet se: “1.8.1. Në kuadrin e këtij rekomandimi të rezolutës dhe rekomandimit prioritar të KM, si dhe në zbatim të ligjit, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit nr. 3/2016, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i ndryshuar, me udhëzimin e përgjithshëm nr. 1/2020, nëpërmjet përdorimit të sitemit CAMS, që mundëson vetëm ndarjen e rastësishme të çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ku si



Përgjithshme dhe prokurorive të apeleve.

Nga dokumentacioni i administruar lidhur me shpërndarjen e çështjeve të tilla në prokuroritë e rretheve gjyqësore, konstatohet se jo nga të gjitha zyrat është përdorur procedura e shortimit, por edhe në ato zyra që është përdorur shortimi, nuk është përdorur shorti elektronik.

Disa zyra të rretheve gjyqësore që nuk përdorin shortimin e kanë zgjidhur nëpërmjet përcaktimit paraprakisht të prokurorit, që do të përfaqësojë prokurorinë, nëpërmjet urdhërit me anë të të cilit rregullohet ekzekutimi i vendimeve penale ku përcaktohet prokurori/ët që do të ngarkohet me këtë detyrë/apo e lidhur me përfaqësimin e çështjes ku kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar. Përveç këtyre dy mënyrave të cilat bazohen në organizimin e kësaj shpërndarjeje referuar specializimit apo njohjes së çështjes, konstatohet se në këto zyra procedohet edhe me caktim të emrit nga drejtuesi i prokurorisë, me siglim të tij<sup>234</sup>, duke u bazuar në ngarkesën e punës dhe një shpërndarje të barabartë.

Nga zyrat e rretheve gjyqësore të cilat kanë përdorur shortin manual, lidhur me këtë mënyrë të proceduarit kanë ngritur si problematikë mosshpërndarje të drejtë ndër prokurorët, për shkak edhe të ndryshimit të organikës së prokurorëve. Për më tepër nga një zyrë<sup>235</sup> është theksuar fakti i mungesës së një rubrike për shortimin elektronik të këtyre kërkesave dhe nga një zyrë tjetër<sup>236</sup> mosfunksionimi i shortimit elektronik për një periudhë kohe.

Dhe për prokuroritë e apeleve, konstatohet se nga të gjitha zyrat për shpërndarjen e çështjeve lidhur me kërkesat për “lirim me kusht”, procedohej për caktimin e prokurorit vetëm me short manual. Në përgjigjet e tyre, zyrat Korçë dhe Shkodër janë shprehur lidhur me arsyen e përdorimit të këtij lloji shorti që lidhet me mosdisponimin e sistemit elektronik apo mungesën e shortit elektronik.

Në konkluzion, duke marrë në konsideratë arsyet dhe argumentet e përmendura nga ana e zyrave të prokurorive lidhur me caktimin e prokurorit përfaqësues në gjykatë lidhur me kërkesat “lirim me kusht”, vlerësohet se duke qenë se ka një parashikim ligjor për këtë, duhet të merren masat për zbatimin e tij, duke i adresuar problematikat/diskutimet e ngritura dhe gjetur zgjidhje, referuar parashikimeve ligjore procedurale dhe ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, për situatat në drejtim të shpërndarjes së pabarabartë që mund të krijojë sistemi elektronik dhe ngarkesa e punës së prokurorëve.

### 3. Analizimi i procedurave të ekzekutimit të vendimit penal me objekt “Lirim me kusht”

---

*rregull në ndarjen e çështjeve nga drejtuesit e prokurorive, që drejton dhe mbikëqyrë këtë proces, përdoret gjerësisht shorti elektronik që mundëson ky system (CAMS) sipas ligjit, që siguron transparencë dhe garanon pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, nëpërmjet këtij procesi (ndarjes së çështjeve me short në prokurori)”.*

<sup>234</sup> Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Mat, Korçë, Gjirokastrë.

<sup>235</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë.

<sup>236</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**në funksion të evidentimit të fakteve nëse ka patur vonesa apo zbatim të gabuar të legjislacionit procedural në fuqi në drejtim të cenimit të lirisë individuale të individit.**

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për shkak të praktikës jo të plotë<sup>237</sup> në përgjithësi të vënë në dispozicion nga zyrat e prokurorive, nuk mund të konkludohet për çdo praktikë ekzekutimi me rastin e vendimeve të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Referuar dokumentacionit të ekzekutimeve të vendimeve penale me objekt “lirim me kusht”, të dërguar nga zyrat e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore konstatohet se në rast të pranimit të kërkesës për lirim me kusht nga gjykata e rrethit gjyqësor, është proceduar si rregull nga prokurori me nxjerrjen e urdhërit për lirimin e menjëhershëm të kërkuarit/të dënuar nga IEVP. Urdhëri i prokurorit mbi lirimin e personit mban të njëjtën datë me vendimin që ka pranuar kërkesën për lirim me kusht.

Për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të lirimit të menjëhershëm, është proceduar si rregull nga prokurori i cili ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës penale “lirim me kusht”. Është për t'u theksuar se nga 1 gjyqtar<sup>238</sup> në rastet kur dispononte me pranim kërkesë, është proceduar edhe me nxjerrjen e urdhërit për lirim të menjëhershëm, i cili i dërgohej zyrës së prokurorisë, që nga ana e saj me anë të një shkrese e përcillte pranë IEVP, Shërbimit të Provës, të dënuarit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Urdhëri përmban dispozitivin për lirimin e kërkuarit.

Në rastet kur është Gjykata e Apelit e cila ka vendosur lirimin e kërkuarit, pasi ka vlerësuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, për ekzekutimin janë evidentuar ndjekje të praktikave të ndryshme nga zyrat e prokurorive.

Njëra praktikë konsiston në procedimin si rregull me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimi për lirim të menjëhershëm nga prokurori i apelit që ka marrë pjesë në gjykim. Këtë praktikë e gjejmë për të gjithë periudhën e inspektimit tek zyrat e prokurorive të Apeleve Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë si dhe për periudhën 2018 – në përfundim të periudhës së inspektimit në zyrat e prokurorive të Apeleve Korçë dhe Durrës.

Praktika tjetër, e ndjekur nga Prokuroria e Apelit Vlorë konsiston në procedimin si rregull me dërgimin e vendimit për ekzekutim në Zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor e cila nxjerr urdhërin përkatës drejtuar IEVP-së për lirim dhe më pas edhe institucioneve të tjera të ngarkuara me ekzekutim, ndërsa në 1 rast urdhëri i ekzekutimit i është dërguar nga prokuroria e Apelit në IEVP për ekzekutim. Në dy raste të vendimit të pranimit për lirim me kusht nga Gjykata e Apelit<sup>239</sup>, evidentohet se është nxjerrë urdhër ekzekutimi nga zyra e prokurorisë së

<sup>237</sup> Dokumentacioni i sjellë nga zyrat e prokurorive nuk është i plotë në drejtim të të gjithë akteve që pasqyrojnë ekzekutimin për çdo rast. Dokumentacioni në fjalë nuk është shoqëruar me inventarizimin përkatës.

<sup>238</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>239</sup> vendimi nr. 74, datë 07.02.2019 dhe nr. 366, datë 13.06.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë që kanë ndryshuar vendimet e rrëzimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

rrethit gjyqësor që për aq sa rezulton nga akti përkatës mban datën e nesërme të shpalljes së vendimit dhe që për të cilat për shkak të konstatimit në përgjithësi të praktikave të paplota të lidhur me mënyrën e administrimit të akteve përkatëse të një praktike ekzekutimi vlerësohet verifikimi përkatës lidhur me veprimtarinë e magjistratëve.

Referuar akteve ligjore<sup>240</sup> që rregullojnë Institutin e lirit me kusht dhe të ekzekutimit të vendimeve penale, në fuqi në kohën e kryerjes së inspektimit, është e qartë se vendimi i pranimit të lirit me kusht për shkak se disponon urdhërimin e lirit nga masat penale që kufizon lirinë personale të të dënuarit, edhe pse nuk ka marrë formë të prerë, është menjëherë i ekzekutueshëm. Ky është interpretimi që konstatohet në mënyrën e të proceduarit si rregull edhe nga zyrat e prokurorive në rastet e praktikave të ekzekutimit objekt i këtij inspektimi.

Për mënyrën e të proceduarit, ligji për ekzekutimin e vendimeve penale i kohës, për periudhën e inspektimit në fjalë, kishte parashikuar nxjerrjen, pas urdhërimin për lirim të menjëhershëm nga gjykata në dispozitivin e vendimit, të një urdhëri ekzekutimi nga ana e prokurorit në cilësinë e organit që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale. Legjislatori me ndryshimet e ligjit për ekzekutimet me ligjin nr. 80/2018, datë 27.11.2018<sup>241</sup> ka parashikuar shprehimisht prokurorinë pranë gjykatës të shkallës së parë që ka dhënë vendimin, si organi që ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit dhe që duhet të nxjerrë urdhërin e ekzekutimit. Dhe për këtë ka parashikuar detyrimin e drejtuesit të prokurorisë së apelit dhe prokurorëve që kanë marrë pjesë në gjykim pranë gjykatës së apelit apo Gjykatës së Lartë, që menjëherë pas administrimit, t'i paraqesin zyrtarisht dispozitivin e vendimit penal prokurorisë përkatëse të shkallës së parë që ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit penal. Të njëjtin parashikim e gjejmë edhe në ligjin aktual për ekzekutimin e vendimeve penale<sup>242</sup>. Parashikimet ligjore në fjalë, janë të qarta në drejtim të përcaktimit të prokurorisë së ngarkuar me ekzekutimin e vendimit penal dhe mënyrën e komunikimit të zyrave të prokurorive midis tyre për të proceduar me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit. Për rrjedhojë, edhe praktika që duhet të ndjekin zyrat e prokurorive në drejtim të ekzekutimit të vendimit të pranimit të “lirim me kusht”, duhet të jetë e njëjtë.

Për ekzekutimin si një hallkë përmbyllëse e një procesi ndaj një të dënuari dhe shumë e rëndësishme në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, legjislatori ka parashikuar në një ligj të veçantë për ekzekutimin e vendimeve penale edhe dokumentimin e kësaj faze, me mbajtjen e një evidence të veçantë për vendimet në ekzekutim dhe për të gjitha faktet e

---

<sup>240</sup> Nenet 462/2 dhe 417/2 të K. Pr. Penale dhe neni 21 i ligjit nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Ligji i veçantë, referuar periudhës së këtij inspektimi, ligji për ekzekutimin e vendimeve penale me nr. 8331, datë 21.04.1998, i cili ka pësuar disa ndryshime me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008 hyrë në fuqi më datë 15.01.2009<sup>240</sup>, me ligjin nr. 80/2018 “Për ndryshimin e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale me nr. 8331, datë 21.04.1998” hyrë në fuqi më datë 20.12.2018<sup>240</sup> dhe shfuqizuar me ligjin nr. 79/2020 hyrë në fuqi më datë 05.08.2020<sup>240</sup> aktualisht në fuqi.

<sup>241</sup> Neni 13, paragrafi 3.

<sup>242</sup> Nenet 10, 11, 12 paragrafi 3.

ndodhura gjatë ekzekutimit<sup>243</sup> - sipas ligjit të kohës kur është kryer inspektimi në fjalë/mbajtjen e një dosjeje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit<sup>244</sup> - sipas ligjit aktual. Referuar këtij parashikimi ligjor, vlerësohet e rëndësishme dokumentimi i të gjitha veprimeve të kryera gjatë fazës së ekzekutimit, i cili duhet të jetë i inventarizuar nga personat përgjegjës të ngarkuar ndër të cilët edhe prokurori që merret me ekzekutimin. Kjo do të mundësonte evidentimin e qartë dhe të plotë të të gjitha fakteve të ndodhura nga fillimi i ekzekutimit deri në përfundimin e tij, dhe si e tillë edhe konkludimin në drejtim të cënimit të lirisë së individit i cili i është nënshtruar procedurave të ekzekutimit të një vendimi penal.

#### IV. Konkluzionet

- Të gjitha kërkesat me objekt “lirim me kusht” të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore janë të paraqitur nga kërkues në cilësinë e personave të dënuar me burgim për kryerjen e krimeve të ndryshme, nga të cilët 4 prej tyre janë paraqitur nga të dënuar të cilët kanë qenë duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm.
- Me paraqitjen e kërkesave në gjykatat e rretheve gjyqësore është proceduar me regjistrimin e tyre, dhe më pas si rregull me hedhjen në short elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të merrej me gjykimin. Kjo procedurë nuk është ndjekur njëjloj nga të gjitha gjykatat objekt i këtij inspektimi, me rastin e ndryshimit të gjyqtarit për shkaqe që lidhen me gjykimin/vendimmarrjen me një vendim jopërfundimtar nga një gjyqtar tjetër të një kërkesë të mëparshme me të njëjtin objekt nga i njëjti kërkues. Për këto raste, nga disa gjykata është proceduar me ndjekjen e rregullit të përgjithshëm për shortimin elektronik dhe nga disa të tjera, në rastet e evidentuara si të riparaqitur nga i njëjti kërkues, është proceduar me caktimin e gjyqtarit që kishte disponuar me vendim jopërfundimtar.

Referuar rasteve të shqyrtimit të kërkesave të përsëritura nga i njëjti kërkues, evidentohen dy raste ku është vënë re mosprespektimi i zbatimit të nenit 477/2 të K. Pr. Penale për të cilat është vlerësuar kryerja e verifikimeve përkatëse në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë.

Procedura e shortimit elektronik është ndjekur edhe në caktimin e gjyqtarit relator në Gjykatat e Apeleve të cilat kanë shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me kërkesat “lirim me kusht”.

<sup>243</sup> Sipas parashikimeve të nenit 12 të ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar në fuqi në periudhën objekt inspektimi.

<sup>244</sup> Sipas përcaktimeve të nenit 11/2, të ligjit nr. 79/2020 aktualisht në fuqi.




Aktualisht procedura e ndarjes së çështjeve, është rregulluar sipas vendimit të KLGJ nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”. Në këtë vendim kanë gjetur rregullim edhe rastet e të proceduarit lidhur me kërkesat e riparaqitura nga i njëjti kërkues, të konstatuara në këtë raport.

- Për përfaqësimin e prokurorisë në gjykatat e rrethit gjyqësor në gjykimet e kërkesave me objekt “lirim me kusht”, në të gjitha zyrat e prokurorive objekt i këtij inspektimi, nuk është proceduar me caktimin e prokurorit me anë të shortit elektronik. Procedura e ndjekur në zyrat e prokurorive për caktimin e prokurorëve në këto gjykime, është e ndryshme si në drejtim të grupimit të prokurorëve të cilit i përket prokurori i caktuar ashtu edhe në drejtim të mënyrës së të proceduarit për këtë përzgjedhje. Kështu në drejtim të grupimit të prokurorëve është evidentuar se një praktikë është të proceduarit me përzgjedhjen e prokurorit nga prokurorët pjesë e seksionit të ekzekutimeve penale dhe praktika tjetër është të proceduarit nga e gjithë trupa e prokurorëve pjesë e zyrës përkatëse. Në drejtim të mënyrës së të proceduarit për këtë përzgjedhje është evidentuar një praktikë nëpërmjet të proceduarit me anë të shortit manual dhe praktika tjetër e caktimit nga vetë drejtuesi pa ndonjë procedurë të përcaktuar. Gjithashtu përveç praktikave në fjalë, evidentohet edhe praktika e të paracaktuarit e lidhur me qënien si prokuror që ka marrë pjesë në gjykimin e themelit të dënimit të kërkuesit.

Për përfaqësimin e prokurorisë në gjykatat e apeleve ku shqyrtohen ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me kërkesat “lirim me kusht, konstatohet se në të gjitha zyrat e prokurorive objekt i këtij inspektimi është proceduar me caktimin e prokurorit me anë të shortit manual nga trupa e të gjithë prokurorëve që ushtronin detyrën në zyrën përkatëse. Lidhur me këtë mënyrë të proceduarit, janë konstatuar se ka ndryshime ndërmjet zyrave pasi disa procedojnë me shortin manual referuar listës së çështjeve të regjistruar në gjykatë me objekt “lirim me kusht”, ndërsa ka zyrë që procedon me shortimin manual duke iu referuar ndarjes së trupave gjyqësore.

Duke patur në konsideratë parashikimet ligjore sipas ligjit organik të Prokurorisë, aktit nënligjor përkatës lidhur me shpërndarjen e çështjeve me anë të shortit elektronik, të dhënat e konstatuara të mungesës së kësaj procedure në rastet e kërkesave “Lirim me kusht”, si dhe fazës së implementimit të hedhjes së shortit elektronik në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vlerësohet si një çështje që do të duhet të mbahet në ndjekje të vazhdueshme nga ILD, pas përfundimit të këtij inspektimi në kuadër të rekomandimeve.

- Kërkuesi si palë në gjykimet me objekt “lirim me kusht”, jo në të gjitha rastet e gjykimeve ka qenë i përfaqësuar nga një mbrojtës. Kjo është evidentuar në përgjithësi tek gjykimet të cilat kanë përfunduar me mënyrë pushimi, deklarim i papranueshëm/moskompetencë, por që në disa rrethe gjyqësore është evidentuar edhe në vendime themeli.



- Në gjykimet me objekt “lirim me kusht” në gjykatat e rretheve gjyqësore, është evidentuar se nuk është proceduar njëllor në drejtim të pjesëmarrjes në gjykim, të institucioneve të IEVP dhe të Shërbimit të Provës. Nga të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore evidentohet se thirret për të marrë pjesë IEVP, ndërsa thirrjen e Shërbimit të Provës, e evidentojmë tek gjykimet në një gjykatë. Gjithashtu është për t’u evidentuar, se të gjitha gjykatat kanë ndjekur të njëjtën praktikë në drejtim të administrimit të raportit të Shërbimit të Provës, që ashtu si edhe raporti i IEVP janë përdorur si prova në vlerësimin dhe konkludimin në themel të kërkesave me objekt “lirim me kusht”.
- Në gjykimet e zhvilluara në gjykatat e apeleve, evidentohet se disa prej tyre kanë proceduar me thirrjen në gjykim të IEVP, ndërsa nuk rezultojnë të thirret Shërbimi i Provës.
- Gjykatat e rretheve gjyqësore kanë disponuar me pushim, mospranim apo mosshqyrtim për shkak të heqjes dorë/tërheqjes nga kërkesa, edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji për shkaqet në fjalë, në nenin 471/5 parashikohet disponimi “deklarim i papranueshëm”.
- Gjykatat e rretheve gjyqësore, në pjesën më të madhe të rasteve, kanë disponuar me shpallje moskompetence për shkak të ndryshimit të vendit të vuajtjes së dënimit të të dënuarit pas paraqitjes së kërkesës prej tij, e cila në 1 rast është evidentuar se kërkuesi ka ndryshuar sërish vendin e vuajtjes së dënimit edhe pas vendimmarrjes “moskompetencë”. Gjykatat e rretheve gjyqësore në vendimmarrjet e tyre, janë mbështetur në argumentim bazuar në nenin 477 të K. Pr. Penale dhe në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale në fuqi në kohën e vendimmarrjes.

Gjykata e Lartë në më shumë se një vendim, ka shprehur qëndrimin e njëjtë sipas të cilit është momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë që përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit në shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit, kompetencë që nuk mund të ndryshojë sa herë ndryshon vendi i vuajtjes së dënimit me burgim të kërkuetit, sipas IEVP-së përkatëse.

- Gjykatat e rretheve gjyqësore, në përgjithësi, në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”, evidentohet se kanë ndjekur dy praktika në mënyrën sesi përlllogaritet kjo periudhë: një praktikë konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është i dënuari dhe praktika tjetër konsiston në interpretimin e

dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata.

Në ndjekjen e këtyre praktikave, referuar vendimeve gjyqësore rezulton se gjyqtarët mbështeten në të njëjtën bazë ligjore, por duke konkluduar ndryshe, pa ndonjë analizë/arsyetim konkret, lidhur me referimin përkatës. Praktika e parë rezulton të jetë ndjekur nga pjesa më e madhe e gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore. Ndjekja e dy praktikave, nga gjykatat e rretheve gjyqësore nuk është bërë objekt ankimi nga prokurorët e rretheve gjyqësore dhe nga vendimmarrjet e të gjithë gjykatave të apeleve nuk vihet re ndonjë qëndrim i qartë në këtë drejtim. Nga këto vendimmarrje të gjykatave të apelit, evidentohet se ka trupa gjykatash të cilat përdorin arsyetim të qartë lidhur me praktikën që ndiqet, duke u ndalur në mënyrë konkrete në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita, ndërsa ka trupa të tjerë të cilët nuk shprehen saktësisht lidhur me interpretimin që ndjekin, por që pranojnë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor që ka pranuar përlllogaritjen përkatëse në të dy praktikat.

Referuar praktikave sa më sipër, aktualisht është vetëm një vendim i Gjykatës së Lartë, ku kolegji ka mbajtur qëndrimin e ndjekjes së praktikës së përlllogaritjes referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata.

- Tre gjyqtarë të dy gjykatave të rretheve gjyqësore kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me interpretimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit, të parashikuar në nenin 65 të K. Penal. Këto qëndrime janë hasur në trajtimin e kërkesave të 4 kërkuessve të dënuar me burgim të përjetshëm. Dy gjyqtarë të dy gjykatave të ndryshme kanë mbajtur qëndrimin e referimit tek dispozitat e nenit 65 të K. Penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, që parashikonte si kohë minimum periudhës prej 25 vitesh burgim që i dënuari duhet të kishte vuajtur për të patur mundësi përfitimin e lirimit me kusht, në rast të plotësimit edhe të kriterëve të tjera. Gjyqtari tjetër, i njërit prej dy gjykatave të gjyqtarit që ka mbajtur qëndrimin e sipërtrajtuar, ka mbajtur qëndrimin e referimit tek dispozita në fuqi në kohën e paraqitjes/shqyrtimit të kërkesës, që parashikonte periudhën prej 35 vitesh burgim si kohë minimum të vuajtjes së dënimit.

Lidhur me qëndrimet sa më sipër, një gjykatë e apelit që ka shqyrtuar deri më tani në themel ankimin ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor që kishte disponuar me pranim, duke iu referuar nenit 65 të K. Penal para ndryshimeve, nuk e ka gjetur të bazuar në ligj. Ky qëndrim është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë e cila duke konkluduar se gjykata do të duhet të zbatojë ligjin që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke zbatuar kushtet dhe kriteret që kërkon dispozita penale konkrete dhe duke e konsideruar jashtë logjikës juridike që për lirimin me kusht të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, pasi instituti i lirimit me kusht nuk ka lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale.

- Gjykatat e rretheve gjyqësore në përgjithësi në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit në drejtim të kohës referuar datës së paraqitjes së kërkesës, evidentohen se kanë mbajtur dy qëndrime. Njëri sipas të cilës përlllogaritja e kohës së

vuajtjes së dënimit duhet të përfshijë vetëm periudhën kohore deri në datën e paraqitjes së kërkesës dhe tjetra se në këtë përlllogaritje përfshihet jo vetëm periudha deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudha në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës. Nga vendimet gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, konstatohet se në pjesën më të madhe nga gjyqtarët mbahet qëndrimi i dytë.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet e prokurorëve ndaj vendimeve të pranimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt "lirim me kusht", ku ndër të tjera nga ana e prokurorëve është pretenduar për mospërbushje të kushtit të plotësimit të kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. Madje në tre prej vendimeve është analizuar mbi mbështetjen e qëndrimit sipas të cilit përlllogaritja e dënimit minimum të vuajtur do të shtrihet përgjatë periudhës së gjykimit deri në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar.

Nga vendimet e Gjykatës së Lartë, kolegje të ndryshme që kanë shqyrtuar vendimet objekt të këtij inspektimi, evidentohen të dy qëndrimet sa më sipër.

- Në kohën minimum të përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të lirit me kusht, referuar vendimeve gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore të trajtuara, evidentohet se në përgjithësi gjyqtarët përfshijnë përveç kohës së përfituar me paraburgim dhe kohës së uljes së dënimit me vendim gjyqësor, edhe ato të përfituar për shkak të punës së kryer në IEVP.

Veçanarisht një gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në 1 vendim që ka qenë i vetmi ku kërkesi ka patur kohë pune në IEVP, ka mbajtur qëndrimin e mospërfshirjes së kohës së kryer në IEVP. Në këtë gjykatë janë trajtuar kërkesat edhe të 3 kërkesëve të tjerë nga 2 gjyqtarë të tjerë të cilët kanë përfshirë kohën e punës në përlllogaritjen e kohës minimum të dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal. Gjykata e Apelit Korçë në të gjitha rastet të cilët janë bërë objekt shqyrtimi për shkak ankimi në drejtim të kohës së punës, ku përfshihet edhe vendimi i gjyqtarit që ka mbajtur qëndrimin e mospërfshirjes së kohës së punës së kryer në kohën minimum të vuajtjes së dënimit, ka pranuar qëndrimin se kjo kohë pune duhet të përfshihet.

Përsa i përket qëndrimit të gjykatave të apeleve të tjera, nuk konstatohet të ketë patur shkaqe ankimi në drejtim të kohës së punës si përfitim në përlllogaritjen e vuajtjes së dënimit me burgim, por nga vendimmarrjet e këtyre gjykatave nuk ka një qëndrim ndryshe për rastet e shqyrtimit të ankimit ndaj vendimeve të rretheve gjyqësore ku kërkesi ka patur kohë pune të kryer dhe është përlllogaritur në kohën minimum të vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal.

Përsa i përket prokurorëve, konstatohet se 2 nga 4 prokurorë në Zyrën e Prokurorisë

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të gjithë prokurorët në Zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kanë patur të njëjtin qëndrim për mospërfshirje si përfitim të kohës së punës së kërkuesit në IEVP. I njëjti qëndrim është përkrahur edhe nga prokurorët e pelit të Prokurorisë së Apelit Korçë, referuar rasteve për të cilat është bërë ankim, ndonëse ky qëndrim nuk është pranuar nga asnjë prej trupave gjyqësore që kanë gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë.

Për shkak të rekursit të prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Korçë, dy raste rezultojnë të jenë shqyrtuar nga i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë, që ka pranuar qëndrimin e prokurorëve për mospërfshirje të kohës së punës në përlogaritjen e kohës minimum të vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të nenit 64 të K. Penal.

- Gjykatat e rretheve gjyqësore kanë qëndrime të ndryshme në drejtim të interpretimit të kushtit ndalues “përsëritës” të parshikuar në nenin 64/3 të K. Pr. Penal në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuar parashikimeve të nenit 69/a të Kodit Penal. Qëndrime të ndryshme në këtë drejtim ndeshen edhe midis prokurorëve. Gjykatat e apeleve në rastet kur kanë shqyrtuar ankimet në drejtimin në fjalë, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim sipas të cilit për përcaktimin nëse kërkuesi është në kushtet e të qenit “përsëritës” referuar parashikimeve të nenit 64/2 të K. Penal, do të merret në konsideratë edhe instituti i rehabilitimit të dënimit të mëparshëm të kërkuesit. Për këtë qëndrim, megjithë rekursit e ushtruara nga ana e prokurorit, nuk ka një vendimmarrje të Gjykatës së Lartë.
- Midis gjyqtarëve të dy gjykatave të rretheve gjyqësore, dhe të një gjykate janë evidentuar qëndrime të ndryshme në drejtim të interpretimit të ligjit material që do të zbatohet në rastin e kërkuesit të dënuar për një krim për të cilën në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në momentin e fillimit të vuajtjes së dënimit nuk përbënte ndalim për të përfituar lirim me kusht. Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, që ka ndryshuar vendimin e pranimit të 1 gjyqtari me qëndrim ndryshe nga 2 gjyqtarët e tjerë, në drejtimin sa më sipër, ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit sipas të cilit në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal gjen zbatim dispozita penale materiale që është në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit dhe se pas shfuqizimit të normës që parashikonte veprën penale për të cilën është dënuar kërkuesi nuk ka patur si qëllim dekriminalizimin e kësaj vepre penale, por me ndryshimet ligjore janë krijuar norma të reja ku parashikohet në veçanti figura e krimit për të cilën është dënuar kërkuesi dhe e cila është përfshirë aktualisht edhe në ndalesat e parshikuar nga neni 64/3 i K. Penal.
- Gjykatat e rretheve gjyqësore në rastet e pranimit të kërkesës “lirim me kusht”, mbajnë qëndrime të ndryshme në përcaktimin e kohës së kushtit/provës. Koha e kushtit rezulton të jetë e barabartë me periudhën e kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit, më e madhe sesa koha e mbetur e pavuajtur e dënimit ku përfshihet edhe përcaktimi si dyfishi i kësaj periudhe, si dhe më e vogël sesa periudha e mbetur e pavuajtur e dënimit. Këto



qëndrime i gjejmë tek gjyqtarë të ndryshëm, por edhe tek të njëjtët gjyqtarë, përgjatë gjithë periudhës objekt i këtij inspektimi.

Lidhur me përcaktimin e periudhës së kohës së kushtit, jo në të gjitha vendimet gjyqësore ka argumentim. Argumentimin e gjejmë kryesisht tek rastet kur kjo kohë kushti është përcaktuar e barabartë me periudhën e kohës së mbetur të pavuajtur të dënimit duke u mbështetur tek vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2015, dhe në disa raste kur periudha e kushtit përcaktohet sa dyfishi i kësaj periudhe të mbetur të pavuajtur të dënimit duke u mbështetur në nenin 59 të K. Penal.

Përsa i përket qëndrimit të gjykatave të apeleve, evidentohet se në dy raste kur shkak i ankimit ka qenë në drejtim të kohës së provës të përcaktuar sa dyfishi në një rast dhe të barabartë me kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit, qëndrimi ka qenë i njëjtë me atë të mbajtur nga gjykatat e rretheve gjyqësore që kishin disponuar me praktika të ndryshme.

- Referuar vendimeve gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit objekt i këtij inspektimi, konstatohet se jo në të gjitha rastet kur është pranuar kërkesa për “lirim me kusht”, është proceduar edhe me përcaktimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal.

Nga vendimet gjyqësore në fjalë, është evidentuar vetëm në 1 rast kur shkak i ankimit ndër të tjera ka qenë edhe ai i mospërcaktimit të një detyrimi për kërkuesin të cilit i është pranuar kërkesa për lirim me kusht. Në këtë rast, rezulton se Gjykata e Apelit ka proceduar me plotësimin e dënimit duke përcaktuar detyrimet sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal. Në të gjitha vendimet e të gjitha gjykatave të apeleve që kanë lënë në fuqi vendimet e pranimit, për të cilat nuk janë parashikuar detyrime sipas nenit 60 të K. Penal, nuk ka evidentim nga kjo gjykatë në vendimmarrjen e saj, lidhur me këtë pikë.

Duke patur në konsideratë detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 60 të K. Penal dhe konstatimet sa më sipër lidhur me zbatimin e saj, vlerësohet si një çështje që do të duhet të mbahet në ndjekje të vazhdueshme nga ILD, pas përfundimit të këtij inspektimi në kuadër të rekomandimeve.

- Dokumentacioni i dërguar nga zyrat e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore objekt i këtij inspektimi, në përgjithësi nuk është shoqëruar me inventarizimin përkatës, për të konkluduar lidhur me plotësimin e të gjitha akteve të përpiluara dhe evidentimit të të gjitha fakteve të ndodhura gjatë fazës së ekzekutimit.
- Referuar dokumentacionit të ekzekutimeve të vendimeve penale me objekt “lirim me kusht”, të dërguar nga zyrat e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore konstatohet se në rast të pranimit të kërkesës për lirim me kusht nga gjykata e rrethit gjyqësor, është proceduar si rregull nga prokurori i seancës me nxjerrjen e urdhërit për

lirimin e menjëhershëm të kërkuarit/të dënuar nga IEVP në të njëjtën datë me vendimin e gjykatës që ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm.

Në rastet kur është Gjykata e Apelit e cila ka vendosur lirimin e kërkuarit, pasi ka vlerësuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, për ekzekutimin janë evidentuar ndjekje e praktikave të ndryshme nga zyrat e prokurorive. Njëra praktikë konsiston në nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit nga prokurori i apelit dhe tjetra, kur urdhëri i ekzekutimit është nxjerrë nga prokurori i zyrës së prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin e ndryshuar. Urdhërat e ekzekutimit për lirimin e menjëhershëm, referuar dy praktikave të ndjekura si rregull janë nxjerrë në të njëjtën datë me vendimin e Gjykatës së Apelit që ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm. Në 2 raste të nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit nga prokurori i zyrës së prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, është evidentuar se mbajnë datën e nesërme të shpalljes së vendimit që ka pranuar kërkesën për lirim me kusht dhe për këtë dy raste për shkak edhe të konstatimit në përgjithësi të praktikave të paplota lidhur me mënyrën e administrimit të akteve përkatëse të një praktike ekzekutimi është vlerësuar verifikimi përkatës lidhur me veprimtarinë e magjistratëve të përfshirë në këto praktika ekzekutimi.

## V. Rekomandimet

### **Për prokuroritë subjekte të inspektimit:**

Raporti i inspektimit t'u njoftohet të gjitha prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me praktikën më të mira të identifikuar dhe problematikën e konstatuar në respektimin e ligjit material dhe procedural lidhur me trajtimin e kërkesave "lirim me kusht".

### **Për Prokurorin e Përgjithshëm**

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm, si autoriteti që ka përgjegjësi për punën e prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, pjesë e të cilave ishin subjektet e këtij inspektimi, dhe ka në kompetencën e tij nxjerrjen e udhëzimeve për përgjithshme për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale.

Në përmbushje të kompetencave të parashikuar në ligjin organik, të vlerësohet unifikimi i praktikës së ndjekur nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me caktimin e prokurorit përfaqësues të prokurorisë në gjykimet e kërkesave "Lirim me kusht", në drejtim të grupimit përkatës të prokurorëve midis të cilëve do të zhvillohet procedura për shpërndarjen e kërkesave me objektin në fjalë.

### **Për gjykatat subjekte të inspektimit:**

Raporti i inspektimit t'u njoftohet të gjitha gjykatave të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim diskutimin në mbledhjen e përgjithshme



të gjyqtarëve të praktikave të identifikuar dhe problematikave të konstatuara në respektimin e ligjit material dhe procedural lidhur me trajtimin e kërkesave “lirim me kusht”.

### **Për Gjykatën e Lartë**

Raporti i këtij inspektimi t’i njoftohet Gjykatës së Lartë në kuadër të vlerësimit të çështjeve të regjistruara mbi bazë rekursi që kanë objekt “lirim me kusht”, për zhvillimin/njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore në drejtim të:

- i. përcaktimit të periudhës kohore referuar datës së paraqitjes së kërkesës “lirim me kusht”/datës së gjykimit që do të merret në konsideratë në përlllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, për efekte të përfitimit të lirimit me kusht.
- ii. përcaktimit të mënyrës së interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 i K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni”, referuar qëndrimeve të konstatuar - sipas dënimit të dhënë nga gjykata apo dënimit që parashikon dispozita penale për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi.
- iii. lidhur me përfshirjen e kohës së punës në përlllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur e cila i jep mundësi kërkuetit të përfitojë lirimin me kusht;
- iv. interpretimit të kushtit ndalues “përsëritës” të parshikuar në nenin 64/3 të K. Pr. Penal në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuar parashikimeve të nenit 69/a të Kodit Penal.
- v. përcaktimit të kohës së kushtit.

### **Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

Raporti i këtij inspektimi t’i njoftohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për t’u patur në konsideratë veprimtaria e prokurorëve, gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 në drejtim të respektimit të ligjit material dhe procedural gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.

### **Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Raporti i këtij inspektimi t’i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, për t’u patur në konsideratë veprimtaria e gjyqtarëve gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 në drejtim të respektimit të ligjit material dhe procedural gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.

### **Për Shkollën e Magjistraturës**

Raporti i këtij inspektimi t’i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, me qëllim që të bëhen pjesë e kurrikulave të trajnimit vazhdues të prokurorëve dhe gjyqtarëve, çështjet lidhur me zbatimin e legjislacionit material dhe procedural të institutit të “lirim me kusht” në drejtim të problematikave të evidentuar në:

- i. interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal “- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të



katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni” dhe në drejtim të shtrirjes së periudhës referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

ii. përfitimeve që përfshihen në përllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit;

iii. kushteve ndaluese “të mos qënurit përsëritës të të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara”;

vi. interpretimin në mënyrë komplementare të parashikimeve të nenit 64 të K. Penal edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm.

vii. përcaktimit të kohës së kushtit;

### **Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë**

Ndjekja në vazhdimësi të problematikës së evidentuar në zyrat e prokurorive në drejtim të mosproceduarit me anë të shortit elektronik për caktimin e prokurorit përfaqësues në gjykimet e kërkesave “Lirim me kusht”.


Ndjekja në vazhdimësi e problematikës së evidentuar të mospërcaktimit të detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K. Penal, në rastet kur nga ana e gjykatës disponohet me pranimin e kërkesës “lirim me kusht”.

Referuar gjetjeve në këtë raport, vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit me nr. 96/2016. Për këto raste<sup>245</sup>, sipas një raporti të veçantë të përgatitur nga inspektorët ku trajtohet hollësisht secili rast në kuadër të evidentimit të shkeljes disiplinore konkrete, është sugjeruar:

i. fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit me nr. 97/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për një magjistrat gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për një magjistrat gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, për një magjistrat gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për një magjistrat gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për një magjistrat prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për një magjistrat prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për një magjistrat prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Berat, për një magjistrat prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për një magjistrat prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë, për periudhën objekt i këtij inspektimi.

---

<sup>245</sup> Fakte sipas terminologjisë së përdorur në nenin 120/1/b të ligjit nr. 96/2016.



## Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

### PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik, datë 28.12.2023, të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.
2. Caktimin e periudhës nga data 01.04.2024 deri në datën 01.10.2024, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohen Gjykatat e Rrethit Gjyqësor (të emërtuara të tilla në periudhën e inspektimit): Shkodër<sup>246</sup>, Lezhë<sup>247</sup>, Tropojë<sup>248</sup>, Kukës<sup>249</sup>, Durrës<sup>250</sup>, Elbasan<sup>251</sup>, Kavajë<sup>252</sup>, Tiranë<sup>253</sup>, Krujë<sup>254</sup>, Mat<sup>255</sup>, Fier<sup>256</sup>, Berat<sup>257</sup>, Vlorë<sup>258</sup>, Korçë<sup>259</sup>, Gjirokastrë<sup>260</sup> dhe Gjykatave të Apelit<sup>261</sup>: Durrës, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër dhe Gjirokastrë, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.
4. Të njoftohet Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Shkolla e Magjistraturës, me Raportin e Inspektimit, duke iu dërguar një kopje të këtij raporti

### INSPEKTORËT

Znj. Elena Pelushi, znj. Joana Asimi, znj. Alma Tafani, znj. Lindita Male,

Z. Julian Zonja

<sup>246</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

<sup>247</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

<sup>248</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

<sup>249</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

<sup>250</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

<sup>251</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

<sup>252</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

<sup>253</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

<sup>254</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

<sup>255</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

<sup>256</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

<sup>257</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

<sup>258</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

<sup>259</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

<sup>260</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë

<sup>261</sup> Aktualisht për shkak të riorganizimit ekziston vetëm Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm